

Fjala e Avokatit të Popullit

**Zoti Kryetar i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë
Të nderuar deputetë,**

Duke e kuptuar funksionin e Avokatit të Popullit, para së gjithash si mandat të deleguar nga Kuvendi, për mbikqyrje të performancës të administratës publike në funksion të mirëqeverisjes, kam nderin dhe përgjegjësinë të vij sot për të raportuar për veprimtarinë e institucionit që më keni besuar të drejtoj gjatë vitit 2003.

Shqipëria ndodhet në vitin e dytë pas hapjes së negociatave për nënshkrimin e Marrëveshjes së Asocim Stabilizimit me Bashkimin Europian. Edhe sikur data e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje të afrohej përmes një vullneti politik panevropjan, topografia e problematikave të shumta ekonomike, sociale, politike apo qoftë edhe vetëm e kompleksitetit të të drejtave të njeriut do ta vinte Shqipërinë nën shokun që mund të pësojë një besimtar i bindur, por fizikisht i dobët, teksa sulet me të tjerë për të kapur kryqin e pagëzimit në ujërat e akullta.

Kësisoj, çdo përpjekje për të përmirësuar mirëqeverisjen, Avokati i Popullit e sheh edhe si sfidë të tij për të avancuar integrimin e vendit tonë në Bashkimin Evropian. Sistemi ligjor transparent, pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje, proceset e rregullta ligjore, kodet e etikës së punonjësve të të tre pushteteve, e sidomos zbatimi i vendimeve të gjykatës, nuk janë nocione abstrakte, por një realitet që na fton për të punuar të gjithë sëbashku, pavarësisht se cila forcë politike do të jetë në krye të qeverisjes kur t'i bashkohemi Europës.

Avokati i Popullit, si një institucion ndërmjetësues midis qytetarit dhe administratës publike shqiptare, suksesin nuk e shikon aq tek performanca e tij dhe vetëm e tij, por tek sinergjite e të tëra institucioneve të shtetit dhe të shoqërisë civile, produkti i të cilave është rritja e cilësisë së jetës në vend, forcimi i autoritetit të shtetit dhe pozicionit të vendit tonë në Evropën e vlerave dhe standarteve demokratike perendimore.

Pikërisht, për arësyet e mësipërme, sikundër del nga analizat që bëhen për kushtet që duhet të plotësojë Shqipëria në prag të procesit të parapranimit në BE, një ndër to ka qenë dhe mbetet ngritja dhe konsolidimi i Institucionit të Ombudsmanit.

Nga ana tjetër, mjedisi social, ekonomik dhe politik në Shqipëri do të mbetet gjithmonë terreni i cili do ta transformojë e do të synohet të transformohet nga Avokati i Popullit, në të mirë të përmirësimit të

qeverisjes së vendit. Qëllimi ka qenë e do të ngelet i njëjtë: në rrugën e vlerave demokratike perendimore, pa segregacione mbi baza partiake, por me shpejtësi të ndryshme, secili duke respektuar korsinë e tij.

Duke patur parasysh se çfarë parashikon legjislacioni shqiptar, duke patur parasysh përputhshmërinë e këtij të fundit me legjislacionin European, duke patur parasysh edhe angazhimet e marra nga Shqipëria për t'u asociuar dhe integruar në Bashkimin European, Avokati i Popullit gjen rastin të rikujtojë si gjithmonë obligimin e administrates publike shqiptare për të bashkëpunuar dhe mirëkuptuar çdo rekomandim të Avokatit të Popullit, tek i cili individët mund të drejtohen me ankesat e tyre, zgjidhja e drejtë e të cilave, në fund të fundit, rrit besimin e qytetarit tek shteti i tyre.

Shqipëria tani ndodhet në një fazë, kur lufta kundër korrupsionit, trafikëve njerëzore dhe drogave, përbën sfidën e saj të sigurisë, pa të cilën as që mund të flitet për stabilitet të brendshëm dhe rajonal. Këto sfida kërkojnë jo vetëm punë të madhe nga njerëzit e zbatimit të ligjit, por edhe ndryshime cilësore të legjislacionit penal dhe procedurial kundër krimit të organizuar.

Megjithatë, Avokati i Popullit ndan mendimin se të gjitha kostot që shteti shqiptar do të jetë i detyruar për të paguar pranimin e tij në strukturat evropjane, kurrësesi nuk do të duhet të çënojë liritë themelore dhe të drejtat e njeriut. Avokati i Popullit do të fokusohet edhe më shumë se deri tani tek garantimi i të drejtave sociale ose më saktë të nevojave njerëzore, të shprehura për më shumë mundësi komunikimi, arsimimi, ndriçimi, ngrohjeje, sidomos për pensionistët, fëmijët dhe të gjitha shtresat më të pambrojtura të shoqërisë, të cilat më shumë se kushdo presin nga shteti që të kujdeset për rritjen e cilësisë së shërbimeve publike, me kosto sa më të përballueshme.

Kam nderin të paraqes para këtij Kuvendi të nderuar Raportin e 4-të vjetor, duke mbetur në pritje të vlerësimit tuaj, i hapur për çdo opinion të vlefshëm.

Ju faleminderit

Ermir DOBJANI

Avokati i Popullit

Tirane, Mars 2003

PERMBAJTJA

Fjala e Avokatit të Popullit	1
Përmbajtja	3
Hyrje	6
Prezantim i shkurtër i Raportit	9

KREU i PARE

1. Struktura, organika dhe cilësitë e personelit të zyrës së Avokatit të Popullit	10
2. Mbështetja ndërkombëtare për institucionin	14
3. Buxheti i institucionit për vitin 2003	15
4. Sfidat dhe objektivat e institucionit për vitin 2004 e në vazhdim	16

KREU I DYTE

1. Statistika përmbledhëse e vitit 2003	20
2. Marrëdhëniet me Kuvendin e Shqipërisë	24
3. Marrëdhëniet me Gjykatën Kushtetuese	26
4. Avokati i Popullit dhe të Drejtat e Njeriut në Shqipëri (Opinione të përgjithshme)	31
5. Mbulimi mediatik i Avokatit të Popullit	38
a. Sektori i Pritjes së Popullit	41
b. Ditët e hapura – përvojë për t'u vazhduar	46
6. Marrëdhëniet me Jashtë	47
7. Bashkëpunimi me Institucionet Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut	57
8. Konferenca Kombëtare "Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë në mbrojtje të të drejtave të individëve	59
9. Aktivitete të tjera të Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2003	68

KREU I TRETE

Veprimtaria konkrete e A.P. për ankesat, kërkesat dhe njoftimet, të grupuara sipas institucioneve qeveritare

1.	Këshilli i Ministrave (Qeveria)	71
2.	Ministria e Drejtësisë	82
3.	Avokati i Popullit dhe marrëdhëniet e tij me gjykatat dhe pushtetin gjyqësor	98
4.	Ankesa për Prokurorinë	106
5.	Ministria e Rendit Publik	112
6.	Ministria e Mbrojtjes	140
7.	Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit	145
8.	Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale	154
9.	Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit	164
10.	Ministria e Ekonomisë	178
11.	Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit	182
12.	Ministria e Financave	185
13.	Ministria e Arsimit dhe e Shkencës	189
14.	Ministria e Shëndetësisë	191
15.	Ministria e Punëve të Jashtme	193
16.	Ministria e Transporteve dhe Telekomunikacioneve	195
17.	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	198
18.	Ministria e Mjedisit	199
19.	Ministria e Industrisë dhe Energjitikës	201
20.	Shërbimet Sekrete	204
21.	Përgjithësime në lidhje me ankesat që kanë të bëjnë me konsumatorin	205

KREU I KATERT

1. Në ndjekje të rasteve të prezantuara në Raportin vjetor 2002	207
2. Çështje të filluara me Iniciativën e Avokatit të Popullit ("ex officio)	209

Anekse

1. Vlerësime të institucioneve dhe personaliteteve ndërkombëtare për punën e Avokatit të Popullit	215
2. Letra falenderimi nga qytetarët	219
3. Grafikët	

Hyrje

Të gjithë jemi dëshmitarë se në periudhën pas Luftës së Ftohtë, të drejtat e njeriut u bënë kryefjalë e proceseve demokratizuese, të cilat në dinamikën e tyre sollën nevojën e krijimit të institucioneve të reja, jo vetëm në përgjigje të problematikave të reja, por edhe të transformimit të mentalitetit të institucioneve ekzistuese të shtetit.

Duke avancuar nga të qënit vetëm pjesë e politikës së jashtme, në atë të një mekanizmi integral të politikës së brendshme dhe të legjislacionit kombëtar të të gjitha shteteve, veçanërisht të atyre ish komuniste, të drejtat e njeriut tashmë janë bërë parametër i rëndësishëm, përmes të cilit qeveritë vlerësohen se sa dhe si përmbushin kontratën me qytetarët, thënë ndryshe, me zgjedhësit që i mandatojnë ato.

Në kapërcyell të katër vjetëve që nga krijimi i tij, Institucioni i Avokatit të Popullit funksionon në Shqipëri si pjesë e atij mekanizmi të monitorimit të të drejtave të njeriut, që vetë shteti ka krijuar për t'u dëshmuar qytetarëve se ka aftësinë të vetkorrigjohet. Avokati i Popullit kontribuon në përmirësimin e praktikave të mirëqeverisjes, duke siguruar një mbikqyrje të sjelljes administrative të organeve qeverisëse dhe autoriteteve publike për mënyrën se sa dhe si këta të fundit u shërbejnë taksapaguesve të tyre. Në këtë ndërveprim të përditshëm, objektivi i Avokatit të Popullit është respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të individit, dhe eventualisht rivendosja e së drejtës së tij të shkelur nga nëpunësi i administratës publike.

Praktika e qeverisjes së mirë dhe ndërveprimi i binomit autoritet publik-taksapagues sigurohen nga funksionimi i mekanizmave të pavarur e të paanshëm për të shqyrtuar mënyrën se si ka vepruar Qeveria. Sistemi i kontrollit dhe balancës sot është një parim bazë i qeverisjes moderne në të gjithë botën.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë e ka miratuar institucionin e Avokatit të Popullit, duke përcaktuar vlerat dhe parimet mbi të cilat vepron ky Institucion. Ato janë pavarësia, paanshmëria, profesionalizmi dhe konfidencialiteti.

Tashmë, pas katër vitesh, me modesti deklarojmë se i kemi zbatuar këto parime, të cilat faktikisht janë edhe standarte të nivelit të lartë, mbi bazën e të cilave bëhet vlerësimi i këtij institucioni kudo në botë.

Në perspektivën e integritetit të vendit tonë në Bashkimin Europian, legjislacioni i Komunitetit është i detyrueshëm për secilin Shtet Anëtar. Prandaj ky legjislacion, edhe për kushtet e Shqipërisë, është burim reference edhe për institucionin e Avokatit të Popullit, sidomos për argumentimin e rekomandimeve tona dërguar administratës. Objektivi i përhershëm i Avokatit të Popullit është që të realizohet transparenca e Administratës publike, ashtu siç e kërkon ekologjia e demokracisë.

Ndërmarrjen e vet ndërmjetësuese, Avokati i Popullit e arrin, kryesisht, në bazë të bisedimeve, të paanësisë dhe të standarteve më të gjëra të drejtësisë. Analiza e Ombudsmanit nuk kufizohet vetëm në atë që thonë shpesh dispozitat e thata ligjore. Përtej teknikës legjislative të formulimit të tyre, Ombudsmani shpesh herë shikon edhe qëllimet më të larta të ligjvënësive për të rregulluar raportet mes shtetit dhe individit. Veç kësaj, kjo kërkon edhe një angazhim fisnik të të gjithë stafit të ekspertëve që punojnë me të. Pa një angazhim të tillë, shumë të drejta të shkelura të qytetarit, as nuk do të njiheshin si të tilla, aq më pak të rivendoseshin.

Veçori themelore e institucionit të Avokatit të Popullit, është sidomos efektiviteti dhe forca e rekomandimeve të tij. Është pikërisht kjo “forcë argumentuese” e bazuar në ligj, ajo që e ka bërë shpesh rekomandimin e Avokatit të Popullit, nga formalisht “jo detyrues”, në thelb “bindës për t’u pranuar e për t’u zbatuar”.

Autoritetet publike në nivel qendror dhe vendor duhet të jenë të kujdesshëm dhe kooperues me Institucionin e Avokatit të Popullit. Fakti që ligja i mundëson Avokatit të Popullit ngritjen e problemit si për kryetarin e komunës dhe për ministrin deri në parlament, tregon qartë se instrumenti ynë kryesor, që është Rekomandimi, kur ka brenda argumentin ligjor, ka edhe forcën reale të “imponimit” të butë. Në kushtet kur kjo bëhet me të vetmin qëllim, për të rivendosur të drejtën e shkelur të qytetarit në raport me administratën, rezultati merr edhe më shumë vlerë, sepse para se të jemi shtetarë, policë, prokurorë apo zyrtarë, të gjithë jemi qytetarë.

Në këtë mënyrë të funksionuarit, edhe vetë fakti i ekzistencës së Institucionit të Avokatit të Popullit ka një ndikim pozitiv në administratë, së paku për një arsye të thjeshtë. Kjo e fundit e di se është një palë e tretë që e vëzhgon kryerjen e detyrës së saj në raport me qytetarin. Nga ana tjetër, ne kemi punuar dhe punojmë sipas një strategjie të veçantë që njerëzit ta dijnë se mund të ankohen pranë nesh, përmes një procedure të

lehtë dhe pa shpenzime, për ato vendime, veprime apo mosveprime të administratës, që i konsiderojnë të padrejta ose të pafavorshme për ta.

Në vëndet e tjera ku Ombudsmani ka mirëfunksionuar duke u mirëkuptuar dhe respektuar nga administrata, është bërë e mundur që të ndryshojë pozitivisht imazhi i administratës në publik. Ky është edhe objektivi ynë, të ndihmojmë për ta bërë administratën shqiptare më të përgjegjshme për cilësinë e vendimeve të saj dhe për përgjegjësinë ndaj publikut. Qëndrimi që administrata mban ndaj ndërhyrjeve të Avokatit të Popullit është tregues i përgjegjshmërisë së saj ndaj gabimeve që kryen si edhe i faktit se sa e gatshme është ajo për t'i riparuar ato.

Mirëfunksionimi gjithmonë si Oponencë për Mirëqeverisje, është, ka qenë e do të jetë thelbi i filozofisë së funksionimit të këtij institucioni. Prandaj, veprimtaria jonë, ashtu si edhe deri tani, duhet mirëkuptuar e trajtuar me drejtësi nga të gjitha palët që bëjnë politikën në Shqipëri. Për të gjitha palët Ombudsmani është dhe do të jetë gjithmonë një ndihmës, tek i cili ekipet qeverisëse duhet të mbështeten, për të përmirësuar çdo ditë e më mirë qeverisjen që fitojnë përmes rotacionit të pushteteve.

Prezantimi i shkurter i Raportit

Mbështetur në nenin 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 26 të Ligjit nr.8454 dt.04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, Avokati i Popullit paraqet në Kuvend një Raport Vjetor, i cili diskutohet në seancë plenare.

Pas Raportit të parë të paraqitur në mars 2001 për veprimtarinë e zhvilluar gjatë vitit 2000, Raportit të dytë të paraqitur në mars 2002, për veprimtarinë e zhvilluar gjatë vitit 2001 dhe Raportit të tretë të paraqitur në prill 2003 për veprimtarinë e zhvilluar gjatë vitit 2002, ky është raporti i katërt që përgatit Avokati i Popullit. Edhe në këtë raport kemi ruajtur të njëjtën strukturë të paraqitjes së punës së Institucionit të Avokatit të Popullit me qëllim që lexuesi të orjentohej më lehtë në pjesë të ndryshme që kanë interes për të. Në mënyrën se si është konceptuar, mund të merret një informacion i plotë për metodën e përdorur dhe fushat e veprimtarisë së Institucionit të Avokatit të Popullit, duke përfshirë dhe të dhëna statistikore. Një vend të veçantë në Raport zënë veprimtaritë e zhvilluara nga Institucioni, opinionet për situatën e të drejtave të njeriut në Shqipëri si dhe opinione për përmirësimin e mirëadministrimit të çështjeve publike në Shqipëri. Gjithashtu vend të veçantë në Raport zënë dhe marrëdhëniet publike të Institucionit me Mediat. Bashkëpunimin me Mediat e kemi parë si mjetin më efikas për të siguruar aksesin e nevojshëm në publik dhe krijimin e individualitetit të domosdoshëm të Institucionit, për ushtrimin e funksionit sipas Kushtetutës dhe Ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Ky raport ilustron punën e organeve dhe autoriteteve publike (përfshirë ato qëndrore dhe vendore) në fushën e respektimit të të drejtave të njeriut dhe prezanton zgjidhjet e rasteve, të cilat mendojmë se duhet të shërbejnë si udhërrëfyes për veprimet e organeve përgjegjëse të administratës në situata të ngjashme.

Raporti përmban gjithashtu rekomandime dhe propozime për eliminimin e të metave dhe “padrejtësive”, të cilat janë identifikuar gjatë shqyrtimit të ankesave të paraqitura tek Avokati i Popullit.

Në këtë Raport kemi përfshirë edhe shumë analiza të detajuara për ato raste dhe në ato fusha që sipas këndvështrimit tonë përbëjnë elemente kyç dhe të cilave në të ardhmen do të vazhdojmë t’i kushtojmë vëmendje.

K R E U I P A R E

1. Struktura, organika dhe cilësitë e personelit

Zyra e Avokatit të Popullit funksionon me tre seksione të specializuara bazuar në ligjin nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, neni 31, të cilët ndjekin ankesat e qytetarëve.

Ligji nr. 8600, dt.10.04.2000, “Për disa ndryshime në ligjin 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit””, i jep Avokatit të Popullit të drejtën e përcaktimit të strukturës, numrit të personelit dhe cilësive të tij, kurse pagat janë caktuar me vendim të veçantë të Qeverisë.

Zyra e Avokatit të Popullit funksionon me tre seksione të specializuara, që ndjekin çështjet e ankesave dhe kërkesave, përkatësisht:

Seksioni i parë merret me ankesat dhe kërkesat për organet e administratës qendrore, pushtetit vendor dhe të tretëve që veprojnë për llogari të tyre dhe drejtohet nga z. Gëzim Lleshi.

Seksioni i dytë merret me ankesat dhe kërkesat për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor dhe drejtohet nga z. Jorgo Dhrami.

Seksioni i tretë, ose seksioni i përgjithshëm, trajton çështjet jashtë fushave të mësipërme, ndjek bashkëpunimin me organizatat joqeveritare dhe kryen studime në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ky drejtohet nga z. Riza Poda.

Veç këtyre seksioneve, hallkë tjetër e rëndësishme e strukturës së institucionit është edhe Kabineti, në përbërje të të cilit janë Shefi i Kabinetit dhe këshilltarët, të cilët janë në vartësi direkte nga Avokati i Popullit.

Sektorë ndihmës të cilët ndihmojnë në realizimin e detyrave kryesore të Institucionit janë edhe Drejtoria e Personelit dhe Administratës, Drejtoria e Marrëdhënieve me jashtë, Sektori i Pritjes dhe regjistrimit të ankesave, Sektori i Financës, të cilët janë në varësi të Sekretarit të Përgjithshëm.

Institucioni i Avokatit të popullit ka gjithësej 47 punonjës, numër ky i miratuar nga vetë Avokati i Popullit. Nga këta 16 juristë, ndihmës-komisionerë të cilët merren direkt me zgjidhjen e ankesave.


Ndihmëskomisionerët i janë nështruar konkursit të hapur në zbatim të ligjit nr. 8549, dt.11.11.1999 “Statusi i Nëpunësit Civil”. I gjithë stafi i punonjësve punon për ngritjen e tyre profesionale. Këtë e tregojnë edhe trajnimet e ndryshme që janë kryer gjatë vitit 2003 brënda dhe jashtë vendit.

Me ftesë të Institutit të Trajnimit të Departamentit të Administratës Publike specialistë të Institucionit të Avokatit të Popullit kanë kryer kurse trajnimi me tematika të ndryshme gjatë vitit 2003 dhe janë paisur me çertifikatën përkatëse.

Përsa i përket cilësive profesionale të personelit të zyrës sonë vemë në dukje se Avokati i Popullit mban titullin “Profesor i Asociuar Doktor” dhe z. Jorgo Dhrami mban gradën shkencore “Doktor i Shkencave Juridike”, përveç disa të tjerëve që aktivizohen për mësimdhënie si pedagogë të jashtëm në Fakultetin e Drejtësisë dhe në shkollën e Magjistraturës.

Disa nga ekspertët e zyrës sonë kanë kryer studimet pasuniversitare në Perëndim, 20 prej tyre zotërojnë dhe përdorin mirë një ose më shumë gjuhë të huaja, kryesisht anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht.

STRUKTURA E INSTITUCIONIT TE AVOKATIT TE POPULLIT



ORGANIKA E INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT

Nr.	EMËRTIMI	NËPUNËS
I.	AVOKATI I POPULLIT	(1)
II.	KABINETI Shefi i Kabinetit Zëdhënës i Avokatit të Popullit Këshilltarë të Avokatit të Popullit Sekretare e Avokatit të Popullit	(5) 1 3 1
III.	SEKSIONI I ORGANEVE TË ADMINISTRATËS QENDRORE DHE VENDORE Komisioner Ndihmëskomisionerë (jurist) Sekretare + Rregjistruese	(6) 1 4 1
IV.	SEKSIONI I SHËRBIMEVE TË VEÇANTA Komisioner Ndihmëskomisionerë (jurist) Sekretare + rregjistruese	(8) 1 6 1
V.	SEKSIONI I PËRGJITHSHËM Komisioner Ndihmëskomisionerë (jurist) Sekretare + rregjistruese	(6) 1 4 1
VI.	SEKRETARI I PËRGJITHSHËM	(1)
VII.	DREJTORIA E MARRËDHËNIEVE ME JASHTË Drejtor Përgjegjës i sektorit të përkthimit dhe bibliotekës	(2) 1 1
VIII.	DREJTORIA E PERSONELIT DHE ADMINISTRATËS Drejtor Shef Sektori Shofer Pastrues	(11) 1 1 7 2
IX.	SEKTORI I FINANCËS Shef Sektori Llogaritar i parë, Arkëtar Magaznier	(3) 1 1 1
X.	SEKTORI I PRITJES SE POPULLIT Shef Sektori Ndihmeskomisioner	(2) 1 1
XI.	SEKTORI I SEKRETARISE DHE ARKIVIT Shef Sektori Arkivist+sekretare e Sekretarit të Përgjithshëm	(2) 1 1

Punonjës gjithsej të Institucionit të Avokatit të Popullit janë 47 veta.

2. Mbështetja ndërkombëtare

Nëse ka një vend ku ideja e ombudsmanit erdhi si nevojë imediate e rritjes së besimit të publikut tek institucionet, ai vend është Shqipëria. Mjafton të përmendim kaosin dhe anarkinë e vitit 1997, që mposhtën edhe atë forcë të pritshme që shteti të imponon si i tillë, pasojë e të cilave ishte kolapsi i shtetit, e bashkë me të edhe i institucioneve të tij.

Që nga ky moment, komuniteti ndërkombëtar, i pranishëm qysh në fillimet e proceseve demokratike në vend, duket se kaloi në një skenar tjetër. Jo me ndihmë ekonomike për mbijetesë, jo me ndihma financiare të pakushtëzuara ndaj qeverive shqiptare, por përkundrazi programe zhvillimi për ngritjen dhe forcimin e institucioneve të shtetit shqiptar.

Një kontribut sa i ekspertëve vendas, aq edhe atyre ndërkombëtarë, rezultoi në hartimin e një kushtetute të re, e cila u aprovua me referendum në vitin 1998. Në katër nene të kësaj kushtetute të re u parashikua pikërisht edhe krijimi i institucionit të Avokatit të Popullit. Në shkurt të vitit 1999, Parlamenti shqiptar miratoi edhe ligjin përkatës “Për Avokatin e Popullit”.

Fill pas zgjedhjes së Avokatit të Popullit nga Parlamenti shqiptar, krijohet një forum i quajtur “Grupi i Miqve të Avokatit të Popullit”, ku përfaqësues të organizmave më të fuqishëm ndërkombëtarë si të KE-së, OSBE-së, Ambasadës së Danimarkës, ambasadës Amerikane, Aba Ceeli, por edhe përfaqësues të disa OJQ-ve shqiptare, tashmë me përvojë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, shprehën angazhimin e tyre për të bërë lobing dhe mbështetur ngritjen e institucionit. Natyrisht, garancia më e sigurtë ishte akordimi i një granti financiar nga Qeveria e Mbreterisë së Danimarkës në kuadrin e Programit DANIDA.

Grupi i Miqve të Avokatit të Popullit, në mënyrë periodike është mbledhur në zyrën e Avokatit të Popullit dhe qysh nga fillimi ka ndjekur hap pas hapi ngritjen, forcimin, konsolidimin dhe veprimtarinë praktike të Institucionit, duke dhënë një ndihmë e kontribut të çmuar për mbrojtjen e të drejtave e lirive themelore si dhe forcimin e demokracisë në vendin tonë. E themi këtë, sepse duke ndihmuar Institucionin tonë, në mënyrë direkte ata, institucionet dhe shtetet që përfaqësojnë, kanë ndihmuar proceset demokratike dhe institucionet e reja që janë garante të demokracisë.

Këshilli i Europës, si me anë të personelit të zyrës së tij në Shqipëri, ashtu edhe direkt ka dhënë një kontribut të madh, nëpërmjet ftesave për të marrë pjesë në aktivitete të organizuara me temë të drejtat e njeriut, dërgimit të ekspertëve për ekspertiza, mbështetjes financiare etj. Kontribut

në këtë drejtim ka dhënë edhe Aba Celli, si dhe Ambasada Amerikane, nëpërmjet përfaqësuesit të saj në Grupin e Miqve.

Presionin nderkombëtar për ngritjen e institucioneve demokratike, në vazhden e mbështetjes financiare ndaj Shqipërisë, jemi munduar ta përkthejmë në mënyrën më pozitive në ndihmën e koordinuar me konsulta, rrahje mendimesh, përkrahje nismash, dhe çfarë është më kryesorja, me garanci financiare për këtë institucion të ri, ligji organik i të cilit është një kombinim midis atij Danez dhe Suedeze.

Duke bërë të vetën filozofinë, sipas të cilës ombudsmanët, duke qenë unike në secilin vend, nuk mund të krijohen e konsolidohen ndryshe, përveçse duke shkëmbyer përvojë me njëri tjetrin, Avokati i Popullit ka pritur pranë zyrës së tij një numër prej 12 Ombudsmanësh (homologë të tij) dhe ekspertësh të huaj. Takimet e Ombudsmanëve të huaj me autoritetet më të larta të vendit kanë mundësuar që atyreve tu përcillen mesazhet e duhura, në mënyrë që Institucionit të Avokatit të Popullit në Shqipëri t'i krijohet mjedisi i mjaftueshëm simpatik dhe solidar, në mënyrë që Institucioni të shihet me një sy dashamirës, si nga ana e autoriteteve, ashtu edhe nga ana e opinionit publik, i cili është njohur me anë të mbulimit mediatik që i është bërë këtyre vizitave.

Mbështetja ndërkombëtare ndaj Avokatit të Popullit po punohet që të vazhdojë për vitin 2004 në kuadrin e një programi tjetër, të quajtur FRESTA, po i qeverisë së Mbretërisë së Danimarkës. Përmes tij synohet të nxiten nismat në fushën e bashkëpunimit rajonal me vendet e tjera të Ballkanit. Ndërkohë, Zyra e Avokatit të Popullit është pjesë e programit EUNOMIA, nxitur nga Zyra e homologut grek në bashkëpunim me Drejtorinë e të Drejtave të Njeriut pranë Këshillit të Evropës, në kuadrin e Tryezës së Parë të Paktit të Stabilitetit. Bashkëpunim tjetër kemi parashikuar të realizojmë me programin SIDA, të qeverisë suedeze, në drejtim të ngritjes së një nënseksioni për trajtimin e problemeve të fëmijëve si dhe të problemeve etike të medias në raport me qytetarin.

3. Buxheti i Institucionit për vitin 2003

Për të funksionuar me efikasitet një institucion i ri siç është Avokati i Popullit, kërkohet jo vetëm mbështetje politike, institucionale, potenciale njerzore, por dhe mbështetje financiare. Nga kjo pikëpamje, mbështetja financiare për Institucionin tonë nga Komuniteti Ndërkombëtar dhe pikërisht nga qeveria Daneze nëpërmjet projektit Danida ka qenë prezente, konkrete dhe efektive. Kjo ndihmë ka mundësuar ngritjen dhe forcimin e

Institucionit si dhe krijoi të gjitha mundësitë për realizimin e detyrave. Më datën 30 shtator 2003 ky projekt ka përfunduar. Por, në këtë veshtrim një konceptim i drejtë ka egzistuar edhe nga Kuvendi dhe qeveria shqiptare. Për vitin 2003 Avokatit të Popullit i është dhënë buxheti në shumën 87.039.000 lekë ose 725.000 USD. Ky buxhet për periudhën objekt raportimi është konsumuar në masën 88% e konkretisht:

Nr. Llog.	Emërtimi	Plan lekë	Realizim lekë	Realiz. %
600	Pagat	42.972.000	40.107.721	93 %
601	Sigurim shoqëror	6.857.000	6.807.000	99 %
602	Shp operative	29.000.000	28.148.738	97 %
605	Kuotë anëtarësie	210.000	94.045	45 %
231	Investime	8.000.000	1.559.367	19 %
	Totali	87.039.000	76.716.871	88 %

Investimet nuk u realizuan sepse për dy zyrat rajonale të planifikuara për t'u hapur në Shkodër dhe Gjirokastrë nuk u dha fondi i pagave për personat që do punonin atje.

Përsa i përket shpenzimeve të buxhetit ato janë përdorur për paga punonjësish, dieta brenda dhe jashtë vendit, blerje kancelerie, karburanti, parkim automjesh, shpenzime për energji elektrike, shpenzime telefoni, pritje të delegacioneve të huaja etj.

Në lidhje me kuotat e anëtarësisë në bejmë pagesën në Institutin Europian të Ombudsmanëve, Institutin Nderkombëtar të Ombudsmanëve, dhe Shoqatën e Ombudsmanëve Frankofone. Kjo pagesë është 1.250 USD në vit ose 94.045 lekë.

Deri në shtator të vitit 2003 fondi nga Projekti Danida është përdorur për organizimin e Konferencave Kombëtare, seminareve të ndryshme, trajnime profesionale të stafit, materiale propagandistike (kalendare, postera, fletë palosje), botimi i raportit vjetor 2002, pagesa të internetit, mirëmbajtje të pajisjeve elektronike etj.

4. Sfidat, objektivat e Institucionit për vitin 2004 e në vazhdim

Si institucion i ri, i cili falë bashkëpunimit të sukseshëm me faktorët brenda vendit, por edhe me atë ndërkombëtar, sfida e parë dhe më kryesore e Institucionit të Avokatit të Popullit vazhdon të jetë qëndrueshmëria e tij organizative, profesionale dhe financiare.

Kjo qëndrueshmëri e tij lidhet së pari me pavarësinë e këtij institucioni, të garantuar si virtualisht nga Kushtetuta, ashtu edhe realisht

nga marrëdhëniet e tij me Parlamentin, Qeverinë dhe Gjyqësorin në Shqipëri. Ndërkaq, produkt i drejtpërdrejtë i kësaj pavarësie është paanësia e tij pikërisht në atë moment që Ombudsmani shprehet publikisht mbi bazën e gjetjeve të tij investiguese. Pikërisht në këtë moment një Ombudsman e ka të pashmangshme të shprehë publikisht filozofinë e veprimtarisë së tij, dhe që konkretisht është paanësia dhe profesionalizmi, edhe këto dy sfida të përhershme për Avokatin e Popullit.

Në funksion të sfidave për të ardhmen, do t'i kushtojmë vëmendje të veçantë ndër të tjera këtyre objektivave:

1-Konsolidimit të arritjeve të deritanishme, me synim rritjen e shifrës së efektshmërisë së ndërhyrjeve të Institucionit tonë për zgjidhjen e ankesave të qytetarëve.

2-Bashkëpunimit më efikas me Parlamentin për të informuar për punën dhe realizuar ndryshimet e nevojshme ligjore, në përsosje të të drejtave të njeriut dhe që do të sillnin një efektivitet më të madh të Zyrës së Avokatit të Popullit.

3-Vendosjes së kontakteve më të rregullta dhe më të ngushta me nëpunësit e Administratës Qëndrore dhe Vendore. Çaktimi i përfaqësuesve vendorë të Avokatit të Popullit duhet të realizohet sa më shpejt të jetë e mundur.

4-Vazhdimin të organizimit të ditëve të hapura në mënyrë periodike në zona të ndryshme të vendit, duke zbatuar edhe forma të tjera për t'ju afruar sa më shumë publikut.

5-Ndikimit më të madh për respektimin e të drejtave të njeriut nga të gjithë institucionet shqiptare, që të garantohet demokracia dhe prosperiteti.

6- Vazhdimin të programit për forcimin e kapaciteteve të zyrës, ku përfshihet kualifikimi i mëtejshëm i stafit të Institucionit të Avokatit të Popullit.

7- Qëndresa organizative besojmë se do të ruhet këtë vit përmes zbatimit të projekteve konkurruese në nivel rajonal, në kuadrin e programit FRESTA të Qeverisë së Mbretërisë së Danimarkës.

8- Për 2004 kemi parashikuar një program bashkëpunimi me programin SIDA të Qeverisë së Mbretërisë së Suedisë, me anë të të cilit synojmë të ngremë një nënseksion që do të trajtojë të drejtat e fëmijëve si dhe çështje të etikës së medias në raport me komunitetin.

9- Elementi i mediacionit ngelet një ndër objektivat për racionalizimin e burimeve njerëzore të institucionit, qoftë edhe si njësi e veçantë pranë institucionit. Kjo faktikisht është e kushtëzuar si nga shtesa në numrin e stafit të ekspertëve, që do t'ia kërkojmë autoriteteve shqiptare

për të na e miratuar, ashtu edhe nga trajnimi i kësaj njësie në zyra të tjera homologe që e aplikojnë këtë teknikë të re për ne.

10- Qëndresa financiare mund të vihet në pikëpyetje, pasi shteti shqiptar është i detyruar të ndjekë një politikë të rreptë fiskale, përmes shkurtimit të buxhetit. Ritmet e deritanishme të suksesit, veç përkushtimit të stafit drejtues dhe të specialistëve, janë kushtëzuar në një masë thelbësore edhe nga frekuenca e trajnimeve që ne kemi realizuar, si duke shkuar në zyra homologe, ashtu edhe duke ftuar ekspertë të huaj në Shqipëri. Por në buxhetin e akorduar nga shteti, ne nuk shikojmë, madje as nuk pretendojmë të jemi prioritarë në krahasim me institucionet e tjera shtetërore buxhetore. Nëse ka një moment për t'u shqetësuar, ky është se sa dhe si politika financiare mund të na çënojë në pavarësinë që na njeh Kushtetuta.

11- Mungesa e ambienteve të mjaftueshme për zhvillimin normal të veprimtarisë sonë përbën një element tjetër në vështirësitë infrastrukturore të funksionimit të zyrës. Që në korrik të vitit 2000, kur Qeveria caktoi për ne ambientet (10 zyra), akoma nuk ishin të qarta nevojat që do të kishte Institucioni ynë, për të përmbushur detyrat që ka caktuar Kushtetuta, shoqëria shqiptare si dhe faktori ndërkombëtar.

Por qëndrueshmëria e zyrës ka shtruar si nevojë urgjente shtesa për ambiente pune. Kështu ne nuk kemi ambiente për Arkivin që shtohet çdo ditë, ambiente pune për takime me ankuesit si dhe për mbledhje apo takime me stafin, bibliotekë, zyra për komisionerët (zëvendësit e Avokatit të Popullit, zyra për këshilltarët dhe ekspertët) etj.

Sikundër shihet qartë, sfidat e Avokatit të Popullit janë në përputhje me prioritetet e vendit drejt Procesit të Stabilizim Asocimit me BE-në, konkretisht për forcimin e administratës publike, të çështjeve të drejtësisë dhe ligjit e të tjera që na bëjnë të plotësojmë standartet për ta merituar vendin që na takon në Evropë.

Teksa gjatë këtyre katër vjetëve veprimtari kemi deklaruar se kemi gëzuar jo vetë mirëkuptimin, por edhe angazhimin konkret të Kuvendit dhe Qeverisë Shqiptare për të mbështetur ngritjen dhe konsolidimin e Avokatin e Popullit, si një institucion i tipit modern, që luan një rol të rëndësishëm në proceset demokratike në vend, ne mendojmë se kjo së pari i bën nder gjithë klasës politike në vend.

Këtë e themi pasi realisht deri tani nuk kemi konstatuar që në adresën tonë të ketë patur kritika për njëanësi partiake. Me profesionalizëm të lartë dhe vlerat etike që kemi manifestuar, ne do vazhdojmë në të njëjtën linjë, duke ruajtur ekuilibrin dhe paanësinë politike në çdo rast.

Avokati i Popullit ndan mendimin se krijimi i një mjedisi politiko-social për të garantuar liritë themelore të individit nuk mund të shihet

kurrësesi si sulm ndaj shtetit. Praktikrat pozitive dhe mesazhet e duhura, të shpërndara në popull dhe tek autoritetet publike kanë krijuar atmosferën dhe ndërgjegjësimin e nevojshëm, që qytetarët shqiptarë të përdorin institucionin tonë për mbrojtjen e të drejtave të tyre nga shkeljet e Administratës Publike.

Avokati i Popullit përpiqet me punën e tij të dëshmojë se reforma në administratën publike është e domosdoshme, nëse nuk duam që ligjet e reja të komprometohen nga qendrimit dhe mendësitë e vjetra. Me anë të dialogut midis Institucionit të Avokatit të Popullit, organizatave të të drejtave të njeriut dhe Parlamentit e Qeverisë Shqiptare, ne do vazhdojmë të inkurajojmë autoritetet për të vazhduar përmirësimet të legjislacionit dhe forcuar zbatimin e tij.

Avokati i Popullit e ka të qartë se mesazhet e forta jepen përmes ligjesh sa më të qarta. Në punën e tij ai ndeshet jo vetëm me gabime njerëzore, por edhe me ato që quhen gabime sistematike. Të bindur se një ligj i hapur ndaj abuzimeve të mundshme duhet plotësuar apo amenduar, kjo është një arsye tjetër se përse ne i kushtojmë shumë vëmendje bashkëpunimit me Parlamentin dhe komisionet e tij përkatëse, të Ligjeve dhe të të Drejtave të Njeriut.

KREU I DYTE

1. Statistika përmbledhëse e vitit 2003

(Rastet sipas fushave përkatëse dhe mënyra e përfundimit të tyre)

Në të tre Raportet Vjetorë që ne i kemi paraqitur Parlamentit, një vënd të veçantë ka zënë pasqyrimi i statistikës për prezantimin e numrit të ankesave të shqyrtuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vitit për të cilin është raportuar.

Numrin e përgjithshëm të ankesave e kemi parë të lidhur ngushtë me numrin e të drejtave të shkelura apo dhe me mënyrën se si individët i konceptojnë të drejtat e tyre. E rëndësishme në këtë pikë, ka qenë evidentimi i numrit të ankesave të bazuara dhe numri i ankesave të pabazuara, çka na ka lejuar të krijojmë mendimin tonë mbi masën e shkeljes së të drejtave të njeriut dhe mënyrën e perceptimit të këtyre shkeljeve si nga ana e qytetarëve, ashtu dhe ana e Administratës Publike Shqiptare.

Ne kemi ndërtuar brenda Institucionit një sistem të tillë, të gatshëm për të pritur në çdo kohë e pa pengesa qytetarët që vijnë për ankesat apo kërkesat e tyre dhe i kemi bërë ata të ndjehen të mirëpritur, si dhe të përfitojnë prej nesh shumë shpejt ato çfarë ne u ofrojmë për t'i ndihmuar. Për këtë, ashtu siç kemi thënë dhe ne Raportin Vjetor 2002, që në Qershor të vitit 2001 ka filluar funksionimi i Zyrës së Pritjes së Popullit, ku qytetarët në çdo orë të ditës, gjatë orarit zyrtar, mund të paraqesin ankesat apo kërkesat e tyre dhe të marrin sqarimet e nevojshme nga një ekspert i zyrës.

Gjatë viteve 2002 dhe 2003 kemi parë që fluksi i qytetareve që nëpërmjet ankesave të tyre i janë drejtuar kesaj zyre, ka qenë i konsiderueshem. Keshtu në vitin 2002 kjo zyre ka pritur 2115 ankesa, kërkesa apo njoftime verbale, nga të cilat për 1412 prej tyre eksperti përkates i ka dhënë përgjigje menjehere qytetareve dhe ju treguar atyre rrugën që duhej të ndiqnin për realizimin e të drejtave të pretenduara. Gjatë vitit 2003 janë trajtuar 2160 ankesa, kërkesa apo njoftime verbale dhe për 1633 prej tyre eksperti ka dhënë menjehere përgjigjet përkatese. Duke parë këto intensitet në rritje të punës së përballuar nga kjo zyre, gjatë vitit 2003

u bë një ristrukturim i Zyres së Pritjes së Popullit, duke e ngritur atë në rangun e Sektorit të Pritjes së Popullit.

Nga statistikat tona kemi nxjerrë raportin midis çështjeve të cilat janë në juridiksionin tonë, me çështjet të cilat janë jashtë këtij juridiksioni. Raporti ka treguar se akoma ka shumë individë që nuk e kanë të qartë sferën e veprimtarisë së Avokatit të Popullit, çka na ka nxitur të hartojmë programe konkrete për njohjen në masën e njerëzve të Institucionit të Avokatit të Popullit, rolit dhe kompetencave tona.

Gjatë periudhës 1 Janar - 31 Dhjetor 2003 janë trajtuar nga Zyra e Avokatit të Popullit 4400 ankesa, kërkesa dhe njoftime (duke përfshirë dhe ato të Zyrës së Pritjes së Popullit, të cilave ju është dhënë përgjigje menjëherë). Nga 4400 ankesa, 767 kanë qenë të mbartura nga viti 2002 dhe janë raportuar si të tilla në Raportin Vjetor 2002. Ankesa, kërkesa dhe njoftime të cilat i janë nënshtruar shqyrtimit nga ana e Zyrës sonë kanë qenë 2767. Nga këto, 576 ankesa ose 21% e tyre kanë kaluar për shqyrtim në vitin 2004. Duke krahasuar numrin e ankesave, kërkesave dhe njoftimeve të ardhura në vitin 2003 me vitin 2002, ka një rënie rreth 15%. Por duhet thënë që kjo rënie është virtuale sepse në mjaft raste, pas një ankese kanë qenë një numër i madh ankuesish, të drejtat e të cilëve demtoheshin nga veprimet e administratës publike. Keshtu pas fillimit me iniciativë për problemin e ndryshimit të tarifave të telefonisë fikse dhe të energjisë elektrike, u depozituan pranë nesh 6000 nënshkrime të konsumatorëve të ndryshëm të cilet raportojmë vetëm si një ankesë. Po keshtu edhe shqyrtimi dhe zgjidhja e ankesës së një punonjësi të Policisë së Shtetit lidhur me disa veprime të padrejta të Komisionit të Dhenies së Gradave, pranë Ministrisë së Rendit Publik. Pas kësaj ankese është problemi i 1216 punonjësve të tjerë të rolit baze (police) të Ministrisë së Rendit Publik dhe të 384 punonjësve të rolit të mesëm dhe të lartë të kësaj Ministrie, që nuk figurojnë të raportuar në numrat tanë të ankesave.

Nga trajtimi i ankesave ka rezultuar se 844 ankesa, ose 38% e tyre kanë qenë jashtë juridiksionit. Por për këto ankesa është bërë punë efektive, sepse qytetarët janë sqaruar për rrugën që ata duhej të ndiqnin për zgjidhjen e problemit të prezantuar tek ne. Nga ankesat që kanë qenë brenda juridiksionit dhe kompetencës së Avokatit të Popullit, 761 ose 59% e ankesave kanë rezultuar të padrejta, kurse 471 ose 37% e tyre janë zgjidhur në favor. Nga 471 ankesat e drejta, për 114 prej tyre janë bërë edhe rekomandimet përkatëse me shkrim, drejtuar autoriteteve publike me qëllim që të rritet cilësia e administrimit publik dhe të sigurohen standarte mirëqeverisje. Për pjesën tjetër zgjidhjet pozitive janë arritur që në fazën e marrjes së shpjegimeve apo ndërmjetësimit tonë verbal me organet e

Administratës Publike, të cilat pas komunikimit me ne, kanë rregulluar gabimin e bërë, ose kanë hequr dorë nga qëndrimet refuzuese apo negative që kanë mbajtur me ankuesit. Rekomandimet e bëra nga Avokati i Popullit dhe të pranuar nga organet të cilave ato u janë drejtuar tregojnë për ndërhyrje të argumentuara nga institucioni ynë për rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura qytetarëve.

Në këtë Raport Vjetor do të prezantojmë, ashtu si dhe vitin e kaluar, rastet e trajtuara nga Zyra e Avokatit të Popullit, të ndara sipas Ministrive përkatëse dhe organeve apo enteve të tjera të Administratës Publike Shqiptare në vartësi të tyre, ndaj të cilave janë drejtuar ankesat apo kërkesat, duke shprehur shpesh dhe opinionet tona për fushat përkatëse.

Më poshtë po paraqesim numrin e ankesave, kërkesave apo njoftimeve të trajtuara në vitin 2003, të ndara sipas Ministrive përkatëse, organeve apo enteve të tjera të administratës publike.

1. Këshilli i Ministrave	105, nga të cilat për:
vetë Qeverinë	14
a. Grupin Mbikqyrës të Firmave Piramidale	9
b. Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	44
c. Komisionet e kthimit dhe kompensimit të pronave	27
ç. Instituti i Integritimit të ish të Përndjekurve politikë	11
2. Ministria e Drejtësisë	306, nga të cilat për:
vetë ministrinë	8
a. Burgjet	147
b. Zyrat e Përmbarimit	151
3. Organet e pushtetit gjyqësor	
Gjykatat	375
4. Prokuroria	163
5. Ministria e Rendit Publik	284
6. Ministria e Mbrojtjes	154
7. Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit	323 nga të cilat për:
vetë ministrinë	36
<i>Organet e pushtetit vendor</i>	
a. Komunat	61
b. Bashkite	202
c. Prefekturat	24

8. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale	229, nga të cilat për:
vetë ministrinë	18
a. Institutin e Sigurimeve Shoqërore	183
b. Shërbimi Social Shtetëror	28
9. Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit	153, nga të cilat për:
a. vetë Ministrinë	32
b. Ndërtimet pa leje	117
c. Ujësjellës kanalizime	4
10. Ministria e Ekonomisë	2
11. Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit	58
12. Ministria e Financave	48, nga të cilat për:
vetë ministrinë	33
a. Agjensinë Kombëtare të Privatizimit	15
13. Ministria e Arsimit dhe Shkences	63
14. Ministria e Shëndetësisë	24
15. Ministria e Punëve të Jashtme	12
16. Ministria e Transporteve dhe Telekomunikacioneve	62, nga të cilat për:
vetë Ministrinë	6
a. Telekom-in	56
17. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	17
18. Ministria e Mjedisit	2
19. Ministria e Industrisë dhe Energjitikës	71, nga të cilat për:
vetë Ministrinë	21
a. Korporatën Elektroenergjitike	50
20. Shërbimet Sekrete	2
Të tjera	314
<u>TOTALI</u>	2767 ankesa

2. Marrëdhëniet me Kuvendin e Shqipërisë

Institucioni i Avokatit të Popullit që nga krijimi i tij dhe në vazhdimësi ka ndjerë kujdesin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për forcimin dhe konsolidimin e tij. Ai e ndjen veten, "... krahu i zgjatur i Parlamentit mbi Administratën Publike, me qëllim që gjatë zbatimit të ligjit, të punojë që të arrihen qëllimet e ligjvënësit". Gjatë vitit 2003 Avokati i Popullit ka informuar herë pas here me shkrim Kryesinë e Kuvendit, apo dhe komisionet parlamentare përkatëse për veprimtarinë e tij ose për çështje të veçanta.

Kemi marrë pjesë në diskutime të projektligjeve të ndryshme, si dhe kemi dërguar edhe rekomandime për çështje të ndryshme, duke sugjeruar që deputetët në komisionet parlamentare jo vetëm të informohen për veprimtarinë e opinionet tona, por edhe që të ndërmarrin inisiativën legjislative për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve, kur i vlerësojnë me vend Rekomandimet tona.

Kryesia e Kuvendit është treguar e gatshme dhe në çdo rast ka pritur homologët e Avokatit të Popullit që kanë zhvilluar vizita zyrtare tek ne, si dhe ka shprehur opinionet pozitive të Kuvendit për veprimtarinë tonë. Komisioni parlamentar i Financës ka mirëkuptuar kërkesat tona për akordimin e buxhetit financiar që të garantojë funksionimin normal të veprimtarisë sonë. Por theksojmë se akoma nuk kemi gjetur zgjidhje për inisiativën tonë për të caktuar përfaqësues vendorë në Shkodër e Gjirokastrë, ashtu siç kemi shpjeguar edhe hollësi kur flasim për buxhetin e Institucionit.

A- Në Raportet vjetorë të vitit 2001 dhe vitit 2002, ne i bëmë të ditur Kuvendit se në tre raste i kemi rekomanduar Qeverisë që të marrë masa për të përgatitur ligje e akte të tjera që të plotësohen detyrimet që rrjedhin nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Por meqë këto detyrime nuk janë plotësuar, po i përsëritim ato:

1. Për zbatimin e nenit 181/1 të Kushtetutës për rregullimin e drejtë të çështjeve që lidhen me pronat. Dihet tashmë se projektligji i përgatitur edhe me asistencën e Zyrës së OSBE në Tiranë ndodhet për diskutim dhe miratim në Kuvendin e Shqipërisë. Shoqatat e ish pronarëve janë shprehur kundër disa dispozitave të këtij projektligji dhe janë ankuar edhe pranë institucionit tonë, duke kërkuar që projekti t'i dërgohet për studim dhe asistencë juridike Komisionit të Venecias pranë Këshillit të Europës.

2. Për lidhjen e marrëveshjeve me bashkësitë fetare, siç kërkon neni 10 i Kushtetutës. Nga informacioni zyrtar që kemi nga Kryetari i Komitetit të Kulteve pranë Këshillit të Ministrave, nga ky Komitet, është përgatitur

projekti i marrëveshjes tip me bashkësitë fetare dhe është depozituar për shqyrtim e miratim nga Qeveria që në vitin 2002. Për nxitjen e këtij procesi, në dhjetor 2002 ja kemi kujtuar zotit Kryeministër detyrimin e plotësimit të detyrës që rrjedh nga neni 10 i Kushtetutës. Por edhe viti 2003 kaloi pa u zbatuar kjo detyrë kushtetuese. Theksojmë përsëri se plotësimi i këtij detyrimi duhet shpejtuar, me qëllim që të parandalohen në kohë edhe disa fenomene negative të vërejtura vitet e fundit, siç janë mbulimi i trupit dhe i kokës nga femrat, rritja e mjekrës nga meshkujt dhe tendenca për të penetruar në institucionet shkollore publike, por sidomos të devijimit të rriteve tradicionale të fesë islame në zona të prapambetura, çka për të ardhmen mund të përbëjë një rrezik për traditën shqiptare të harmonisë fetare.

3. Për nxjerrjen e ligjit për rehabilitimin apo zhdëmtimin nga aktet apo veprimet e paligjshme të organeve shtetërore, siç kërkon neni 44 i Kushtetutës. Qeveria ja ka ngarkuar si detyrë Ministrisë së Drejtësisë që të përgatitë projektligjin gjatë vitit 2003. Por kjo Ministri akoma nuk e ka përfunduar këtë projekt.

B-1. Gjatë vitit 2003, pas Rekomandimit tonë është bërë plotësimi i ligjit që i ka dhënë Avokatit të Popullit të drejtën për të bërë inspektime në burgje. Komisioni parlamentar i të Drejtave të Njeriut ndërmori inisiativën ligjvënëse për plotësimin e Ligjit nr.8328 datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, me qëllim që të parashikohej e drejta e Avokatit të Popullit për të kryer inspektime në burgje. Ky rekomandim u miratua nga Kuvendi me ligjin nr.9071 datë 22.05.2003 “Për një ndryshim në ligjin nr.8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”.

2. Gjithashtu pas rekomandimit tonë Komisioni Parlamentar i të Drejtave të Njeriut mori inisiativën ligjvënëse për përmirësimin e nenit 4 të Ligjit nr.8292 datë 25.2.1998 “Për Forcat Speciale dhe ato të Ndërhyrjes së Shpejtë”, sepse ky nen pengon vënien para ligjit të policëve kur shkelin rëndë të drejtat e njeriut. Ky rekomandim nuk u miratua në seancë parlamentare nga Kuvendi.

Falenderojmë deputetët Vangjel Dule, Pjetër Arbnori, Shpëtim Kateshi, Ligoraq Karamelo, etj që morën inisiativën legjislative dhe futën dy rekomandimet e mësipërme në procedurën legjislative.

Më hollësisht për këto çështje flitet edhe në pjesët përkatëse të këtij Raporti.

C. Gjatë vitit 2003, i kemi nisur direkt Kuvendit edhe këto Rekomandime për përmirësimin e ligjeve:

1. Rekomandim për përmirësimin e Kodit Zgjedhor, për të drejtën e personave për të votuar kur ndodhen në paraburgim jo në vendin ku janë të regjistruar. Ky rekomandim ju drejtua Komisionit Bipartizan që përgatiti Kodin Zgjedhor të vitit 2003. Verbalisht na u tha se rekomandimi është i drejtë, por nuk u pasqyrua në Kod. Duke qenë se ky Kod besojmë se do ripunohet këtë vit, do ta ndjekim që të merret parasysh.

2. Rekomandim drejtuar Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, me qëllim që të dënuarve që kanë ndenjur në dhomat e paraburgimit tej kohës mbasi vendimi i tyre kishte marrë formë të prerë, t'u llogaritet kjo kohë sipas nenit 57 të Kodit Penal, pra një ditë paraburgim baraz me një ditë e gjysmë burgim. Rekomandimi është në shqyrtim.

Pa u vetëkënaqur për sa më sipër, për të ardhmen ndiejmë si detyrë që të informojmë më tepër Kuvendin për veprimtarinë tonë, për gjendjen e ligjshmërisë dhe të zbatimit të të drejtave të njeriut nga ana e Administratës Publike Shqiptare. Gjithashtu, të shfrytëzojmë akoma më tepër mundësinë për të rekomanduar direkt në komisionet parlamentare marrjen e inisiativës së tyre legjislative, në interes të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njerëzve në Shqipëri.

3. Marrëdhëniet me Gjykatën Kushtetuese

Sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ndër subjektet që kanë të drejtë të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese përfshihet edhe Avokati i Popullit.

Por sipas nenit 134 të Kushtetutës, subjektet që mund të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese ndahen në dy grupe: në subjekte që mund të ushtrojnë kërkesë në mënyrë të pakushtëzuar dhe në subjekte që, mund të ushtrojnë kërkesë të kushtëzuar “vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre”. Ky dallim del nga përmbajtja e pikës 2 të nenit 134 të Kushtetutës dhe në këtë kategori subjektësh që mund t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese, në mënyrë të kushtëzuar, përfshihet edhe Avokati i Popullit.

Përcaktimi nëpërmjet interpretimit të rrethit të çështjeve që përbëjnë “interesa të Avokatit të Popullit”, në momentin kur sapo filluam punën, paraqiste rëndësi për funksionimin e Institucionit të Avokatit të Popullit. Prandaj në muajin qershor 2000 ju drejtua Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për të bërë interpretimin se çfarë kuptohet me “çështje që lidhen me interesat e Avokatit të Popullit”.

Në përputhje me kompetencat e saj, Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj nr.49, dt.31.07.2000, vendosi që “Avokati i Popullit ka të

drejtë të parashtrijë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për pajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, për pajtueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën, dhe për interpretimin e Kushtetutës, gjithnjë kur çështja lidhet me interesat e tij. Gjithashtu Avokati i Popullit mund të bëjë kërkesë për çështje që lidhen me funksionin e tij në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit, kur këto janë shkelur nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike e të konstatuara nga Avokati i Popullit, si dhe kur janë cënuar rregullat kushtetuese për organizimin dhe funksionimin e institucionit të tij”. Ne kemi shfaqur kënaqësinë për vendimin e mësipërm të Gjykatës Kushtetuese sepse siç interpretohet lehtë, nuk e kufizon të drejtën tonë për të realizuar detyrën për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të Njeriut.

Të drejtën për t’ju drejtuar Gjykatës Kushtetuese e parashikon edhe gërma “c” e nenit 24 të ligjit nr.8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, e cila përcakton se:

“Kur Avokati i Popullit vëren se është vetë përmbajtja e ligjit ose e akteve të tjera normative dhe jo zbatimi i tyre shkak që krijon premisa për shkelje të të drejtave të njeriut, të njohura nga Kushtetuta ose ligjet e tjera, Avokati i Popullit ka të drejtë:....

c) T’i rekomandojë Gjykatës Kushtetuese shfuqizimin e akteve të tilla”.

Ne e kemi zbatuar të drejtën tonë në disa raste për të bërë kërkesa në Gjykatën Kushtetuese. Rasti i çështjes së mëposhtme, është pasqyruar në Raportet e vitit 2000, 2001 dhe 2002.

1. Një shtetas shqiptar, ish pronar trualli, me anë të letrës së tij, është ankuar se Vendimi i Qeverisë nr.119, datë 18.03.2000 “Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, i ka kufizuar atij dhe ish pronarëve të tjerë, në kushte të barabarta me të, një nga të drejtat themelore të njeriut, atë të ushtrimit të së drejtës së pronës së tij të ligjshme.

Gjykata Kushtetuese, pasi e shqyrtoi këtë kërkesë, me vendimin nr.26, datë 24.04.2001, vendosi pranimin e kërkesës sonë dhe shfuqizimin si antikushtetues të pikës 1, shkronja “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.119, datë 18.03.2000 “Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive që veprojnë në sektorët jo strategjikë”, si dhe të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.438, datë 14.08.1995 “Për privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore të transformuara në shoqëri tregtare”, vetëm për pjesët ku ato

shprehen: E para, “dhe çmimit të truallit të përcaktuar sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.312, datë 30.06.1994” dhe e dyta, “... në përpjestime që i përgjigjen çmimit të truallit të njohur në bazë të Vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave nr.312, datë 30.06.1994”.

Ky vendim i Gjykatës Kushtetuese është përshëndetur nga opinioni publik, sidomos nga ana e ish pronarëve të trojeve ku janë ngritur objektet shtetërore që po privatizohen. Nga ana tjetër, ky vendim ka rëndësi sepse përbën një bazë kushtetuese për gjithë legjislacionin që duhet të ndryshohet nga Kuvendi i Shqipërisë, në zbatim të pikës 1 të nenit 181 të Kushtetutës, e cila e detyron Kuvendin që “brenda dy deri tre vjetëve nga hyrja në fuqi e kësaj Kushtetute, të nxjerrë ligje për rregullimin e drejtë të çështjeve të ndryshme që lidhen me shpronësimet dhe konfiskimet e kryera para miratimit të kësaj Kushtetute, duke u udhëhequr nga kriteret e nenit 41”. (Garancitë për mbrojtjen e të drejtës së pronës private). Prandaj këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese, ndonëse është botuar në Fletoret Zyrtare në vitin 2001, ja dërguam në muajin tetor 2002 si kujtesë komisionit parlamentar të ngritur nga Kuvendi i Shqipërisë për përgatitjen e ligjit të ri për Kthimin dhe Kompensimin e ish pronarëve si dhe Komisionit të përhershëm parlamentar për ligjet dhe Çështjet Kushtetuese.

Shpresojmë që projektligjet që do të shqyrtojë Kuvendi në zbatim të nenit 181/1 të Kushtetutës të miratohen, duke patur parasysh këtë frymë për respektimin deri në fund të të gjitha të drejtave themelore të asaj shtrese të madhe të njerëzve që përbëjnë ish pronarët.

Në vijim ne informojmë Kuvendin e Shqipërisë, që Këshilli i Ministrave bëri rregullimet përkatëse në përputhje me këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese. Në VKM me nr.119, datë 27.02.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.119, datë 18.03.2000 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, në pikën 3 thuhet:

Pika 1 e shkronjës “C” të kapitullit I, e shfuqizuar me vendimin nr.26, datë 24.04.2001 të Gjykatës Kushtetuese, të riformulohet si më poshtë vijon:

“1. Ish-pronarët e truallit, si subjekte kërkuese, në dallim nga subjektet e tjera kërkuese, në mbështetje të ligjit nr.7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, ndryshuar me akte të tjera ligjore, kanë të drejtë të marrin aksione të shoqërisë që privatizohet, në bazë të sipërfaqes së truallit, të përcaktuar në vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve, brenda kufizimit të shoqërisë dhe çmimit të truallit, të përcaktuar sipas vendimit të

Këshillit të Ministrave “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe të shitjes së trojeve të ndërmarrjeve shtetërore, që u nënshtrohen procedurave të privatizimit ose transformimit të tyre në shoqëri tregtare (si dhe trojeve të shoqërive me kapital shtetëror)”.”

2. Në vitin 2001, ne paraqitëm një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për të shfuqizuar si antikushtetues një pjesë të ligjit nr.8377, datë 22.07.1998 “Për shpalljen e moratoriumit për detyrimet e pashlyera të ish ndërmarrjeve të Tregëtisë së Jashtme të Republikës së Shqipërisë kundrejt kreditorëve të huaj”.

Për fat të keq, ashtu siç kemi theksuar në Raportin e vitit 2002, Gjykata Kushtetuese nuk ju fut themelit të çështjes, për të shqyrtuar pretendimin tonë se ky ligj shkel të drejtat e subjekteve juridike (që vlejnjë njëlloj si për ato të njerëzve, për aq sa përputhen, sipas nenit 16/2 të Kushtetutës sonë). Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.178 datë 08.11.2001 nuk pranoi kërkesën tonë për “mungesë legjitimiteti”. Në këtë vendim arsyetohet se: “Avokati i Popullit kërkon shfuqizimin e një ligji që dihet se nuk është akt i organeve të administratës publike. Prandaj Gjykata Kushtetuese duke iu referuar përmbajtjes së nenit 134, pika 2 dhe nenit 60 të Kushtetutës dhe duke i interpretuar këto dispozita të lidhura me njëra tjetrën arrin në përfundimin se në kushtet kur objekt i kësaj kërkesë është shfuqizimi i një ligji për të cilin Avokati i Popullit nuk ka interes dhe jo shfuqizimi i një akti të organeve të administratës publike, atij i mungon legjitimiteti sepse nuk ka cilësitë e subjekteve që kanë të drejtë ta vënë atë në lëvizje”.

Gjykata Kushtetuese ndërkohë përfundoi shqyrtimin edhe të një kërkesë tjetër të Avokatit të Popullit, për shfuqizimin si antikushtetuese të pikave 3 dhe 5 të nenit 289 të Kodit Doganor, të cilat sipas mendimit tonë, shkelin nenin 13 të Konventës Europiane të të drejtave të njeriut dhe nenin 8 të Deklaratës Universale të të drejtave të njeriut “Për një ankim efektiv”.

Kjo kërkesë është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese që në muajin nëntor 2001. Bashkë me Avokatin e Popullit ishte bashkuar si subjekt i interesuar edhe Dhoma e Tregëtisë dhe Industrisë të Tiranës, e cila sipas pikës “f” të nenit 134 të Kushtetutës ka të drejtë të bëjë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese vetëm për çështje që lidhen me interesat e saj. (Në fakt kjo është një paradoks, sepse Dhoma e Tregëtisë apo organizata të ndryshme joqeveritare janë vënë nga Kushtetuta në pozitë të njëjlojtë me Avokatin e Popullit).

Më datën 24 janar 2002 në Gjykatën Kushtetuese u zhvillua seanca e shqyrtimit të çështjes, në të cilën Avokati i Popullit paraqiti arsyet përse duhej të pranohej kërkesa jonë, të cilat i kemi paraqitur si pjesë përbërëse

në Raportit tonë vjetor për vitin 2002. Më në fund, pas më tepër se 2 vjet, Gjykata Kushtetuese shpalli vendimin e saj nr.2 datë 13.02.2004 për këtë çështje, me anë të të cilit, me shumicë votash (pesë kundër tre), rrëzoi kërkesën tonë. Arsyet e rrëzimit të kërkesës janë pothuaj ato të përshkuara më sipër, “për mungesë legjitimiteti për të kërkuar shfuqizimin e ligjeve të nxjerra nga Kuvendi”.

Në Raportet e mëparshme të paraqitura në Kuvend, ne kemi theksuar dhe theksojmë se Avokati i Popullit i zbaton dhe do t'i zbatojë vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Por kjo edukatë e bindjes ndaj Kushtetutës dhe ligjeve nuk na heq të drejtën që të shfaqim mendimet tona për elementet juridike të çfarëdolloj ligji apo vendimi gjyqësor, në kuadrin e diskutimeve akademike. Pra, opinionin ynë është se Gjykata Kushtetuese me vendimet e saj nr.178 datë 8.11.2001 dhe nr.2 datë 03.02.2004 ka vepruar në kundërshtim edhe me vendimin e saj nr.49, datë 31.07.2000 me anë të të cilit ka interpretuar pikën 2 të nenit 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Siç kemi theksuar edhe më parë, Vendimi nr.49, datë 31.07.2000 është përshëndetur për hapësirat që krijoi për Avokatin e Popullit që të kryejë realisht detyrën për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njerëzve në Shqipëri, të cilat kanë përbërë dhe përbëjnë thelbin e interesave të këtij Institucioni. Edhe në konkluzionet e Konferencës së Lubjanës, të mbajtur në nëntor 2001 të organizuar nga Këshilli i Europës me institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut theksohet ndër të tjera për vendet në tranzicion se “... është e rëndësishme për ombudsmanët që të kenë aftësinë të parashetrojnë një vlerësim të aspektit ligjor dhe kushtetues të rregullave dhe ligjeve përpara Gjykatës Kushtetuese”. Vendimin nr.178 datë 08.11.2001 të Gjykatës Kushtetuese e ka kritikuar edhe organizata prestigjioze e të drejtave të njeriut, Human Rights Watch. Në Raportin botëror për ngjarjet e vitit 2002, publikuar në janar 2003 për Shqipërinë, ndër të tjera pasi përmendën rezultatet pozitive të Avokatit të Popullit, nënvizohet se: “... një vendim shqetësues i Gjykatës Kushtetuese, (i shpallur në nëntor 2001), duket se e ka kufizuar në një masë të madhe kompetencën e Avokatit të Popullit për të inicuar shqyrtimin e Kushtetutshmërisë së legjislacionit”.

Më thjeshtë kjo çështje mund të kuptohet po të marrim p.sh. rastet e kërkesave të ngritura në Gjykatën Kushtetuese nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit. Kjo OJF përshëndetet nga ana jonë për këto raste, por është e pakuptimtë që OJF-ve Gjykata Kushtetuese ju njeh të drejtën (legjitimitet) që të kundërshtojnë ligjet antikushtetuese që shkelin të drejtat e njeriut, kurse Avokatit të Popullit, i cili është institucion kushtetues i ngarkuar me

këtë detyrë, shpallet prej saj me mungesë legjitimiteti për të bërë të tilla kërkesa???

4. Avokati i Popullit dhe të Drejtat e Njeriut në Shqipëri (Opinione të përgjithshme)

Kushtetuta shqiptare e vitit 1998 ka përcaktuar qartë që “të drejtat e njeriut dhe liritë themelore janë të patjetërsueshme dhe i takojnë çdo njeriu me lindjen e tij”. Ajo gjithashtu parashikon që “njohja dhe respektimi i të drejtave të njeriut është detyrë e shtetit”. Të njëjtat standarte janë vendosur edhe nga Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe Karta e të Drejtave të Njeriut të Bashkimit Europian (Konventa e Nisës). Mbi bazën e këtyre akteve fundamentale janë miratuar në Republikën e Shqipërisë pothuajse të gjitha ligjet specifike që kanë si objekt respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Por hartimi i ligjeve të reja nuk është i mjaftueshëm. Aftësia për t’i zbatuar ato mirë është një element po aq thelbësor i garantimit të demokracisë dhe sundimit të ligjit. Tashmë në Shqipëri është fakt që në drejtim të zbatimit me efikasitet të këtij kuadri ligjor hasen një sërë problemesh dhe fenomenesh negative serioze që kërkojnë zgjidhje. Në këto kushte në jetën e përditshme kanë marrë jetë mjaft fenomene negative, që në thelb janë shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Duke qenë i vetmi institucion kombëtar me status kushtetues për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut në Shqipëri, përfitojmë nga rasti për të dhënë konsiderata të veçanta për çështje të të drejtave të njeriut. Në lidhje me gjendjen e të drejtave dhe lirive të individëve në Shqipëri jemi shprehur edhe gjatë këtij raporti, kur kemi analizuar raste apo fusha të caktuara. Por për disa probleme që do të prezantojmë më poshtë, nuk jemi bazuar vetëm në ankesat e paraqitura tek Institucioni ynë, por dhe në informacionet e marra nga organizatat jofitimprurëse për fusha të veçanta të së drejtës, nga sondazhet e publikuara në Mediat shqiptare, si dhe në raportet e organizmave dhe institucioneve prestigjioze kur flasin për gjendjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Shqipëri, siç janë ato të Bashkimit Europian, Këshillit të Europës, Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Human Rights, Amnesty International etj.

E drejta e jetës në Shqipëri, si e drejtë themelore e njeriut, vazhdon të jetë e rrezikuar për sa kohë që armët vazhdojnë të jenë pa kontrollin e duhur në duart e popullsisë civile. Këto armë përditë marrin jetë njerëzish

nëpërmjet krimeve brenda familjes, vetvrasjeve, krimeve me dashje apo pakujdesive në administrimin e tyre. Ashtu siç e kemi prezantuar dhe në Raportet e mëparshme, ligji për mbledhjen e armëve nuk ka dhënë dhe nuk po jep rezultatet e pritshme. Nuk po konstatojmë që struktura e posaçme e policisë së shtetit që është ngritur për këtë qëllim të ketë efektivitet. Ndërkohë që gjithmonë e më shpesh, rastësisht po zbulohen armë apo municione që për t'i transportuar nga vendet ku gjenden në depot e shtetit duhen makina.

E drejta e jetës, si e drejtë themelore e njeriut ka qenë në qendër të Konferencës Kombëtare që Avokati i Popullit organizoi në Dhjetorin e vitit 2001. Synimi i saj ishte inicimi i një strategjie kombëtare të përbashkët nga të gjithë organet shtetërore dhe OJF-të, për masat parandaluese të ngutshme dhe të qëndrueshme, në mbrojtje të së drejtës së jetës dhe në veçanti, ndaj fenomenit të gjakmarrjes. Konkluzionet dhe rekomandimet e kësaj konference janë publikuar. Por këto rekomandime, vazhdojnë të mos zbatohen deri tani nga të gjitha autoritetet, të cilave ato u janë drejtuar. Veç Presidentit të Republikës, i cili disa herë publikisht ka kërkuar që organet shtetërore të merren më shumë me gjakmarrjen si dhe Ministrisë së Rendit Publik, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Ministria e Drejtësisë dhe ajo e Arsimit dhe Shkencës nuk kemi dijeni që të kenë bërë ndonjë gjë për këtë çështje. Masat parandaluese ndaj gjakmarrjes mesa duket janë lënë vetëm në objektin e punës të disa organizatave joqeveritare apo punës spontane të organeve të pushtetit vendor.

Liritë dhe të Drejtat Vetjake si liria e shprehjes, e shtypit, medias e televizionit, liria e ndërgjegjes dhe e fesë, liria individuale, paprekshmëria e banesës, liria e fshehtësia e korrespondencës janë të garantuara me ligj. Për to ka patur dhe do të ketë ankesa apo dhe mbrojtje të tyre si nga ana e Avokatit të Popullit ose me anë të proceseve gjyqësore. Por mendimi ynë, ashtu sikundër është thënë dhe më parë, është se këto të drejta dhe liri përgjithësisht respektohen. Janë ndëshkuar shkaktarët, kur janë vërtetuar shkelje të tyre të kryera nga autoritete publike, apo nga individë të veçantë që ju kanë cënuar këto të drejta atyre individëve që janë ankuar tek Avokati i Popullit apo në organet gjyqësore.

Për lirinë e shtypit, medias e televizionit, duhet thënë se vazhdon të ketë raste kur kjo liri është shkelur, por më tepër raste kur ajo është tejkaluar. Mediat tona nuk e konsiderojnë shkelje të japin me hollësi të dhëna personale që shkelin të drejtën e privacisë, të rregulluar nga dispozitat e Ligjit nr. 8517, datë 22.07.1999, "Për mbrojtjen e të dhënave personale". Më e theksuar është kjo kur ka akuza për vepra penale dhe, aq

më tepër, kur janë të akuzuar dhe të dëmtuar të miturit apo femrat e shfrytëzuara për trafikë të paligjshme, për krime seksuale në familje. Shpesh herë gazetarët kanë rendur të marrin intervista dhe të botojnë foto, me identitete të plota e të sakta për fëmijë apo femra të dhunuara si nga trafikantët, përsëritësa në krime seksuale apo prindër dhunues, duke harruar se publikimi i këtyre fakteve i sjell dëme të pariparueshme personit të dhunuar. Konstatohet se në këto raste ka edhe klientelizëm të organeve të policisë me gazeta apo gazetarë të caktuar kur ndodhin për çështje të tilla.

Liritë dhe të Drejtat Politike, si e drejta e zgjedhjeve, e organizimit dhe tubimeve dhe manifestimeve paqësore, janë të garantuara me ligj dhe në përgjithësi respektohen. Ka edhe ankesa dhe opinione të ndryshme në këto drejtime. Avokati i Popullit është shprehur pozitivisht për masat legjislative dhe administrative për të zbatuar Rekomandimet e ODIHR-it, si dhe kur ka qenë rasti ka punuar konkretisht për respektimin e të drejtës themelore të votës së lirë për çdo qytetar të Republikës së Shqipërisë, si dhe ka dhënë rekomandime konkrete për të mos lejuar asnjë mundësi manipulimi nga cilado palë apo subjekt elektoral. Për procesin e zgjedhjeve për organet e pushtetit vendor të zhvilluara më 12 tetor 2003 Avokati i Popullit paraprakisht kontribuoi me dy rekomandime, të bëra publike që në gusht 2003 si dhe caktoi kryetarin e Bordit të Monitorimit të Mediave.

Së pari, duke marrë shkas nga ekzistenca e të vdekurve në regjistrat e gjendjes civile, të hiqeshin ata nga listat e zgjedhjeve. Ky rekomandim u muar parasysht pjesërisht.

Së dyti, të mos pranoheshin nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve si anëtarë të komisioneve zgjedhore personat që në proceset elektorale të mëparshme kishin bërë fallsifikime, grindje etj, duke ndikuar gjithmonë në prishjen e procesit elektoral dhe imazhit të tij. Ky rekomandim nuk u zbatua.

Faktikisht njerëz të tillë përsëri krijuan probleme gjatë procesit të numërimit të votave. Ky fenomen dhe parregullsitë e listave elektorale janë dy pikat për të cilat është kontestuar faktikisht procesi elektoral i vitit 2003. Veç krijimit të Regjistratit të saktë të zgjedhësve ne rekomandojmë që të ndryshohet Kodi Zgjedhor dhe të caktohen gjykatësit që të bëjnë numërimin e votave dhe nxjerrjen e rezultateve të votimit, në prani të komisionerëve të caktuar nga subjektet elektorale.

Së treti, duke caktuar me paanshmëri politike Kryetarin e Bordit të Monitorimit të Mediave gjatë procesit zgjedhor, Avokati i Popullit ndikoi që veprimtaria e këtij Bordi të vlerësohej pozitivisht nga të gjitha palët.

Vazhdojmë të konstatojmë që mjaft të drejta dhe liri të tjera themelore shkelen apo nuk realizohen si duhet. Edhe në konferencën

ndërkombëtare mbi trafikimin e fëmijëve, organizuar në Tiranë më 19 janar 2004 nga Këshilli i Europës dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale u nënvizua se ndonëse Shqipëria qysh në vitin 1992 ratifikoi Konventën e OKB-së për të drejtat e fëmijëve, trafikimi i fëmijëve shqiptarë përbën një plagë mjaft shqetësuese. Dihet që ky është një fenomen jo vetëm shqiptar, por për të gjitha vendet ish komuniste që filluan proceset e tranzicionit drejt demokracisë pas vitit 1990. Deri në vitin 2002 është veçori për Shqipërinë që ndërsa për trafiket e tjera të drogës, prostitucionit, të klandestinëve etj, kemi qënë më tepër vend tranziti se sa vend origjine, për trafikun e fëmijëve kemi qënë veçse vend origjine. Pa mohuar rezultatet pozitive të dy viteve të fundit që kanë patur të bëjnë sidomos me rritjen e kontrollit të kufijve, por sidomos hartimin nga Qeveria shqiptare në vitin 2001 të Strategjisë Kombëtare për Fëmijët, sipas të dhënave jo të plota, konstatohet se gjatë viteve 1991-2002 rreth 4000 fëmijë shqiptarë janë larguar në emigracion të pashoqëruar nga prindërit (3000 në Greqi dhe 1000 në Itali). Kjo kategori fëmijësh të ndodhur larg familjes dhe kujdesit të saj, ndodhet përballë rreziqeve të shumta si keqtrajtimi, abuzimi fizik e seksual, trafiku i organeve apo përfshirja në trafiqe të tjera të paligjshme. Në jo pak raste këta fëmijë janë shitur nga të afërmit apo prindërit e tyre ose edhe grabiten dhe shfrytëzohen nga rrjete mafioze e kriminale për qëllime fitimi. Trafikimi i fëmijëve, sidomos i vajzave të vogla, të moshës 14-18 vjeç është një burim fitimi maksimal për trafikantët, të cilët shfrytëzojnë çdo mundësi deri edhe grabitje dhe përdhunime për të realizuar gjahun e tyre.

Burimet e trafikut të fëmijëve janë: nga familje të divorcuara dhe me mungesë edukimi e kujdesi familjar; nga familje me shumë fëmijë dhe në gjendje të vështirë ekonomike, nga familje fshatare që shpresojnë në ndihmën e fëmijëve pak më të mëdhenj për të rritur fëmijë të tjerë më të vegjël; nga fëmijë të mbetur jetimë dhe pa kujdes; nga familje që prindërit u janë larguar për punësim jashtë shtetit si dhe fëmijët që kanë braktisur shkollën dhe janë marrë me lypësi e veprimtari tjetër të kundërligjshme edhe në Shqipëri.

Kushtet e jetesës të të miturve të trafikuar në shumicën e rasteve janë të mjerueshme, bëjnë punë të rënda sidomos lypësi dhe me orar të zgjatur dhe pagesë minimale sa për t'u ushqyer. Këta fëmijë janë të preferuar për trafikantët, sepse u kushtojnë pak dhe përfitimi nga puna e tyre është gjithnjë e në rritje.

Rrugët e trafikimit të fëmijëve zakonisht janë të njëjta me ato të trafikimit të qenieve njerëzore, por shpesh përdoren nga trafikantët edhe dokumente false si kujdestarë apo prindër të tyre. Ka patur jo pak raste

ankesash edhe për proceset e birësimit ndërkombëtar, i cili mbetet një formë trafiku që duhet investiguar në mënyrë të veçantë.

Fëmijët e rrugës, të cilët për fat të keq më të shumtët janë romë dhe jevgjitë (gipsi) përfaqësojnë kategorinë më të vuajtur, më të pambrojtur, më të ekspozuar ndaj shumë rreziqeve si keqtrajtimi, pasiguria, analfabetizmi, kequshqyerja etj, të cilët ushtrojnë “profesionin” e lypësit, shitësit ambulant, të ilustraxhiut etj.

Fëmijët e përfshirë në punë dhe aktivitete të tjera fitimprurëse janë fëmijë të cilët e kanë braktisur përfundimisht shkollën, ndërsa të tjerë e frekuentojnë atë dhe kryejnë punë të ndryshme, kryesisht pas mësimit, duke u aktivizuar në ekonominë familjare ose aktivitete jashtë familjes. Këta fëmijë janë kryesisht nga familjet shqiptare që kanë bërë migracion nga zonat e varfra verilindore, në qytetet kryesore të Shqipërisë së mesme apo zonat bregdetare. Në veri të Shqipërisë ka shumë fëmijë që janë të rrezikuar nga gjakmarrja dhe si rrjedhojë ata janë të përjashtuar nga lëvizja e lirë, edukimi në shkollë dhe jetojnë në varfëri sepse edhe prindërit e tyre të ngujuar nuk punojnë.

Shkaqet që kanë çuar në këtë gjendje burojnë nga shumë faktorë si gjendja dhe niveli i ulët ekonomik e social i vendit, tronditja e bazamentit tradicional të familjes shqiptare, por mbi të gjitha moszbatimi efikas i ligjit dhe mos bashkëpunimi i duhur nga agjencitë e caktuara si policia, prokuroria, gjykata, shërbimet inteligjente dhe struktura të tjera të shtetit si pushteti vendor, shkollat, institucionet e ndihmës dhe përkrahjes sociale etj. Jo në pak raste elemente të korruptuar të këtyre strukturave të shtetit kanë bërë pjesë apo kanë favorizuar këtë situatë, por shumë prej tyre nuk kanë marrë dënimin e merituar.

Gjatë shqyrtimit të rasteve konkrete, Avokati i Popullit ka shqyrtuar nëse janë zbatuar detyrimet që rrjedhin nga nenshkrimi i konventave ndërkombetare apo nga legjislacioni vendas. Në këto raste ndërhyrjet e Avokatit të Popullit kanë qenë frutdhënëse, jo vetëm sepse janë vene në levizje strukturat e përmbarimit, ato të shkollës apo ndihmës sociale, por se duke ju bërë këtyre rasteve edhe publiciteti i nevojshëm, është krijuar precedenti pozitiv. Në vitin 2003, nga ana e Avokatit të Popullit janë hartuar Rekomandime për Ministrin e Drejtësisë dhe Ministrin e Rendit, për t'i sensibilizuar që të kontrollojnë e t'u kërkojnë llogari organeve të tyre vartëse, për të vlerësuar në radhë të parë interesin e fëmijëve.

Gjithashtu kemi rekomanduar se ka vend për një bashkëpunim dinamik dhe real me Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministrinë e Arsimit dhe shumë struktura të tjera që në Strategjinë e Qeverisë për

femijet shqiptare përmenden shpesh, por realisht nuk ndjehen sepse kanë bërë pak.

Duke e menduar si efikase, në bashkëpunim me “Save the Children” këtë vit në zyrën tonë, do të fillojë funksionimi i një nënseksioni që do të merret në mënyrë specifike me problemet e fëmijëve në Shqipëri. Por rekomandimi ynë është se ka ardhur koha që edhe në Shqipëri të krijohet një autoritet i fortë shtetëror, i cili jo vetëm që do të nxitë autoritetet dhe organet shtetërore për zhvillimin e fëmijëve, por do të jetë edhe një mbrojtës i të drejtave të fëmijëve. Por për këtë në radhë të parë duhet vullnet politik, angazhim financiar si dhe ndryshimet e duhura në legjislacion.

Hartimi i një ligji të posaçëm për të drejtat e fëmijëve, mendojmë se është i domosdoshëm. Po kështu, akoma nuk funksionon një sistem gjyqësor dhe penitenciar, i veçantë për minorenët. Vlen të përmendet si moskrijimi i qendrës për edukimin e minorenëve, ashtu dhe mungesa e burgut të veçantë për minorenët.

Jo të pakta janë dhe shkeljet e të drejtave të Grave. Nuk ka shifra të sakta për numrin e femrave viktime të trafikut për qëllim shfrytëzim prostitucioni. Konstatohet që vitet e fundit ka rënie të këtij trafiku në mënyrë të ndjeshme. Kjo ka ardhur edhe si rrjedhojë e fushatave ndërjegjësuere të ndërmarra nga OJF-të e ndryshme në media, shkolla, universitete etj. Por kryesore ka qenë ndjekja dhe zbatimi me rreptësi i ligjit ndaj trafikantëve, miratimi dhe zbatimi i politikave dhe programeve të posaçme për mbrojtjen e viktimave të trafikut, si dhe monitorimin e këtij procesi nga organizmat që janë krijuar enkas nga strukturat qeveritare.

Çështje që kanë të bëjnë me keqtrajtimin bashkëshortor apo dhunën në familje ndaj grave dhe vajzave janë publikuar shpesh në shtyp. Situata po rëndohet çdo ditë, prandaj puna parandaluese nuk duhet lënë vetëm në dorë të organizatave joqeveritare. Komiteti për Mundësi të Barabarta, që ka kaluar në vartësi të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale me një personel prej 13 personash, i cili ka pothuajse aq ekspertë sa ka dhe Institucioni i Avokatit të Popullit, mendojmë se duhet ristrukturuar për të mos qenë një organizëm që bën vetëm studime dhe propozon politika, por të ketë mjete efektive për të ndikuar që të ruhen dhe zbatohen të drejtat e grave. Miratimi i Kodit të ri të familjes duhet shfrytëzuar për të përmirësuar trajtimin dhe pozitën e femrave në familje dhe në shoqërinë shqiptare.

Trajtimi i të dënuarve dhe të paraburgosurve në dhomat e izolimit pranë komisariateve të policisë, megjithë përmirësimet nga viti në vit, vazhdon të ketë probleme dhe ankesa. Edhe trajtimi i të sëmurëve mendorë në spitalet tona psikiatrike vazhdon të jetë problem shqetësues. Problemet

dihen dhe kanë filluar disa masa parandaluese, por problemet që ngrihen në të dy raportet e Komitetit Europian për parandalimin e torturës dhe trajtimit ose dënimit ç'njerëzor dhe poshtërues (CPT) janë akoma të pranishme. Qeveria Shqiptare duhet t'i kërkojë më tepër llogari institucioneve përkatëse të drejtësisë, policisë e mjekësisë që të punojë seriozisht për zbatimin e këtyre rekomandimeve, ndaj të cilave edhe ne reagojmë vazhdimisht.

Kujdesi shëndetësor, ndihma dhe përkrahja sociale janë akoma në nivele të ulta, jo vetëm për shkak të mungesës financiare në buxhet, por edhe për shkak të abuzimeve dhe shfaqjeve korruptive. Ratifikimi nga Kuvendi i Shqipërisë në vitin 2002 i Kartës Europiane Sociale të ndryshuar e ka vënë Shqipërinë para standarteve më të larta, prandaj duhet shumë punë që kjo Kartë të zbatohet në praktikë. Kuptohet që jo të gjitha të drejtat ekonomike dhe sociale mund të garantohen plotësisht. Por Qeveria duhet të lëvizë drejt realizimit të tyre dhe jo të shkojë mbrapa. Ndonëse mund të jetë e pamundur për çdo njeri të ketë një punë, Qeveria duhet të përpiqet maksimalisht për të krijuar mundësira punësimi, shanse të barabarta dhe një mjedis të përshtatshëm për të punuar, nëpërmjet politikave të shprehura me legjislacionin stimules.

Ankesat dhe akuzat për korrupsion si në administratë, ashtu edhe në gjyqësor janë jo të pakta. Për këtë situatë pa komente po citojmë shprehimisht fjalët e Kryeministrit më 26 janar 2004 në analizën e punës të Qeverisë Shqiptare për vitin 2003: "Drejtësia e vendimeve gjyqësore është ende një makth i qytetarëve dhe institucioneve, ndonëse viti që kaluam ka qenë viti më i mirë për sa i takon zbatimin të vendimeve gjyqësore. Kjo sigurisht ka rritur besimin e njerëzve tek gjykatat, por jo ende tek drejtësia. Për pasojë, rruga për vetgjyqësi është ende e hapur dhe krimi që buron prej saj është shumë i rëndë". Prandajne rekomandojmë se duhet vazhduar puna për përmirësimin dhe hartimin e ligjeve të reja, lufta kundër korrupsionit brenda sistemit gjyqësor; përmirësimi i punës të inspektoriatit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë; zbatimi pa kushte i vendimeve gjyqësore; reforma për përjasjen e legjislacionit vendas me marrëveshjet ndërkombëtare, në veçanti për probleme të tilla si pastrimi i parave, korrupsioni, terrorizmi dhe mbrojtja e dëshmitarit; përmirësimi i marrëdhënieve konkrete të punës së përditshme midis prokurorisë, policisë gjyqësore dhe gjykatave kundër krimit të organizuar etj.

Përmirësimi i mëtejshëm i gjëndjes së të drejtave të njeriut në Shqipëri, varet gjerësisht nga njohja dhe respektimi i shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut. Dihet nga të gjithë se përgjegjëse për gjëndjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në çdo vend janë Parlamenti dhe

Qeveritë që dalin prej tij. Avokati i Popullit si institucion që ka dalë nga Parlamenti e ka të qartë rolin dhe ka bërë dhe do të vazhdojë të bëjë pa u lodhur apo pa u dekurajuar detyrën e tij kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Republikën e Shqipërisë.

5. Mbulimi Mediatik i Avokatit të Popullit

Si institucion kombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut është e kuptueshme që imazhi publik i Avokatit të Popullit merr rëndësi parësore.

Performanca e tërë kontakteve të përfaqësuesve të Institucionit tonë me individin, administratën dhe publikun në tërësi ka si rezultante imazhin institucional, duke reflektuar kompetencat dhe juridiksionin që atij i njeh Kushtetuta dhe Ligji “Për Avokatin e Popullit”.

Marrëdhëniet publike fillojnë që nga elementet etike në kontaktet e para me ankuesit, deri tek ato institucionale me zyrtarët e shtetit, pavarësisht nga hierarkia. Natyrisht që dimensionin e tyre më të plotë, marrëdhëniet publike e fitojnë përmes marrëdhënieve me pushtetin e katërt, pra me shtypin e shkruar dhe median në tërësi.

Marrëdhëniet me median gjithmonë i kemi parë me përparësi, sepse kemi patur dhe kemi si objektiv të rritim besueshmërinë e publikut ndaj institucionit tonë në praktikë. Jemi të bindur se **suksesi** arrihet duke u bazuar në dy shtylla, të cilat janë zgjidhjet me **kompetencë** profesionale dhe **transparenca** në punën tonë. Ajo që kemi synuar është mënjanimi i çdo elementi demagogjik në marrëdhëniet me median. Ne mendojmë se këtë e kemi arritur, duke zbatuar një strategji disi të veçantë të informimit për punën tonë. Paradigma tashmë e konsoliduar në marrëdhëniet me median është përqendruar në tre nivele komunikimi. E para, mediave u kemi dhënë materiale, kryesisht mbi bazën e rasteve konkrete. E dyta, jemi munduar të bëjmë edhe përgjithësime, duke shpjeguar rolin, kompetencat dhe juridiksionin tonë pas çdo rasti konkret, të trajtuar gjithmonë me mjaft transparencë nga ekspertët tanë. E treta, njoftimet për shtypin, të shpërndara për median sipas rasteve dhe aktivitetit të Zyres.

Në raportimet tona vjetore para Kuvendit, ne bëjmë evidentimin e çdo informacioni në shtyp nga ne dhe për ne. Këtë nuk e kemi parë thjesht si element teknik. Tabelat përkatëse të mbulimit mediatik pasqyrojnë praktikën tonë njëvjeçare, duke evidentuar problematikën që ne kemi bërë publike në Media. Tregues tjetër është intensiteti dhe frekuenca e pranisë sonë në Mediat. Sipas monitorimit që kemi mundur të bëjmë, rezulton se Institucioni i Avokatit të Popullit, gjatë vitit 2003, ka qënë 340 herë i

pranishëm në Media e shkruar, dhe 97 herë në Media elektronike, ose me sakte janë realizuar mbi 100 kontakte mediatike me shumë ne krahasim me vitin 2002. Por kryesore është që këtë rritje sasiore, në krahasim me një vit më parë, ne nuk e shohim si qëllim në vetvete. Kjo është diçka e ndryshueshme nga viti në vit, pa mohuar këtu edhe pamundësinë objektive dhe subjektive të evidentimit në masën njëqind përqind të të gjithë paraqitjeve në Media. Tregues cilësor është zgjerimi i gjeografisë dhe shumëllojshmërisë tematike të këtij mbulimi mediatik.

Përmes Medias ne jemi njohur edhe me ankimet e mjaft njërëzve, por dhe me prioritetet e Qeverisë shqiptare. Në këtë mënyrë, fokusin e punës tonë e kemi drejtuar për të krijuar precedentë në ato sektorë të qeverisjes, tek të cilët kërkohet krijimi dhe rritja e standarteve për shërbimet publike, presioni për uljen e kostos së këtyre shërbimeve, domosdoshmëria e zbatimit të vendimeve gjyqsore, të drejtat e fëmijëve, zbatimin e të drejtës së informimit, përmirësimin të legjislacionit për pronësinë, lufta kundër korrupsioni, kundër abuzimeve të zyrtarëve si dhe fusha të tjera që janë pasqyruar në kreun përkatës sipas rasteve. Tek media gjithashtu kemi patur aleatin më të sigurtë, për tu bërë pjesë e opinionit publik, në rastet kur na është dashur të ndeshemi me rezistencën e atyre zyrtarëve publikë, të cilët fatkeqësisht ende e konsiderojnë rekomandimin e Avokatit të Popullit si diçka bezdisëse, aq më shumë ne rastet kur harrojnë se ky instrument, vërtetë është jo detyrues formalisht, por sa kohë që ai është mirëbazuar në ligj, është e qartë se askush nuk i shpëton detyrimit për zbatimin e tij. Dhe me të drejtë, në raste të tilla, Avokati i Popullit kurrësesi nuk kërkon dafina, pasi vetëm për të tilla nuk ka vend tek ne, por thjesht falenderon te gjithë ata zyrtarë publikë, te cilët në respektim parimeve të kodit të mirësjelljes administrative, thjesht realizojnë edhe etikën e nëpunësit civil, për çka edhe paguhen. Sa për rastet, kur zyrtaret nuk kane deshmuar vullnetin institucional për te zbatuar rekomandimin e Avokatit te Popullit, ato jane bërë te njohura edhe ne kete raport, objekt njohjeje dhe shqyrtimi nga Parlamenti dhe zyrtaret me te larte te shtetit, te cileve u takon e drejta e gjykimit dhe e marrjes se masave konkrete për te bërë vleresimin e përgjegjesise dhe përgjegjshmerise se zyrtareve te niveleve te ndryshme te administrates publike. Le te mos harrojme, se nese Avokati i Popullit konsiderohet si “krah i zgjatur” i Parlamentit, instrumenti baze ne justifikim te ketij atributi është pikerisht Raporti Vjetor i tij, përmes te cilit ai deshmon se sa dhe si ka vezhguar gabimet e administrates ne raport me individet, te cilet nga ana e tyre përbejne kontigjentet e votave te dhena apo te munguara për përfaqesuesit e tyre ne institucionin me te larte te demokracise se përfaqesuar.

Bashkëpunimi me Mediat na ka mundësuar aksesin e nevojshëm në publik si dhe krijimin e integritetit të domosdoshëm për ushtrimin e funksionit të parashikuar, si nga Kushtetuta, ashtu edhe nga ligji “Për Avokatin e Popullit”.

Duke përqafuar vlerësimin se gazetarët janë “rojtarë publikë”, bashkëpunimin me ta e kemi parë si mjetin, pa të cilin edhe publiku nuk do të dinte si të na drejtohej, sikunder edhe zyrtarët nuk do të njiheshin me forcën praktike të instrumentit tonë të vetëm, që është Rekomandimi i bazuar në ligj dhe i përpiluar me fuqinë më të madhe të mundshme argumentuese. Veçoria e rekomandimit të Avokatit të Popullit është se për të arritur deri tek ai kërkohet dhe mundësohet një kohë më e madhe fizike dhe intelektuale, për më tepër kur operohet nga një këndvështrim edhe më i gjerë, sikundër është mbrojtja e të drejtave të njeriut.

Gazetarëve u jemi ofruar jo vetëm për t’u dhënë informacionin e prodhuar prej zyrës sonë, por edhe për t’i ndihmuar të marrin informacion nga zyra të tjera, nëpunësit e të cilave ende nuk janë qartësuar sa duhet për ekzistencën e një ligji për të drejtën e informimit. Kontaktet me ta janë të përditshme, mjaft që informacioni të jetë i gatshëm për t’u servitur.

Larmia e problematikës, që është pasqyruar në Media është pasqyruar pa komente në tabelat përkatëse me statistikën e mbulimit mediatik. Në një farë mënyre, duke u nisur qoftë edhe nga titujt e informacioneve, bëhet e qartë edhe veprimtaria që kemi kryer dhe sa kemi mundur ta bëjme të njohur atë për publikun.

Informacionet nga shtypi përbëjnë bazën e një drejtimi të rëndësishëm të punës tonë, sikundër është vënia në lëvizje edhe me iniciativë, parashikuar nga neni 13-te i Ligjit “Për Avokatin e Popullit”. I gjithë spektri i shtypit të përditshëm, atij periodik shqiptar si dhe sherbimi i plotë i ATSH-se, filtrohet posaçërisht çdo ditë në zyrën tonë.

Informacionet që paraqesin interes për objektin e punës sonë, u shpërndahen seksioneve, sipas problematikës, të cilët më pas bëjnë verifikimet përkatëse dhe, sipas rastit, ose nisin investigimin ose i mbajnë në evidencë për arsye studimore në përcaktimin e politikave dhe prioritetëve të zyrës.

Në strategjinë e mbulimit mediatik janë patur parasysh si ndërjegjësimi i publikut, ashtu edhe efekti edukativ i informacionit. Kjo është bërë me pasqyrimin e vazhdueshëm në Mediat të të gjitha rasteve, kur administrata na ka mirëkuptuar, duke rivendosur të drejtën e shkelur të qytetarit.

Mjetet që kemi përdorur kanë qënë ato të parashikuara në strategjinë që kemi formuluar që në fillim të veprimtarisë sonë njohëse dhe sqaruese

për grupe të ndryshme të komunitetit. Gjatë vitit 2003 janë riprodhuar të përditësuara në anglisht dhe shqip broshura “Avokati i Popullit në Shqipëri – Ombudsmani Parlamentar”, dy postera tematikë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, janë botuar përmbledhjet me tituj “Akte ligjore në ndihmë të të burgosurve shqiptarë jashtë vendit” si dhe “E drejta e informimit – e drejtë themelore e njeriut”, si dhe janë shpërndarë pesë fletëpalosjet e prodhuara nga Kabineti i Avokatit të Popullit, për grupe të ndryshme interesi, përmes të cilave shpjegojmë rolin, kompetencat dhe rrugët si mund t’i drejtohen Avokatit të Popullit. Dokumentari njohës dhe promovues për Institucionin e Avokatit të Popullit tashmë është vënë në dispozicion dhe transmetuar në shumicën e televizioneve lokale dhe kombëtare. Të disponueshme kanë qenë edhe pesë spotet televizive që informojnë publikun për shërbimet që ne ofrojmë dhe rrugët e përfitimit të këtyre shërbimeve. Instalimi i teknologjisë informative na ka mundësuar që tashmë të kemi edhe faqen tonë në Internet, ku të interesuarit mund të gjejnë të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me zyrën tonë dhe aktivitetin që kryen ajo. Mbulimi mediatik ka qenë gjithmonë në përshtatje me problematikën dhe intensitetin e punës që institucioni ka kryer.

Duke bërë herë pas here një analizë të secilit seksion për punën e kryer, ne kemi punuar paralelisht edhe për zbatimin e pikave bazë të strategjisë sonë në fushën e marrëdhënieve me publikun, sidomos përmes Medias. Në tërësinë e saj, kjo **Strategji** e mbulimit mediatik, si pjesa thelbësore e **Marrëdhënieve me Publikun** është formuluar që në vitin 2000 dhe është publikuar edhe në raportet e viteve të mëparshme.

A. Sektori i Pritjes së Popullit

1) Organizmi i Punës

Në Institucionin e Avokatit të Popullit është ngritur dhe funksionon Zyra e Pritjes së Qytetarëve. Kjo zyrë u krijua si nevojë e përballimit në vazhdimësi të një fluksi të madh individësh, të cilët paraqiten pranë Institucionit të Avokatit të Popullit për të parashtruar ankesa, kërkesa dhe njoftime lidhur me shkelje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të tyre. Ky shërbim ndaj qytetarëve, i cili vazhdon ende me ritme të larta, ka formuar një fizionomi pozitive për institucionin e Avokatit të Popullit, duke e shfaqur atë më afër ankuesve për zgjidhjen e problemeve të tyre. Zyra e Pritjes së Popullit në vazhden e këtij intensiteti të madh pune, ka pësuar një reformim strukturor, duke u ngritur në rangun e Sektorit të Pritjes së Popullit. Ky ndryshim ka ardhur si pasojë e rëndësisë gjithnjë e në rritje të organizmit të punës në marrëdhënie me individët, si dhe të dhënies së një

ndihme sa më të madhe dhe të shpejtë në favor të tyre. Krahas kësaj, infrastruktura e kryerjes së këtij shërbimi është përmirësuar ndjeshëm. Masa të ndryshme administrative janë marrë për krijimin e kushteve optimale për pritjen e individëve, për avantazhet dhe lehtësitë e parashtrimit me detaje të ankesave, kërkesave apo njoftimeve, për njohjen dhe aksesin me dokumentat zyrtare, për pasqyrimin tepër transparent të punës së Avokatit të Popullit, për këshillimin ligjor dhe të kualifikuar etj. Në organizimin e këtij sektori dhe në përgjithësi për shërbimet që i ofrohen qytetarit, Avokati i Popullit ka implementuar eksperiencën e homologëve të tij ne Europë (veçanërisht në Spanjë), duke e gërshetuar këtë me një zbatim sa më të efektshëm të Kushtetutës dhe legjislacionit në fuqi, ku shtetasit i njihet e drejta për tu ankuar, për t'u informuar dhe për të realizuar të drejtat e tij në çdo organ të administratës publike, pa qenë i penguar nga asnjë strukturë shtetërore apo nëpunës zyrtar.

Faktor kryesor për përmbushjen e funksioneve kushtetuese të Avokatit të Popullit është kryesisht mardhënia me publikun. Termi Avokat i Popullit parakupton një organ, i cili mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të qytetarëve. Në këtë kuptim edhe marrëdhënia e krijuar duhet të jetë e një niveli mjaft të lartë e cilësor, duke arritur të përftojë me sukses besimin e individëve në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të tyre. Ne besojmë me modesti se kemi arritur të jemi pjesë e pandarë e zgjidhjes së shumë problemeve dhe shqetësimeve të qytetarëve, duke qëndruar pranë tyre, ndihmuar, këshilluar dhe ndjekur me përparësi çështjet që ata shtrojnë për zgjidhje. Kjo frymë mirëkuptimi dhe bashkëpunimi e ndërsjellë është përcjellë e plotë edhe në Zyrën e Pritjes së Popullit, ku përherë e më shumë po manifestohet një qëndrim dhe marrëdhënie shumë e ngushtë dhe e çlirët me njerëzit në nevojë. Në këtë aspekt të organizimit të punës, konstatohet me kënaqësi se mardhënia me publikun është përsosur dhe perfeksionuar me ritme të kënaqshme. Fakt për këtë janë bërë lehtësitë e komunikimit dhe të pritjes nga nëpunësit e Zyrës së Avokatit të Popullit, duke dhënë ndihmën e tyre gjatë përpilimit të ankesës ose kërkesës që parashtrojnë individët në mënyrë të shkruar, orientimet dhe këshillimet ligjore që ju jepen me përgjegjësi dhe profesionalizëm kur çështja që ngrenë si shqetësim nuk përbën objekt të veprimtarisë së Avokatit të Popullit, asistenca e mëtejshme që ndiqet pas pranimit të ankesës, informacionet dhe njohja me legjislacionin që i bëhen të njohura në çdo kohë qytetarit etj.

2) Statistikat Përmbledhese

Në këtë raport duke parë numrin e madh të individëve të paraqitur, si dhe një gamë të larmishme problematikash të bëra prezent, mendojmë të pasqyrojmë me detaje aktivitetin në shifra të Sektorit të Pritjes së Popullit.

Në lidhje me statistikën e vitit 2003, numri i përgjithshëm i ankesave të paraqitura pranë Zyrës së Pritjes së Popullit është **2160 ankesa/kërkesa**. Në pasqyrën e mëposhtme janë ankesat e paraqitura çdo muaj dhe numri i pranimit të atyre, që kanë qënë brenda juridiksionit dhe kompetencave të Avokatit të Popullit.

Muaji janar: ankesa gjithsej	158	pranuar	30 ankesa
Muaji shkurt	147		22 ankesa
Muaji mars	163		43 ankesa
Muaji prill	184		52 ankesa
Muaji maj	204		44 ankesa
Muaji qershor	192		41 ankesa
Muaji korrik	210		42 ankesa
Muaji gusht	50		28 ankesa
Muaji shtator	219		50 ankesa
Muaji tetor	237		70 ankesa
Muaji nentor	186		56 ankesa
Muaji dhjetor	210		49 ankesa
Totali	2160		527

Nga numri i përgjithshëm i ankesave apo kërkesave të paraqitura veçojmë se numri i tyre të pranuar nga Zyra e Pritjes së Popullit është **527 ankesa/kerkesa ose 24%** e gjithë ankesave të rregjistruara për shqyrtim gjatë vitit 2003. Pra gjatë vitit 2003 Zyra e Pritjes së Popullit kaloi për shqyrtim pranë Avokatit të Popullit 527 ankesa ose kërkesa, të cilat u trajtuan dhe kanë gjetur pasqyrim në pjesët e tjera të raportit sipas fushave dhe organeve të administratës publike.

Zyra e Pritjes së Popullit duke përmbushur detyrat e saj funksionale gjatë vitit 2003, ka pritur, trajtuar, këshilluar, orientuar dhe kthyer përgjigje të menjëhershme **1633 ose 76%** të numrit të përgjithshëm të individëve apo kërkesave dhe ankesave të paraqitura nga ana e tyre. Këta qytetarë për vetë llojin dhe klasifikimin e ankesës së paraqitur, janë grupuar në dy grupe si më poshtë:

1-Individë që ankesat/kërkesat e tyre janë konstatuar jashtë juridiksionit dhe kompetencave janë 1098 ose 51% të numrit të përgjithshëm të trajtuar.

2-Individë të paraqitur për këshillime, ndihmë të ndryshme ligjore dhe për probleme të tjera jashtë objektit të veprimtarisë së Institucionit të Avokatit të Popullit janë 535 ose 25% të numrit të përgjithshëm të trajtuar.

3) Problematikat e shfaqura

Ankesat të cilat pranohen për shqyrtim të mëtejshëm nga ana e Zyrës së Pritjes janë pasqyruar në pjesët e tjera të raportit. Por këtu dëshirojmë t'ju japim një ekspozitë të çështjeve kryesore që megjithatë ndodhen jashtë kompetencave dhe juridiksionit të Avokatit të Popullit, duhen marrë parasysh në kuadrin e evidentimit të një situatë reale që prezantohet me shqetësim nga individë të ndryshëm.

Konkretisht, duke iu referuar grupit të parë të lartpërmendur do të shtonim se shumica e ankesave apo kërkesave të paraqitura drejtohen kundër vendimeve të gjykatave të të gjitha niveleve, të cilat sipas individëve mbartin padrejtësi, pavërtetësi, paragjykim, anshmëri dhe zhgënjim të madh. Nga faktet dhe pretendimet që parashtrihen, vihet në dukje një humbje e besimit të individit tek organet gjyqësore dhe në procedurat që ato ndjekin gjatë procesit të vendimmarrjes. Në këtë kuader nuk duhet lënë në harresë edhe figura e avokatit, i cili mbron palët apo të pandehurin në një proces gjyqësor. Ka patur raste kur ndaj avokatëve janë shfaqur ankesa, duke i përkufizuar ata si ndërlidhës për afera të dyshimta mitmarrje. Pranë Zyrës së Pritjes së Popullit janë denoncuar edhe mos përmbushje të detyrës së tyre karshi klientëve, si dhe mos kthim të shumave në lekë për një punë të pa kryer. Ky sistem drejtësie i artikuluar dhe përshkruar nëpërmjet problemeve të qytetarëve në Zyrën e Pritjes, denoncohet në të gjitha rastet për mbartje elementësh të dyshimtë korrupsioni, niveli të ulët etiko-profesional dhe me lidhje interesash të paligjshme.

Një problem tjetër që është evidentuar gjatë pritjes së qytetarëve janë edhe konfliktet e shumta të pronësisë ndërmjet tyre. Ka një numër të konsiderueshëm çështjesh në të cilat Komisionet e Kthimit e Kompesimit të Pronave me anë të vendimeve të tyre të mëparshme kanë krijuar konflikte pronësie, mbivendosje, njohje pronarësh të dyshimtë, kthime trojesh në zona urbane të ndaluara me ligj etj. Kjo dukuri vihet re edhe në zonat rurale ku nga vendimet e mëparshme të komisioneve të tokave janë krijuar amulli midis pronarëve të rinj dhe të vjetër, të cilët enden dyerve të gjykatave. Gjithashtu nuk mund të lëmë pa përmendur edhe vetë sjelljen e pa ekuilibruar dhe të pa mbeshtetur në ligj të individëve, të cilët forcërisht

kanë pushtuar troje dhe toka bujqësore, duke passjellë probleme dhe konflikte sociale deri edhe në humbjen e jetës së njerëzve.

Një dukuri e veçantë e shfaqur me mjaft rezerva dhe protestë janë procedurat e aplikimit për vizë në ambasadat e huaja në Shqipëri dhe sjellja e autoriteteve të huaja jashtë vendit më individët shqiptarë. Nga deshmیتë dhe faktet e vëna në dispozicion, kemi evidentuar një situatë në të cilën, përfaqesitë diplomatike, veçanërisht Greke dhe Italiane veprojnë me mungesë respekti, dinjiteti, rregulli gjatë aplikimit për vizë të qytetarëve shqiptarë. Gjatë refuzimit të vizës që përfaqësia konsullore Italiane apo Greke kryen ndaj individëve, shpesh ajo nuk jep arsyen dhe të dhënat konkrete të këtij refuzimi. Për shumë individë është e pamundur e drejta e ankimit për këtë refuzim pasi organi i cili shqyrton këto ankesa ndodhet në shtetin e huaj dhe në Shqipëri nuk ekziston një infrastrukturë e mirëfilltë ndihmë ligjore private avokatore për ndjekjen e ankesave në gjykatat e huaja. Ky fenomen haset shpesh edhe për personat të cilët shpallen të pa dëshirueshëm në shtetet fqinje dhe dëbimi i tyre nuk ka mundësi reale ankimimi pasi afatet për ta kryer këtë janë të shkurtra. Gjithashtu janë bërë prezente ankesa lidhur me trajtimin çnjerëzor e brutal të autoriteteve policore greke në ambjentet e postave të policisë si dhe në sistemin e burgjeve.

Një grupim tjetër ankesash e kërkesash jashtë juridiksionit dhe kompetencave të Avokatit të Popullit, por që gjithsesi bëhen prezent dhe marrin orientim nga ana e zyrës tonë janë edhe ato të cilat bëjnë fjalë për konfliktet e mardhënieve midis qytetarit dhe subjekteve juridike private. Shkurtimisht dukuritë që vihen re kanë të bëjnë me pushime nga puna, me mos përpilimin e një kontrate punësimi, me mos pagimin e sigurimeve shoqërore nga firmat private, me mos pagimin e pagave dhe shpërblimeve të tjera për një kohë të gjatë, me mos respektimin e statusit të patrehut nga ana e firmave private të ndërtimit etj. Në këto raste qytetarët janë orientuar në instancat përkatse shtetërore (Psh ne Inspektoriatin Shtetëror të Punës) për të marrë ndihmën e nevojshme ligjore. Në cdo rast është bërë e qartë se Avokati i Popullit është i gatshëm të ndërhyjë me kompetencat që i jep ligji vetëm kur në organet përgjegjëse për parandalimin e këtyre fenomeneve nuk gjendet angazhimi dhe përkushtimi i duhur institucional.

Si rrjedhim i problemeve të lartpërmendura, Zyrës së Pritjes së Popullit i janë ngarkuar detyra të rëndësishme funksionale. Këshillimi ligjor, orientimi dhe sugjerimi për zgjidhje të problemeve të ndryshme janë procedura që ndiqen me shumë individe. Këta të fundit paraqiten e kërkojnë mendime të ndryshme për mjaft shqetësime, padrejtësi, procese gjyqësore, konflikte pronësie etj. Sigurisht këshillimi i Zyrës së Pritjes

është i limitizuar dhe përkon më shumë në parime e përgjithsime të zgjidhjes së rasteve, sepse në një mënyrë më të detajuar qytetarit i ofrohet ndihmë nga ana e zyrave avokatore private, aktivitet i cili nuk mund të zhvillohet nga Avokati i Popullit.

Nga konkluzionet e arritura si rrjedhim i nje eksperience prej më shumë se 2 vjetësh së Zyrës së Pritjes së Popullit dhe të mardhënieve me individët në përgjithësi, mendojmë se angazhimi ynë i mëtejshëm për krijimin e urave të reja të komunikimit do të përbëjë një aspekt mjaft pozitiv të punës tonë, i cili do të ketë reflektimin e tij edhe në vlerësimet e qytetarëve. Në planet e punës tonë mendohet të krijohen strategji të reja mardheniesh të cilat në gjuhën e thjeshtë dhe pa ekuivoqe përkthehen si kontakt intensiv dhe i vazhdueshëm me publikun, më shumë lehtësi dhe mirëkuptim në parashtrimin e ankesave, më tepër obligim dhe mirëbesim në shërbimet që ofrojmë ndaj qytetarëve.

B. Ditët e Hapura – Përvojë për t'u vazhduar

Sikundër kemi informuar në raportin e vitit të kaluar, Institucioni i Avokatit të Popullit, gjatë vitit 2002 filloi të zbatojë një formë të re të komunikimit të drejtpërdrejtë me qytetarët, që e quajmë “Ditët e hapura”. Kjo formë e takimeve të drejtpërdrejta me publikun lindi nga vizioni ynë se qytetarët duhet ta ndejnë kudo mirëqeverisjen e shtetit të tyre. Në kushtet e një decentralizimi gjithnjë e në rritje në favor të kompetencave të qeverisjes vendore, Avokati i Popullit mendon se më e mira është që problemet të zgjidhen atje ku lindin dhe me personat që, me dashje apo nga padituria, ua krijojnë atyre këto probleme. Çdo autoritet vendor, qysh kur kandidon për t'u zgjedhur, angazhohet që, përmes mirëqeverisjes, ta bëjë fshatin, komunën, apo qytetin ku zgjidhet apo caktohet për të qeverisur, një vend më të mirë për të jetuar.

Kjo praktikë mendojmë se është efikase për një njohje të gjerë e të thellë spektrale të problematikës që fle poshtë sipërfaqes së shoqërisë. Kjo praktikë shkurton së tepërmi procedurat burokratike, rrugët e gjata drejt Tiranës, shpenzimet ekonomike, e pse jo, edhe manipulimet e mundshme me të drejtat e qytetarëve. Nëse procedurat zbatohen me korrektesë, qytetari nis të rrisë besimin tek shteti i vet, tek institucionet dhe ligji. Nga ana tjetër, kjo synon të ndryshojë gradualisht qëndrimin e qytetarit ndaj shtetit, duke mos e parë atë thjesht si “gogol” detyrimesh, që tund para tij vetëm ashpërsinë formale të ligjeve e taksave, por as edhe si “prind” që të merr për dore për të treguar ta gjitha ato që ti dëshiron të bësh.

Sikundër kemi bërë të ditur edhe për opinionin publik dhe atë zyrtar, Avokati i Popullit ka menduar që shërbimin e tij ta ofrojë në mënyrë

permanente, fillimisht në pesë rrethe në skajet e largëta të vendit. Për këtë është përgatitur edhe një projekt i cili deri tani fatkeqesisht ka ngelur ende në letër.

Megjithatë ky projekt po synohet të kthehet në një projekt bashkëpunimi rajonal, qe Avokati i Popullit ka inicuar me zyrat e Ombudsmanit ne vendet e tjera të Ballkanit, si Maqedonia, Kosova, Mali i Zi. Ky projekt synohet të realizohet përmes programit FRESTA që qeveria e Mbretërisë së Danimarkës ka hartuar në kuadrin e nxitjes së bashkëpunimit rajonal. Në këto kushte gjatë vitit 2003, Avokati i Popullit e shfrytëzoi fondin e mbetur nga projekti DANIDA, i cili u mbyll në 31 Shtator 2003, për blerjen e dy makinave tip furgon, të parashikuara të jenë si zyra lëvizëse, për të realizuar objektivin tonë, pra të jemi sa më afër njerzve, pikërisht atje ku lindin problemet.

6. Marrëdhëniet me jashtë

Gjatë vitit 2003, nëpërmjet pjesëmarrjes ne konferenca, aktivitete nderkombetare e ne tryeza shumëpaleshe sikurse dhe nëpërmjet vizitave te zhvilluara brenda dhe jashtë vendit është arritur qe Institucioni i Avokatit te Popullit, jo vetem qe ka bërë te njohur përvojen e tij si dhe ka shkëmbyer mendime qe i sherbejne interesit te përbashket te familjes se madhe te Ombudsmanit por ka mundur te konsolidoje me mire urat e bashkepunimit me organizmat nderkombetare për mbrojtjen e te drejtave te njeriut sikurse dhe ka bërë te mundur zgjerimin dhe forcimin e metejshem te marredhenieve me Homologet Ombudsmane dhe zyrat e tyre.

Me poshte ju njohim me aktivitetin e marredhenieve me jashtë te ketij Institucioni për vitin 2003

I. Aktivitete të organizuara nga Këshilli i Europës:

a) Konferenca e Pestë mbi Reformën në Drejtesinë Shqiptare në kuader të Planit të Dytë të Veprimt për një funksionim sa më efektiv të sistemit gjyqësor nënshkruar më 23 Maj 2001 nga Autoritetet e Shqipërisë, Komisionit European dhe Këshillit te Europës.

Sarandë, 10-11 Shkurt 2003

Avokati i Popullit, prezantoi realitetin tre vjeçar të egzistencës së këtij institucioni që nëpërmjet ndërhyrjeve të tij ka synuar zbatimin korrekt të procedurave administrative dhe rivendosjen e se drejtes se shkelur te

qytetarit nga administrata apo autoritetet publike. Avokati i Popullit theksoi se këto nderhyrje behen edhe me imperative nese merret parasysh fakti i mungeses deri tani te Gjykates Administrative e për pasoje impakti i tyre duhet te jete edhe me i madh.

Pjesemarresit nenvizuan qe Avokati i Popullit kishte zhvilluar nje bashkepunim konstruktiv me autoritetet shteterore. Ata vleresuan bashkepunimin efikas te disa partnereve nderkombetare duke ju bërë thirrje atyre te vazhdojne bashkepunimin e tyre lidhur me trajnimet profesionale te stafit te Avokatit te Popullit si dhe për zhvillimin e metejshem te sistemit te menaxhimit te rasteve. Ata e mbeshteten rolin e Avokatit te Popullit ne ndihmen për akses ne drejtesi te qytetareve si dhe ne ndihmen për nje sistem gjyqesor efikas.

***b) Seminari me teme “Roli i Konventes Europiane për te Drejtat e Njeriut ne Mbrojtjen e te Drejtave te Njeriut dhe përdorimi i saj nga Institucioni i Avokatit te Popullit”
Tirane, 17-18 Mars 2003.***

Institucioni i Avokatit te Popullit ne bashkepunim me Drejtorine e Përgjithshme te te Drejtave te Njeriut prane Keshillit te Europes, organizuan ne Tirane , me 17 dhe 18 mars 2003, seminarin me teme “Roli i Konventes Europiane për te Drejtat e Njeriut ne Mbrojtjen e te Drejtave te Njeriut dhe përdorimi i saj nga Institucioni i Avokatit te Popullit”.

Qëllimi i këtij seminari ishte te analizonte përdorimin e Konventes Europiane për te Drejtat e Njeriut ne trajtimin e ankesave te qytetareve nga ana e Avokatit te Popullit.

Ne kete seminar moren pjese studiues vendas edhe te huaj Ombudsmani i Sllovenisë zoti Handzhe te cilet referuan rreth sfondit historik, mekanizmave dhe parimeve te interpretimit te Konventes, rolit te Institucionit te Ombudsmanit ne mbrojtjen e te drejtave te njeriut dhe bashkepunimit te tij me institucionet e tjera kombetare dhe OJF.

***c) Konferenca me rastin e 5- vjetorit te hyrjes ne fuqi te Struktures se Konventes për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombetare, te Keshillit te Europes.
Strasburg, 30-31 tetor 2003***

Konferenca e organizuar nga Keshilli i Europes me rastin e 5- vjetorit te hyrjes ne fuqi te Struktures se Konventes për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombetare, mbajtur ne Strasburg me 30-31 tetor 2003, u përqendrua ne

shkëmbimin e eksperiencave dhe pikepamjeve të pjesëmarrësve lidhur me arritjet në zbatimin e kësaj konvente, e cila u përkufizua si një mjet i përbashkët për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare që promovon stabilitet dhe siguri demokratike në Europë.

Në këto konference morën pjesë edhe përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit.

***d) Tavolina e 8-të e Rrumbullakës së Ombudsmenëve Europiane.
Oslo, 3-5 nëntor 2003***

Avokati i Popullit, Z. Ermir Dobjani, mori pjesë në Tavolinën e 8-të të Rrumbullakës organizuar nga Këshilli i Europës në bashkëpunim me Ombudsmenin Parlamentar të Norvegjisë që u mbajt në Oslo më 3-5 nëntor 2003. Kjo tavolinë synonte shkëmbimin e eksperiencave dhe informacioneve mbi gjendjen e të drejtave të njeriut në shtetet anëtare, duke u përqendruar veçanërisht në:

- Statusin ligjor të të burgosurve
- Të drejtat e anëtarëve të minoriteteve
- Të drejtat e aksesit në dokumentat zyrtare nga publiku
- Fuqitë respektive të Ombudsmenëve dhe gjykatave.

Për këto çështje tashme të identifikuar nga Ombudsmenet, u diskutua përfshirja praktike e normave europiane për të drejtat e njeriut në punën e tyre, e në veçanti masat që Ombudsmenet vetë duhet të marrin me qëllim që të sigurojnë respektimin e të drejtave të lartpërmendura të individëve.

II Aktivitete të organizuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB):

***a) Sesionin e raportit vjetor të Komitetit Nderkombëtar të Koordinimit të Institucioneve Kombëtare për Promovimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.
Gjenevë 15-16 prill 2003***

Një delegacion i Institucionit të Avokatit të Popullit mori pjesë në cilësinë e vëzhguesit, në Sesionin (e raportit) vjetor të Komitetit Nderkombëtar të Koordinimit të Institucioneve Kombëtare për Promovimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut që u mbajt në Gjenevë më 15-16 prill 2003. Delegacioni u njoh nga afër me aktivitetin e këtij komiteti dhe

strategjine e tij për konsolidimin e institucioneve kombetare, koordinimin e punes se tyre si dhe format e mbeshtetjes institucionale qe ushtron ky organizem ndaj shteteve për mbrojtjen e te drejtave te njeriut. Ne fjalen e tij Komisioneri i Larte për te Drejtat e Njeriut u ndal ne rolin e rëndësishem qe duhet te luajne institucionet kombetare për mbrojtjen e te drejtave te njeriut si dhe ne punen e madhe qe këto institucione duhet te bejne për te ndergjegjesuar shtetet pale te konventave ne respektimin e parimeve te gjithepranuara.

***b) Tavolina e Rrumbullaket dy ditore mbi Institucionet Kombetare dhe Administraten e Drejtesise
Kopenhagen,13-14 nentor 2003***

Dy përfaqesues te Avokatit te Popullit moren pjese ne Tavolinen e Rrumbullaket dy ditore mbi Institucionet Kombetare dhe Administraten e Drejtesise, organizuar nga Komisioneri i Larte për te Drejtat e Njeriut te Kombeve te Bashkuara ne bashkepunim me Institutin Danez për te Drejtat e Njeriut ne Kopenhagen, me 13-14 nentor 2003, me rastin e 10 vjetorit te miratimit te Parimeve te Parisit. Kjo Tavoline synonte te rriste ndergjegjesimin e instancave shteterore te shteteve pjesemarrese për sigurimin e nje aksesit me te madh ne administrimin e drejtesise te instancave kombetare për mbrojtjen e te drejtave te njeriut dhe zyrave te Ombudsmanit. U theksua rritja e rolit te Ombudsmanit ne sistemin e drejtesise përmes rolit te tij si *amicus curia*, sikurse dhe nxitja e bashkepunimit te tij me zyrat e prokurorise për mbarevajtjen e hetimeve, por edhe për sigurimin e mosshkeljes se te drejtave te njeriut gjatë tyre .

III. Konferenca te tjera nderkombetare:

***a) Takimi i pare i Ombudsmaneve Kombetare te Ballkanit
Perendimor
Sarajeve 24-26 janar 2003***

Avokati i Popullit, Z. Ermir Dobjani, me ftese te Ombudsmanit Kombetar te Bosnje Hercegovines, Z. Frank Orton, mori pjese ne Takimin e pare te Ombudsmaneve Kombetare te Ballkanit Perendimor, mbajtur ne Sarajeve me 24-26 janar 2003. Qellimi i ketij takimi ishte te analizoheshin çështje dhe problematika te interesit te përbashket, te degjoheshin keshilla me vlere lidhur me probleme te aktualitetit sikurse dhe te shkembeshin

eksperiencat e njeri tjetrit përsa i përket metodave të dobishme për të luftuar burokracine e stilit të vjetër dhe keqadministrimin.

Shumë me interes u diskutua çështja e organizimit të institucionit të Ombudsmanit Kombëtar si një i vetëm, që u pranua nga të gjithë pjesëmarrësit si modeli më i mirë për realizimin sa më efikas të detyrës së Ombudsmanit në mbrojtje të të drejtave të qytetarit.

b) *Konferenca e 19-të Vjetore të Ombudsmanëve Amerikane në Orlando, Florida, më 19-21 maj 2003*

Dy përfaqësues nga Institucioni i Avokatit të Popullit morën pjesë në Konferencën Vjetore të 19-të të Ombudsmanëve Amerikane me temë: “Sfida e Ombudsmanëve Profesionale: balancimi i praktikës me teorinë”.

Shoqata e Ombudsmanëve Amerikane (TOA) është shoqata më e madhe jofitimprurese e ombudspersonave profesionale, e cila përfaqëson mbi 400 anëtarë nga shumë vende të botës. Kjo shoqatë mbështet dhe promovon praktiken më të mirë organizative të ombudspersonave në mbare botën, duke u përqendruar në korporata, universitete, organizata jofitimprurese, ente qeveritare dhe joqeveritare.

Në këtë konferencë pjesëmarrësit patën mundësinë të diskutojnë në tavolinë të rrumbullakta mbi çështje të rëndësishme bashkohore për të gjithë Ombudsmanet të cilat përfshinin: Marrëdhënien e Ombudsmanit me median, Paanshmeria, Barazia dhe Drejtësia si baza e punës së Ombudsmanit si dhe u diskutua shumë gjëllërisht mbi praktikën më të mirë të Ombudsmanëve të sjella në këtë Konferencë.

Delegacioni i Avokatit të Popullit foli mbi bazën e përvojës së përditshme të Zyres tone, duke bërë të njohura njekohësisht edhe vështirësitë e ndeshura gjatë veprimtarisë së deritanishme.

c) *Seminari “Roli i Ombudsmanit në vendet e Europës Juglindore- Forcimi i shtetit ligjor si një hap përpara drejt integritetit Europian” Athinë, 22-23 maj 2003*

Ishte pjesë e “Projektit Eunomia” të Këshillit të Europës dhe të Ombudsmanit Grek për promovimin e institucioneve të Ombudsmanit në vendet e Europës Juglindore që bëri të mundur organizimin në Athinë të seminarit me temë: “Roli i Ombudsmanit në vendet e Europës Juglindore- Forcimi i shtetit ligjor si një hap përpara drejt integritetit Europian”. Në këtë seminar morën pjesë dy përfaqësues të Avokatit të Popullit, të cilët

diskutuan mbi mundësite e forcimit të rolit të Ombudsmanit si një faktor stabilizues në vend si dhe mbi bashkëpunimin e Ombudsmaneve rajonale, si kusht dhe nxitje për bashkëjetese integruese në komunitetin Europian.

**ç) Konferenca me teme:
“Ombudsmani në demokracite e reja dhe të vjetra”
Insbruck 26 qershor 2003**

Me ftese të Institutit Europian të Ombudsmanit (EOI), një përfaqësues Avokati i Popullit mori pjesë në konferencën me temë “Ombudsmani në demokracite e vjetra dhe të reja” organizuar në Insbruck nga Instituti Europian i Ombudsmanit (EOI), në bashkëpunim me Universitetin e Insbruckut më 26 qershor 2003. Qëllimi i kësaj konference ishte të bente një analizë të krahasuar si dhe të ndihmonte Ombudsmanet europiane në evidentimin e diversiteteve të tyre në planin ligjor dhe praktik.

Roli i Ombudsmanit Parlamentar të Suedisë u vlerësua si mjaft eficient, tepër pozitiv për nga tradita, kuadri ligjor, kompetencat dhe arritjet dhe u evidentua si shembull konkret që tregon se Ombudsmanet Europiane kanë një të ardhme të gjatë, të sigurt dhe të suksesshme.

d) Vizita e Parlamentareve shqiptare dhe e Avokatit të Popullit në Danimarkë

Më 2-4 korrik 2003 Avokati i Popullit sëbashku me 7 deputetë shqiptarë anëtarë të Komisionit Parlamentar të Ligjeve e të drejtave të njeriut bënë një vizitë zyrtare në Kopenhagë ku patën mundësinë të njihen nga afër me punën në institucione të rëndësishme shtetërore daneze si Parlamenti, Ombudsmani, Policia etj.

**e) Konferenca e Pare Nderkombetare e Rrjetit Ballkanik për të Drejtat e Njeriut.
Zagreb, 3-4 tetor 2003**

Në konferencën e Pare Nderkombetare të Rrjetit Ballkanik për të Drejtat e Njeriut me temë: “Komisioni i Europës jug-lindore për të drejtat e njeriut, mundësitë dhe perspektivat”, që u mbajt në Zagreb, Kroaci më 3-4 tetor 2003 mori pjesë edhe një përfaqësues i Avokatit të Popullit. Kjo konference kishte qëllim të nxirrte në pah domosdoshmerinë dhe mundësinë për krijimin e një organi ndërqeveritar që do të përqendroje pushtetin e vet politik dhe keshillues në përmirësimin e rregullave dhe

praktikave të drejtave të njeriut në rajon. Kjo konferencë e zhvilloi tematikën e vet në tre aspekte:

- Domosdoshmeria e bashkepunimit rajonal të Institucioneve Kombëtare për të drejtat e njeriut me OJF-te që ushtrojnë aktivitetin e tyre në këto fushë.
- Domosdoshmeria e bashkepunimit të Qeverive përkatëse me këto Institucione dhe OJF.
- Domosdoshmeria e krijimit të Komisionit të Europës juglindore për të drejtat e njeriut.

f) Konferenca nderkombëtare “Natyra në ndryshim e Institucionit të Ombudsmanit në Europë” si dhe Takimi Vjetor i anëtarëve votues të Institutit Nderkombëtar të Ombudsmanit (IOI) për rajonin e Europës.

Nikosia, Qipro 9-10 tetor 2003

Me ftesë të Komisioneres për Administratën (Ombudsman) e Qipros, Zj. Eliana Nicolau, dy përfaqësues të Avokatit të Popullit morën pjesë në Konferencën Nderkombëtare “Natyra në ndryshim e Institucionit të Ombudsmanit në Europë” si dhe në Takimin Vjetor të anëtarëve votues të Institutit Nderkombëtar të Ombudsmanit (IOI) për rajonin e Europës, organizuar në Nikosi më 9-10 tetor 2003.

g) Kongresi Statutor i Shoqatës së Ombudsmanëve dhe Mediatorëve Frankofone

Tunizi, 14-17 tetor 2003

Duke qenë anëtar i Shoqatës së Ombudsmanëve dhe Mediatorëve Frankofone që përmban rreth 40 Ombudsmanë dhe Mediatorë prej 30 vende të ndryshme, Avokati i Popullit mori pjesë në Kongresin statutor të kësaj Shoqate me temë: “Ombudsmani/Mediator, aktor i transparencës administrative” që u mbajt në Yasmine Hammamet, Tunizi më 14-17 tetor 2003. Në këtë Kongres doli në pah domosdoshmeria për të mbrojtur vlerat e demokracisë, të shtetit të së drejtës si dhe të drejtat e personit nëpërmjet kater nentemave ku u përqendrua ky Kongres:

1. Ombudsmanet/Mediatorët dhe lufta kundër korrupsionit
2. Ombudsmanet/Mediatorët dhe administrata.
3. Ombudsmanet/Mediatorët dhe aksesimi në dokumentat administrative.

4. Ombudsmanet/Mediatoret dhe aksesit në të dhënat personale të disponuara nga administratat.

h) Konferenca e Ombudsmaneve Rajonale të Europës Juglindore Sofie, 28-30 nëntor 2003

Me ftesë të Parlamentit bullgar dhe Ombudsmanit të Greqisë, Z. Yorgos Kaminis, Avokati i Popullit, Z. Dobjani, mori pjesë në Konferencën e Ombudsmanit Rajonal të Europës Juglindore që u mbajt në Sofie me 28-30 nëntor 2003. Konferenca u mbështet nga Këshilli i Europës nëpërmjet Projektit EUNOMIA që kontribuon në promovimin e Institucioneve të Ombudsmanit në Europën Juglindore nëpërmjet një vargu aktivitetesh. Qëllimi i aktiviteteve është kontributi për krijimin dhe mbështetjen afat mesme të institucioneve mediatore të reja në vendet e Europës Juglindore duke siguruar njëkohësisht trajnime për personelin e Ombudsmanit nëpërmjet krijimit të rrjeteve ndërkombëtare joformale.

Qëllimi i konferencës ishte për t'i bërë një shqyrtim punës së Ombudsmanit rajonal si dhe për të konsideruar rekomandime të rëndësishme në të mirë të kryerjes së punës së Ombudsmanit në mënyrën më optimale të mundshme. Konferenca dha mundësinë e diskutimit të atyre çështjeve të rëndësishme që Ombudsmani përballët në punën e tij të përditshme duke theksuar vecanërisht specifikat rajonale.

i) Simpoziumi i Pare Nderkombëtar “Drejt një Konsumi të Panderprerë”, Paris 1 dhjetor 2003

Një përfaqësues i Avokatit të Popullit mori pjesë në Simpoziumin e Pare Nderkombëtar në Paris me temë “Drejt një Konsumi të Panderprerë” organizuar nga Sekretari i Shtetit për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, për tregtine, artizanatin, profesionet e lira dhe çështje të konsumit.

IV. Vizitat e Ombudsmaneve të shteteve të tjera në Shqipëri

Gjatë vizitave të dy homologeve të Avokatit të Popullit të realizuara me ftesë të tij gjatë vitit 2003, përveç solidaritetit të tyre dhe gadishmerisë për bashkëpunim është shprehur edhe impresionimi i tyre pozitiv mbi sukseset dhe mbarevajtjen e këtij Institucioni të ri në Shqipëri.

Shkëmbimi i këtyre vizitave konfirmon angazhimin e institucioneve të vendeve tona ballkanike për të bashkëpunuar e për tu integruar në strukturat euroatlantike.

1. Me 27 shkurt-2 mars 2003, ne kuadrin e bashkepunimit rajonal e te shkembimit te eksperiencave midis zyrave homologe bëri nje vizite zyrtare ne Shqipëri Z. Ante Klaric, Ombudsman i Republikës se Kroacisë.

Z. Klaric, jurist i vjeter me nje kariere 30 vjeçare ne çeshtjet ligjore, pasi u njoh me veprimtarine e kryer nga Institucioni i Avokatit te Popullit te Shqipërisë u shpreh shumë pozitivisht për arritjet e ketij institucioni duke nenvizuar qe përfitimet nga kjo vizite kishin qene te ndersjellta.

Ne takimet e Z. Klaric me autoritetet e larta te Shqipërisë ai vleresoi gjithashtu marredheniet e mirekuptimit te vendosura midis Avokatit te Popullit dhe përfaqesuesve te larte te administrates shtetore.

2. Ne daten 24-27 prill 2003, me ftese te Avokatit te Popullit, Z. Ermir Dobjani, erdhi ne Tirane Ombudsmani i Maqedonise, Z. Branko Naumoski. Qellimi i kesaj vizite ishte bashkepunimi midis dy zyrave homologe, ne kuadrin e bashkepunimit rajonal ne fushen shumë te rëndësishme të mbrojtjes se te drejtave te qytetareve.

Me nje përvoje 25 vjecare ne fushen e drejtesise Z. Naumoski, pasi u njoh nga afer me Institucionin tone dhe aktivitetin e kryer gjatë periudhes 3 vjeçare te veprimtarise se tij dhe pasi vleresoi pozitivisht arritjet e ketij institucioni dhe shprehu edhe njehere gadishmerine e tij për nje vazhdimesi gjithmone e ne rritje te bashkepunimit midis dy zyrave homologe.

V. Vizitat e Avokatit te Popullit ne zyrat e Ombudsmaneve te vendeve te tjera

1. Me 8-11 prill 2003, me ftese te Komisionerit për te Drejttat e Njeriut ne Federaten Ruse, Z. Oleg Mironov, nje delegacion i Institucionit te Avokatit te Popullit i kryesuar nga Avokati i Popullit beri nje vizite zyrtare ne Moske.

Qellimi ishte kthimi i vizites qe Z. Mironov beri ne Shqipëri ne korrik 2002 si dhe zhvillimi i marredhenieve dypaleshe me Zyren homologe ne Moske. Ne bisedimet e bera, Ombudsmani Rus theksoi se ligji shqiptar për Avokatin e Popullit është nder me te miret ne Europe dhe se ky ligj nuk paraqitet si nje skeme tradicionale e kopjuar, por aty gjen te reflektuar edhe traditen e vendit.

Delegacioni shqiptar u prit nga personalitete te larta te shtetit rus, përfshire Kryetarin e Dumes Shtetore (Parlamentit Rus), zv.Ministrin e Drejtesisë etj.

2. Me ftesë të Ombudsmanit të Republikës së Kroacisë, Z. Ante Klaric, Avokati i Popullit i ktheu vizitën homologut të tij në Zagreb.

Qëllimi i vizitës ishte njohja nga afër me Institucionin dhe punën e Ombudsmanit të Kroacisë si dhe fillimi i fazës së thellimit të bashkëpunimit midis të dy zyrave nëpërmjet shkëmbimit të përvojave, trajnimeve profesionale, seminareve etj.

Në këtë vizitë Avokati i Popullit u prit nga Presidenti i Republikës së Kroacisë, Z. Stipe Mesiç, sikurse dhe nga autoritete të tjera të larta të vendit.

VI. Vizitat për shkëmbim eksperience dhe trajnime të stafit të zyrës së Avokatit të Popullit

1. Gjatë muajit shkurt 2003, specialistët e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë realizuan mundësinë e ngritjes profesionale të gjuhës angleze nëpërmjet pjesëmarrjes në kurset 2 javore në Qendrën e Gjuhës Angleze Bell, në Angli.
2. Më 15- 26 Shtator 2003 një ekspert i zyrës së Avokatit të Popullit mori pjesë në trajnimin ofruar nga Instituti i Administratës Publike (PAI) në Londër.
3. Më 20-25 shtator 2003 grupi i dytë i ekspertëve i Zyrës së Avokatit të Popullit realizoi trajnimin një javor pranë Zyrës së Ombudsmanit të Republikës së Sllovenisë.

VII. Ekspertët e huaj në zyrën e Avokatit të Popullit

1. Në Janar 2003 kanë qenë në Zyrën e Avokatit të Popullit për të dhënë kontributin profesional në vazhdim Keshilltari Ligjor pranë Ombudsmanit Danez, Z. Jens Olsen dhe specialisti i sistemit kompjuterik Z. Christian Moller nga Zyra e Ombudsmanit Parlamentar të Danimarkës.
2. Më 9-13 mars 2003 erdhën në zyrën e Avokatit të Popullit për të dhënë eksperiencën e tyre profesionale 2 ekspertë nga Zyra e Ombudsmanit Kombëtar të Hollandës.

7. Bashkëpunimi me Institucionet Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut

Avokati i Popullit ka vendosur tashmë marrëdhënie partneriteti me Institucionet Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, si Amnestia Ndërkombëtare, Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, Komiteti Kundër Torturës dhe Trajtimeve Çnjerëzore etj.

Objekt i këtyre marrëdhënieve janë informimi reciprok për çështje të veçanta të abuzimit të policisë shqiptare me të drejtat e njeriut, sikundër edhe koordinimi i veprimeve për të ushtruar presion pozitiv mbi autoritetet përkatëse të vendeve fqinj, në rastet kur është abuzuar me shtetasit shqiptare, sepse sikundër dihet juridiksioni i Avokatit të Popullit mungon.

Faktikisht, Amnestia Ndërkombëtare, gjatë vitit 2003, na është drejtuar për tre raste konkrete, ndër të cilët, një për qëndrimin e Parlamentit lidhur me ndryshimin e ligjit për mbajtjen e fytyrës së maskuar nga forcat speciale, në rastin e dytë për shtetasin V.B, të vrarë nga policia greke, sikundër edhe në rastin e tretë të shtetasit G.D, të keqtrajtuar po nga policia greke.

Nga ana tjetër, Avokati i Popullit nuk ka munguar të informojë Amnestinë Ndërkombëtare si dhe instancat e tjera ndërkombëtare për raste të tjera, sa konkrete, aq edhe të një natyre të përgjithshme, që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut nga forcat e policisë.

Grupet e Amnestisë Ndërkombëtare insistojnë që organet e drejtësisë në Shqipëri nuk kanë qenë efikase, sidomos në drejtim të rasteve që kanë patur të bëjnë me atë që quhet fenomen i pandëshkueshmërisë të abuzuesve të ligjit dhe të drejtave të njeriut.

Lidhur me rastet e keqtrajtimit të shtetasve nga policia shqiptare, e kemi gjykuar me vend të përmendim një rast, të ardhur pranë Zyrës së Avokatit të Popullit, dhe konkretisht, rastin e ankimit të prindërve të shtetasve P.Ll dhe I.Ll, ku pretendohej për keqtrajtim të tyre nga Policia e Tiranës.

Në informacionin lidhur me këtë rast kemi shpjeguar se qytetarja D.Ll, nëna e P.Ll dhe I.Ll, më datën 27.05.2003, i ka paraqitur Avokatit të Popullit, ankesën ndaj Komisarariatit Nr.2 të Policisë Tiranë, se ishin kryer veprime keqtrajtuese ndaj dy fëmijëve të mësipërm. Po sipas saj, keqtrajtimi ka qënë në një shkallë të tillë, sa dy fëmijët e saj, P.Ll dhe I.Ll, ishin në gjendje të keqe shëndetësore.

Duke u nisur nga natyra e ankesës, si dhe praktika e punës tonë që, rasteve të tilla u japim përparësi për verifikimin e tyre, bëmë menjëherë verifikimet e nevojshme. Në këtë kuadër, më datën 27.05.2003 morëm

takim me P.Ll dhe I.Ll, duke i pyetur rreth ngjarjes në dëm të tyre. Mirëpo, nga ana e tyre, na u shpjegua se ndonëse punonjësit e policisë të komisariatit nr.2 Tiranë kishin përdorur dhunë ndaj tyre, ata nuk donin që çështja e tyre të ndiqej si nga Institucioni i Avokatit të Popullit, ashtu dhe ndonjë organ tjetër shtetëror.

Megjithë sqarimet tona, si dhe dhënien e sigurisë që ankimi i tyre për keqtrajtim nga Policia, nuk do të kishte asnjë ndikim negativ ndaj tyre, ata përsëri qëndruan në mendimin e tyre. Në këto kushte, në bazë të Ligjit “Për Avokatin e Popullit”, jemi të detyruar të ndërpresim verifikimet. Për sa më sipër vumë në dijeni ankuesen D.Ll, e cila na falenderoi për gadishmërinë tonë.

Ndërsa përsa i përket rasteve të keqtrajtimit të shqiptarëve nga ana e policisë greke, Amnestia Ndërkombëtare ka qenë ndër të parat që ne kemi informuar për të bërë sensibilizimin e nevojshëm, në mënyrë që autoritetet përkatëse të shtetit grek të mos lejojnë precedente të tilla që krijojnë hije dyshimi mbi marrëdhëniet shumë të mira që ekzistojnë midis dy shteteve dhe popujve fqinj. Avokati i Popullit i ka vlerësuar këto raste si shprehje të frymës ksenofobe të individëve të veçantë grekë ndaj imigranteve shqiptarë.

Ne menyrë të vazhdueshme Avokati i Popullit e ka falenderuar Amnestinë Ndërkombëtare për reagimin sensibilizues lidhur me rastet e keqtrajtimit të shqiptarëve nga forcat e policisë ushtarake greke, duke afirmuar në këto raste se edhe qëndrimi i tij ka qenë në të njëjtën linjë. Bashkërisht kemi ndarë konstatimin se në disa raste, kriminelët me uniformë të policisë apo ushtrisë gëzojnë pandëshkushmërinë e autoriteteve të drejtësisë së vendit fqinj. Avokati i Popullit ka bërë me dije se ai i ka ndjekur me precedencë rastet e keqtrajtimit, jo vetëm për hir të kryerjes së funksionit të tij për të trajtuar ankesat e ardhura, por ka konfirmuar se të njëjtën gjë ai do të bëjë edhe për ankesat eventuale të shtetasve grekë në Shqipëri, nëse do të keqtrajtoheshin nga policia shqiptare.

Duke iu referuar rasteve tashmë të bëra publike si ato të vrasjes së shtetasit V.B, apo të keqtrajtimit të mjaft shtetasve të tjerë, Avokati i Popullit ka vënë në lëvizje edhe zyrën e homologut të tij grek, z. Yorgos Kaminis, Zyrën e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut pranë Këshillit të Evropës, z. Alvaro Gil Robles, Komitetin kundër Torturës dhe Trajtimeve Çnjerëzore, pa munguar të informojë për këto çështje edhe në tryeza shumëpalëshe, sikundër ka qenë Seminari për Administrimin e Drejtësisë, organizuar nga Zyra e Komisionerit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut dhe Instituti Danez për të Drejtat e Njeriut, në Kopenhage 13-14 Nentor 2003.

Ndër rastet ku kemi informuar si dhe kemi kërkuar angazhimin e Amnesty International si dhe të gjitha instancaat ndërkombëtare të sipërpërmendura, është edhe ai i përkthyeses greke N.Vavacula, e cila megjithëse nuk e di gjuhën shqipe, është pranuar nga gjykata greke për të përkthyer shqiptarët nga 1991 deri 2000. Këto veprime kanë përbërë shkelje të rëndë të germës “e”, pika 3-të e nenit 6-të të Konventës Evropjane të të Drejtave të Njeriut nga gjykatat e Selanikut në Greqi.

Lidhur me këtë rast, Avokati i Popullit ka kërkuar nga Ombudsmani grek, të angazhohet për të mbledhur informacion nga Gjykata Penale e Selanikut (shkalla e parë dhe e dytë), për të saktësuar numrin e rasteve ku ka qenë përkthyes qytetarja greke në fjalë, dhe pas kësaj, të shikohet mundësia për rishikim të vendimeve në bazë të një procesi të rregullt, në përputhje me legjislacionin grek dhe konventat ndërkombëtare.

Kohët e fundit kemi filluar bashkëpunimin edhe me Komitetin Grek të Helsinkit, për të cilin kemi konstatuar se është një organizatë joqeveritare mjaft aktive në mbrojtje të të drejtave të të huajve në Greqi.

Si përfundim mund të themi se bashkëpunimi organizatat e mësipërme ka qenë dhe do të jetë i mirëpritur edhe në të ardhmen.

8. Konferenca Kombëtare “Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë në mbrojtje të të drejtave të individëve”

Sipas nenit 30, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, Institucion ynë në bashkëpunim me organizatat joqeveritare duhet të organizojë, të paktën një herë në vit, veprimtari kombëtare për gjendjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Shqipërisë. Në zbatim të këtij detyrimi, dhe te problematikes se sipërpërmendur, më datën 19 Dhjetor 2003, u zhvillua Konferenca Kombëtare “Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore te formes se prerë ne mbrojtje te te drejtave te individeve”, konferenca që u organizua nga Institucioni ynë në bashkëpunim me Komitetin Shqiptar te Helsinkit(OJF).

Për përgatitjen e Konferencës u punua gjatë gjithë vitit 2003, së pari duke shqyrtuar të gjitha ankesat që lidhen me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale dhe civile të formës së prerë, si dhe problemet që paraqesin ato. Në të njëjtën kohë u zhvilluan paralelisht tre monitorime. Kështu, mbështetur në kritere shkencore në hartimin e pyetësoreve dhe të numrit të të anketuarve, u intervistuan rreth 100 përmbarues në të gjithë vendin, një numër i konsiderueshëm të dënuarish që vuanin dënimin në burgje dhe të dënuar që vuanin ende dënimin në dhomat e paraburgimit. Në

te njejten kohe u intervistuan ne rrethet kryesore te vendit rreth 300 individe te cilet kishin probleme me zyrat e përmbarimit. Qellimi i zhvillimit te monitorimeve ishte evidentimi i problemeve nga disa kendveshtrime, se pari nga vete përmbaruesit gjyqesor, së dyti nga individet qe cenohen drejtepërdrejte nga mosveprimet dhe veprimet e paligjshme te organeve te administrates publike, dhe së treti nga te denuarit.

Konferenca synoi të rrisë ndergjegjësimin e strukturave shtetere ne funksion te realizimit te detyrimit kushtetues te ekzekutimit te vendimeve gjyqesore te formes se prere, duke e pare te lidhur ngushte kete proces me rekomandime konkrete ne drejtim te përmiresimit te legjislacionit përkates, apo te rritjes se aftesive profesionale te strukturave shtetere kompetente për ekzekutimin e vendimeve.

Përfundimet e Konferencës ishin:

1. Organizimi i konferences lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqesore te formes se prere, si nje detyrim kushtetues ne mbrojtje te te drejtave dhe interesave te ligjeshme te individeve, behet ne nje moment kur ky problem shqeteson nje pjese te mire te shoqerise shqiptare dhe si rrjedhoje paraqet nje problem serioz para shtetit shqiptar. Prandaj te gjitha institucionet shtetere shqiptare qe lidhen me kete çeshtje si Ministria e Drejtesise, Ministria e Financave, Ministria e Rendit, Organet e qeverisjes vendore jane te interesuara dhe detyrohen te angazhohen te gjenden zgjidhjet për te minimizuar kete fenomen negativ. Prandaj dhe Kryeministri me Urdhrin nr. 98 date 14.07.2003 ka urdheruar ngritjen e grupit te punes për evidentimin e vendimeve gjyqesore te formes se prere, me pale Institucionet e administrates shtetere, si dhe për marrjen e masave për fillimin e ekzekutimit te ketyre vendimeve, te kryesuar nga Zevendesministri i Financave dhe me përfaqesues nga Ministria e Drejtesise, Ministria e Puneve te Jashtme dhe Avokatura e Shtetit. Kjo sepse ne shtetin e te drejtes, nje element i rëndësishem i sistemit gjyqesor është ekzekutimi i vendimeve gjyqesore te formes se prere.

Duke patur parasysh kerkesat e Konventes Europiane te te drejtave te njeriut dhe ne veçanti njohjen qe i ben kjo konvente ekzekutimit te vendimeve gjyqesore, përfshire dhe afatet e ekzekutimit, trajtimi i kesaj çeshtjeje (ekzekutimit te vendimeve) duhet te konsiderohet si nje pjese integrale e te drejtes për te patur nje proces gjyqesor te paanshem, ashtu siç parashikohet nga neni 6 i Konventes. Shembull negativ është rasti i çështjes së parë nga Shqipëria që Gjykata e Strasburgut ka pranuar për gjykim, nga

ku pritet që shteti shqiptar të dënohet për mosekzekutim të një vendimi të Gjykatës së Tiranës.

2. Dihet se organi i ngarkuar me ligj për ekzekutimin e vendimeve janë përmbaruesit gjyqësor, të cilët duhet që me profesionalizimin dhe përkushtimin e tyre të arrijnë të përmbushin detyrimet e tyre ligjore për realizimin e të drejtës së individit. Por përmbaruesi, pothuaj në çdo çështje konkrete ndodhet para disa pengesave dhe presioneve nga të cilat vlen të vihen në dukje:

Trysnia e parë është ajo që transmeton kreditori me paraqitjen e kërkesës për ekzekutim, i cili pas një stresi dhe kalvari të gjatë seancash gjyqësore për disa vite, shpesh gjykimesh e rigjykimesh në të tre shkallët e gjyqësorit, gjatë të cilave ka konsumuar pjesën më të madhe të durimit, pret ekzekutim sa më të shpejtë të të drejtës së fituar.

Por nga ana tjetër përmbaruesi ndeshet me mungesën e vullnetit të debitorit për ekzekutimin vullnetar të detyrimit të tij. Shpesh ka presione dhe kërcënime, nderhyrje të personave të ndryshëm, me veprime ose mosveprime që mundohen ta pengojnë atë, duke mos pranuar e njohur vendimin e gjykatës. Rreth 40-50% e vendimeve të Komisionit të Sherbimit Civil që janë në favor të personave që kanë statusin e nënpunësit civil nuk zbatohen. Për fat të keq kjo ndodh edhe me funksionare të organeve të administratës publike, si për mungesë të formimit të tyre juridik, ashtu dhe mos marrjes së mendimit të juristëve të tyre që punojnë pranë tyre. Këta kundërshtojnë veprimet e përmbaruesit, duke patur në shumë raste edhe “ndihmen” e gjykatës që pezullon ekzekutimin, me apo pa të drejtë shpesh atë ditë që ka caktuar përmbaruesi për veprim. Pengesa janë edhe largimi nga vendi i banimit i debitorit, fshehja e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme me lloj lloj marifetesh që çojnë në pamundësinë financiare të shlyerjes së detyrimit, etj. Një shmangie sado e vogël e përmbaruesit në fazën e ekzekutimit çon në zgjatjen disa mujore të veprimeve të mëtejshme. Kjo gjendje ka bërë që përmbaruesit të zbatojnë në mjaft raste sanksionet me gjobe ose në rreth 80 raste kallezimin në prokurori si mjete detyruese.

Shpesh ka edhe vështirësi që dalin gjatë procesit të ekzekutimit, si psh. difektet që përmban vetë dispozitivi i vendimit gjyqësor të formës së prerë, duke qenë në kontradiktë llogjike me përmbajtjen e vendimit.

3. Transparenca gjatë ekzekutimit të vendimit gjyqësor dhe informimi i personave ndaj të cilave është dhënë një vendim si elementë shumë të rëndësishëm që ndikojnë në funksionimin dhe vlerësimet e zyrtare të përmbarimit, nuk janë në nivelin e duhur. 16.2 % e publikut të intervistuar

mendojnë se zyrat e përbarimit janë transparente, 57.84% thonë se janë disi transparente, ndersa 21.6% thone se jane aspak transparente.

4. Korrupsioni është një ndër problemet e ndeshura gjatë ekzekutimit te vendimeve. Nga intervistimi i publikut, 27% e tyre e pranojne ekzistencen e ketij fenomeni tek përbaruesit.

5. Situate e veshtire qe është krijuar prej kohesh është ajo për mos ekzekutimin e vendimeve gjyqesore te formes se prere nga entet, organet dhe institucionet buxhetore, me argumentin se mungojne fondet e duhura. Prej vitesh nuk po gjen zgjidhje ky problem i mprehte jo vetem ligjor, por edhe social, i shoqeruar edhe me renien e besimit ndaj organeve përbarimore dhe qe shpesh sjell edhe situata konfliktuale me te. Ne pushtetin vendor situata është me e rende. Bashkite kane ekzekutuar vetem 30%, kurse komunat vetem 20% te shumave qe ju detyrohen shtetasve sipas vendimeve gjyqesore te formes se prere. Debiti i krijuar ndaj kreditoreve buxhetore është ne shumta jo te vogla. Për kete shkelje te drejtave dhe interesave te ligjeshme te gjyq-fituesve, shumë struktura shteterore kane përgjegjesite e tyre ligjore. Jane planifikuar 250 milion leke për ekzekutimin e vendimeve gjyqesore për vitin 2004, qe jane rreth 100 milion me shumë se ne vitin 2003, Kjo paraqitet si diçka pozitive ne kete proces.

6. Ne dosjet përbarimore për ekzekutimin e vendimeve gjyqesore rezultojnë shtyrje pafundësisht të afateve të ekzekutimit vullnetar të detyrimit. Ka mosveprime edhe kur detyrimet janë në vlera të vogla, sidomos në rastet e detyrimeve për ushqim. Nga anketimi i publikut 69% e të intervistuarve thanë se ekzekutimi i tyre zvarritet 1 muaj deri në 1 vit; 22.4% pohuan se kjo zvarritje ishte prej 1-5 vjet dhe 3.9% e personave të intervistuar thanë se kishin mbi 5 vjet dhe vendimi nuk ishte ekzekutuar ende.

Me flagrante jane rastet kur nga kqyrja e dosjeve përbarimore gjatë procesit të verifikimit të ankesave, del se është vendosur pushimi i ekzekutimit për pamundësi pagimi ose të mos gjetjes të pasurive të debitorit, pa bërë verifikime dhe pa patur asnjë konfirmim zyrtar, nga Zyrat e Takse-Tatimeve, nga Bankat e nivelit të dytë, apo organe te tjera nga ku mund të merren të dhëna të sakta për pasurinë e luajtëshme e të paluajtëshme që mund të ketë debitorit.

7. Problematike paraqitet edhe situata lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqesore ndaj personave juridike e fizike private. Rreth 90.6% e te intervistuarve pranojne se kane ndeshur pengesa për ekzekutimin e

detyrimeve ne te holla ndaj personave fizike e juridike private. Veshtiresite ne me te shumten e rasteve kane qene per shkak te mungeses se te ardhurave dhe pasurive te ketyre te fundit, nderkohe qe dhe mungesa e te dhenave rreth adreses se sakte te debitoreve eshte mjaft problem gjate ekzekutimit te vendimeve gjyqesore. Kjo e fundit perben nje detyrim per gjykatën qe ne vendimin e dhene prej saj te jepen sakte gjeneralitetet dhe adresa e sakte e te debitorit apo te denuarit.

8. Nga te dhenat e anketimit te permbauesve paraqitet problematik niveli jo i kenaqshem i bashkepunimit midis organit permbaues dhe organeve te tjera te administrates shtetore dhe publike. Kjo situatë demton tepër punën, duke patur parasysh se ne shumicen dermuese te rasteve debitore jane pikerisht këto organe. Ne antiteze me këto rezulton se maredheniet dhe bashkepunimi me Policine e Shtetit dhe Prokurorine jane ne nivele te kenaqshme.

9. Institucioni i Avokatit e Popullit qe ne fillimet e punes se tij, si dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit, kanë patur ne vemendje trajtimin e problemit te mosekzekutimit te vendimeve gjyqesore qe kane marre forme te prere. Nuk kane qene te pakta rastet kur qytetare te ndryshem me vendime te gjykatave te formes se prere jane ankuar per kete ose ate organ te administrates, qe shperfill vendimin e dhene nga gjykata, duke mos e ekzekutuar ate dhe duke shkelur keshtu ne menyre flagrante te drejten e qytetarit te garantuar nga neni 143 i Kushtetutes dhe akte te tjera ligjore. Qysh ne vitin 2001, Avokati i Popullit i ka derguar rekomandim Ministrin te Financave dhe atij te Drejtesise, per marrjen e masave per nxjerrjen e udhezimeve qe percakton VKM nr.335, date 2.6.1998 "Per procedurat per zbatimin e vendimeve gjyqesore per detyrimet qe prekin buxhetin e shtetit". Ky rekomandim eshte ngritur ne te gjithë raportet vjetore te paraqitura para Parlamentit. Ne te njejten kohe te dhenat e anketimit te permbauesve tregojne se 95.8 % e te intervistuarve e pranojne dhe evidentojne si pengese kontraditat e ligjit me udhezimet e Ministrise se Financave si dhe mungesen e fondeve.

10. Nje konstatim tjetër eshte mungesa e Rregullave te hollesishme per funksionimin e sherbimit permbaues gjyqesor, detyrim qe rrjedh nga pika 2 e nenit 10 te Ligjit "Per organizimin dhe funksionimin e Sherbimit te Permbaues Gjyqesor". Kjo mungese ka sjelle qe te mos ketë uniformitet ne dosjet permbaues, sepse akoma nuk janë percaktuar se cilat duhet te jene aktet e domosdoshme qe duhet te ketë një dosje permbaues, procedurat per te mundesuar kalimin per vazhdimin e ekzekutimit te dosjes nga një permbaues tek tjetri brenda te njëjtës zyre, si do ndërtohen

marrëdhëniet përmbarues-përgjegjës i zyrës, etj. probleme që lindin gjatë praktikës së përditëshme.

Përsa i përket ekzekutimit të vendimeve gjyqesore penale të formës së prere, nëpërmjet ankesave të të burgosurve të bera tek Avokati I Popullit del se shumë raste të shkeljes së të drejtave të të burgosurve vijne si rezultat i mosëkzekutimit si duhet të vendimeve gjyqesore penale dhe të mungesës së kushteve të përshtatshme në burgjet apo në dhomat e izolimit pranë Komisariateve të policisë.

Ankesat e të paraburgosurve dhe të burgosurve kanë të bëjnë kryesisht me:

1. Kushtet e jetesës janë të papërshtatshme në dhomat e izolimit në të gjithë Komisarifat e Policisë në Shqipëri.

2. Të burgosurit që mbaheshin për periudha të gjata kohe në dhomat e izolimit dhe në gjendjen e përshkruar më lart, pasi vendimi i gjykatës kishte marrë formën e prere, për shkak të mungesës së vendeve në burgje. Aq më keq sepse koha që mbahen në këto dhoma nuk ju llogaritet si paraburgim, një ditë e gjysëm ditë burgu.

3. Familjet e të burgosurve të semurë menderisht për të cilët gjykata ka marrë masën mjeksore të mjekimit të detyruar, vazhdojnë të ankohen se ata qëndrojnë brenda sistemit të burgjeve në mënyrë të kundraligjeshme, si dhe nuk marrin asistencë mjeksore të duhur për shëndetin mendor .

4. Nuk është ngritur Komisioni Mbikqyres për ankesat e të burgosurve, i cili duhej të funksiononte qysh në vitin 1999.

5. Nuk përfitojnë sa duhet nga puna që bëjnë në burg për shkak se dispozitat përkatëse janë të vjetra, qysh para vitit 1990.

Për eliminimin e situatës së pakenaqshme të krijuar në sistemin e paraburgimit Institucioni e Avokatit të Popullit bëri rekomandimet përkatëse si dhe hyri në një dialog konstruktiv me Ministrinë e Drejtësisë. Gjithashtu herë pas here Komiteti Shqiptar I Helsinkit ka treguar publikisht si dhe i është drejtuar me rekomandime Ministrisë së Drejtësisë dhe qeverisë Shqiptare, duke kërkuar përgatitjen e bazës ligjore për pagesën e punës së të denuarve.

Mbi bazën e përfundimeve të mësipërme Konferenca doli me këto rekomandime:

1. Situata aktuale lidhur me ekzekutimet e vendimeve gjyqesore cenon rëndë parimet e shtetit të së drejtës dhe në veçanti të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të mbrojtura si nga Kushtetuta shqiptare, ashtu dhe nga të gjitha Konventat dhe normat tjera nderkombetare të pranuara nga Republika e Shqipërisë. Prandaj nevojitet krijimi i një koncepti me të drejtë

lidhur me domosdoshmerine e zbatimit ne çdo rast dhe pa asnje kusht te vendimeve gjyqesore nga çdo autoritet apo organ i administrates publike.

2. Te punohet sa me shpejt për plotesimin dhe përsosjen e legjislacionit dhe ne veçanti te akteve nenligjore te nevojshme ne fushen e ekzekutimit te vendimeve gjyqesore. Ne kete rast duhet te mbahet parasysh përputhja e ketyre te fundit me Kushtetuten, ne menyre qe individi i cili pretendon shlyerjen e detyrimit te mos ndihet i diskriminuar ne raport me organin e administrates.

3. Nga Ministria e Financave duhet te qartesohet situata ne lidhje me faktin, nese ky organ duhet te nxjerre udhezim te përbashket me Ministrin e Drejtesise për vendosjen e kriterëve dhe procedurave për zbatimin e vendimeve gjyqesore qe përballohen nga buxheti i vete institucionit. Ky detyrim rrjedh nga VKM Nr.355 date 2.6.1998, i cili ende nuk është përmbushur, apo duhet qe ne zbatim te nenit 589 te K.Pr. Civile, Ministri i Financave duhet te nxjerre udhezimet e nevojshme për ekzekutimin e detyrimeve ne te holla te institucioneve buxhetore ne llogari te thesarit.

Roli i Ministrise se Financave për te mbrojtur buxhetin me akte nenligjore nuk duhet te cenoje Kushtetuten qe parashikon qe vendimet gjyqesore jane detyrimisht te zbatueshme. Aktet e Minsitrise se Financave duhet te parashikojne kriteret dhe procedurat qe duhet te respektohen nga organet buxhetore përkatëse, te cilet nuk mund te gjykojne ne lidhje me bazueshmerine e vendimeve gjyqesore. Vetem ne kete menyre do te rritet transparenca e organeve ne kete proces dhe do te eleminohen ne maksimum elementet korruptive.

4. Ekzekutimi i vendimeve gjyqesore te formes se prere nga 85 Komunat e deklaruar te varfëra me Vendim te Keshillit te Ministrave mund te behet i mundur duke u bërë buxhetimi i tyre drejtepërdrejte nga buxheti i shtetit nëpërmjet akordimit te fondeve për kete qellim. Vetem ne kete menyre mund te behet i mundur ekzekutimi i vendimeve nga këto te fundit.

5. Duhet rritur më tej përgjegjësia në punën e çdo përmbaruesi, rritja e shkallës së përkushtimit ndaj detyrës, zbatimi e respektimi rigoroz i ligjit. Të gjitha këto do te konvergojnë në rritjen e forcimin e autoritetit të organit, si dhe të respektimit e besimit në opinionin publik. Rrugët për të arritur këtu mund të jenë të ndryshme, por nga më kryesoret janë ridimensionimi i organizimit të punës brenda Zyrës së Përmbarimit. Duhet të zënë shumë vend seminaret zonale, analizat për zëra të veçantë pune, studimet e përgjithesimet për praktikën përmbarimore në shkallë rrethi apo më gjerë. Rol kryesor ka Kryetari i zyrës, i cili duhet të ketë autoritetin e

duhur, shpirtin e veprimit e të kërkesës së llogarisë, sidomos për aftesimin profesional te punonjesve te sherbimit përmbarrimor.

6. Gjatë ekzekutimit te vendimeve gjyqesore, Përmbarruesit gjyqesor duhet te kene parasysh zbatimin ne te njejtën kohe dhe te akteve nderkombetare te ratifikuara nga vendi yne, sidomos respektimit te Konventes për mbrojtjen e te drejtave te femijeve gjatë procesit te ekzekutimit te vendimeve për pension ushqimor dhe te drejtes për takim. Ka jo pak raste kur me veprimet e tyre përmbarruesit i cenojne këto te drejta. Ne këto kushte nevojitet nje sensibilizim i strukturave kompetente ne drejtim te respektimit te te drejtave themelore te individit, dhe ne veçanti te femijeve, mbrojtja e interesave te te cileve nga ligji duhet te jete ne nivele te larta. Në ekzekutimet e vendimeve rreth konflikteve familjare duhet studjuar gjithashtu nevoja e pranisë së punonjësit social për problemet familjare.

7. Për të motivuar më tej punën e përmbarruesit gjyqësor, mund të shikohet mundësia që për ekzekutimin e detyrimeve të veçanta, ose për nje vellim te caktuar çeshtjesh te ekzekutuara gjatë vitit, përmbarruesi të shpërblehet me shtese page. Ministria e Drejtesise mund te studjoje e te paraqese aktet e nevojshme nenligjore.

8. Për realizimin me sukses te detyres se tyre përmbarruesit gjyqesore duhet te kene infrastrukturen e nevojshme, pasi 89.6% e te intervistuarve mendojne se nuk e kane kete gje, ndersa 81.3% mendojne se mungesa e saj ul shpejtesine dhe cilesine e punes se tyre. Te punohet për plotesimin e nevojave aktuale të tyre për zyra, me ambiente për mbajtjen e sendeve te sekuestruara, me kanceleri, kompjutera dhe mjete lëvizëse etj, te cilat janë mese te domosdoshme.

9. Gjykatat shqiptare duhet të kene me mire parasysh qe ne vendimet e tyre te plotësojnë të gjitha kërkesat e përcaktuara nga ligji lidhur me gjeneralitetet e personave debitorë apo të dënuar, adresat e sakta të tyre, me qëllim që të mundësohet ekzekutimi i vendimeve të ndryshme gjyqesore.

10. Ne lidhje me ekzekutimin e vendimeve penale te formes se prere, kryesisht për transferimin e të dënuarve nga vendet e paraburgimit në burgje, është e nevojshme që te përshpejtohet procesi që ka filluar dhe të respektohet grafiku i këtij transferimi siç është caktuar nga vendimi i keshillit te Ministrave. Gjithashtu nevojitet qe Ligji “Për ekzekutimin e vendimeve penale” të përmirësohet duke përcaktuar qartë dhe saktë afatet e transferimit, kurse për personat të cilët kanë vuajtur dënimin në paraburgim, t’u përlllogaritet dënimi i vuajtur 1 ditë paraburgim baraz me 1.5 ditë burg.

11. Ministria e Drejtësisë duhet të përgatisë projektligjet dhe aktet nënligjore për zbatimin e alternativave të dënimit me burgim. Gjithashtu të marrë masa për të vënë në funksionim Komisionin Mbikqyrës për ekzekutimin e vendimeve me burgim dhe të përgatite vendimin për shpërblimin e punës së të dënuarve sipas kushteve të reja.

12. Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë të marrin masa për trajtimin e personave të sëmurë psikik të cilët mbahen padrejtësisht në spitalin e burgut ose në komisariate, për ne institucione të posaçme, të veçanta nga burgjet.

13. Prokurorite e rretheve duhet të kryejnë me mire detyrën e tyre e të kontrollojnë me rigorozitet ekzekutimin e vendimeve penale si dhe të vënë me shumë para përgjegjësisë penale ata punonjës të organeve përgjegjës të cilët shkelin ligjet dhe pengojnë për ekzekutimin e vendimeve gjyqesore.

* * *

Zhvillimi i kësaj Konference, pjesëmarrja e drejtuesve dhe kuadrove të disa ministrive kryesore, përmbaruesve nga gjithë vendi si dhe fjalimet, problemet dhe sugjerimet e tyre për çështjet e trajtuara në Konferencë, janë një tregues që premtojnë për ndryshime pozitive lidhur me situatën aktuale të ekzekutimit të vendimeve gjyqesore të formës së prerë.

Sipas mendimit të përgjithshëm, Konferenca ia arriti qëllimit të caktuar për sensibilizimin dhe angazhimin më të madh të të gjitha organeve dhe autoriteteve të administratës publike shqiptare për zbatimin e Kushtetutes, të ligjeve përkatës si dhe rekomandimeve të kësaj Konference.

Përfundimet dhe rekomandimet përkatëse që dolën gjatë punimeve të saj i janë dërguar Presidentit të Republikës, Kryeministrit, Kryesisë së Kuvendit të Shqipërisë, Komisionieve Parlamentare të Çështjeve Kushtetuese dhe Ligjore, të Drejtave të njeriut dhe minoriteteve, të Ekonomisë dhe Financave, Prokurorit të Përgjithshëm, Ministrit të Drejtësisë, të Financave, të Rendit si dhe Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit.

Të shpresojmë se rekomandimet e kësaj Konference do të vlerësohen me seriozitet dhe do fillojnë të zbatohen nga gjithë organet kompetente.

9. Aktivitete të tjera të Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2003

Krahas ndjekjes së problematikës së përditshme, për të shqyrtuar ankesat e qytetarëve, Avokati i Popullit ose përfaqësues të tij, kanë marrë pjesë duke dhënë kontributin e tyre në aktivitete të ndryshme, organizuar nga organizma qeveritare dhe të shoqërisë civile. Ashtu siç kemi theksuar dhe në Raportin Vjetor 2002 një gjë e tillë ka qenë dhe mbetet një angazhim sa institucional, aq edhe qytetar i Institucionit të Avokatit të Popullit, për tu investuar dhe thënë fjalën e tij për një problematikë edhe më të gjerë se ajo që paraqitet në statistikat e punës së tij normale.

Më poshtë po ju njohim thjesht me tematikën e këtyre aktiviteteve, duke menduar të paraqesim edhe grupet e interesit, të synuara prej tyre.

1. Seminar me temë “Mbi Konventen për Mbrojtjen e Grave” organizuar nga Forumi i Gruas dhe Komiteti Mbarekombetar i Pajtimit të Gjakeve, Shkurt 2003.

2. Seminar me temë: “Trajnim për nepunesit civile shqiptare” organizuar nga Departamenti i Administratës Publike në bashkëpunim me Bankën Botërore, Mars 2003.

3. Pjesëmarrje në diskutimet e platformës për eliminimin e pasojave të gjakmarrjes në zonen veriore dhe verilindore, organizuar nga shoqata “Fshati i Paqes”, Prill 2003.

4. Seminar me temë: “Trajnimi i punonjësve të policisë që merren me procedurat e shtetësisë” i organizuar nga Ministria e Rendit Publik dhe Presidenca, Qershor 2003.

5. Tryeze e rrumbullakët me temë “Reforma në drejtësi sfide për të ardhmen”, organizuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Korrik 2003.

6. Seminar me temë: “E drejta e individit për t’ju drejtuar Gjykatës Kushtetuese për një proces jo të rregullt ligjor” organizuar nga Gjykata Kushtetuese, Korrik 2003.

7. Seminar me temë: “Mbi problemet e ligjit “Për Tokën”” organizuar nga Këshilli i Qarkut Tiranë dhe Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, Korrik 2003.

8. Seminar me temë: “Promovimi i të Drejtave të Fëmijëve” organizuar nga Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Femijëve në Shqipëri, CRCA, Shtator 2003.

9. Seminar me temë: “Për masat disiplinore” organizuar nga Departamenti i Administratës Publike pranë Këshillit të Ministrave, Shtator 2003.

10. Tryeze rrumbullakët me temë: “Për nismen kombëtare të lirit të femijëve dhe grave të ngujuara nga gjakmarrja”, organizuar nga Institucione Qendrore, Institucione Fetare, O.J.F të ndryshme etj, Shtator 2003.

11. Seminar me temë: “Menaxhimi i mjedisit”, organizuar nga Instituti i Trajnimit të Administratës Publike, Tetor 2003.

12. Tryezë e rrumbullakët me temë: “Për reformën ligjore në burgje” organizuar nga Këshilli i Evropës, Tetor 2003.

13. Seminar me temë: “Çeshtje të decentralizimit në institucione” organizuar nga Departamenti i Administratës Publike, Tetor 2003.

14. Seminar me temë: “Lufta kundër korrupsionit”, organizuar nga Instituti i Trajnimit të Administratës Publike, Nëntor, 2003.

15. Seminar me temë: “Hartimi dhe Menaxhimi i Projekteve” organizuar nga Departamenti i Administratës Publike pranë Këshillit të Ministrave, Nëntor 2003.

16. Seminar me temë: “Për ratifikimin e Konventës “Për marrjen e pensionit ushqimor jashtë shtetit””, organizuar nga Zyra e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit pranë Ministrisë së Drejtësisë, Nëntor 2003.

17. Tryezë e rrumbullakët me temë: “Mbi kontratën e re të Albtelekom-it”, Dhjetor 2003.

18. Seminar me temë: “Për hyrjen në fuqi të ligjit “Për Konsumatorin”” organizuar nga Ministria e Ekonomisë, Dhjetor 2003.

19. Tryezë e rrumbullakët me temë: “Për tarifën e reja të energjisë elektrike” organizuar nga KESH, Dhjetor 2003.

20. Konventa Ushtarake - Ministria e Mbrojtjes, Dhjetor 2003.

21. Konferenca Gjyqësore Kombëtare, dhjetor 2003.

22. Pjesëmarrje në grupin nderdikastrial të punës pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme gjatë vitit 2003 për përgatitjen e raporteve kombëtare dhe paraqitjen e tyre në organizmat ndërkombëtare. (periodike)

23. Pjesëmarrje në Grupin e Monitorimit Anti Korrupsion. (periodike)

Në të gjitha këto aktivitete, Institucioni i Avokatit të Popullit ka promovuar rolin, kompetencat dhe juridiksionin e tij në ndërveprimin me institucionet e tjera shtetërore dhe ato të shoqërisë civile. Problematika e diskutuar në to na ka ndihmuar në sqarimin e pozicioneve të ndryshme, në të cilat ndodhemi, në raport me instancat të cilave u drejtohem, nisur nga ankesat konkrete që vijnë pranë zyrës tonë. Kjo pjesëmarrje aktive do të vazhdojë të jetë përparësi e punës tonë edhe në të ardhmen, pasi bashkëpunimin me organet e administratës dhe të të tre pushteteve, si dhe me organizmat e shoqërisë civile e shohim si domosdoshmëri për perfeksionimin e mëtejshëm të punës tonë, si mbikqyrës të respektimit të të drejtave të njeriut në të gjitha dimensionet e tyre.

KREU I TRETE

Veprimtaria konkrete e Avokatit të Popullit për ankesat, kërkesat dhe njoftimet (rastet), të grupuara sipas institucioneve qeveritare

1. Këshilli i Ministrave (Qeveria)

Duke realizuar detyrën e tij kryesore, mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Shqipëri, Avokati i Popullit në të njëjtën kohë, ka informuar, rekomanduar apo i ka bërë propozime Kryeministrit dhe ministrave për të gjitha çështjet kryesore që kanë dalë gjatë punës së tij. Pavarësisht nga forma në të cilën janë paraqitur opinionet e Avokatit të Popullit, mendojmë se, në një rën ose tjetrën mënyrë, ato kanë ndikuar në rritjen e standarteve të mirëqeverisjes.

Gjatë vitit 2003, Qeverisë, të kryesuar nga kryeministri, zoti Fatos Nano, i kemi dërguar zyrtarisht këto rekomandime, propozime apo njoftime:

1. Rekomandim për marrjen e masave për parandalimin e rasteve të shkeljes së të drejtave të njeriut gjatë shoqërimit, ndalimit apo arrestimit dhe vuajtjes së dënimit për personat e mitur me moshë 14-18 vjeç (10.01.2003).

2. Rekomandim për marrjen e masave për të realizuar plotësimin e bazës ligjore që shërben për funksionimin bashkëkohor të shërbimit publik të ujësjellës-Kanalizimeve (15.01.2003). Jemi në dijeni që Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit po punon për këtë qëllim.

3. Rekomandim për marrjen e masave për të bërë të mundur njohjen dhe zbatimin e ligjit nr.8950 datë 10.10.2002 “Për gjendjen Civile” (15.04.2003). Kryeministri ka nxjerrë një urdhër të posaçëm që ngarkon Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit për këtë qëllim.

4. Kërkesa për sigurimin e jetës së dëshmitarit Z.K. (26.05.2003).

5. Propozimi drejtuar Qeverisë për ndryshimin e Vendimit të K.M nr. 64, datë 02.02.2001 “Për inkuadrimin e gradave ushtarake, në gradat e Policisë së Shtetit dhe për caktimin e funksioneve organike, që do të

ushtrohen sipas tyre”. Ky propozim mori shkas nga ankesat e policëve për gradat që ju dhanë në muajin maj 2003. (data 29.05.2003).

Nga studimi i ligjit nr. 8643, datë 20.07.2000 “Për Gradat në Policinë e Shtetit” dhe të VKM nr. 64, datë 02.02.2001 rezulton se ka parregullsi dhe mospërputhje midis tyre.

a) Pika 1 e VKM nr. 64, datë 02.02.2001 nuk përputhet plotësisht me pikën 4 të nenit 26 të ligjit “Për Gradat në Policinë e Shtetit”. Në ligj “funksioni” përcaktohet si *detyra që mbulon ose ka mbuluar punonjësi i policisë*, ndërsa në VKM “funksioni” përcaktohet *detyra që ka punonjësi i policisë në çastin e hyrjen në fuqi të këtij vendimi*. Pra vendimi padrejtësisht e ngushton ligjin, duke ja mohuar të drejtën e fitimit të gradës më të lartë atyre punonjësve të Policisë së Shtetit që kanë patur funksione më të larta përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, por që në momentin e inkuadrimin të gradave nuk i kanë ato.

b) Në pikën 2 të tij, së bashku me lidhjen nr. 1, përcaktohen funksionet organike që mbulohej nga punonjësit e policisë sipas gradave.

Funksionet e rolit bazë duhet të ishin vlerësuar më shumë dhe me grada më të larta. Kështu p.sh. funksioni i inspektorit të policisë së rendit, i cili është një hallkë e rëndësishme e strukturës së Policisë së Shtetit, sipas vendimit mbulohej nga grada “Agjent i parë” dhe “Asistent”, duhet të mbulohej nga grada “Asistent i parë” ose “Kryeasistent”. Po kështu mund të themi edhe për punonjësin e policisë patrullë, polic roje objekti dhe funksione të barasvlefshme me to, që sipas vendimit mbulohej vetëm nga grada “Agjent”, pavarësisht nga vjetërsia, duhet të mbulohej edhe nga grada “Agjent i parë”. Këto ndryshime do të bënin që punonjësit e policisë në këto role të motivoheshin më shumë për punën. Në të njëjtën kohë do të bëhej edhe një vlerësim objektiv i punonjësve të policisë të këtyre funksioneve, qoftë nga vjetërsia e shërbimit, ashtu edhe në përputhje me kualifikimin dhe vlerësimin e punës së tyre, të cilat nuk janë njëlloj për të gjithë punonjësit e policisë të këtyre funksioneve dhe për rrjedhojë ata duhet të diferencohen edhe në gradë.

Për të rivendosur në vënd të drejtat e ankuesve, i propozuam Qeverisë ndryshimin e Vendimit të K.M nr. 64, datë 02.02.2001, në pikat e përmëndura me sipër dhe përputhjen e tij me ligjin në bazë të cilit ka dalë. Propozimi është në shqyrtim nga Ministria e Rendit Publik dhe jemi në pritje të zgjidhjes.

6. Rekomandimi për të deklaruar (konstatuar) pavlefshmërinë absolute të Urdhërit të Kryeministrit nr. 226 datë 20.08.2002 “Për komunikimin me organet e medias së shkruar dhe elektronike” (datë 02.06.2003). Ky rekomandim mori shkas nga ankesa e policit Qamil

Hajdari në media për gradën që i dhanë dhe për këtë veprim ai u largua nga puna. Kemi argumentuar paligjshmërinë e këtij Urdhëri si më poshtë:

a- Kufizimi për të komunikuar me mediat është shkelje e njërës prej lirive themelore të njeriut, e garantuar nga neni 22 pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Liria e shprehjes është e garantuar”*.

b- Akti administrativ i mësipërm, i cili kufizon lirinë themelore të shprehjes, është një kapërcim i kompetencave kushtetuese e ligjore të Kryeministrit, sepse në bazë të nenit 17 të Kushtetutës, *“Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjestim me gjëndjen që e ka diktuar atë. Këto kufizime nuk mund të çenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut”*.

c- Urdhëri nr. 226, datë 20.08.2002 *“Për komunikimin me organet e medias së shkruar dhe elektronike”* ishte nxjerrë në mbështetje të shkonjes “ç”, të pikës 1 dhe të pikës 3 të nenit 102 të Kushtetutës. Por nuk citohet ligji i posaçëm i cili duhet të autorizonte Kryeministrin për nxjerrjen e këtij akti nënligjor, siç kërkon neni 118 i Kushtetutës sonë.

Në këto kushte, ky urdhër është akt administrativ absolutisht i pavlefshëm. Duke qënë i tillë, në bazë të nenit 117, pika 1 e *“Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, ai nuk prodhon pasojë ligjore, pavarësisht nga fakti nëse është deklaruar ose jo si i tillë.

Ne i propozuam Kryeministrit, ta deklaronte absolutisht të pavlefshëm Urdhërin nr. 226 datë 20.08.2002 *“Për komunikimin me organet e medias së shkruar dhe elektronike”*.

Rekomandimi ynë u la në heshtje për rreth 6 muaj, por pas ankesës së disa OJQ-ve në Gjykatën Kushtetuese, Kryeministri me Urdhërin nr. 157, dt. 12.11.2003, e revokoi Urdhërin e mësipërm.

7. Informacioni për negociatat dhe kërkesat e përfaqësuesve të ish të burgosurve dhe të përndjekurve politikë (03.06.2003). Dihet tashmë se projektligji përkatës ndodhet për diskutim e miratim në organin kompetent, Kuvendin e Shqipërisë.

8. Informacioni për zbatimin dhe nevojën e përmirësimit të legjislacionit në fushën e sigurimeve shoqërore (23.09.2003).

9. Kërkesë për bashkëpunim për Konferencën Kombëtare për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (datë 30.09.2003). Kryeministri ngarkoi Ministrin e Financave, Ministrin e Drejtësisë dhe

Ministrin e Shtetit, zotin Blendi Klosi për të bashkëpunuar. Konferenca u zhvillua më datën 19.12.2003.

10. Rekomandim për planifikimin e fondit të nevojshëm në buxhetin e shtetit për vitin 2004, për të përfunduar brenda vitit 2005 ekzekutimin e të gjitha vendimeve gjyqësore, ku debitor është shteti, sipas angazhimit të marrë në programin e Qeverisë në korrik 2002 (datë 15.10.2002). Nga Ministria e Financave jemi njoftuar se për këtë qëllim në buxhetin e vitit 2004 janë planifikuar 250 milion lekë.

11. Rekomandim në lidhje me nevojën e shqyrtimit të projektligjit të paraqitur nga Ministria e Mbrojtjes “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.8087 datë 13.03.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, Ministrisë së Rendit Publik dhe Shërbimit Informativ Shtetëror” (datë 19.11.2003).

12. Rekomandim për revokimin e paragrafit që parashikon formularin e “autorizimit të Prodhuesit” në kapitullin e tretë të Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.1 datë 10.01.1996 “Për prokurimin publik”. (31.12.2003).

Kryeministri është informuar rast pas rasti edhe në lidhje me problemet me interes për Qeverinë që kemi diskutuar me homologët gjatë takimeve në Shqipëri, raporteve të tyre apo vizitave tona jashtë shtetit.

Gjatë vitit 2003, për aparatën e Këshillit të Ministrave dhe institucionet administrative në vartësi direkte të tij, si Grupi Mbikqyrës i firmave piramidale, Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Komisionet e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve, Instituti i Integritimit të të Përndjekurve Politikë, kanë ardhur gjithsej 105 ankesa dhe kërkesa.

a. Grupi Mbikqyrës i Firmave Piramidale pranë Këshillit të Ministrave

Një nga problematikat që ka gjetur trajtim në ankesat e trajtuara për vitin 2003, ka qenë edhe ajo që ka të bëjë me veprimtarinë e Grupit Mbikqyrës pranë Këshillit të Ministrave.

Numri i ankesave të marra nga ana jonë për këtë vit është 7, kurse 2 janë të mbartura nga viti i kaluar. Kanë përfunduar së shqyrtuari 6 ankesa, ndërsa 3 ankesa janë ende në shqyrtim.

Ndonëse këtë vit numri i këtyre ankesave nuk ka qenë sa edhe në vitin paraardhës (15), duhet theksuar se problematika e evidentuar në to mbetet e njëjtë.

Edhe për këtë vit e veçanta në kuadrin e trajtimit të këtyre ankesave është mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të

detyrueshme për pagimin e vlerave të caktuara monetare nga ana e Grupit Mbikqyrës ndaj subjekteve të ndryshme.

Zhvillim i ri në këtë fushë të administratës publike, mund të cilësohet ngritja e Komisionit Parlamentar për shqyrtimin e veprimtarisë së Grupit Mbikqyrës në lidhje me administrimin e ish firmave piramidale, përfshirë këtu edhe veprimtarinë e administratorëve të pavarur të caktuar për këtë qëllim.

Problemet e parashtruara në ankesat e marra në shqyrtim kanë qenë:

1. Për mosekzekutim të vendimeve gjyqësore nga ana e Grupit Mbikqyrës, vendime në të cilat vendoset detyrimi i shlyerjes së një detyrimi në të holla, ndaj subjekteve të ndryshme.

2. Për zvarritje në procesin e kthimit të parave kreditorëve të ish firmave piramidale nga ana e Grupit Mbikqyrës.

3. Për mënyrën e administrimit të firmave piramidale nga ana e administratorëve të pavarur dhe për ecurinë e procesit të transparencës.

4. Për mosderdhje të kontribucioneve të sigurimeve shoqërore nga ana e ish firmave piramidale për punonjësit e tyre apo edhe administratorët aktualë të këtyre firmave në administrim, për punonjësit që kanë punuar me kontrata për ta.

5. Për mospërfshirje në administrim të pasurive të ndryshme nga ana e administratorëve të ish firmave piramidale, pasuri të cilat rezultojnë të jenë tjetërsuar në pronësi të individë të tjerë.

Në disa ankesa është trajtuar problemi i mospërfshirjes në listat e kreditorëve të ish firmave piramidale. Ky pretendim ngrihet pasi kanë kaluar të gjitha afatet e caktuara me aktet ligjore përkatëse në këtë fushë, afate që mundësonin ezaurimin e këtij problemi.

Evidencimet e bëra nga ana jonë në raportet e mëparshme në lidhje me transparencën e veprimtarisë së Grupit Mbikqyrës pranë Këshillit të Ministrave, kanë gjetur pasqyrimin e tyre me të qartë në punën e Komisionit Parlamentar të sipërcituar. Ne gjykojmë se në tërësinë e punës së tij, ky Komision arriti të krijojë tek publiku i gjerë një tablo më të qartë dhe më të kuptueshme, se çfarë po ndodh me procesin e administrimit të ish firmave piramidale dhe në fund te fundit, kush janë rezultatet e mundshme të pritshme.

Komunikimi mes nesh si Institucion dhe Grupit Mbikqyrës, evidentojmë se ka qenë më korrekt se në vitet e mëparshme, por ende vërehen zvarritje në dhënien e përgjigjeve për çështje të caktuara.

Sikurse është theksuar edhe në raportin e vitit 2002, një problem shumë i mprehtë që mbetet në veprimtarinë e këtij organi të administratës publike është mospërfundimi i plotë i procesit të transparencës dhe

mospërcaktimi i afateve konkrete të procesit të kthimit të parave ndaj kreditorëve të firmave piramidale.

Kemi gjykuar dhe vazhdojmë të vlerësojmë se një qëndrim i tillë pavarësisht vlerësimeve në aspektin politik dhe atë shoqëror, nuk ndihmon aspak imazhin e veprimtarisë që ka marrë përsipër të kryejë Grupi Mbikqyrës.

Në çështjet e shqyrtuara nga ana jonë konstatohet në vazhdimësi se me procesin e transparencës, ndërthuren edhe procese gjyqësore, kundër veprimeve të Grupit Mbikqyrës apo të administratorëve të caktuar për administrimin e ish firmave piramidale. Problem kryesor mbetet mosekzekutimi i disa vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të cilat i ngarkojnë Grupit Mbikqyrës, shlyerjen e detyrimeve financiare ndaj subjekteve të ndryshëm.

Rekomandimet e bëra nga ana jonë vazhdojnë të ngelen me një mosveprim real apo veprim të pjesshëm të pajustificuar, pavarësisht se shkelet parimi kushtetues për zbatimin e vendimeve gjyqësore. Kjo është pasqyruar edhe në Konferencën Kombëtare të organizuar në Dhjetor 2003, për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore .

Një nga pasojat më të rënda që rrodhën nga ekzistenca e firmave piramidale, janë të pastrehët që humbën banesat e tyre për shkak të depozitimit të parave në firmat piramidale. Në aspektin social është për t'u përshëndetur vendimi më i fundit i Qeverisë (VKM nr.792 date 26.11.2003), për përdorimin e fondeve të ish fondacioneve për ndërtimin e apartamenteve për këtë kategori të pastrehësh.

Moment tjetër që është vërejtur në punën e administratorëve të ish firmave piramidale dhe Grupit Mbikqyrës, është mosderdhja e kontribucionit të sigurimeve shoqërore për punonjësit që kanë vazhduar të punojnë në asetet e pashitura të këtyre shoqërive edhe pas marrjes së tyre në administrim. Në përgjigjet e kthyera në këto raste mbahet qëndrimi zyrtar i trajtimit të këtyre pagesave në kuadër të përfundimit të procesit të transparencës së shoqërive huamarrëse.

Ne gjykojmë se qëndrimi që mbahet në këto raste është jo i bazuar, pasi që nga momenti i fillimit të punës nga individët e ndryshëm në bazë të administrimit që u bëhet ish shoqërive huamarrëse nga administratorët dhe Grupi Mbikqyrës, kemi të bëjmë me marrëdhënie direkte ndërmjet një punëdhënësi të ri, i cili është i detyruar ligjërisht të parashikojë dhe derdhë si pagesë të gjitha detyrimet ndaj punëmarrësit, përfshirë edhe kontribucionin për sigurimet shoqërore.

Lidhur me sa është evidentuar më sipër po paraqesim një rast të shqyrtuar nga ana jonë:

Shtetasja Xh.M, së bashku me një grup qytetarësh të tjerë, në ankesën drejtuar zyrës tonë ka ngritur pretendimin për sa më poshtë vijon:

Këta shtetas kanë qenë kreditorë të firmës “Gjallica” që nga viti 1997. Ndërkohë kanë ngritur pretendimin që apartamentet ku ata banojnë aktualisht në Tiranë, kanë qenë pronë e ish firmës piramidale të sipërcituar, ndaj edhe ju takojnë atyre si kreditorë, për kompesim.

Përveç sa më sipër, ankuesit kanë ngritur pretendimin se me anë të fallsifikimit të dokumentave, pronat në fjalë (apartamentet) i kanë kaluar në pronësi shtetasit P.Sh, fakt të cilin ata e kontestojnë.

Pavarësisht nga çfarë pretendohet, ankuesit sqarojnë ndërmjet të tjerash se i janë drejtuar Grupit Mbikqyrës pranë Këshillit të Ministrave, lidhur me problematikën që është parashtruar në ankesën e tyre. Po kështu në lidhje me këtë çështje, ata shkruajnë se kanë bërë edhe kallëzim pranë Prokurorisë së Rrethit Tiranë. Sa më sipër është kërkuar ndërhyrja e Avokatit të Popullit për zgjidhjen e kësaj çështje.

Me pranimin e kësaj ankese për shqyrtim nga ana jonë, janë kërkuar shpjegime lidhur me trajtimin e saj, nga ana e Grupit Mbikqyrës pranë Këshillit të Ministrave dhe nga e Prokurorisë të Rrethit Tiranë.

Administratorët e pavarur të shoqërisë “Gjallica” shpk në administrim, i janë drejtuar me shkresën nr.1 datë 14.01.2002 dhe shkresën nr.100 datë 2.07.2002, organit të Prokurorisë së Përgjithshme dhe me shkresën nr.115 datë 3.08.2002, Prokurorisë së Rrethit Tiranë.

Ndërsa lidhur me pretendimin se apartamentet e mësipërme i takojnë ankuesve si kompensim, për arsye se ata janë kreditorë në firmën e sipërcituar, ankuesit janë sqaruar se në bazë të Ligjit nr.8386 datë 30.07.1998 “Për mënyrën dhe procedurat e shitjes së pasurive të personave juridike jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, çdo pasuri e shoqërive huamarrëse shitet nëpërmjet ankandit publik, sipas nenit 6, pikat 6 dhe 3, ku favorizohen kreditorët që kanë depozituar kapitalet në këto shoqëri huamarrëse.

Duke mos u mjaftuar me kaq, në vazhdim i jemi drejtuar në mënyrë të përsëritur Prokurorisë të Rrethit Tiranë dhe Prokurorisë të Përgjithshme, nga ku kemi mësuar edhe për përcjelljen e çështjes përkatëse penale në gjykatë ndaj shtetasit P.Sh, lidhur me kalimin e disa prej pronësive të “Gjallica” shpk, këtij të fundit, nëpërmjet fallsifikimit të dokumentave.

Në këto kushte kur tashmë çështja është në kompetencë dhe në juridiksion trajtimi nga ana e Gjykatës, ne kemi vendosur ndërprerjen e shqyrtimit të saj, për shkak se është gjykata tashmë që do të vendosë përfundimisht, lidhur me faktin nëse pronësia e pretenduar si pronë e ish firmës piramidale “Gjallica”, është tjetërsuar me fallsifikim. Ky fakt do të

radhiste këtë pronësi në listën e aseteve të administruara nga administratorët e pavarur të shoqërisë “Gjallica”, në administrim dhe do të rriste përfitimet për kreditorët.

b) Ankesa për zyrat e regjistrimit të pasurive të palujtëshme (ZRPP)

Për vitin 2003 pranë Institucionit tonë kanë ardhur 44 ankesa, që si objekt të tyre kanë patur të njëjtat pretendime : zvarritje në regjistrimin e pasurisë të tyre të palujtëshme, mos regjistrimin e oborreve të banesave private dhe mos marrjen e certifikatës së pronësisë. Nga to janë shqyrtuar përfundimisht 26, nga të cilat 9 janë zgjidhur në favor të ankuesve. Mund të thuhet që në fillim, se bashkëpunimi dhe mirëkuptimi midis ZRPP dhe Institucionit të Avokatit të Popullit është i mirë. Veçojmë Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Palujtëshme në rrethet e Tiranës, Pogradecit dhe Lushnjës, që kanë vepruar menjëherë pas ndërhyrjes së institucionit tonë, për të bërë regjistrimin fillestar të pasurive të palujtëshme, respektivisht për ankuesit F.T.e Sh.J, E.L. dhe K.A. Në asnjë rast të shqyrtuar, nuk ka rezultuar që mosveprimet për të cilat ankohen qytetarët ndaj këtyre Zyrave, të kenë ardhur nga veprime abuzive të punonjësve të tyre ose për zbatim të gabuar të ligjit “Për regjistrimin e pasurive të palujtëshme” dhe të Rregullores të Punës të këtyre Zyrave. Mos veprimet e Zyrave, gjithmonë për rastet e shqyrtuara, kanë qënë pasojë e mangësive në dokumentacionin e paraqitur nga ankuesit. Çështjet e zgjidhura pozitivisht kanë të bëjnë pikërisht me plotësimin e akteve të duhura nga të interesuarit për një kohë të shkurtër, që i kanë hapur rrugë regjistrimit fillestar të pasurisë. Ankesat e tjera kanë qënë të pabazuara, pasi regjistrimi nuk ju është bërë për shkak të mbivendosjes së pronave me njëra tjetrën dhe të mos pasjes së aktit të pronësisë për oborret. Ankuesit janë orientuar rast pas rasti, që t’i drejtohen rrugës gjyqësore për zgjidhjen e konflikteve të pronësisë në rastet e mbivendosjes së trojeve, ose për fitimin e pronësisë së oborreve të banesave private me parashkrimin fitues. Është shumë e vështirë të bindesh qytetarët, se çdo mbivendosje e pronës në regjistrat hipotekore, çdo regjistrim i pasurisë së palujtëshme që pretendohet se është bërë në mungesë të akteve të pronësisë, etj, janë në vetvete konflikte pronësie që mund të zgjidhen vetëm në rrugë gjyqësore, dhe jo administrativisht; se çregjistrimi i një pasurie bëhet vetëm me vendim të gjykatës etj. Për të gjitha këto probleme, ankuesit pretendojnë për veprime korruptive të punonjësve të ZRPP. Por në asnjë rast, gjatë verifikimit të këtyre ankimeve, nuk ka dalë se regjistrimi është bërë në kundërshtim me ligjin përkates.

Një mangësi që sjell zvarritje në shqyrtimin e këtyre ankesave dhe keq kuptime në marëdhëniet tona me ankuesit, janë vonesat e pajustificuara në kthimin e përgjigjeve nga disa ZZPP në rrethe, që nuk respektojnë afatin ligjor prej 30 ditësh që ka caktuar Ligji për “Avokatin e Popullit”

Problem që duhet evidentuar për këto Zyra, është që tashmë i bërë publik, është hezitimi i pakuptueshëm për rregjistrimin e pasurive të fituara me vendim gjyqësor të formës së prerë, duke shkelur haptazi të drejtat dhe interesat e ligjshme të individëve që kanë fituar gjyqësisht një të drejtë të shkelur.

Zyra qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Palujtëshme duhet të unifikojë sa më shpejt praktiken e Zyrave në vartësi të saj në zbatim të kërkesave të pikës 3 të nenit 142 të Kushtetutës që i detyron organet shtetërore të ekzekutojnë vendimet gjyqësore të formës së prerë. Çdo kontestim ndaj këtyre vendimeve gjyqësore, duhet bërë vetëm në rrugë gjyqësore me ane të rishikimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, parashikuar në nenin 494 të Kodit të Proçedurës Civile. Në të kundërt, e vetmja alternativë është të rregjistrohet pasuria e fituar me vendimin gjyqësor të formës së prerë.

Problem tjetër që duhet rregulluar është fakti se duhen krijuar mundësi që të ketë më tepër transparencë në punën e këtyre zyrave, të ketë njoftime zyrtare në ambientet e tyre për dokumentacionin që duhet paraqitur, të ketë më tepër sportele dhe mundësi komunikimi me drejtuesit e zyrave kur qytetarët ankohen për punonjës të veçantë të zyrave.

c) Ankesat për Komisionet e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish pronareve (KKKP)

Këto lloj ankesash kanë rënie drastike për vitin 2003 në krahasim me vitin 2002. Kjo ka ardhur për faktin se pjesa dërmuese e ish-pronarëve ose trashëgimtarëve të tyre, janë në pritje të miratimit nga Kuvëndi të ndryshimeve në legjislacionin që trajton problemin e kthimit, e të kompensimit sa më të pranueshëm të pronave. Gjithsej rezultojnë 27 ankesa, nga të cilat janë përfunduar 21 dhe janë mbartur për në vitin 2004 gjashtë të tjera. Pjesa më e madhe e ankesave kanë patur pretendimin për zvarritje të gjata në shqyrtimin e tyre për njohjen dhe kthimin fizik të pasurive të palujtëshme. Nga verifikimet tona ka dalë se pjesa dërmuese e tyre ishin të pabazuara pasi në dokumentacionin e depozituar pranë komisioneve kanë patur mangësi esenciale të tilla, si mungesa e gen-planeve, të kufinjve për përcaktimin dhe identifikimin e saktë të pronës së pretenduar e të tjera. Disa ankesa janë vlerësuar të bazuara dhe jemi në pritje të shqyrtimit të tyre nga Komisionet në bazë të rekomandimeve tona.

Pak ankesa kanë patur per objekt ankimin e vendimeve te KKK te Pronave për arsye se nuk ju janë kthyer ne natyre siperfaqe trojesh qe pretendojnë se janë të lira nga ndërtimet. Meqë zgjidhja është në kompetencë të gjykatës së vëndit ku ndodhet pasuria e palujtëshme, ankuesit janë udhëzuar për zgjidhjen në rrugë gjyqësore të pretendimeve të tyre.

Konstatojmë që nuk ka ankesa të viteve të kaluara për mosveprimet e organeve të qeverisjes vendore për dorëzimin fizik të pronave të kthyer me vendim të KKK të Pronave dhe të tjera të kësaj natyre.

Një problem më vete mbetet ai i tokave të NB-ve. Përveç shkaqeve të tjera, që kanë të bëjnë me saktësinë e dokumentacionit të ish-pronarëve, në shumë raste ato janë ndarë si nga KKK të Pronave ashtu edhe nga Komisionet e Tokave. Kjo ka sjellë mos regjistrimin e tokave bujqësore të ish NB-ve, për shkak të pezullimit të Akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, nga bashkë-themeluesit ose ish punonjësit e Ndërmarrjeve Bujqësore (NB-ve), si në ish-NB-të në Vlorë, Korçë, Elbasan, etj, deri në riverifikim të tyre nga Komisionet e Tokave pranë Qarqeve.

Grup ankesash të veçanta perbejne ato të personave fizikë ose te grup-banorëve nga disa fshatra te Himares dhe të Sarandës që shprehin pakënaqësinë për mënyrën që e trajton legjislacioni aktual çështjen e kthimit dhe kompensimit të pronave. Institucioni ynë ka dhënë gjatë gjithë kesaj periudhe mendimet e sugjerimet e tij per ndryshimet e mundëshme në kete fushe te legjislacionit. Por fjalën e fundit për t'i dhënë zgjidhje perfundimtare dhe te ballancuar ketyre ankesave e ka Kuvendi i Shqiperise me mitatimin e projekt ligjit qe ka ne shqyrtim.

ç) Instituti i Integritit të të Përndjekurve Politikë (IIPP)

Numri i ankesave ndaj Institutit të Integritit të të Përndjekurve Politikë (IIPP) është 7, nga të cilat 5 kanë rezultuar jashtë juridiksionit dhe 2 janë ende në fazën e shqyrtimit. Nga ankesat e mbartura nga viti 2002 kanë rezultuar 3 ankesa jashtë juridiksionit dhe 1 në favor të ankuesit.

Një nga problemet që kjo kategori e popullsisë ka adresuar pranë Zyrës sonë është problemi i strehimit. Ekziston një kuadër ligjor për një kategori të caktuar të përndjekurish politikë të pastrehë, të cilët përfitojnë strehim falas (VKM nr.476 datë 10.10.1994 “Për procedurat e strehimit të ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”). Megjithëse ekziston një numër mjaft i madh kërkesash nga të përndjekurit që duhet të përfitojnë banesa nga shteti prane ketij Instituti, del se nga IIPP çdo vit janë kërkuar fonde strehimi për këtë kategori personash, por kjo gjë nuk është realizuar për mungesë të fondeve nga buxheti i shtetit.

Problematika më e nxehtë dhe nga më emergjentet që shtrohet në disa prej këtyre ankesave është ajo e mosdhënies së dëmshpërblimit për vitet e vuajtjes në burgjet e periudhës së diktaturës komuniste. Në Maj 2003, një përfaqësi e shoqatave të ish të burgosurve politikë, kërkuan takim me Avokatin e Popullit, ku parashtruan dy çështje: E para, kërkuan ndërhyrjen e Avokatit të Popullit pranë organeve të policisë, për një tolerancë më të madhe nga ana e këtyre të fundit lidhur me tubimet e kësaj shtrese, në kërkim të realizimit të të drejtave të tyre. E dyta, një konsultë dhe mundësisht ndërhyrje të Avokatit të Popullit pranë Qeverisë shqiptare, në mënyrë që kjo e fundit të bënte realizimin në praktikë të dëmshpërblimit të plotë të kësaj shtrese për vitet e vuajtura burgjeve të diktaturës.

Për pikën e parë, Avokati i Popullit, sugjeroi zbatimin e ligjit përkatës për tubimet, gjë që kërkonte angazhim si nga shoqatat e të përndjekurve, ashtu edhe nga organet e policisë. Më pas nuk ka patur më konfrontime me policinë gjatë protestave.

Lidhur me pikën e dytë, pas takimit me Kryeministrin zotin Fatos Nano, ky sugjeroi që Avokati i Popullit të ishte ndërmjetës, që të përndjekurit të cilët paraqiteshin në tre grupe, të unifikonin kërkesat e tyre dhe të merrnin pjesë në grupet e punës që ishin ngritur me Urdhër të tij, për të përcaktuar mundësitë e zgjidhjes së kërkesave të tyre. Të përndjekurit pranuan rolin ndërmjetës, të Institucionit të Avokatit të Popullit, duke shprehur angazhimin e tyre për institucionalizimin e dialogut për gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme për dëmshpërblimin e tyre brenda standarteve kushtetuese dhe ligjeve në fuqi. Gjatë muajve Maj-Qershor të vitit 2003 u bënë mjaft takime pranë Zyrës së Avokatit të Popullit, me përfaqësues nga shoqatat e të përndjekurve politikë, të Qeverisë dhe nga ky Instituti. (IIPP)

Përfaqësuesit e tre grupimeve të ish të përndjekurve politikë arritën të unifikojnë një përmbledhje të kërkesave, lidhur me dëmshpërblimin e tyre për punën dhe vitet e burgut gjatë sistemit komunist. Kërkesat e tyre u përputhën me qëndrimin e Avokatit të Popullit se zgjidhja e kërkesave të ish të përndjekurve politikë parashikon një faturë që nuk mund të jetë përgjegjësi vetëm e një qeverie. Pra të gjitha palët duhet të përpilojnë dhe negociojnë një strategji që do të garantojë një zgjidhje të shtrirë në kohë të këtyre kërkesave.

Grupi i punës i caktuar nga Kryeministri Nano, në Shtator 2003 përfundoi verifikimin e detajuar të të gjithë veprimeve apo mosveprimeve të institucioneve të shtetit dhe mundësitë për shpërblimin e ish të dënuarve politikë si bazë për hartimin e një projektligji që të çojë drejt zgjidhjes përfundimtare.

Sikundër dihet, fatkeqësisht jemi në një fazë kur, vullneti politik i palëve në Parlament ende ka mbetur i pamaterjalizuar. Pozitiv mund të konsiderojmë faktin se tashmë gjithçka e arritur në nivel bisedimesh shërbeu si bazë sensibilizuese për zgjidhjen konkrete dhe në terma financiare të këtij problemi, të cilin në parim e pranojnë të gjitha palët. Gjithashtu ndërmjetësimi i Avokatit të Popullit bëri që debati të institucionalizohet, të unifikohet qëndrimi dhe kërkesat e të përndjekurve, si dhe të mënjanohej nga konfrontimi absurd, duke i përfshirë ato në angazhime konkrete.

2. Ministria e Drejtësisë

Gjatë vitit 2003 janë trajtuar gjithësej 306 ankesa e kërkesa që kanë të bëjnë me autoritete në juridiksionin e Ministrisë së Drejtësisë, e konkretisht me Drejtorinë e Përgjithshme të burgjeve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të zyrave të Përmbarimit.

Edhe gjatë vitit 2003 bashkëpunimi me këtë ministri ka rezultuar efektiv dhe cilësor.

A. Ankesat për burgjet dhe administratën e burgjeve

Në lidhje me burgjet dhe personelin e burgjeve kemi patur mjaft ankesa. Burgjet janë institucione të mbyllura dhe liria në të gjitha shprehjet e saj është e kufizuar dhe mund të shkelen me lehtë të drejtat e të burgosurve. Prandaj nga ana jonë, ankesave nga këta persona ju është kushtuar dhe do t'i kushtohet vëmendje e veçantë. Prandaj gjatë vitit 2003, punonjës të stafit të Avokatit të Popullit kanë vizituar pothuajse të gjitha burgjet që janë në përdorim, si dhe dhomat e izolimit të komisariateve të policisë në rrethe, ku qëndrojnë të burgosur, për të cilët vendimi i gjykatës ka marrë formën e prerë si dhe të paraburgosurit, që presin të gjykohen. Deri në fund të vitit 2003 ka patur 2057 të burgosur në burgje dhe 137 të dënuar që mbaheshin në dhomat e izolimit të komisariateve të policisë. Po kështu kanë qënë dhe 1115 persona nën hetim sepse akoma nuk kishte përfunduar gjykimi i tyre. Pra gjithësej kanë qënë rreth 3200 persona të privuar nga liria, nga 3000 persona që ishin në fund të vitit 2002.

Gjatë vizitave në këto institucione janë takuar personalisht 245 të dënuar apo të paraburgosur. Në 136 raste ankesat e të dënuarve janë bërë me shkrim. Gjithësej janë ankuar 379 persona, ku përfshihen të burgosur, familjarë të tyre apo personel i administratës së burgut që kanë aplikuar në

zyrën tonë për çështje që lidhen me administratën gjyqësore, të prokurorisë dhe burgjeve.

Si veçori të vitit 2003 për burgjet mund te përmendim organizimin e disa inspektimeve në burgje, në dhomat e izolimit dhe në Institucionet psikiatrike. Ky fakt tregon se nga njëri vit në tjetrin vjen duke u rritur dhe konsoliduar besimi i publikut në drejtim të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të burgosurve, të paraburgosurve, të sëmurëve mendor etj. Në vitin 2003 të burgosurve ju është ardhur në ndihmë më mirë nëpërmjet linjës telefonike për të bërë ankesat e tyre, është verifikuar disa herë dhe ka rezultuar se ajo ka funksionuar rregullisht. Në 18 raste (që janë përfshirë në numrin e përgjithshëm të ankesave) të burgosurit ankesat e tyre i kanë paraqitur nëpërmjet telefonit që është vendosur në dispozicion të tyre. Kjo tregon për një hapje akoma më të madhe të burgjeve shqiptare dhe është një arritje në drejtimin e duhur e institucionit të Avokatit të Popullit. Telefonata ka patur edhe nga të burgosurit tanë në Greqi siç ka qënë rasti i të burgosurit S. K. nga Burgu i Larisës në Greqi.

Të burgosurit që kanë bërë ankesa me shkrim kanë qënë gjithsej 136 persona. Të ndarë sipas burgjeve, gjëndja paraqitet si më poshtë:

1.Nga burgu 313	Tiranë	janë ankuar	16
2. Nga burgu 302	Tiranë	janë ankuar	13
3.Nga burgu 325	Tiranë	janë ankuar	3
4.Nga burgu	i Lushnjës	janë ankuar	8
5.Nga burgu i	Tepelenës	janë ankuar	10
6. Nga burgu i	Burrelit	janë ankuar	23
7.Nga burgu i	Vaqarrit	janë ankuar	19
8.Nga Spitali	burgjeve	janë ankuar	2
9.Nga burgu i	Rrogozhinës	janë ankuar	2
10.Nga burgu i	Krujës	janë ankuar	3
11. Nga paraburgimi		janë ankuar	27
12.Nga burgjet	jashtë vëndit	janë ankuar	10

Në këtë numër janë përfshirë edhe ankesat apo kërkesat me shkrim të 22 familjarëve të burgosurve si dhe 5 kërkesa të tjera që janë paraqitur nga drejtoritë e burgjeve apo komisariatet e policisë në rrethe.

Të ndarë sipas gjinisë, në 126 raste kanë bërë ankesë burrat, në 5 raste gratë dhe në rastet e tjera ankesat apo kërkesat jane dërguar nga drejtoritë e burgjeve apo komisariatet e policisë në rrethe.

Sipas mënyrës së përfundimit ankesat paraqiten si vijon:

Për vitin 2003 janë përfunduar **127** ankesa apo kërkesa të ardhura me shkrim, nga **136** të ardhura, ndërsa janë në shqyrtim **20** çështje. Nga **11** ankesat e mbartura nga viti 2002 në muajt e parë të vitit 2003 janë përfunduar të gjitha, 6 prej tyre janë zgjidhur në favor, 3 raste janë refuzuar, 2 janë dërguar për kompetencë.

Në rastet e përfunduara të vitit 2003, **48 ose 35 %** prej tyre janë zgjidhur në favor, **55 ose 40%** janë dërguar për kompetencë në organet e tjera, **24 ose 18%** janë konsideruar si të pabazuara në ligj, duke u refuzuar si të padrejta, **9** raste janë në shqyrtim.

Duke bërë grupimin sipas natyrës së ankesave rezultojnë:

1. Mjaft të burgosur janë ankuar se mbahen padrejtësisht në dhomat e izolimit të komisarateve të policisë, në të njëjtën kohë kur vendimet e gjykatave kanë kohë që kanë marrë formën e prerë.

Ata kanë pretenduar se ju është shkelur e drejta e njohur nga neni 462 i K.Pr.Penale që urdhëron ekzekutimin e menjëhershëm të vendimit të gjykatës që ka marrë formën e prerë.

Numri i ankesave të kësaj natyre për vitin që raportojmë është 17 raste. Institucioni i Avokatit të Popullit ndërmori një proces hetimi, në përfundim të të cilit, rezultoi se ende në dhomat e izolimit pranë komisarateve të policisë në rrethe, kishte dhe vazhdon të ketë një numër jo të vogël të dënuarish (më 31. 12. 2003 ndodheshin 137 të dënuar me vendim të formës së prerë në dhomat e izolimit), të cilët qëndrojnë padrejtësisht në këto dhoma. Shkaku i qëndrimit të këtyre të burgosurve në këto ambiente është mungesa e kapaciteteve në burgje të seksioneve të sigurisë së lartë, ashtu siç ka percaktuar gjykata për këta të burgosur. Pjesa më e madhe e të burgosurve për të cilët vendimet e gjykatës kishin marrë formën e prerë janë sistemuar në fund të vitit 2003 në Burgun e Peqinit, i cili funksionon me kapacitet pothuajse të plotë.

Për rastet konkrete të të dënuarve që bëjnë ankesat me shkrim pranë zyrës së Avokatit të Popullit, në kemi ndërhyrë nëpërmjet rekomandimeve që ata të dërgohen sa më parë në burgje dhe këto rekomandime janë pranuar.

Ashtu si edhe më parë, problemi i të dënuarve që mbahen në dhomat e izolimit pa të drejtë ka qënë dhe do të mbetet, një nga drejtimet kryesore të punës sonë deri në zgjidhjen përfundimtare të tij.

Në takimet me drejtuesit e Ministrisë së Rendit Publik dhe atyre të Ministrisë së Drejtësisë në vazhdimësi është kërkuar që të fillojë kalimi

gradual i dhomave te izolimit në vartësi te Ministrisë së Drejtësisë, deri në zgjidhjen përfundimtare të këtij problemi. Kështu në takimin e muajit Prill te vitit 2002, drejtuesit e Ministrisë së Rendit dhe Ministrisë së Drejtësisë u angazhuan se do te merrnin masa për zgjidhjen përfundimtare të problemit. Ky problem është ndjekur në vazhdimësi, duke bërë presion mbi Administratën e Burgjeve deri sa Qeveria nxorri vendimin nr 327, datë 15.05.2003, për kalimin e sistemit të paraburgimit në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë.

Zyra jonë është duke e ndjekur këtë problem mbasi deri tani, faktikisht kanë kaluar në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë vetëm dhomat e izolimit në Vlorë.

Ne mendojmë se ka edhe rrugë të tjera për zgjidhjen e këtij problemi kaq delikat. Problemi i mbipopullimit të burgjeve nuk mund të zgjidhet vetëm duke ndërtuar burgje të reja. Më shumë rëndësi duhet t'i jepet në radhë të parë punës parandaluese që duhet të bëjë gjithë shoqëria dhe shteti Shqiptar, dhe së dyti prokuroritë dhe gjykatat duhet të bëjnë një politikë më të drejtë në zbatimin e masave alternative të dënimit. Ne duhet të jemi më racionalë, jo çdo gjë duhet të zgjidhet me burg. Mohimi i lirisë është një masë ekstreme, e cila duhet të jepet dhe të përdoret vetëm nëse masa të tjera alternative do të ishin pa vënd për shkak të rrezikshmërisë së krimit të kryer dhe autorit.

2. Të sëmurë mendorë që mbahen ende padrejtësisht në spitalin e burgut.

Edhe në vitin 2003, problemi i personave për të cilët gjykata ka marrë masën mjeksore të mjekimit të detyruar nuk ka marrë ende zgjidhje. Siç kemi raportuar edhe vitin e kaluar. jate vitit 2002 institucioni i Avokatit te Popullit organizoi një inspektim në Spitalin e Burgjeve për të parë gjëndjen e të sëmurëve mendorë për të cilët gjykatat kanë marrë masën mjeksore të mjekimit të detyruar dhe padrejtësisht mbahen në kushte burgimi. Nga inspektimi doli se këta persona ndonëse nuk janë të denuar, mbahen ende brënda sistemit të burgjeve. Nga hetimet e ndërmara nga ana jonë, veç te tjerash pengesë për zgjidhjen përfundimtare të këtij problemi rezultoi se ishte edhe mosplotesimi nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Drejtësisë të akteve nënligjore për ruajtjen e këtyre personave. Për këtë kemi bërë rekomandimin e datës 13.05.2002: **për plotësimin e kërkesave të ligjit nr.8092 dt.03.02.1996 “Për Shëndetin Mendor” për të nxjerrë rregulloren “Për masat e sigurimit të personave për të cilët gjykata ka marrë masën mjeksore të mjekimit**

të detyruar”, drejtuar Ministrit të Drejtësisë, Ministrit të Shëndetësisë dhe për dijeni ish Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, zotit Pandeli Majko.

Pra ky ligj përcakton detyrimin Ministrit të Drejtësisë, Ministrit të Shëndetësisë dhe Ministrit të Mjedisit për të miratuar Rregulloren e masave të sigurimit për personat që kanë kryer një vepër penale dhe janë dënuar nga gjykata të vuajnë dënimin në Institucione psikiatrike. Por megjithëse kanë kaluar rreth 6 vjet nga dita kur ka hyrë në fuqi ligji “Për shëndetin mendor”, një rregullore e tillë ende nuk ka dalë. Aktualisht të gjithë të dënuarit me mjekim të detyruar qëndrojnë në kundërshtim flagrant me ligjin në Spitalin e Burgut dhe në ndonjë komisariat policie. Ky qëndrim ka sjellë moszbatimin e nenit 28 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që përcakton se çdo person i tillë ka të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tij dhe ka lënë shteg për të abuzuar në drejtim të kërkesave ligjore për të drejtat e liritë e këtyre personave, duke i dëmtuar edhe më tepër nga ana mendore.

Në përgjigje të këtij rekomandimi Ministria e Shëndetësisë e quan të zgjidhur problemin me kalimin kapital që ka bërë të godinës së Spitalit të Krujës në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë. Kurse Ministria e Drejtësisë në përgjigje të këtij rekomandimi ka marrë angazhimin se me hapjen e Burgut të Krujës do të fillojë së funksionuari edhe rregullorja e kerkuar nga ana jone.

Ne realitet burgu i Krujes ka filluar nga aktiviteti, por funksionon përsëri si burg dhe jo si institut mjekesor që të sistemohen personat e sipërpërmendur. Në kushtet kur ligji ndalon sistemimin e këtyre personave brenda sistemit të burgjeve nuk duhet marrë në konsideratë sistemimi i tyre në këtë burg. Gjate vitit 2003 zyra jone ka insistuar pranë të dy ministrive për nxjerrjen e rregullores dhe përcaktimin e vendit ku do të shkojnë këta persona.

Ne mendojmë se nuk ka munguar vullneti i Qeverisë për zgjidhjen e këtij problemi. Këtë konkluzion e nxjerrim duke parë angazhimin e Kryeministrit që në muajin Qershor 2003 urdhëroi ngritjen e një grupi pune për të bërë propozimet konkrete për zgjidhjen e këtij problemi. Kohët e fundit së bashku me Ministrinë e Drejtësisë ne kemi bërë bashkëautorët e një projekti për zgjidhjen e këtij problemi duke i propozuar Kryeministrit mënyrat e zgjidhjes. Gjatë muajit Janar 2004 është përcaktuar vendi në Spitalin psikiatrik të Elbasanit dhe është hartuar drafti i rregullores së përbashkët të dy ministrive për ruajtjen e këtyre personave.

Edhe për të ardhmen sistemimi i këtyre personave, ashtu siç është përcaktuar në ligj, do të jetë një nga përparësitë e punës sonë.

3. Ushtrim dhune dhe shkelje të tjera nga Policia e burgjeve

Pas miratimit nga Kuvendi të ligjit nr.9071 datë 22.05.2003”Për një ndryshim në ligjin nr.8328 datë 16.04.1998 ”Për te drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, Avokati i Popullit ka të drejtën për të bërë vizita pa autorizim dhe inspektime në burgje.Në zbatim të këtij ligji Avokati i Popullit organizoi një inspektim në burgun e Burrelit. Ky inspektim u organizua për shkak të te dhënave që dispononte Institucioni i ynë se në këtë burg përdorej dhunë nga ana e policisë së burgut. Doli se kishte fakte edhe për përdorim të dhunës nga ana e policisë së burgut të Burrelit. Konstatimet tona ju bënë prezent Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, Ministrin të Drejtësisë, si dhe u vu në dijeni edhe Kryetari i Kuvendit Z. Servet Pëllumbi.

Rast tjetër është ai i të dënuarit E.M.që nëpërmjet telefonit është ankuar në zyrën tonë se nga ana e policisë së burgut të Tepelenës ndaj tij ishte ushtruar dhunë. Me të marrë këtë ankesë me shpejtësi është shkuar në Burgun e Tepelenës dhe është nisur një proces hetimi.Nga grumbullimi i të gjitha te dhënave rezultoi se ndaj tij ishte ushtruar dhunë. Prandaj i rekomandua Prokurorisë së Rrethit Tepelenë të fillonte ndjekjet penale kundër punonjësve të policisë të cilët kanë ushtruar dhunë ndaj tij. Prokuroria e Rrethit Tepelenë e ka vlerësuar rekomandimin tonë dhe ka vendosur fillimin e çështjes.

Ankesa për keqtrajtime nga policia e Burgjeve pranë zyrës së Avokatit të Popullit kanë bërë edhe të dënuarit A.G. dhe V. L. Ankesat e tyre janë verifikuar në vënd brënda ditës dhe nëpërmjet rekomandimeve është kërkuar marrja e masave karshi personave fajtorë si dhe organizimi i punës për zbatimin e ligjit dhe konventat ndërkombëtare që mbrojmë të drejtat e të dënuarve me burgim. Me miratimin e të drejtës së Avokatit të Popullit për të bërë vizita në burgje pa autorizim, si dhe për të organizuar inspektime në burgje është krijuar një mundësi shumë më efektive për mbrojtje të të drejtave dhe lirive të të dënuarve. Praktika e inspektimeve do të nbëhet më e shpeshtë në të ardhmen, pavarësisht nga pengesat që po na nxirren nga ana e Ministrisë së Drejtësisë që nuk lejon ndihmës komisioneret të futen në burgje edhe me autorizim të Avokatit të Popullit.

4. Kërkesa të të burgosurve kundër vendimeve të gjykatave

Edhe gjatë vitit 2003 në zyrën tonë kanë vazhduar të vijjnë ankesa të të dënuarve kundër vendimeve të gjykatave të cilat i kanë deklaruar ata fajtorë. Në ankesat e tyre ata pretendojnë se nuk janë fajtorë për veprat për

të cilat janë dënuar, sepse gjykatat nuk kanë vlerësuar drejt provat në ngarkim të tyre. Numri i këtyre ankesave për vitin 2003 është 42. Pavarësisht se Avokati i Popullit në bazë të ligjit nuk ka në kompetencë shqyrtimin e vendimeve të gjykatës, në të gjitha këto raste nga ana jonë ankuesve ju është treguar rruga që ata duhet të ndjekin për të realizuar të drejtën e pretenduar prej tyre, me kërkesë për rishikimin e vendimit pranë Gjykatës së Lartë

5. Ka patur disa të dënuar që janë ankuar duke pretenduar se ju janë shkelur të drejtat që ju ka njohur ligji për amnistinë në vitin 1997 dhe atë të vitit 2003

Jane paraqitur 3 ankesa dhe në të gjitha këto raste është marre takim ose me të dënuarit ose me familjare të tyre. Në ankesat e paraqitura nuk është gjetur ndonjë rast që amnistia të jetë zbatuar gabim.

6. Grevat e urisë

Avokati i Popullit në kater raste që është vënë në dijeni nga administrata e burgjeve për hyrjen në greva urie të denuarve, ka qenë ndërmjetës midis tyre dhe të burgosurve. Në dy nga këto raste, ndërhyrja e Avokatit të Popullit ka qënë e suksesshme sepse të dënuarit kanë ndërprerë grevën e urisë, pasi ju janë plotësuar me parë ato kërkesa për të cilat kanë patur të drejte. Ndërsa, në rastet kur ata kanë përdorur këtë mjet si presion për ndryshimin e vendimit të gjykatës, ju është bërë e qartë se ankesa nuk ishte në juridiksionin tonë dhe se çështja nuk zgjidhej me grevë urie, por duke apeluar në organet më të larta të gjyqësorit.

7. Ankesa për transferime të padrejta apo nga një burg në tjetrin

Në 3 raste të dënuarit janë ankuar për transferime të padrejta ose kanë kërkuar të transferohen nga njëri burg në tjetrin.

Nga verifikimet tona është vërtetuar se në dy raste që u përkasin të burgosurve E.M.dhe N.A. transferimi i tyre nga një burg në tjetrin është bërë në kundërshtim me kriteret ligjore. Avokati Popullit nëpërmjet rekomandimit në këto raste ka kërkuar anulimin e urdhrave të transferimit. Kërkesa jonë është quajtur e drejtë dhe nga Drejtoria e Përgjithme e Burgjeve është vendosur transferimi i tyre në një burg afër vendbanimit të tyre.

8. Ankesa të të dënuarve të ekstraduar nga Greqia që vuajnë dënimin në burgjet shqiptare

Me kërkesë të Drejtorisë së burgut të Rrogozhinës në vitin 2002 për të takuar 16 të dënuar që pretendonin se ju ishin shkelur të drejtat e tyre nga gjykatat greke, një grup i stafit të Avokatit të Popullit mori takim nje per nje me secilin te denuar, duke degjuar me kujdes ankesat e paraqitura prej tyre. Takime të tilla janë bërë me ta edhe në vitin 2003 në burgun e Rrogozhinës, në burgun e Vaqarit dhe atë të Burrelit.

Nga takimet ka rezultuar se këta të burgosur ndonëse i kishin kaluar të gjitha shkallet e gjykimit në Greqi, pretendonin se ishin dënuar padrejtësisht.

Ata janë sqaruar se vendimet e gjykatës greke janë jashtë juridiksionit të zyrës sonë dhe se shqyrtimi i këtyre vendimeve nga gjykatat tona nuk mund të bëhet. Disa vendime unifikuese të Gjykatës së Lartë i ndalojnë gjykatat që të marrin në shqyrtim vendimet e dhëna nga gjykatat greke.

Ky problem është duke u ndjekur në kuadrin e hetimit të rastit që ka filluar me inisiativë zyra jonë, ku pretendohet që gruaja që është paraqitur para gjykatës greke si përkthyes nuk di fare gjuhën shqipe.

9. Ankesa të familjareve të shtetasve shqiptarë që vuajnë dënimin në burgjet e shteteve të tjera

Kane patur 8 ankesa të familjarëve, me anën e të cilave ata kanë pretenduar se ndaj të afërmeve të tyre në burgjet në Itali dhe Greqi përdoret dhunë, se ata nuk kanë asnjë dënim për shkaqet e burgosjes së fëmijëve të tyre etj.

Duke qënë se këto ankesa janë jashtë juridiksionit tonë, 6 prej tyre, ja kemi dërguar Drejtorisë Konsullore pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë, që nëpërmjet zyrave tona konsullore në këto shtete, të japin ndihmesën e tyre në bazë të ligjit nr.8372 datë 09.07.1998 “Për ushtrimin e funksioneve konsullore nga përfaqesitë diplomatike apo konsullore”. Në dy raste, ato të shtetasve E.D dhe M.K ankesat i janë dërguar Mediatorit të Francës dhe Ombudsmanit të Greqisë.

Lidhur me angazhimin tonë për realizimin e një projekti për të pajisur të gjithë të burgosurit shqiptarë jashtë vëndit me një broshurë në gjuhën Shqipe, të quajtur “Akte ligjore në ndihmë të të burgosurve jashtë Shqipërisë”, ju informojmë me kënaqësi së tashmë ky botim është realizuar. Ka filluar shpërndarja e tij, duke dërguar 1850 kopje për burgjet

në Greqi, 100 kopje ne Angli, 30 kopje ne Slloveni dhe 50 kopje ne Danimarkë. Po vazhdon puna per ta derguar në shtete të tjera.

Nga analiza e ankesave dhe kërkesave të të burgosurve që ndodhen në burgje dhe në dhomat e izolimit pranë komisariateve të policisë, del se gjatë vitit 2004, veprimtaria e Institucionit te Avokatit te Popullit duhet të synojë në realizimin e rekomandimeve kryesore për Qeverinë, për Ministrinë e Drejtësisë që ka në vartësi Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe për Ministrinë e Rendit dhe konkretisht:

1. Shpejtimin e procedurave për marrjen në dorëzim nga Ministria e Drejtësisë të dhomave të izolimit në të gjithë vëndin.

2. Sistemimin në një institut mjekësor të personave për të cilët gjykata ka vendosur mjekimin e detyruar, ashtu siç kërkon ligji.

3. Mbi bazën e ankesave të të burgosurve, duke parë se në disa raste vetë ligji ishte bërë shkak për shkeljen e disa te drejtave të të burgosurve, mbështetur në ligjin për Avokatin e Popullit, kemi bërë edhe rekomandime për plotesimin e akteve ligjore që lidhen me të drejtat e të burgosurve.

Kështu i kemi dërguar Komisionit Parlamentar të të drejtave të njeriut rekomandimin e mëposhtëm:

Ne kemi patur dhe kemi ankesa në vazhdimësi se të dënuarve që janë mbajtur në qelitë e paraburgimit nuk ju njihet dhe nuk ju llogaritet kjo kohë si paraburgim. Shkaku i shkeljes së të drejtës së të paraburgosurve është bërë neni 7 i ligjit nr.7941, datë 27.01.1995, “Për Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, i cili përcakton se: Me paraburgim do të kuptojmë ditët e qëndruara në ndalim dhe arrestim në burg. Kur arrestimi nuk është ndërprerë, periudha e paraburgimit do të konsiderohet nga dita e ndalimit, derisa vendimi i gjykatës ka marrë formën e prerë.

Për këto arsye, në zbatim te nenit 63 të Kushtetutës së Shqipërisë kemi propozuar që një grup deputetësh të ndërmarrin një inisiativë për një ndryshim të paragrafit të dytë dhe të tretë të nenit 7, të ligjit nr.7941, datë 31.05.1995, me këtë përmbajtje: “Me paraburgim do të kuptohen ditët e qëndruara në ndalim ose arrestim në ambiente paraburgimi. Kur arrestimi nuk është ndërprerë, periudha e paraburgimit do të konsiderohet nga dita e ndalimit derisa sipas vendimit të gjykatës të formës së prerë i dënuari të dërgohet në burg. Të dënuarit me vendim gjyqësor të formës së prerë që për arsye të ndryshme janë mbajtur në kushte paraburgimi t’u llogariten ditët e burgimit në këto kushte njëjloj si ditët e paraburgimit”.

Nga kjo dispozitë përfitojnë edhe të gjithë personat e dënuar që janë mbajtur për disa kohë në kushte paraburgimi dhe në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdojnë të kryejnë dënimin. Në këtë mënyrë zgjidhen edhe ankesat e tyre të drejta.

4. Duke parë se një pjese të madhe të të dënuarve nuk ju sigurohej e drejta për të votuar në zgjedhjet për pushtetin lokal, Zyra jonë i ka dërguar komisionit bipartizan rekomandimin **per plotesimin e ligjit nr.8609 date 08.05.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”**

Në këtë rekomandim ne kemi parashtruar: “Sipas pikes 3 te nenit 45 te Kushtetutes se Republikës së Shqipërisë te denuarit qe jane duke vuajtur denimin me heqje te lirise kane vetem te drejten “per te zgjedhur”.

Ne piken 2 te nenit 59 te ligjit nr.8609, date 08.05.2000 **Per zgjedhjet dhe referendumet vendore” thuhet: Dy dite para dites se votimit, drejtuesi i institucionit te posaçem pergatit listen e zgjedhesve me vendbanim ne njesine zgjedhore, ku ndodhet institucioni dhe ia dorezon ate K.Z.Q.V-së”.**

Sipas praktikës së zgjedhjeve të kaluara vendore të vitit 2000, sipas përcaktimit të bërë nga kjo dispozitë pjesë më e madhe e të dënuarve u privuan nga e drejta për të zgjedhur. Kjo për arsye të thjeshtë se ligji ka përcaktuar dhe është zbatuar, që në listen e zgjedhësve, janë përfshirë vetëm ata të dënuar që kanë patur vendbanimin në vendin ku ndodhë institucioni (burgu). Në praktikë kjo ndodh shumë rrallë për shkak se p.sh. në burgjet e Tiranës ka më qindra të dënuar që e kanë vendbanimin në qytete të tjera. Sipas ligjit ekzistues, ata nuk mund të regjistrohen në listat e zgjedhësve, për rrjedhojë edhe nuk votojnë.

Duke parë se vete ligji në nenin 59 pika 2 është bërë pengesë që të denuarit të ushtrojnë të drejtën e zgjedhjes që ju njihet Kushtetuta jone në piken 3 te nenit 45 te saj, mendojme se ka vend për përmirësimin e ligjit nr.8609 date 08.05.2000”. Verbalisht nga drejtuesit e Komisionit Bipartizan u vumë në dijeni se ky rekomandim ishte i drejtë, por gjatë hartimit të ligjit zgjedhor të vitit 2003, “U harrua”. Si rrjedhojë edhe në zgjedhjet vendore të 12 Tetorit 2003 një pjesë e të dënuarve nuk votuan.

5. Gjithashtu i kemi ridërguar Ministrisë së Drejtësisë rekomandimet e mëposhtëme, për të cilat ndonëse kemi marrë përgjigje se janë pranuar si të drejta, në realitet nga ana e kesaj Ministrie nuk janë bërë hapa konkrete për vënien në zbatim të angazhimeve të marra:

- a) Rekomandim për plotësimin e kërkesave të ligjit nr.8328 dt.16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim.”

Nga shqyrtimi i ankesave të tyre si dhe në këndvështrim të neneve 76 dhe 34 të ligjit nr.8328, dt.16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” del se Këshilli i Ministrave duhej të miratonte Rregulloren e Burgjeve dhe akte të tjera nënligjore brenda 3 muajve nga hyrja e ligjit në fuqi, pra që në vitin 1998. Sipas nenin 34 të këtij ligji

(paragrafi i fundit) puna e të burgosurve shpërblehet sipas kriterëve të përcaktuara me Vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

Megjithëse kanë kaluar rreth 5 vjet nga dita kur ka hyrë në fuqi ligji “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, një vendim i tillë ende nuk ka dalë. Aktualisht gjithë të burgosurit që punojnë në burgje, marrin një shpërblim simbolik (90 lekë në muaj dhe për çdo një muaj pune përfitojnë 4 ditë burgim).

Për këto arsye kemi rekomanduar që të hartohet drafti i Vendimit të Këshillit të Ministrave për kriteret e shpërblimit të punës së të dënuarve dhe të dërgohet për miratim në Këshillin e Ministrave.

b. Rekomandim për krijimin e kushteve të nevojshme për funksionimin e Komisionit Mbikqyrës të ekzekutimit të Vendimeve me Burgim, sipas kreut të tretë të ligjit nr.8331 datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e Vendimeve Penale”

Në kreun e tretë të ligjit “Për ekzekutimin e Vendimeve Penale” është përcaktuar, ngritja e Komisionit Mbikqyrës të ekzekutimit të vendimeve penale me burgim, si organ këshillimor për zbatimin e ligjit “Për ekzekutimin e vendimeve penale me burgim dhe mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve”.

Ky komision ngrihet pranë Ministrit të Drejtësisë, dhe e shtrin veprimtarinë në të gjithë vendin. Komisioni ka për detyrë që mbi bazën e ankesave ose njoftimeve të paraqitura nga të burgosurit të rekomandojë marrjen e masave të menjëherëshme për rivendosjen e ligjit apo të drejtës së shkelur. Sipas nenit 60 të ligjit në fjalë komisioni përbëhet nga 9 anëtarë që caktohen respektivisht nga: 1. Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvëndit dhe Kryetari i Këshillit të Ministrave caktojnë si anëtarë nga një person që nuk ka funksione publike. 2. Ministrat që mbulojnë shëndetësinë, ushqimin, ndërtimin dhe kulturën, caktojnë nga një anëtarë prej punonjësve të tyre, me kusht që të jenë specialist në profilet përkatëse. Ministria e Drejtësisë cakton një anëtar, që nuk ka funksione publike, por që ka kushte për të qenë gjyqtar. 3. Një anëtar caktohet nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë. Kryetari dhe zëvendësi i Komisionit zgjidhen nga mbledhja e parë e anëtarëve.

Nga shqyrtimi i çështjes prej zyrës sonë rezulton se ngritja e këtij komisioni ka mbetur vetëm në letër. Ne pergjigje te rekomandimit tone me datën 22.12.2003 Ministri i Drejtësisë ka njoftuar se janë krijuar kushtet prane Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për funksionimin normal te Komisionit Mbikqyres, dhe po pregatit projekt vendimin për shpërblimin e antarëve të këtij komisioni.

B. Ankimet per zyrat e permbarimit

Një nga shqetësimet më të mëdha të shtetasve shqiptarë mbetet problemi i mos ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Ky konkluzion del nga sasia e ankesave prej 151 rastesh. Janë përfunduar 80 prej tyre, nga të cilat 27 ose 33 % të rasteve janë zgjidhur pozitivisht, 53 kanë rezultuar si të pabazuara, ndërsa 71 të tjera vazhdojnë të jenë në shqyrtim.

Pjesa më e madhe e ankesave ka të bëjë me problemin tashmë të njohur dhe të pazgjidhur të mos ekzekutimit të detyrimeve në të holla të debitorëve institucione buxhetore. Të drejtat e gjyqfituesve (kreditorëve) vazhdojnë të mos rivendosen në vend, duke mos u mbyllur kështu cikli i procesit gjyqësor, i cili përfundon me ekzekutimin e të drejtës së fituar në rrugë gjyqësore. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut konsiderohen jo vetëm si të drejta apo liri që u përkasin individëve, por edhe si pjesë përbërëse e detyrimeve që u takojnë organeve shtetërore. Në nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut që bën fjalë për një proces të rregullt gjyqësor, midis të tjerave parashikohet se : “Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brënda një afati të arësyeshem nga një gjykatë e pavarur dhe e paanëshme, e krijuar ligjërisht, e cila do të vendosë qoftë për konfliktet mbi të drejtat dhe detyrimet e tij me karakter civil, qoftë për bazueshmerinë e çdo akuze të natyrës penale të drejtuar kundër tij...”.

Ky problem po mbartet nga viti ne vit duke shtuar në këtë menyrë detyrimet e shtetit në shuma sugestionuese. Megjithë sensibilizimin që i është bërë këtij problemi, edhe nga Institucioni tonë, nëpërmjet Konferencës Kombëtare për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore te formës së prerë, ashtu edhe me rekomandimet e adresuara Ministrive dhe Institucioneve qëndrore rast pas rasti, ende nuk ka shenja për një zgjidhje të afërt. Në shumë raste Zyrat e Përmbartimit kanë vendosur gjoba ndaj debitorëve që refuzojnë të veprojnë në përputhje me vendimin e gjykatës, por thuajse asnjë prej tyre nuk është vjelë për arsye të anullimit nga gjykata.

Vazhdon të mos kuptohet nga shumë drejtues të administratës publike, se parashikimi ne piken 3 te nenit 142 të Kushtetutes të detyrimit të organeve te shtetit për të ekzekutuar vendimet gjyqësore, nuk është element fakultativ, por urdhërues. Për më tepër që këto praktika negative, në shumë raste i konsiderojnë si të drejta, duke i mbrojtur edhe publikisht. Nuk është e largët dita që Gjykata Evropiane e të Drejtave te Njeriut, lidhur me gjykimin e ankesave të shtetasve shqiptarë, të depozituara tashmë pranë

saj, me objekt mos ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, do të penalizojë shtetin shqiptar në shuma të mëdha për mos veprimet e tij, që në fund të fundit do të paguhen nga taksapaguesit shqiptarë dhe do të rëndojnë fondet publike të parashikuara për fushat e ekonomisë, arsimit, shëndetësisë, etj. Një pjesë e mirë e personave përgjegjës, me mos veprimet e tyre, tregojnë se në formimin e tyre të përgjithshëm si administratorë, kanë boshllëqe të mëdha, pa shtuar shkallën e ulët të ndjenjës së përgjegjësisë. Një përfundim i tillë mund të duket disi i rende, por faktet janë kokeforte. Nuk ka si shpjegohet ndryshe që nuk ekzekutohen vendime gjyqësore te formes se prere nga institucione buxhetore për shuma të vogla. Ky problem ka edhe anen tjetër të medaljes, atë të vlerësimit të drejtë të këtij problemi nga Institucione të veçanta, që vullnetarisht kanë shlyer detyrimin ndaj kreditorëve të tyre, si ai i Komisarariatit të Policisë të Devollit me t'u vënë në dijeni nga Zyra e Përmbarimit për ekzekutimin vullnetar të shumës në të holla ndaj zotit S.M, e bëri menjehere realitet. Nga praktikat që çuditërisht po zgjaten pa gjetur zgjidhje ligjore, përmendim rastin e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Palujtëshme të rrethit Krujë që me gjithë referencat në Kushtetutë dhe ligj, me dhënien e sqarimeve përkatëse verbale dhe rekomandimet e bëra, në mënyrë tepër stoike nuk lëviz nga pozicioni për të mos rregjistruar një pasuri të palujtëshme të ankueses Sh.M, fituar me vendim gjyqësor të formës së prerë që ka patur si objekt ndryshimin e vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Po ashtu Drejtoria e Përgjithëshme e Doganave prej më se një vit nuk ka pranuar të ekzekutojë një vendim gjyqësor të formës së prerë dhe një vendim të Komisionit të Shërbimit Civil për kthimin në vëndin e mëparshëm të punës të shtetasit A.B.

Nga shqyrtimi i ankesave për Zyrat e Përmbarimit janë konstatuar se ka patur zvarritje në ekzekutimin e titujve ekzekutivë edhe nga veprimet proceduriale jo të rregullta të përmbaruesve. Kjo ka ardhur për mangësi të formimit të tyre profesional dhe zbatim të gabuar të normave përkatëse për ekzekutimin e detyrueshëm të parashikuara në Kodin e Proçedurës Civile. Për çdo konstatim të tillë është vënë në dijeni si Zyra përkatëse e Përmbarimit, ashtu edhe Drejtoria e Përgjithëshme e Përmbarimit në Ministrinë e Drejtësisë me të cilën kemi patur bashkëpunim dhe mirëkuptim të plotë për rastet e trajtuara.

Në çështjet, të cilat me ndërhyrjen tonë kanë përfunduar pozitivisht, duam të përmendim atë të kthimit në vëndin e mëparshëm të punës të punonjësit të strukturave të Policisë së shtetit, zotit Gj.B. mbi rekomandimin tonë drejtuar Ministrisë të Rendit, që u muar parasysht dhe u ekzekutua. Po ashtu vlerësojmë veprimet e shpejta të Zyrave të

Përmbarrimit në rrethet e Korçës, Krujës, Tiranës, pas sugjerimeve tona, për ekzekutimin e detyrueshëm të detyrimeve ndaj debitorëve persona fizikë, përkatësisht ndaj kreditorëve P.D, V.S. dhe Sh.S.

Në vitin 2003, Avokati i Popullit i ka dërguar rekomandim Ministrit të Drejtësisë dhe atij të Rendit për marrjen e masave për të bërë të mundur njohjen dhe zbatimin e akteve ligjore nga ana e Sherbimit të Përmbarrimit Gjyqësor si dhe strukturat që janë në varesi të Ministrisë së Rendit për çështjet e femijeve.

Shkak që shtyu Avokatin e Popullit të ndermarrë këto iniciative sensibilizuese të meshiruara në këto rekomandime, u bënë ankesat nga ku rezultuan se shumë përmbarrues gjyqësor si dhe punonjës të rendit nuk ishin të orientuar në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të femijeve dhe ekzistencën e shumë dispozitave ligjore të cilat mbrojnë këto të drejta. Kështu nga hetimet e praktikave rezultoi se pjesa më e madhe e Përmbarruesve Gjyqësorë udhëhiqeshin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre nga apatia, mos njohja e plotë e akteve ligjore dhe nenligjore, subjektivizmi si dhe mos respektimi i procedurave administrative për subjekte kaq komplekse dhe të brishta siç janë femijet.

Rezultoi nga kontaktet e realizuara me përmbarrues gjyqësorë, që këta të fundit të kenë boshllëqe në formimin e tyre juridik, duke mos njohur dhe ditur ekzistencën e akteve ligjore, kombëtare dhe ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti ynë, të cilat rregullojnë dhe zgjidhin marrëdhëniet juridike civile, të cilat kanë për objekt ose subjekt të tyre femijet.

Për shembull "Konventa Për Mbrojtjen e Femijeve" e ratifikuar prej gati 10 vjetësh nga shteti shqiptar, në të gjitha nënet e saj, jep mundësi interpretimi më të mjaftueshme për të udhëhequr Përmbarruesit Gjyqësorë gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre kur zbatohen vendimet gjyqësore me objekt femijet. Kështu, neni 3 i kësaj Konvente sanksionon:

"Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me femijen, të marra qoftë nga institucionet publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative ose organet legjislativë, interesi më i lartë i femijes duhet të jetë konsideratë mbizotëruese"....

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë neni 54 i saj sanksionon ...

"Femijet...kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti."

Kodi i ri i Familjes, neni 2.

"Prinderit, organet kompetente dhe gjykatat, në vendimet dhe veprimtarinë e tyre, duhet të kenë si konsideratë parësore interesin më të lartë të femijes"

Sa më sipër e citojmë për të kuptuar që nuk ka mangësi ligjore, por mangësi në të kuptuar dhe moszbatim të ligjit nga strukturat kompetente.

Nga disa ankesa qe Institucioni i Avokatit te Popullit ka hetuar rezulton se :
1. I mituri M M, me vendimin nr.182, date 18.07.2001 te Gjykates se Rrethit Kukes, i eshte lene per rritje dhe edukim nenes se tij. Ne vendimin e gjykates jane percaktuar ne baze te ligjit dhe e drejta e takimit te femijes me te atin e tij si dhe detyrimi i ketij te fundit per te paguar nje pension ushqimor per femijen.

Por rezultonte se femija mbahej forcerisht larg nenes se tij, duke shkelur vendimin e gjykates dhe interesat e femijes. Babai, duke qene efektiv i Policise se shtetit dhe duke abuzuar me detyren i ndihmuar dhe nga neglizhenca e Kryetarit te Zyres se Permbarimit perkates nuk zbatonte vendimin e gjykates qe te miturin ia linte nenes se tij. Prej tre vjetesh ky femije ishte izoluar, duke i mohuar nenen si dhe nenes te drejten e mbajtjes dhe rritjes te femijes se saj. Kjo realizohej me ndihmen ose neglizhencen me dashje te strukturave te shtetit.

2. E mitura A.B, ne zbatim te vendimit te Gjykates se Rrethit Shkoder i eshte lene nenes se saj per rritje dhe edukim, por disa here eshte marre forcerisht nga forcat e policise ne Shkoder me ndermjetesine dhe bashkepunimin e Zyres se Permbarimit. Justifikimi eshte per te realizuar forcerisht takime me babain e saj (i cili ka vetem te drejten e takimit). Por shumicen e rasteve siç deshmojne dhe vete policet ne proces verbale e mbajtura vajza ka patur humbje ndjenjash dhe traume te forte psikike. Kjo situatë eshte perseritur disa here, duke arritur deri aty sa babai i te mitures kundrejt reagimit te vajzes per te mos e takuar ate, e ka dhunuar fizikisht femijen dhe nenen e saj, per te cilin eshte denuar me tre muaj heqje lirie. Po edhe pse ka ndodhur kjo, eshte vazhduar serish nga forcat e policise te shkohet per te marre me force te mituren, duke shkelur ne menyre flagrante interesat e te mitures. Rezultoi gjate hetimit te kesaj çeshtje, se vajza kurohet prane mjekteve psikoterapeutike dhe ne çdo fund jave, kur mendon se do te merret forcerisht, kalon kriza paniku dhe ankthi.

Si ky rast ka edhe mjaft te tjera ku permbaruesit dhe forcat e policise, nisur nga shkaqe abuzive ne kundërshtim me ligjin, ekzekutojne keto lloj vendimesh, duke shkelur te gjitha ligjet dhe procedurat.

3. Me poshte po ju prezantojme nje rast tjetër flagrant ku Zyra e Permbarimit Tirane, strukturat e Policise se Rajonit nr.1, Posta e Qytetit Studenti dhe strukturat e Rajonit te Policise nr.3 Tirane, nuk kryejne detyrat e percaktuara me ligj.

I mituri B.F ne muajin shkurt 2003 merret forcerisht nga ambjentet e shkolles nga babai K.F. per takimin e percaktuar konforme vendimit perkates te Gjykates se Rrethit Tirane. Ai izolohet ne bodrumet e godines 15 te Qytetit Studenti, ne nje dhome te marre me qira nga bashkjetuesja e

babait. Per kete arsye dhe pse ishte nje femije me nota shume te mira ne klase te pare (7 vjeç), ngel ne shkolle per shkak te mungesave. Prej gati 6 muajsh pengohet te takoje nenen e tij e cila me vendim te gjykates eshte caktuar te kujdeset per rritjen dhe edukimin e femijes. Nga shqyrtimi i ketij rasti nga zyra jone, rezultoi se femija shfrytëzohej nga i ati dhe femra me te cilin ai bashkejeton per te shitur bashke me kete te fundit cigare deri ne mesnate ne rrethinat e Qytetit Studenti. Mbas verifikimit ne vend te ketij rasti dhe mbas takimit me femijen, dallohej qarte trauma, frika dhe gjendja e tij e renduar psiqike sidomos nga dhuna fizike dhe psiqike qe pesonte nga gruaja me te cilin ai bashkejetonte. Ambjentet qe ndeshem ne Qytetin Studenti dhe respektivisht ne godinen 15 ishin ngjethese. Me ngjethes ish fakti se kur u pyet kujdestari i godines per vendndodhjen e te miturit, ai e fshehu te verteten duke u kthyer nga nje punonjes shteti, ne nje fshehes dhe bashkepunetor ne krim. Kjo apati dhe indiferece u has dhe ne shkollen e te miturit etj.

Sa me siper, qe permbush te dhenat per vepra penale, ndodhte me dijenine e Zyres se Permbarimit Tirane dhe strukturave te Policise se Rendit te Rajoneve Nr.1 dhe Nr.3. Kjo sepse nena e te miturit, vazhdimisht gjate 6 muajve te izolimit te djalit, ishte ankuar per rrembimin e femijes se saj dhe denonconte dhunen qe mund te ushtrohej ndaj tij nga ish burri dhe gruaja me te cilin ai jetonte. Por asnjehere nuk u reagua nga Permbaruesi i ceshtjes dhe strukturat e rendit ne menyre qe ti jepej fund trajtimit çnjerezor kundrejt te miturit. Edhe ne kete rast babai nuk ka paguar asnje here pension ushqimor per femijen e tij.

Mbas angazhimit dhe insistimit te Institucionit tone prane strukturave te Zyres se Permbarimit dhe Rajonit te Policise, u arrit qe te tre rastet e mesiperme te zgjidheshin. Por per fat te keq, ish ministrat Peçi dhe Rama qe ju derguam ne te njejten kohe rekomandimet perkatese per problematika kaq te rendesishme dhe delikate nuk kemi dijeni qe te kene reaguar per keto raste.

Perveç ankesave qe u paraqitën me siper, prane Institucionit tone, jane depozituar dhe ankesa te tjera me te njejtin objekt ankimi, duke vertetuar qe tashme kemi te bejme me nje fenomen dhe jo me ankesa te veçanta. Prandaj dhe i rekomanduam ministrit te Drejtesise qe Drejtori i Pergjithshem i Permbarimit , konform me ate qe parashikon paragrafi b i nenit 8 te ligjit “Per Sherbimin Permbarimor”, te marre masa per nxjerrjen e udhezimeve dhe metodikave per trajtimin ne pergjithesi te çeshtjeve ne ekzekutim, si dhe te marre masa per te udhezuar dhe unifikuar konforme akteve ligjore dhe nenligjore praktikat te cilat kane per objekt te tyre

zbatimin e vendimeve gjyqesore, pasojat e te cilave lidhen me interesat e femijeve.

Nje pjese jo e vogel e prinderve ne Shqiperi nuk paguajne pensionet ushqimore dhe kjo vjen vec te tjerash dhe nga mos impenjimi serioz i disa prej permbaruesve, por dhe nga papergjegjshmeria e prinderve, te cilet perballe apatise te strukturave shteterore bejne aleance te heshtur ne kurriz te bukes se femijve te tyre. Mendoj se ka vend per nje bashkepunim me te madh te struktures "Per te Miturit" qe ndodhet prane Ministrise se Drejtesise dhe te Drejtorise se Pergjithshme te Permbarimit, struktura te cilat jane te dyja ne varesine e Ministrise se Drejtesise.

3. Avokati i Popullit dhe marrëdhëniet e tij me gjykatat dhe pushtetin gjyqësor

Institucioni i Avokatit të Popullit është institucion i ri në shoqërinë shqiptare, por bashkë me gjykatat janë dy institucionet më të rëndësishme për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Në kushtet e sotme tek ne duhet të rritet efikasiteti dhe besimi i publikut tek gjyqësori. Duhet thënë se ndihma e institucionit të Avokatit të Popullit i cili është jashtë gjyqësorit, luan një rol të rëndësishëm për këtë çështje.

Nga literatura dhe shkëmbimi i legjislacionit dhe eksperiencave me kolegët nga vende të ndryshme, pushteti i Ombudsmanit në marrëdhëniet me organet gjyqësore është i ndryshëm nga një vend në tjetrin. Duhet theksuar kompetenca maksimale që ka Ombudsmani parlamentar Suedez, vendi ku ky institucion ka origjinën dhe është krijuar qysh në vitin 1809.

Po të shikohet Kushtetuta dhe ligji "Për Avokatin e Popullit" del se ato i kanë zgjidhur drejtë marrdhëniet tona. Juridiksioni i Avokatit të Popullit në lidhje me gjyqësorin është i tillë që as prek dhe as rrezikon pavarësinë e gjyqtarëve në dhënien e vendimeve gjyqësore.

Nga praktika jonë disa vjeçare del se ne kemi patur mirëkuptim me gjyqësorin për këto probleme dhe, edhe në të ardhmen marrdhëniet tona do vazhdojnë që të jenë korekte. Kjo sepse pothuaj të gjithë jemi të interesuar që të realizohen e respektohen me përpikmëri të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Vendi ynë, si vend ish komunist që po kalon një periudhë tranzicioni ka akoma mjaft të meta dhe mangësi në veprimtarinë e dhënies së drejtësisë nga gjykatat. Këto e kanë bazën e tyre dhe rrjedhin për shkaqe të tilla duke filluar nga pa aftësia e gjyqtarëve e deri tek korruptimi i tyre.

Avokati i Popullit me punën e tij ka dhënë ndihmesën e duhur në punën e gjykatave, duke njoftuar Ministrin e Drejtësisë apo Inspektoriatin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë për shkelje proceduriale të konstatuara nga gjyqtarë të veçantë si dhe shkelje të kryera nga administratat e gjykatave.

Përveç këtyre Avokati i Popullit ndihmon edhe në një drejtim tjetër duke kërkuar që administrata shtetore të zbatojë patjetër vendimet gjyqësore kur ato kanë marrë formë të prerë. Në këtë mënyrë ne ndihmojmë që të rritet autoriteti i pushtetit gjyqësor ndaj degës së ekzekutivit, e cila ka treguar dhe vazhdon të tregojë me qëndrimet e saj se nëvleftëson fuqinë e vendimeve gjyqësore duke i bërë në këtë mënyrë një dëm të madh (jo ekonomik) shtetit të së drejtës.

1. Ankesat për gjykatat

Në vitin 2000 për 6 muaj që kemi punuar kanë qënë 177 ankesa që zinin rreth 22% të të gjithë ankesave. Në vitin 2001 kanë ardhur 392 ankesa që zinin rreth 17% të të gjithë ankesave. Në vitin 2002 kemi patur 405 ankesa ndaj gjykatave që zinin 13 % të gjithë ankesave të shqyrtuara.

Kurse për vitin 2003 ndaj gjykatave kanë ardhur gjithsejt 306 ankesa që zenë 15.3% të ankesave të ardhura në vitin 2003. (Në këtë numër nuk përfshihet numri i ankesave të mbartura nga viti 2002).

Nga 306 ankesa 148 ankesa kanë qënë kundra vendimeve gjyqësore dhe si të tilla ato janë refuzuar sepse janë jashtë juridiksionit tonë.

Por 118 ankesa të tjera, duke i analizuar sipas objektit del se kanë qënë në këto drejtime dhe për këto probleme:

- Ankohen për zvarritje pa shkaqe ligjore të gjykimit të çështjeve të ndryshme penale e civile.
- Kanë kërkuar që të përfaqësohen nga Avokati i Popullit në gjykimet në Gjykatën e Lartë, meqenëse në dy shkallët e tjera të gjykimit kanë humbur gjyqet.
- Ankohen se nuk u jepet ndihma e nevojshme ligjore mbasi nuk kanë të ardhura për të marrë avokatë privatë.
- Ankohen se u kanë kaluar afatet e ankimit ndaj vendimeve gjyqësore të marra në mungesë dhe nuk u pranohen nga gjykata ankimet ndaj vendimeve dhe kërkojnë rivendosje në afat të ankimit.
- Ankohen ndaj vendimeve gjyqësore me të cilin vendoset pezullimi i punimeve ose pezullimi i ekzekutimit të vendimeve nga zyrat e përmbarimit në rrethe.
- Ankohen për qëndrime subjektive e të njëanshme të gjyqtarëve gjatë gjykimit të çështjes dhe kërkohet përjashtimi i tyre.

- Ankohen ndaj vendimeve të gjykatës së shtetit grek se janë dënuar me masa dënimi të rënda dhe pa përkthyes dhe kërkohet rishikim vendimi.
 - Ankohen ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe kërkohet ndihma ligjore për t'ju drejtuar Gjykatës Lartë me kërkesë për rishikim vendimi.
 - Ankohen ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë, se nuk janë respektuar të gjitha kërkesat për një proces të rregullt ligjor nga gjykatat dhe kërkohet ndihmë ligjore për dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese.
 - Ankohen ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe se kanë ezauruar të gjitha mjetet e ankimit në rrugë gjyqësore në shqipëri dhe kërkohet ndihma ligjore për t'ju drejtuar Gjykatës së Strazburgut.
 - Ankohen ndaj vendimeve gjyqësore për masë të rëndë dënimi dhe kërkohet nga Avokati i Popullit që në gjykatën e Apelit të zbatohet Amicus Curiae (miku i gjykatës).
 - Ankohen se ka zvarritje të gjata në dërgimin e dosjeve nga gjykatat e rretheve në Gjykatën e Apelit apo në Gjykatën e Lartë dhe anasjelltas.
 - Ka patur ankesa nga familjarët e viktimave se gjykatat dhe gjyqtarë të veçantë, ndaj autorëve që kanë kryer krimin e vrasjes kanë dhënë masa dënimi të buta.
 - Ankohen ndaj gjyqtarëve të veçantë të gjykatave të rretheve dhe apelit që ndaj tyre të fillohet procedimi disiplinor për shkelje të ndryshme në detyrë dhe korrupsion.
- Është pozitiv fakti se gjatë vitit 2003 për ankesat e ardhura ndaj gjykatave në 45 raste ato janë zgjidhur në favor të ankuesave.

a) Ankesat ndaj Gjykatave të rretheve gjyqësore.

Nga 306 ankesa të ardhura gjithsej për vitin 2003, ndaj Gjykatave të Shkallës së parë kanë ardhur 235 ankesa.

Kryesisht ankesat ndaj këtyre gjykatave kanë qënë për zvarritje pa shkaqe ligjore të gjykimit të çështjeve ; për qëndrime të padrejta dhe të njëanëshme të gjyqtarëve dhe është kërkuar ndërhyrja jonë për përjashtimin i tyre ; ndaj gjykimeve dhe vendimeve të bëra në mungesë të personit nga gjykata ; duke mos respektuar kërkesat për njoftimin e palëve ; për mos dhënie të kopjeve të vendimit gjyqësor të arsyetuara dhe të zbardhura ; për zvarritje në dërgimin e dosjeve për shqyrtim në Gjykatat e Apelit apo në Gjykatën e Lartë dhe anasjelltas etj.

Nga verifikimet e këtyre ankesave ka rezultuar se në përgjithësi shkaqet e dokumentuara në dosjet e zvarritura kanë qënë për mosparaqitjen

e palëve në gjykim, për mosparaqitje në datën dhe orën e caktuar të dëshmitarëve dhe ekspertëve për shkak të vështirësive që vrehen në drejtim të njoftimit të tyre si pasojë e lëvizjes së lirë dhe të shpeshtë të njerëzve, pasaktësitë e adresave.

Në shumicën e rasteve rezulton se në përgjithësi ankuesit nuk kanë patur të drejtë, pasi gjyqtarët e akuzuar për zvarritje kanë paraqitur shkaqet e shtyerjes seancave gjyqësore dhe kanë bërë “kujdes” që nga ana ligjore të mos vërtetohet shkelja e tyre.

Ja disa nga rastet e zgjidhura në favor gjatë këtij viti :

1.Shtetasi I.M. nga qyteti i Tiranë është ankuar ndaj Gjykatës së shkallës parë Kurbini për zvarritje pa shkaqe ligjore të gjyqimit penal ndaj bashkëshortes tij F.M.

Nga verifikimi rezultoi se nga KLD-ja për shkelje në detyrë është larguar nga detyra gjyqtari B.Q.Pas kësaj janë marrë masa për zëvendësimin e tij me gjyqtar nga rrethet e tjera dhe në këto rrethana, gjykimi detyrimisht kanë filluar nga fillimi.Në sajë të ndërhyrjes tonë u arrit të bëhej jo vetëm shpejtimi i gjyqimit, por edhe përfundimi i shpejt i tij.

2.Shtetasi A.T. nga qyteti i Laçit është ankuar ndaj Gjykatës shkallës së parë Krujë, për zvarritje pa shkaqe ligjore të gjyqimit të një çështje civile.Nga verifikimi ynë rezultoi se shkaqet e shtyerjes së seancave gjyqësore ishin të justifikuar.Por jo vetëm kaq sepse ankuesi ishte i painformuar se padia e ngritur nga ai ishte pranuar nga gjykata dhe çështja ishte zgjidhur në favor të tij.

3.Shtetasi A.K. nga qyteti i Vlorës ka paraqitur ankesë për zvarritjen e gjyqimit ndaj të pandehurit Gj.S. i cili akuzohej për vrasje me dashje të bashkëshortes E.K.Nga verifikimi ynë rezultoi se shkaqet e shtyerjes së seancave gjyqësore ishin për mosparaqitjen e dëshmitarëve, të ekspertit, të avokatit mbrojtës etj.Në saj të ndërhyrjes tonë u arrit shpejtimi i gjyqimit të kësaj çështje dhe përfundimi i saj.

4.Shtetasi L.M. nga rrethi i Tepelenës është ankuar ndaj Gjykatës rrethit Tepelenë për zvarritje gjyqimi të çështjes penale ndaj djalit tij A.M.Nga verifikimi i kësaj ankese rezultoi se shkak i zvarritjes së gjyqimit ka qënë mungesa e gjyqtarëve të cilët janë caktuar me vendim të KLD.Me caktimin e gjyqtarëve dhe formimin e trupit gjykues ka vazhduar gjykimi i kësaj çështje normalisht.

5.Shtetasi P.K. nga qyteti i Tiranës është ankuar ndaj Gjykatës së Shkallës së parë Tiranë për zvarritje të gjyqimit të çështjes penale ndaj V.S. e akuzuar për veprën penale të rrëmbimit të fëmijës.Nga verifikimi i bërë rezultoi se me vendimin Nr.38 dt.23.01.2003 të kësaj gjykate është

vendosur pushimi i gjykimit të çështjes mbasi në gjykim nuk janë paraqitur palët, ndonëse kanë patur dijeni për datën dhe orën e gjykimit të çështjes. Në bazë të ligjit ankuesi u sqarua për rrugën ligjore që ai ka për t'u ankuar ndaj vendimit gjyqësor brenda afatit ligjor, në shkallën e dytë.

6.Shtetasi N.Z. është ankuar se çështja e tij civile ka përfunduar së gjykuari nga Gjykata e Apelit Tiranë në mars 2002 dhe vendimi ka marrë formë të prerë. Ankuesi pretendon se pas një viti ai njoftohet se ndaj këtij vendimi ishte bërë rekurs nga pala tjetër në Gjykatën e Lartë Tiranë duke aluduar se këto veprime e qëndrime janë të padrejta dhe korruptive.

Nga verifikimi i bërë rezultoi se rekursi në fakt është bërë dhe dorëzuar në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda afatit 30 ditor, por ka patur zvarritje në komunikimin e tij pjesmarrësve të tjerë në gjykim.

Shtetasi B.M. nga qyteti i Fierit është ankuar ndaj Gjykatës së shkallës parë Fier se ajo ka dhënë masë të butë dënimi ndaj të pandehurit E.S. i cili është akuzuar për vrasjen e djalit tij në bashkëpunim me persona të tjerë.

Ankesa të tilla kanë bërë edhe shtetasit B.A. nga Leskoviku, Xh.B. dhe B.F. nga qyteti i Korçës, L.K. nga Saranda, L.Gj. nga Kurbini etj.

Nga ana e jonë duke qënë se familjarët e viktimave kanë qënë tepër të revoltuar dhe kanë shkruar për veprime korruptive të gjyqtarëve të veçantë të Gjykatave të rrethit dhe ato të Apelit, ankesat e tyre i janë dërguar organit kompetent si Ministrin të Drejtësisë apo Inspektoriatit të KLD së bashku me fotokopjen e ankesave.

Në disa raste ankesat kanë patur si objekt gjykimet e zhvilluara duke pretenduar për njëanshmëri dhe mungesë objektiviteti gjat gjykimit dhe është kërkuar ndihma dhe ndërhyrja e Avokatit të Popullit që t'i përfaqësojë ato në gjykimet e çështjeve para Gjykatës së Apelit.

Në disa raste ankuesit duke qënë të mërzitur e të lodhur nga tejzgjatja e proceseve gjyqësore në gjykata, nga njera shkallë tek tjetra, nuk binden me përgjigjen e dhënë nga ana e jonë, sidomos me arsyetimin se vendimet gjyqësore janë jashtë juridiksionit tonë.

Në shumë raste ankuesit këmbëngulin se institucioni ynë duhet që të bëjë patjetër vlerësimin e vendimeve gjyqësore pasi ato janë të padrejta dhe janë dhënë nga gjyqtarë të korruptuar.

Në shumë raste ankuesit paraqesin pranë nesh dokumenta dhe prova të ndryshme shpresore me anë të cilave kërkojnë të na bindin se kanë plotësisht të drejtë, por kjo e drejtë nuk u jepet sepse nga gjykatat ato nuk merren në konsideratë.

Këto ankesa tregojnë se në mjaft raste ankuesit kanë humbur besimin tek gjyqtarët dhe gjykatat duke i akuzuar ato direkt si njerëz dhe organe të korruptuara.

Në lidhje me problemet e zvarritjeve të gjykimit për çështjet penale, siç e kemi theksuar edhe në raportet e mëvonëshme del nevoja e rishqyrtimit të dispozitave të Kodit Procedurës Penale me synim të shkurtimit të afateve të hetimit dhe të gjykimit. Kjo për arsye se me afatet ekzistuese lihet shteg për abuzim nga punonjës të veçantë, si në organet e procedimit penal ashtu edhe ato të gjykimit. Ka vend për t'u studjuar si problem, duke u caktuar afate të tjera të arsyeshme, sepse në vetvete zgjatja e tyre cënon në mënyrë të drejtëpërdrejtë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Ndryshe qëndron problemi me gjykimin e çështjeve civile. Duke ju referuar dispozitave të Kodit Procedurës Civile të cilat nuk parashikojnë afate gjykimi në shkallët e gjykimit dhe duke studjuar numërin e ankesave dhe shkaqet e zgjatjes së këtyre gjykimeve kemi mendimin se të bëhen hapa konkrete me parlamentin shqiptar për të bërë propozime konkrete, për të caktuar afate gjykimi për disa lloje gjykimesh civile.

Një shkak tjetër që ka ndikuar në zvarritjen e gjykimeve në shkallë të parë si për çështjet penale dhe civile është se në disa raste ato shqyrtohen nga një trup gjykues i përbërë nga 3 gjyqtar. Ndodh shpesh që në disa gjykata janë konsumuar gjyqtarët dhe mbi këtë bazë bëhet komandimi i gjyqtarëve nga rrethet e tjera me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Kjo shkakton vonesa tej afatit që mund të quhet "i arsyeshëm". Prandaj duhet që të ketë sa më tepër çështje që të gjykohen nga një gjyqtar i vetëm.

b) Ankesat ndaj Gjykatave të Apelit.

Gjatë vitit 2003 ndaj Gjykatave të Apelit kanë ardhur 41 ankesa. Numrin më të madh të këtyre ankesave 31 e zenë ato për kundërshtim të vendimeve gjyqësore për të cilat ne kemi vendosur refuzimin e tyre, pasi ato kanë qënë jashtë juridiksionit tonë.

Në 10 raste ankesat kanë qënë për shkelje të ndryshme procedure apo se nuk u jepet kopja e vendimit gjyqësor pas përfundimit të gjykimit; se janë shkelur të drejtat e tyre gjatë gjykimit; për zvarritje të padrejta të gjykimeve; se ka vonesa të pajustificuara në dërgimin e dosjeve nga Gjykatat e shkallës parë në Gjykatën e Apelit dhe anasjelltas etj.

P.sh. Shtetasi A. T. nga qyteti i Tiranës është ankuar se nuk i jepet kopje e vendimit gjyqësor të Gjykatës Apelit Tiranë si dhe një fotokopje e

proçes verbalit të seancës gjyqësore të gjykimit të një çështje civile nga kjo gjykatë. Nga verifikimi i kësaj ankese rezultoi se shkak i mos dhënies së këtyre dokumentave ishte se dosja gjyqësore ishte dërguar në Gjykatën e shkallës së parë Tiranë. U ndërhy pranë kësaj gjykate dhe ankuesit ju dhanë në praninë tonë të gjitha dokumentat e kërkuara prej tij.

c) Ankesat ndaj Gjykatës së Lartë.

Dihet se Gjykata e Lartë nuk ka lidhje vartësie nga Ministria e Drejtësisë, por ne e kemi radhitur në këtë kre për shkak se problemet që ngrenë shtetasit për këtë gjykatë janë pothuaj të njëjlojta me ato që ngrenë edhe për gjykatat më të ulta.

Në vitin 2003 kundër Gjykatës së Lartë kanë ardhur 30 ankesa, nga 44 ankesa që kanë ardhur në vitin 2002.

Në 13 raste ankesat janë bërë kundra vendimeve gjyqësore, duke pretenduar se në shqyrtimin e çështjeve nuk janë raspektuar procedurat gjyqësore.

Në rastet e tjera ankesat kanë qënë për zvarritje të gjata të gjykimit të çështjeve; për përjashtim gjyqtari se ka marrë pjesë në gjykimet e mëparëshme; kanë kërkuar që çështjen e tyre ta përfaqësojë në gjykim Avokati i Popullit; të shqyrtohet kërkesa e tyre me objekt rishikim vendimi gjyqësor; janë kërkuar kopjet e vendimit pas përfundimit të gjykimit; që të shikohet mundësia e ndërhyrjes tonë që të pranohet rekursi i tyre etj.

1. Shtetasja L.M. nga qyteti i Tiranës është ankuar se ndonëse ka përfunduar gjykimi i çështjes saj në Gjykatën e Lartë, pa asnjë shkak nuk i jepet kopja e vendimit. Nga verifikimi i bërë rezultoi se vendimi nuk ishte firmosur nga personat e mbetur në pakicë, pasi nuk ishte përfunduar arsyetimi i mendimit kundra. Me ndërhyrjen tonë u bë e mundur të shpejtoheshin këto veprime dhe ankueses ju dha kopja e vendimi.

2. Shtetasi P. B. nga qyteti i Tiranës është ankuar pranë këtij institucioni duke kërkuar përjashtimin e gjyqtarëve të Gjykatës Lartë, antarë të kolegjit civil sepse kanë marrë pjesë në gjykimin e çështjes civile me vendimin nr.1806 dt.31.03.2003 të kësaj gjykate.

Nga verifikimi i bërë rezultoi se kërkesa e tij ishte e drejtë dhe u ndryshua përbërja e trupit gjykues.

Për ankesat që janë bërë kundra vendimeve të Gjykatës së Lartë nga ana e jonë janë bërë sqarimet e nevojshme se këto ankesa janë jashtë juridiksionit tonë dhe kur ankuesit kanë pretendime në lidhje me një proçes jo të rregullt ligjor, në bazë të neneve 42/2 dhe 134 germa “g” të

Kushtetutës ata janë orjentuar t'i drejtohen me kërkesë për gjykim, Gjykatës Kushtetuese.

Po edhe persona të ndryshëm që kanë patur pretendime se çështja e tyre nuk është gjykuar drejtë dhe se atyre u janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore si nga organet e administratës publike shqiptare, ashtu edhe nga gjykatat, ata janë dëgjuar me kujdes dhe janë orjentuar se në bazë të nenit 6/1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës së Strazburgut, duke mbajtur gjithmonë parasysh se kjo kërkesë bëhet brenda një afati 6 mujor dhe pasi nga ankuesit të jenë konsumuar të gjitha mjetet e ankimit sipas legjislacionit shqiptar.

2. Amicus Curiae (Miku i Gjykatës).

Ky është një rol që nuk njihet akoma mirë në legjislacionin tonë.

Amicus curiae, fjalë për fjalë do të thotë, Miku i Gjykatës. Është një person që ka interes apo pikpamje të forta mbi çështjen në gjykim, por nuk është palë në gjykim. Ai mund t'i kërkojë leje gjykatës që të paraqesë një këshillë, në dukje në emër të një pale, por në fakt për të sugjeruar një arsye themelore në përputhje me pikpamjet e tij. Këto këshilla të Mikut të Gjykatës zakonisht paraqiten në Apel lidhur me çështje me interes shumë të gjërë publik, p.sh. çështjet e të drejtave civile, të grave, të fëmijëve etj.

Në Gjykatat Amerikane të Apelit, këto dosje mund të paraqiten vetëm nëse janë të shoqëruara, me një miratim me shkrim të të gjitha palëve, ose me leje të gjykatës.

Ne në Shqipëri, gjatë punës tonë në shqyrtimin e ankesave, për çështje që janë në gjykim shpesh herë konstatojmë se ka vend për ta luajtur këtë rol dhe në një rast edhe e kemi luajtur. Kështu shtetasi J. S. është ankuar ndaj vendimit të gjykatës me të cilin ishte vendosur dënimi i nipit tij E.S. me 4 vjet burgim për vjedhje të bërë ndaj xhaxhait të tij.

Mbasi është bërë ankim në Gjykatën e Apelit në Durrës ka kërkuar edhe ndihmën e Avokatit të Popullit duke parashtruar se vjedhësi është nipi i tij, se ka kthyer shumën e lekëve të vjedhura, se është në moshë të re, i pa dënuar më parë dhe mjaftë i sëmurë etj.

Kjo ankesë u studjua me kujdes dhe u vendos të ndërhyhej me Amicus Curiae në Gjykatën e Apelit Durrës, në të cilën u parashtrua se : “Ne e kemi të qartë dhe besojmë se në Gjykatën e Apelit çështja do shqyrtohet me objektivitet dhe drejtësi. Por në kuadrin e Amicus Curiae (Miku i Gjykatës) mendojmë të lozim këtë rol, pa na keqkuptuar apo keqinterpretuar si ndërhyrje në vendimin e trupit gjykues. Në rastin konkret ka vend të rishikohet lloji dhe masa e dënimit ndaj fajtorit.

Mendojmë se duhet patur më shumë parasysh mosha e re e të gjykuarit E.S., pendimi i tij i thellë për veprën e kryer qysh në fillim të

hetimit, ashtu edhe gjatë gjykimit; se ai nuk ka qënë i dënuar më parë; se shumica e dëmit i është kthyer të dëmtuarit, pra është bërë zëvendësimi i dëmit; marrdhëniet gjinore shumë të afërta me ankuesin, xhaxhai i tij.

Ne kemi mendimin që në rastin konkret të arsyetohet se çfarë do të arrihet më tej në kuadrin e riedukimit të dënuarit, në qoftë se ai do mbahet në burg për 4 vjet, në një kohë që dënimi i tij mund të jetë edhe me kusht. Mbase duken mbajtur parasysh edhe mbingarkesa e burgjeve tona, shpenzimet që bëhen për të mbajtur një person në burg rëndojnë mbi buxhetin e shtetit, i cili mbushet me taksat që paguajmë me pagat tona. Mbase interesi më i madh i shoqërisë është lënia e tij i lirë, duke zbatuar kërkesat e nenit 59 të K.P. që thotë se *“për shkak të rrezikshmërisë shoqërore të pakët të personit dhe rrethanave të kryerjes së veprës penale gjykata kur jep dënim me burgim gjer në 5 vjet mund të urdhërojë që i dënuari të vihet në provë, duke u pezulluar vendimi i dënimit me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale po aq të rëndë”*.

Gjykata e Apelit Durrës me vendimin Nr.163 dt.14.05.2003 vendosi përfundimisht ndryshimin e vendimit të gjykatës së faktit dhe dënimit e E.S. me 2 vjet burgim me kusht për 4 vjet kohë.

4. Ankesa për Prokurorinë

A. Sipas Kushtetutës sonë edhe Prokuroria nuk bën pjesë në juridiksionin e Ministrisë së Drejtësisë, por për lehtësi studimi e kemi përfshirë pas saj.

Për vitin 2003 në Institucionin tonë 250 shtetas të ndryshëm kanë paraqitur 142 ankesa apo kërkesa, të cilat kanë patur për objekt veprimtarinë e punës së organit të Prokurorisë. Duke parë numurin e ankesave të ardhura në Institucionin e Avokatit të Popullit, prej fillimit të veprimtarisë së tij konstatohet se, në vitin 2000 kanë qënë 31, për vitin 2001 kanë qënë 100 ankesa, ndërsa për vitin 2002 kanë qënë 196 ankesa.

Nga 142 ankesat për vitin 2003 janë përfunduar 138. Mënyra e përfundimit të ankesave kanë qënë: 46 ankesa janë zgjidhur në favor ose 32.4 përqind, 58 ankesa kanë qënë jashtë kompetence, 34 ankesa të pabazuara, kurse 4 ankesa aktualisht janë në shqyrtim. Gjatë vitit 2003 janë shqyrtuar dhe përfunduar edhe 21 ankesa të mbartura nga viti 2002. Konkretisht 8 ankesa janë zgjidhur në favor, 10 ankesa kanë qënë jashtë kompetence dhe 3 ankesa të pabazuara.

Edhe për vitin 2003 ankesat e shtetasve ndaj veprimtarisë së organit të Prokurorisë janë shqyrtuar me përparësi. Për ankesat që kanë qënë

brënda kompetencës sonë, Avokati i Popullit ka bërë vlerësimet e rastit dhe ka urdhëruar kryerjen e procesit të hetimit nëpërmjet realizimit të veprimeve të nevojshme si, marrja e deklarimeve të shtetasve të ndryshëm, kqyrjes së dokumentave, kryerjes së ekspertimeve mjeko-ligjore me specialistë të fushave përkatëse, apo duke studjuar dosje hetimore për të cilat Prokuroria kishte vendosur pushimin apo pezullimin e çështjes penale.

Për mjaft ankesa është shkuar në vëndbanimin e ankuesit ose kërkuesit, apo janë kryer veprimet në vënd, duke marrë dhe shpjegimet e nevojshme në organin e Prokurorisë, ndaj të cilit shtetasi ka bërë ankimin.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka ndjekur me preçedencë dhe ankesat e shtetasve apo shoqatave që përfaqësojnë interesa të një grupi të caktuar personash.

Për ankesën e komunitetit të përbërë prej 100 familje në Ishull Lezhë, Avokati i Popullit rekomandoi fillimin e hetimit në ngarkim të shtetasit B.Gj. për veprat penale “të shkatërrimit të pronës me përmytje”, “shkatërrim të rrjetit ujitës” dhe “pushtim toke”, parashikuar nga nenet 153/2, 157 dhe 200 të Kodit Penal. Prokuroria e rrethit Lezhë pas rekomandimit tonë ka filluar proçedimin penal.

Gjatë shqyrtimit të ankesave për vitin 2003, vihet re se objekti i tyre është i njëllajtë me objektin e ankesave të paraqitura edhe gjatë vitit 2002. Në mënyrë të grupuar shtetasit ankohen ndaj Prokurorisë :

1. Për zvarritje në hetimin e çështjeve penale.

Raste të tilla mund të përmenden ankesat e shtetasve M.M. nga Tirana, S.GJ. nga Kavaja, S.C. nga Shkodra, Ç.GJ. nga Elbasani etj.

Rast flagrant është hetimi i proçedimit penal nr.314, nga Prokuroria e rrethit Vlorë, që bën fjalë për mbytjen në kanal in e Otrantos më datën 4 maj 2000 të 17 shtetasve shqiptare kryesisht nga Shkodra. Bazë për fillimin e kësaj çështje ka qënë rekomandimi i Avokatit të Popullit qysh në vitin 2002, sepse megjithë ankesat e vazhdueshme të familjarëve drejtuar gjithë autoriteteve më të larta të shtetit, përfshirë ish Prokurorin e Pergjithshëm z. Arben Rakipi, nuk ishte filluar çështje penale, megjithëse krimi ishte flagrant dhe i dukshëm. Pas fillimit të hetimit nga Prokuroria e rrethit Shkoder, çështja i ka kaluar për hetime të mëtejshme Prokurorisë Vlore, e cila në mënyrë të pajustificuar ka zvaritur hetimin mbi 6 muaj pa kryer veprimet e domosdoshme me qellim vënien para përgjegjësisë penale te autorëve te trafikut te klandestinëve dhe organizatorëve të tyre.

2. Për moskryerje të hetimeve të gjithanshme dhe objektive.

Të tilla janë, ankesat e shtetasve S.H. nga Dibra, D.H. nga Berati, M.A. nga Puka, SH.H. nga Kashari i rrethit të Tiranës etj.

Vlen të përmendet rasti i hetimit të çështjes penale në ngarkim të punonjësit të policisë në Durrës Flamur Gjuzi, nga Prokuroria e atij rrethi. Ankuesi F.B. i dëmtuar nga vepra penale, duke çmuar se pushimi i çështjes penale ishte i padrejtë, ka bërë ankim në Gjykatën e rrethit Durrës. Kjo gjykatë në dy raste ka pranuar ankimin dhe ka vendosur prishjen e vendimit të pushimit. Edhe pas këtyre vendimeve përsëri Prokuroria vendos pushimin e çështjes, veprim i cili detyroi Prokurorin e Përgjithshëm të urdhërojë shfuqizimin e vendimit, me qëllim kryerjen e hetimeve objektive.

3. *Për mosvënie në lëvizje, apo mosvlerësim të kallëzimit të shtetasve*, si p.sh ankesat e shtetasve XH. S. nga Lezha. Shtetasit E.A. nga Vlora etj.

4. *Për mosnjoftim apo njoftim me vonesë për mënyrën e zgjidhjes së kallëzimit apo përfundimit të çështjes penale*, si p.sh ankesa e shtetasit A.B. nga Lushnja etj.

5. *Për bllokime apo sekuestrime të sendeve prove materiale sidomos per automjetet dhe kthimin e tyre me vonesë*, si p.sh ankesa e shtetasit J.M. nga Tirana, Ç.GJ. nga Elbasani.

Gjatë shqyrtimit të disa ankesave është konstatuar se organi i Prokurorisë ka vepruar në mënyrë të nxituar dhe të pabazuar në përfundim të hetimit, duke konkluduar padrejtësisht si mënyrë zgjidhje të çështjes pushimin ose pezullimin e hetimeve. Pas studimit nga ana e jonë është vënë re se pushimi i çështjes nuk ka qënë rezultat i hetimit të gjithanshëm dhe objektiv, e për rrjedhojë i është rekomanduar Prokurorit të Përgjithshëm ose Kryeprokurorëve në rrethe shfuqizimi i vendimit. Raste të tilla flagrante për vitin 2003 mund të përmëndim çështjen penale Nr. 106 të vitit 2002 hetuar nga Prokuroria e rrethit Pogradec, për veprën penale të “shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor” me pasojë vdekjen e shtetasit Perlat Voshtina nga Tirana. Bashkëshortja e viktimës u ankua se padrejtësisht çështja penale e filluar për vdekjen e bashkëshortit të saj gjatë një aksidenti automobilistik ishte pushuar, me arsyetimin se në timon si shofer kishte qënë viktimja. Hetimet tona vërtetuan pretendimet e ankueses se shoferi i mjetit që u aksidentua kishte qënë tjetër person dhe se për faj të tij kishte ndodhur aksidenti. Pas rifillimit të hetimeve, mbi bazën e rekomandimit tonë, çështja ndodhet në gjykatën e rrethit Pogradec, ku si i pandehur ndodhet personi që ishte drejtues mjeti.

B. Nga shqyrtimi i ankesave të ndryshme që janë konsideruar të drejta për shkeljet e konstatuara, Avokati i Popullit i ka paraqitur Prokurorit të Përgjithshëm, apo Kryeprokurorëve në rrethe 15 rekomandime, nga të cilat 11 janë pranuar, 3 rekomandime janë refuzuar dhe për 1 rekomandim është hequr dorë nga ana jonë.

Pra, konstatohet se rekomandimet e Avokatit të Popullit, përgjithësisht janë pranuar. Në mënyrë të grupuar rekomandimet tona drejtuar organit të Prokurorisë, paraqiten si më poshtë:

I. Rekomandime per fillimin e hetimit .

1. Rekomandim drejtuar Prokurorit të rrethit Durrës, “për fillimin e hetimit ndaj punonjesve të policisë R.Xh. etj për veprën penale të kryerjes së veprimeve arbitrare në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 250 e 25 të Kodit Penal. Pas fillimit të hetimit çështja është dërguar në gjykatë dhe aktualisht ndodhet në fazën e shqyrtimit gjyqësor.

2. Rekomandim drejtuar Prokurorit të rrethit Tiranë “per fillimin e hetimit ndaj oficerit te policisë E.H. në Komisariatit e Policsë Nr. 2 Tiranë, për veprën penale të kryerjes së veprimeve arbitrare”, parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal. Pas fillimit te hetimit, çështja është dërguar në gjykatë dhe aktualisht ndodhet në fazën e shqyrtimit gjyqësor.

3. Rekomandim drejtuar Prokurorit të rrethit Tiranë, “për fillimin e hetimit ndaj punonjësve të policisë A.D. dhe A.Ç. për veprën penale të kryerjes së veprimeve arbitrare”, parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal. Çështja ndodhet në fazën e hetimit paraprak.

4. Rekomandimi drejtuar Prokurorit të rrethit Tiranë “për fillimin e hetimit ndaj oficeres së policisë I.B. për veprën penale të shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Prokuroria ka vendosur mosfillimin e proçedimit penal.

5. Rekomandimi drejtuar Prokurorit të rrethit Lezhë, “për fillimin e hetimit në ngarkim të shtetasit B.GJ. për veprat penale të shkatërrimit të pronës me përmbytje, shkatërrimin e rjetit ujitës dhe pushtim toke”, parashikuar përkatësisht nga nenet 153/2, 157 dhe 200 të Kodit Penal. Janë filluar hetimet.

6. Rekomandimi drejtuar Prokurorit të rrethit Vlorë “për fillimin e hetimit për zhdukjen e shtetasit S.A. për veprën penale të vrasjes me dashje”, parashikuar nga neni 76 të Kodit Penal. Prokuroria ka filluar çështjen penale duke kryer veprimet e nevojshme hetimore.

7. Rekomandimi drejtuar Prokurorit të rrethit Tepelenë “për fillimin e hetimit ndaj punonjesve të burgut Tepelenë, për veprën penale të shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Prokuroria ka filluar hetimet dhe ne përfundim e ka pushuar atë.

II. Rekomandime për shfuqizimin e vendimit te pushimit të çështjes penale.

1. Rekomandimi drejtuar Prokurorit të rrethit Pogradec “për shfuqizimin e vendimit të pushimit të proçedimit penal Nr.106 të vitit 2002, që bën fjalë për veprën penale të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal.

2. Rekomandimi drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm “për shfuqizimin e vendimit të mosfillimit të proçedimit penal Nr.60 të vitit 2003 të Prokurorisë së rrethit Korçë”, i cili bën fjalë për veprën penale “te shkeljes se rregullave të qarkullimit rrugor”, me pasojë vdekjen e shtetasit F.A, parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal. Rekomandimi është pranuar dhe Prokurori i Përgjithshëm me vendimin Nr. 171, datë 20.08.2003 ka vendosur shfuqizimin e vendimit të mosfillimit të proçedimit penal dhe rifillimin e hetimit.

3. Rekomandimi drejtuar Prokurorit te rrethit Tiranë, për shfuqizimin e vendimit të mosfillimit të proçedimit penal ne ngarkim të Sh.K. ish kryetar i bashkisë Vorë, për moskezekutimin e vendimit te gjykates per rikthimin në punë të shtetasës V. H. Rekomandimi është pranuar dhe për rrjedhojë është shfuqizuar vendimi i mosfillimit të proçedimit penal, dhe mandej ankuesja ka filluar punën duke shkuar ne vendin e mëparshëm.

Siç shihet janë jo të pakta rastet kur, shtetas të ndryshëm ankohen për “mbyllje” të çështjeve për veprën penale te “shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor me pasoja të rënda”. Nga studimi dhe analiza e bërë rasteve të ankesave të paraqitura në Institucionin tonë, arrijmë në përfundimin se nga ana e Prokurorisë jo gjithmonë bëhet vlerësimi i duhur i këtyre çështjeve, të cilat fillojnë mbi bazën e ngjarjes, dhe kërkojnë kryerje të shpejta te veprimeve të para hetimore dhe të papërsëritshme, njohuri profesionale ne fushën autoteknike dhe objektivitet. Njëanshmëria, dhënia e konkluzioneve te pasakta dhe te padrejta në aktet e ekspertimit mjekoligjor ose autoteknik, moskryerja e veprimeve të gjithanëshme, janë pasoja te vendimeve te pabazuara te ndërmara nga policia gjyqësore e të miratuara nga Prokuroria. Nga ana tjetër, ato sjellin zvarritje në hetimin e çështjeve penale dhe pasoja të tjera që lidhen me probleme sociale, deri ne acarimin e marrëdhënieve ndërmjet autoreve te veprës me familjarët e te dëmtuarëve apo viktimave te shkaktuara nga vepra penale.

III. Rekomandime per kryerje të ekspertimit neuropsihiatrik

1. Rekomandimi dërguar Prokurorit të rrethit Bulqizë, për shpejtim te kryerjes së ekspertimit psihiatrik te pandehurit S.M. Rekomandimi është pranuar.

IV. Rekomandime për marjen e masave disiplinore ndaj prokurorëve.

1.Rekomandimi drejtuar Prokurorit të rrethit Elbasan “Për marrje masash disiplinore ndaj prokurorëve që nuk kanë zbatuar vendimin e gjykatës për lirim të menjëhershëm nga burgu të të pandehurit H.P”. Nuk është marrë masë disiplinore.

2.Rekomandimi drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm “Për marrje masa disiplinore ndaj zv/prokurorit të rrethit Tiranë H.L”. Është hequr dorë.

3.Rekomandimi drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm për marrje masa disiplinore ndaj prokurorit të çështjes të pandehurit Sh.U. Krujë për kryerje të hetimeve të njëanshme. Rekomandimi nuk është pranuar.

4. Rekomandimi drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm për marrjen e masës disiplinore ndaj prokurorëve I.M. dhe L.H. për moszekutim të vendimit të Gjykatës së Lartë, për ndryshimin e masës së sigurimit personal të pandehurit L.P. nga arrest në burg pa afat në detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore. Prokuroria e rrethit Fier nuk e ka zbatuar këtë vendim për 11 ditë dhe ka qënë ndërhyrja e Institucionit tonë, që mundësoi lirim të personit nga dhomat e paraburgimit të Komisarariatit të Policisë Fier. Mbi rekomandimin tonë Prokurori i Përgjithshëm mori masë disiplinore ndaj prokurorëve që kishin kryer shkeljen, largimin e tyre nga detyra.

C. Gjatë shqyrtimit të çështjeve që kemi paraqitur për keqtrajtime apo veprime arbitrare të organeve të policisë ndaj qytetarëve në dy raste organi i Prokurorisë ka vendosur pushimin e çështjeve në rastet e kryerjes së veprave penale të dukshme nga punonjës policie. Kështu është rasti i përmendur më sipër i oficerit të policisë Flamur Gjuzi në Durrës si dhe rasti i ushtrimit të dhunës nga punonjësit e policisë së burgut të Tepelenës, ndaj të denuarit E.M. Prokuroria e atij rrethi, ndonëse filloi hetimin mbi rekomandimin tonë, pa kryer hetime të gjithanshme dhe objektive përsëri e pushoi çështjen. Vihet re se në krahasim me vitin e kaluar këto raste “ortakllëku” janë të pakta.

Pas raportit tepër kritik të vitit të kaluar në lidhje me marrëdhëniet me organet e Prokurorisë kemi konstatuar se, marrëdhëniet e Prokurorisë me Institucionin e Avokatit të Popullit kanë patur përmirësime.

Avokati i Popullit problemet kryesore i ka biseduar e zgjidhur me Prokurorin e Përgjithshëm, zotin Sollaku. Prokurorët e rretheve kanë vlerësuar më me korrektësi rekomandimet tona, por ka patur edhe raste që ngurojnë të dërgojnë apo japin për studim dosjet penale për të cilat janë pushuar hetimet prej tyre, por për të cilat ka patur ankesa nga shtetasit.

Veprimtaria e punës së Avokatit të Popullit, në shqyrtimin e ankesave të shtetasve ndaj organit të Prokurorisë ka konsistuar në zbatimin korrekt dhe objektiv të Kushtetutës, ligjit që normon punën tonë dhe ligjit

procedural penal. Qëndrimi ynë është se, duke konstatuar shkeljet reale të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve që janë subjekte në procesin penal, si dhe duke bashkëpunuar me prokurorinë ato duhet t'i shërbejnë qëllimit të mirë për përmirësimin e punës së prokurorisë dhe ngritjen e saj në nivelet bashkëkohore.

5. Ministria e Rendit Publik

Pranimi dhe shqyrtimi me përparësi dhe me rigozitet i ankesave dhe kërkesave ndaj organeve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Policisë së Shtetit ka qënë dhe do të vazhdojë të mbetet një nga detyrat tona kryesore. Kjo jo vetëm për faktin se ky organ i administratës publike përbën strukturën që përfaqëson fuqinë shtrënguese të shtetit, por edhe për vetë specifikën e Policisë Shqiptare, e cila krahas arritjeve pozitive, vazhdon të ketë në radhët e saj elemente të pakulturuar, të papërgatitur profesionalisht, të pa trajnuar me konceptet e shtetit ligjor dhe respektimit të të drejtave të Njeriut, të korruptuar etj.

Në institucionin tonë për sektorin e policisë gjatë vitit 2003 kanë ardhur gjithsej 240 ankesa, kërkesa apo njoftime. (Në këtë numër nuk përfshihet numri i ankesave të mbartura për vitin 2002). Nga këto 93 prej tyre janë bërë nga banorë të Tiranës, ndërsa 147 nga banorë të rretheve të ndryshme të vendit, 30 ankesa janë bërë nga femrat dhe 210 nga meshkuj. Kanë përfunduar 221 ankesa si vijon: 56 ose rreth 25 % janë zgjidhur në favor, 64 kanë qënë jashtë juridiksionit, kurse 101 kanë qënë të padrejta. Janë mbartur për shqyrtim në vitin 2004, 63 ankesa. Numri i ankesave në vitin 2003 do të kishte qënë edhe më i madh në qoftëse do të prananim ankesat për gradat.

Gjatë këtij viti për rastet të cilat i kemi vërtetuar shkeljet e ligjit janë bërë 11 rekomandime për dhënien e masave disiplinore, nga të cilat janë pranuar 10, ndërsa 1 është në shqyrtim. Në bazë të rekomandimeve tona janë dhënë 18 masa disiplinore ndaj punonjësvë të policisë që kanë bërë shkelje të ligjeve, midis të cilëve kanë qënë edhe 11 oficerë. Nga masat e dhëna mund të përmëndim, 3 përjashtime nga Policia e Shtetit, 3 pezullime nga detyra, midis tyre edhe 1 oficer dhe 12 masa të tjera disiplinore.

Ndërsa për vitin 2002 janë bërë 10 rekomandime për dhënien e masave disiplinore dhe në bazë të tyre janë ndëshkuar 12 punonjës policie.

Ankesat e trajtuara ndahen sipas problemeve të mëposhtme:

I. Ankesat për keqtrajtim të shtetasve:

Këto ankesa janë vlerësuar më tepër sepse kur ato kanë rezultuar të vërteta, kanë qënë shkelje të rënda të nenit 25 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë që parashikon se: *“Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës”*. Njëkohësisht ato janë edhe dhunime të rënda të nenit 3 të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut. Gjithashtu, është një shqetësim i madh fakti se këtë vit, ndonëse ato kanë qënë më të pakta në krahasim me vitin e kaluar, është rregjistruar një rast shumë i rëndë që solli si pasojë vdekjen e shtetasit G.Tahirllari për shkak të dhunës së ushtruar ndaj tij nga disa punonjës të papërgjegjshëm të policisë së Korçës.

Në institucionin tonë janë bërë 56 ankesa për keqtrajtime të shtetasve nga Policia e Shtetit. Nga këto janë përfunduar 50 dhe mënyra e zgjidhjes së tyre është: 9 janë vlerësuar të drejta, 19 kanë qënë jashtë juridiksionit, 22 të pa bazuara dhe 6 ankesa janë në shqyrtim.

Për rastet kur kemi vërtetuar pretendimet e ankuesve për keqtrajtime nga punonjësit e Policisë kemi bërë rekomandime organeve përkatëse. Gjatë këtij viti, vetëm për rastet e keqtrajtimit, i janë bërë 2 rekomandime organit të Prokurorisë për fillimin e ndjekjes penale, të cilat janë pranuar. Si raste të vërtetimit të ankesave për keqtrajtime të shtetasve mund të përmendim:

1. Njoftimi publik bërë nga disa media elektronike dhe e shkruar në datat 04 dhe 05.01.2003, për vdekjen e shtetasit G.Tahirllari për shkak të dhunës së përdorur ndaj tij nga disa punonjës të policisë së Korçës. Në bazë të nenit 13 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, institucioni ynë e filloi me nismën e vet këtë çështje, duke marrë pëlqimin e familjarëve të të ndjerit. Sipas prononcimeve në media të drejtuesve të Policisë, të Prokurorisë dhe të spitalit Korçë, shtetasi G.Tahirllari kishte vdekur nga përdorimi mbi masë e pijeve alkolike dhe jo nga përdorimi i dhunës. Nga hetimet e bëra nga ana jonë rezultoi se ndaj viktimës ishte përdorur dhunë nga punonjësit e policisë. Për të arritur një kokluzion të saktë dhe objektiv për shkakun e vdekjes së të ndjerit, Avokati i Popullit, në bazë të nenit 19, gërma “ç” të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, mori vendim për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor, ç’varrimin dhe ekzumimin e kufomës së viktimës G.Tahirllari, nga një grup

ekspertësh të Shërbimit Qëndror të Ekspertimit Mjeko-Ligjor Tiranë. Mbi bazën e vendimit tonë dhe të kërkesës së Prokurorisë së rrethit Korçë, në datën 10.01.2003 u bë ç'varrimi dhe ekzumimi i kufomës nga një grup prej 4 ekspertësh. Në përfundim të ekspertimit grupi i ekspertëve mjeko-ligjorë arriti në konkluzionin se: *“Shkaku determinant i vdekjes së shtetasit G.Tahirllari ishte kontuzioni i trurit, si pasojë e goditjes me mjet të fortë (grusht, shkelm, etj) në fytyrë”*.

Menjëherë pas konkluzionit të grupit të ekspertëve, organi i prokurorisë vendosi arrestimin e 6 punonjësve të policisë, Lorenc Balliu, me detyrë oficer i policisë gjyqësore, Dashnor Ganolli, me detyrë inspektor i policisë së zonës, Albert Myftari, Sokol Gurishta, Robert Qyli dhe Ramazan Ymeraj, me detyrë polic të grupit të gatshëm, të cilët u akuzuan respektivisht për veprat penale të vrasjes, kryerjes së veprimeve arbitrare dhe atë të moskallzimit të krimit. Mbas përfundimit të hetimeve çështja u dërgua në gjykatë dhe me vendim të formës së prerë të akuzuarit u dënuan penalisht, respektivisht me 16 vjet, 3 vjet, 5 muaj dhe tre të fundit me nga 4 muaj burg.

Për këtë ngjarje shumë të rëndë edhe nga M.R.Publik u morën masa disiplinore ndaj drejtuesve të Policisë Korçë, duke bërë shkarkimin nga detyra të Drejtorit të Policisë së Qarkut Arben Dashi dhe Shefit të Komisarariatit Fatmir Shehu, për shkak të qëndrimit jo korrekt të tyre lidhur me ngjarjen e ndodhur.

Nisur nga ky rast, ne i rekomanduam Shërbimit Qëndror të Ekspertimit Mjeko-Ligjor që të nxirte një udhëzim, ku të përcaktohej se për rastet kur ka viktimë në rrethe dhe për vdekjen akuzohen punonjës të policisë apo nëpunës së shtetit, të njoftohet menjëherë Shërbimi Qëndror i Ekspertimit Mjeko-Ligjor dhe kryeja e ekspertimit në këto raste të bëhet gjithmonë në prezencë edhe të një mjeku të dërguar nga qendra. Rekomandimi u mirëprit dhe u pranua.

2. Ankesa e shtetasit B. C., i cili pretendonte se në dt. 09.02.2003 ishte keqtrajtuar nga oficeri i policisë Ervin Hasrama, me detyrë komandat i repartit të policisë në Komisariatin nr. 2 Tiranë.

Nga verifikimet që u bënë nga ana jonë rreth kësaj ankese, në librin e shoqërimit të personave në Komisariatin e Policisë nr. 2 Tiranë, rezultoi se shtetasi B. C. ishte shoqëruar në këtë komisarjat nga grupi i gatshëm për arësye se kishte bërë konflikt me shtetas të tjerë. Ndërsa z. Ervin Hasrama, gjatë pyetjes me procesverbal, pretendonte se nuk e njihte dhe se nuk e kishte keqtrajtuar ankuesin.

Shënimet në librin e shoqërimit dhe mohimi i keqtrajtimit të ankuesit nga Ervin Hasrama, u rrëzuan nga pyetja e vetë ankuesit dhe e disa

personave të tjerë, dëshmitarët A. B., E. K. dhe A. H., të cilët konfirmuan se:

Ankuesi B. C. punonte si drejtues muzike në diskon “San Paolo”, e cila ndodhet në qëndër të Tiranës së Re. Në datën 09.02.2003, rreth orës 12.30 në disko kishte ndodhur një zënkë midis dy të rinjve dhe ankuesi kishte ndërhyrë për t’i ndarë ata. Dikush kishte njoftuar policinë, e cila kishte ardhur pas pak minutash. Policët morën në komisariat dy të rinjtë që u zunë dhe ndërkohë kërkuan edhe ankuesin, i cili në ato momente nuk ndodhej në disko. Punonjësit e diskos njoftuan pronarin e saj A. B., i cili erdhi aty menjëherë. Policët i kërkuan atij që të sillte në polici punonjësin e tij B. C. për ta pyetur rreth zënkës së dy të rinjve. Pronari e telefoni B. C dhe i thotë që të vinte në disko. B. C., duke qënë aty pranë, ka shkuar në disko dhe së bashku me pronarin kanë shkuar në Komisaratin e Policisë nr. 2 Tiranë. Pronari hyri në komunikim me një inspektor të policisë kriminale, të cilit i thotë se kishte sjellë B. C.. Inspektori i thotë atij se do ta pyesnin për sherrin e ndodhur në disko dhe se nuk do ta vononin. Pronari i diskos e ka pritur tek porta e komisariatit disa orë B. C, deri në orën 18.00. Kur B. C dali nga policia, A. B. ka konstatuar shënja dhune në fytyrën e B. C., si skuqje, ënjtje në pjesën e poshtëme të syrit të majtë dhe të dy veshet i kishte të nxirë. Kur janë futur në makinë, B. i ka thënë se e kishin rrahur dhe ndërkohë ai i ka demonstruar atij edhe shënjat e dhunës në trup dhe në kërcirin e këmbës së majtë. Të nesërmen A. dhe B. kanë mësuar nga punonjësit e policisë, se ai që e kishte rrahur B. në polici quhej Ervin Hasrama, me detyrë komandant i repartit të policisë.

Faktin që ankuesi ishte rrahur brënda ambjenteve të policisë e provuan me shpjegimet e tyre dëshmitarët A. B., E. K. dhe A. H., të cilët deklaruan se B. C. hyri në polici pa patur asnjë shënjë dhune dhe doli me shënja, të cilat i përshkruam më lartë. Dhuna e përdorur në ambjentet e policisë nga Ervin Hasrama u provua edhe nga dëshmia mjekoligjore nr.141, dt. 13.02.2003 mbi ekzaminimin e shtetasit B. C.

Nga verifikimet e bëra për këtë ankese, arritëm në konkluzionin se oficeri i policisë Ervin Hasrama kishte shkelur rëndë të drejtat dhe lirite themelore të shtetasit B. C., të mbrojtura dhe garantuara nga neni 25 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 3 i Konventës Europiane për mbrojtjen e drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe neni 27, pika 2 te ligjit nr. 8553, dt. 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”. Me veprimet e tij, ai ka konsumuar elementët e figurës së veprës penale të kryerjes së veprimeve arbitrare të parashikuar nga neni 250 i K.Penal.

Për këto arsye, nga ana jonë ju rekomandua Prokurorisë së rrethit Tiranë fillimi i ndjekjes penale në ngarkim të punonjësit të policisë të rolit

të mesëm Ervin Hasrama, për veprën penale të kryerjes së veprimeve arbitrare, të parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal. Rekomandimi u pranua, ndaj tij filloi procedimi penal dhe dosja u dërgua për gjykim në Gjykatën e rrethit Tiranë.

3. Ankesa e shtetasit M. Ll., i cili na shkruante se në dt. 31.03.2003 ishte shoqëruar në postën e policisë Kamëz nga disa punonjës policie, për arsye se në servisin e tij ishte gjetur një makinë e vjedhur, të cilën ai po e riparonte. Në postën e policisë ankuesi ishte marë në pyetje nga inspektori i policisë kriminale i zonës së Bathores, i quajtur Alket. Ankuesi pretendonte se Alketi, mbiemrin e të cilit ne e mësuam nga verifikimet e bëra më vonë, ishte Dizdari, e kishte goditur atë me shufër hekuri në pjesë të ndryshme të trupit. Gjithashtu ai pretendonte se ishte goditur disa herë me grushta në fytyrë edhe nga punonjësi i policisë Ali Çerenishti, i cili pretendonte se ishte i zoti makinës së gjetur në servisin e tij.

Pas dy orësh ankuesi ishte shoqëruar në Komisaratin e Policisë nr. 3 Tiranë. Sipas tij, edhe në këtë komisarati ai ishte keqtrajtuar nga punonjësi i policisë Sadik Dika dhe një person tjetër civil. Ankuesi në dt. 12.06.2003 ka ardhur në institucionin tonë dhe hoqi dorë me shkrim nga ankesa ndaj punonjësve të policisë të këtij komisarati, por jo ndaj Alket Dizdarit dhe Ali Çerenishtit.

Mbi bazën e vendimit tonë, ankuesi u ekzaminua nga Shërbimi i Ekspertimit Mjekoligjor Tiranë. Nga Akt Dëshmia Mjekoligjore nr. 299, dt. 09.04.2003 rezultoi se në trupin e tij u konstatuan gjurmë dhune, të shkaktuara me mjet të fortë mbretës, të cilat kanë sjellë për pasojë uljen e aftësisë së përkohëshme për punë në masën deri në 9 ditë pushim. Gjithashtu në konkluzionet përcaktohej se dëmtimet kishin një moshë rreth një javë që nga momenti që ishte bërë vizita mjekoligjore. Kjo kohë përputhej me kohën që ankuesi pretendonte se ishte keqtrajtuar.

Keqtrajtimi i ankuesit nga punonjësit e policisë provohej edhe nga dëshmia e shtetasit Rr. Ll., i cili deklaroi se kur ankuesin e mori policia, ai nuk kishte asnjë shënjë dhune në trup e në fytyrë, ndërsa kur ai u lirua nga policia pas tre ditësh, kishte shënja dhune në trup e në fytyrë si dhe ishte i enjtur.

Dy punonjësit e policisë të përmëndur më sipër nuk pranuan që ta kishin keqtrajtuar ankuesin, por pretendimet e tyre u rrëzuan nga provat e përshkuara më lartë.

Në përfundim të hetimeve të kësaj ankese arritëm në konkluzionin se veprimet e punonjësve të policisë Alket Dizdari dhe Ali Çerenishti ishin të kundraligjeshme dhe përmbanin elementët e figurës së veprës penale të

kryerjes së veprimeve arbitrare të parashikuar nga neni 250 i K.Penal. Për këto arsye, i rekomandua Prokurorisë së rrethit Tiranë fillimin e ndjekjes penale në ngarkim të tyre. Rekomandimi u pranua dhe aktualisht çështja është në hetim.

4. Ankesa e shtetases Nexhmije Dedolli, e cila na shkruante se në datën 24.08.03, në qytetin e Klosit, nga disa policë të Komisarariatit të Policisë Burrel dhe të forcave të ndërhyrjes së shpejtë, ishte keqtrajtuar bashkëshorti i saj Behar Dedolli. Sipas saj, policët e kishin marrë forcërisht në banesë atë, duke e goditur dhe keqtrajtuar në prani të fëmijëve dhe të bashkëshortes së tij. Keqtrajtimi i tij ka vazhduar edhe më pas, pasi ai ishte dërguar në gjëndje të rëndë në spitalin e Burrelit për tëu mjekuar. Edhe pse ai, sipas mjekëve, ka qënë në gjëndje të rëndë dhe ka patur nevojë për trajtim mjekësor (madje i ishte plotësuar dhe kartela e shtrimit në spital me nr. 1683), ishte marrë dhe izoluar në dhomat e paraburgimit të Komisarariatit të Policisë Burrel.

Gjithashtu ankuesja na shkruante se kur tek Oficeri i Rojes së këtij Komisaritati janë paraqitur dy vëllezërit e Beharit përkatësisht Ali dhe Mirjan Dedolli, për tëu interesuar në lidhje me gjëndjen shëndetësore të vëllait të tyre Beharit, këta të fundit janë marrë nga policët, janë keqtrajtuar dhe izoluar në dhomat e paraburgimit. Sipas ankueses, Behari nga goditjet e shumta në kokë, ka patur si pasojë “marrje të gojës” (të folurit me vështirësi dhe me belbëzime).

Ankesa u vlerësua me seriozitet dhe për verifikimin e saj, në datën 27.08.2003, shkoi në vënd vet Avokati i Popullit, i cili mori kontakt dhe pa gjëndjen e të dëmtuarve.

Fakti i keqtrajtimit të tyre u vu re dukshëm në trupin e secilit, por veçanërisht të Beharit, i cili kishte dy çarje mjaft të theksuara në kokë të qepura me kapse, pa përmëndur hematomat e dërmishjet e shumta në trup.

Nga verifikimet e bëra arritëm në konkluzionin se punonjësit e policisë kishin demonstruar paaftësi profesionale, nuk kishin respektuar të drejtat e personave të shoqëruar dhe kishin përdorur më shumë forcë se sa ishte e arsyeshme. Të ndodhur në këto kushte i rekomandua Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë verifikimin e kësaj çështjeje dhe marjen e masave përkatëse.

Rekomandimi u mirëprit dhe nga analiza e bërë kësaj ngjarjeje nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë rezultuan të drejta konstatimet tona. Meqënëse organi i prokurorisë kishte filluar procedimin penal në ngarkim të vëllezërve Dedolli për veprën penale të “Goditjes për shkak të detyrës” dhe për “Kundërshtim me dhunë të punonjësve të policisë” dhe

mbi bazën e pretendimeve për ushtrim dhune të vëllezërve Dedolli, kishte filluar procedimin penal ndaj forcave të policisë për veprën penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare” dhe çështjet ishin në hetim, u vendos të pritej përfundimi i hetimeve për të parë e vendosur për masat disiplinore ndaj punonjësve të policisë të implikuar në këtë ngjarje.

II. Ankesat për veprime të tjera të paligjshme nga policia

Kanë qënë 95 ankesa për veprime arbitrare të punonjësve të policisë, nga të cilat 4 për kontrole të paligjshme banese e lokali; 8 arrestime, ndalime dhe shoqërime të paligjshme; 4 për veprime korruptive; 36 për mos evidencim apo mos ndjekje të kallzimeve apo të ankesave; 3 për gjopa të padrejta; 3 për bllokim të pasaportave dhe 37 për veprime të tjera të kundraligjshme, si për sende të sekuestruara nga policia, mos lejimi i avokatëve të takohen me personat e arrestuar apo ndaluar në polici, etj. Si raste të zgjidhjes pozitive mund të përmëndim:

1. Ankesa e kryepoleqësisë së fshatit Borje të rrethit Kukës, e cila pretendonte për shkelje të të drejtave të banorëve të këtij fshati nga punonjësit e policisë, si ushtrim dhune dhe terrori psikologjik, kontrole të paligjshme të banesave e ushtrim dhune fizike ndaj disa qytetarëve.

Nga ana jonë ankesa u vlerësua me seriozitet dhe objektivitet dhe rreth saj u bënë hetime, duke shkuar në vënd e pyetur ankuesit, personat që pretendonin se ju ishin shkelur të drejtat, punonjësit e policisë të akuzuar prej tyre, si dhe u kqyrën dokumente në polici e gjykatë që lidheshin me këtë ankesë.

Në përfundim të hetimeve të bëra nga ana jonë u arrit në konkluzionin se, veprimet e policisë, si kontrollet e banesave e kasolleve të disa banorëve të fshatit Borje, prona të personave të arratisur nga dhomat e paraburgimit të Komisarariatit të Policisë Kukës ose të lidhjeve të tyre, nga ana e policisë ishin bërë në bazë të ligjit nr. 8553, dt. 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”. Gjithashtu edhe shoqërimi dhe pyetja e disa banorëve të këtij fshati, familjarë, të afërm ose përkrahës të të arratisurve ishin bërë konform ligjit të mësipërm dhe dispozitave të K.Pr.Penale. Të gjitha këto veprime ishin bërë në funksion të gjetjes dhe kapjes së personave të arratisur nga dhomat e paraburgimit.

Por gjatë kontrolleve të banesave dhe ambjenteve të tjera, megjithëse kanë qënë të shumta dhe të tensionuara, punonjësit e policisë nuk i janë përmbytur me rigorozitet kritereve ligjore. Nga ana e punonjësve të policisë që i kishim kryer këto veprime, nuk ishin përpiluar dokumentat

përkatëse, procesverbalet e kontrolleve, menjëhere pas kryerjes së tyre, siç parashikohet në pikën 2 të nenit 43 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”.

Për të rivendosur në vend dinjitetin e personave të dëmtuar dhe për të parandaluar shkelje të tilla në të ardhmen nga ana e punonjësve të policisë, i rekomanduam Drejtorit të Policisë së Qarkut Kukës që të analizonte me objektivitet shkeljen ligjore të konstatuar më sipër dhe t’i jepte masa disiplinore personave përgjegjës që i kishin bërë ato. Masat disiplinore të komunikoheshin para efektivit me qëllim që të parandaloheshin shkelje të tilla në të ardhmen nga punonjësit e tjerë të policisë.

Rekomandimi u pranua dhe në bazë të tij u ndëshkuan me masa disiplinore tre punonjës policie, dy të rolit të mesëm dhe një i rolit bazë.

2. Ankesa e shtetasit Q. Gj., banor i rrethit Kavajë. Ai na shkruante se në datën 09.06.2003, në orën 18.00 ishte shoqëruar në Komisariatin e Policisë Kavajë padrejtësisht dhe mbajtur tej afatit ligjor. Sipas tij, në Policinë e Kavajës ai ishte mbajtur 3 orë dhe më pas ishte transferuar në Rajonin e Policisë Rrogozhinë, duke u mbajtur i shoqëruar edhe 10 orë të tjera.

Nga verifikimi që i bëmë kësaj ankese dhe konkretisht, pyetja e disa punonjësve të policisë dhe kqyrja e librit të shoqërimit të shtetasve në Komisariatin e Policisë Kavajë dhe në Rajonin e Policisë Rrogozhinë, u provuan plotësisht pretendimet e ankuesit për mbajtjen e tij në gjëndje shoqërimi, tej afatit ligjor, pa patur shkaqe ligjore. Ndërsa shoqërimi i tij në polici ishte bërë në përputhje me ligjin, sepse nuk i ishte bindur punonjësve të policisë për kontrollin dhe shoqërimin e automjetit të tij në polici.

Meqënëse ankuesi Q. Gj. ishte mbajtur i shoqëruar në organin e policisë tej afatit ligjor (deri në 10 orë), të parashikuar nga neni 45 i ligjit nr. 8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, i rekomanduam Shefit të Komisarariatit të Policisë Kavajë që të analizonte këtë shkelje ligjore dhe ndaj punonjësve të policisë që kishin shkelur ligjin në rastin konkret, të jepeshin masa disiplinore dhe t’i komunikonte ato në prezencë të efektivit, me qëllim parandalimin e rasteve të tilla në të ardhmen. Rekomandimi i bërë u mirëprit dhe u pranua.

3. Ankesa e shtetasit A. Gj., banor i rrethit Kavajë, na shkruante se para disa muajve kishte bërë një kallzim për kanosje serioze për vrasje dhe fyerje që i kishte bërë atij shtetasi B. B. Ankuesi kallzimin e kishte bërë tek inspektori i policisë kriminale të Rajonit të Policisë Rrogozhinë Gramoz Dafku, por ai nuk e kishte përcjellë atë në organin kompetent (prokurori).

Nga pyetja e bërë nga ana jonë në datën 26.06.2003, oficeri i policisë Gramoz Dafku, nuk pranoi që të kishte mbajtur kallzimin e ankuesit, por vetëm i kishte marë atij dhe personave të tjerë deklarime rreth konflikteve që ata kishin me njëri tjetrin. Ndërsa nga ripyetja që ju bë atij, në datën 02.07.2003, ai pranoi se e kishte marë kallzimin e ankuesit në datën 30.03.2003, por atë nuk e kishte përcjellë në organin kompetent, duke e nënvlerësuar rëndësinë e tij.

Nga shqyrtimi i kësaj ankese, arritëm në konkluzionin se inspektori i policisë kriminale, i cili ka edhe atributet e oficerit të policisë gjyqësore, Gramoz Dafku, duke e mbajtur kallzimin e ankuesit, kishte shkelur hapur dispozitat e K.Pr.Penale dhe konkretisht nenet 30, 293 dhe 294 në të cilat përcaktohen funksionet, detyrat dhe veprimtaria me inisjativë e policisë gjyqësore.

Megjithse shkelja e kryer prej tij ishte e rëndë, por duke mbajtur parasysh eksperiencën e pakët të punës së tij, prej 6 muaj, i rekomanduam Shefit të Komisarariatit të Policisë Kavajë që të dërgonte menjëherë në organin e prokurorisë kallzimin e ankuesit A. Gj. Gjithashtu ju rekomandua edhe dhënia e masën disiplinore “Vrejte me paralajmërim” ndaj oficerit të policisë Gramoz Dafku dhe t’ja komunikonte atë në prezencë të efektivit me qëllim parandalimin e rasteve të tilla në të ardhmen.

Rekomandimet u mirëpritën dhe u vunë në zbatim.

4. Ankesa e shtetasit N. M., i cili ankohej ndaj punonjësve të Komisarariatit të Policisë Fier. Ankuesi kishte bërë kallzim për kryerje të veprës penale, kanosje serioze për vrasje, plagosje dhe armëmbajtje pa leje ndaj shtetasit S. G., por nga policia nuk ishte marë asnjë masë për vënien në lëvizje të tij, për kryerjen e veprimeve proceduriale dhe për vënien para përgjegjësisë ligjore të autorit të veprave penale.

Nga verifikimi që i bëmë në vënd ankesës rezultoi se, ankuesi në datë 27.04.2003, ishte kanosur për vrasje dhe ishte qëlluar me pjesën e qytës së një pistolete të cilën shtetasi S. G. e mbante pa leje të organeve kompetente, duke e gjakosur dhe shkaktuar dëmtime në fytyrë.

Ditën e nesërme në mëngjes, datën 28.04.2003, ankuesi kishte shkuar në polici dhe kishte bërë kallzimin penal tek inspektori i policisë kriminale z. Ilir Barjami, që kryente dhe funksionet e oficerit të policisë gjyqësore.

Që nga ajo ditë dhe deri më datën 22.05.2003, kallzimi i ankuesit kishte ngelur në kasafortën e oficerit të policisë gjyqësore, pa kryer asnjë veprim tjetër të domosdoshëm procedural. Kallzimi nuk ishte vënë në

lëvizje megjithë përpjekjet dhe ankimet e ankuesit tek Shefi i Policisë Kriminale z. Ervin Hodaj dhe Shefi i Komisarariatit të Policisë Fier.

Konstatuam se, nga ana e z. Ilir Barjami në cilësinë e oficerit të policisë gjyqësore nuk ishin kryer veprimet e domosdoshme procedurale dhe më konkretisht, me marrjen e kallzimit duhej të merte vendimin për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor, marrjen e deklarimeve të personave që kishin dijeni për ngjarjen, si dhe kërkimet me qëllim ndalimin e autorit të veprës penale. Pas grumbullimit dhe administrimit të materialeve të mësipërme, ato duhet të shikoheshin dhe studjoheshin nga ana e Shefit të Policisë Kriminale dhe menjëherë t'i dërgoheshin Prokurorisë, si organ i vetëm i ndjekjes penale.

Vlen të theksohet se moszbatimi me korrektësi i rregullave procedurale, solli për pasojë jo vetëm moskryerjen e aktit mjeko-ligjor nga eksperti përkatës (veprim ky i domosdoshëm dhe i papërsëritëshëm), por dhe përsëritjen e veprimeve kanosëse të shtetasit S. G. ndaj ankuesit, siç ishte ai i datës 7 maj 2003.

Në deklaratimet e datës 22.05.2003 oficeri i policisë gjyqësore Ilir Barjami, ndërmjet të tjerave pranoi mosvlerësimin e kallzimit, duke filluar qysh me mosdhënien e vendimit për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor, kërkimin me qëllim ndalimi të autorit të veprës, etj.

Në këto rrethana, përgjegjësi për moskryerjen e veprimeve procedurale me kallzimin e ankuesit dhe mosndjekjen e tij, kishte edhe z. Ervin Hodaj, si shefi direkt i tij dhe që duke kryer detyrën e Shefit të Policisë Kriminale e kishte në vartësi atë. *Fshehja e të dhënave ose mosnjohimi në gjykatë ose prokurori për kryerjen e një vepre penale, në përputhje me afatet dhe mënyrën e parashikuar në Kodin e Procedurës Penale nga oficerët e policisë gjyqësore*, përbën shkelje ligjore. Ajo është parashikuar si e tillë edhe në pikën 1, gërma "b", të nenit 14, të ligjit Nr. 8677, datë 02.11.2000, "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Policisë Gjyqësore".

Duke analizuar në tërësi materialet e administruara, pas kryerjes së hetimit konstatuam se, ankesa e shtetasit N. M. ishte e drejtë dhe se nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore z. Ilir Barjami dhe shefit të tij z. Ervin Hodaj ishin kryer shkelje të rënda të dispozitave të K.Pr.Penale dhe konkretisht nenet 30, 293 dhe 294, në të cilat përcaktohen funksionet, detyrat dhe veprimtaria me inisjativë e policisë gjyqësore.

Të ndodhur në këto rrethana i rekomanduam Drejtorit të Policisë së Qarkut Fier që të dërgonte menjëherë në organin e prokurorisë kallzimin e ankuesit. Gjithashtu ju rekomanduam edhe dhënia e masave disiplinore ndaj të dy oficerëve të policisë. Rekomandimi u pranua dhe ndaj Inspektorit të

Policisë Kriminale N/Inspektor Ilir Barjami u dha masa disiplinore “Vrejte me paralajmërim”, ndërsa ndaj Shefit të Policisë Kriminale, Inspektor Ervin Hodaj u dha masa disiplinore “Vrejtje”. Në të njëjtën kohë me këtë shkelje dhe me rekomandimin e mësipërm u njoh edhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

5. Ankesa e avokatit V.Gj., i cili na shkruante se nuk lejohej nga punonjësit e policisë të Drejtorisë së Policisë të Qarkut Tiranë që të takohej me klientin e tij, të arrestuarin I.L.. Nga verifikimet e bëra nga ana jonë rezultoi i vërtetë pretendimi i ngritur në ankesë. Drejtuesit e policisë e justifikonin këtë veprim të tyre me faktin se avokati nuk kishte prokurë nga i arrestuari për ta mbrojtur atë për çështjen konkrete. Justifikimi i policisë nuk kishte bazë ligjore, sepse i arrestuari e kishte kërkuar drejtpërdrejtë avokatin, menjëherë pas arrestimit të tij. Kjo e drejtë e të arrestuarit ishte e mbështetur edhe në pikën 2 të nenit 48 të K.Pr.Penale, në të cilin është parashikuar zgjedhja e avokatit me deklaram para organit proçedues. Përveç kësaj, duhet theksuar se pretendimi i policisë nuk kishte as bazë llogjike, sepse i ndodhur në kushtet e arrestit, ai nuk mund të bënte prokurë, e cila bëhet vetëm përpara noterit. Ky veprim i policisë binte ndesh me gërmën “e”, të nenit 2, të ligjit nr. 9109, datë 17.07.2003, “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë”, ku parashikohet se ndihma juridike e avokatit jepet edhe nëpërmjet *pranisë si mbrojtës në kohën e shoqërimit, ndalimit, arrestimit, gjatë proçesit të hetimit, shqyrtimit gjyqësor të personave në çështjet penale.*

Meqënëse ky veprim i policisë ishte i kundraligjshëm, ne ndërhyëm pranë drejtuesve të policisë Tiranë, për të respektuar të drejtën e të arrestuarit dhe të avokatit të tij për t’u takuar.

Pas ndërhyrjes tonë problemi u sqarua dhe u bë i mundur takimi i të arrestuarit me avokatin e zgjedhur prej tij. Vlerësuam që në këtë rast të mos kërkonim masa disiplinore, por rasti të vlente për të parandaluar këtë shkelje për të ardhmen.

6. Gjatë ndjekjes së rasteve të keqtrajtimit të shtetasve shqiptarë nga policët e vendeve fqinjë, ne konstatuam se punonjësit e Policisë Shqiptare të kufirit nuk zbatonin e nuk kryenin detyrat e tyre të përcaktuara në Udhëzimin e përbashkët të Prokurorisë së Përgjithshme nr. 1210, datë 23.07.2001 dhe të Ministrisë së Rendit Publik nr. 2037, datë 23.07.2001, “Për mbajtjen e proçesverbaleve të kallzimit të personave të keqtrajtuar jashtë shtetit”. Ky udhëzim ishte nxjerrë pas Rekomandimit të Avokatit të Popullit.

Për një rast konkret të ndodhur me punonjësit e policisë në VKK Kapshticë, ne reaguam dhe bëmë dy rekomandime. Njëri drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për të urdhëruar drejtuesit e policisë në qarqet që kanë Pika të Kontrollit të Kalimit Kufitar që të ripunojnë me efektivat e tyre Udhëzimin e përbashkët të Prokurorisë së Përgjithshme nr. 1210, datë 23.07.2001 dhe të Ministrisë së Rendit Publik nr. 2037, datë 23.07.2001, “Për mbajtjen e procesverbaleve të kallzimit personave të keqtrajtuar jashtë shtetit”. Ndërsa tjetri ju bë Drejtorit të Policisë së Qarkut Korçë për të analizuar ngjarjen e ndodhur në Kapshticë në rastin e keqtrajtimit të tre shtetasve nga Elbasani në datën 15.09.2003 dhe për mos kryerje të detyrave nga punonjësit e policisë, t’i ndëshkonte ata me masa disiplinore.

Rekomandimet u mirëpritën dhe u pranuan. Në bazë të tyre u ndëshkuan me masa disiplinore 4 punonjës policie, njëri u përjashtua, ndërsa tre u pezulluan nga detyra. Pas këtyre rekomandimeve nga punonjësit e policisë në VKK filluan të bëheshin veprimet proceduriale dhe të mbahej dokumentacioni përkatës për të gjitha rastet e keqtrajtimit nga policitë e vendeve fqinjë, duke i përcjellë ato organeve të prokurorisë.

III. Ankesat për largime nga puna të punonjësve të M.R.Publik dhe të Policisë së Shtetit

Në Institucionin tonë kanë paraqitur ankesa 30 oficerë dhe policë për largime të padrejta nga puna. Në disa raste ankuesve nuk ju është komunikuar motivacioni dhe shkaqet ligjore të largimit nga puna, si dhe nuk janë thirrur e dëgjuar sipas procedurave përkatëse kur ju jepen masa disiplinore. Si shëmbuj të zgjidhjes pozitive në favor të ankuesve mund të përmëdim:

1. Ankesa e punonjësit të policisë të rolit bazë Q. H., efektiv i Komisarariatit të Policisë Nr. 3 Tiranë. Ai na shkruante se i kishin dhënë gradën minimale “agjent”, ndërkohë që kishte vjetërsi shërbimi në polici prej 35 vjetësh, aftësi profesionale dhe vlerësim pune të mirë. Duke gjykuar se i kishin bërë padrejtësi, ai kishte bërë ankim tek eprorët e vetë dhe njëkohësisht këtë pakënaqësi e kishte shprehur në media, në Gazetën Shqiptare dhe në TV NEWS 24. Të nesërmen në dt. 08.04.2003, pas botimit në gazetë, ai është thirrur nga eprorët e tij, të cilët i kanë komunikuar urdhërin “Pezullim nga shërbimi deri në sqarimin e çështjes” me motivacionin se ka shkelur Urdhërin e Kryeministrit dhe të Ministrit të Rendit Publik “Për komunikimin me mediat”. Më pas u përjashtua edhe nga Policia.

Nga studimi i dokumentacionit rezultoi se ankuesi ishte përjashtuar nga Policia e Shtetit me urdhërin e Drejtorit të Policisë së Qarkut Tiranë nr. 5053/1 prot. dt. 16.05.2003, me motivacionin “Për akte të rebelimit publik ose nxitje për rebelim, pasi në dt. 08.05.2003, në kundërshtim me Urdhërin e Kryeministrit nr. 226 datë 20.08.2002 “Për komunikimin me organet e medias së shkruar dhe elektronike” dhe Urdhërin e Ministrit të Rendit Publik nr. 1661, datë 08.04.2002 “Për komunikimin me median” ka dhënë intervistë në median e shkruar dhe elektronike për gradat policore, duke kryer shkeljen e parashikuar në paragrafin e katërt, të pikës 7, të rregullit 12 të Rregullores së Disiplinës së Policisë së Shtetit”.

Ndërsa nga studimi i dokumenteve të tjera që lidhen me këtë problem si, propozimi i bërë nga komandanti i repartit, relacioni sqarues bërë nga Shefi i Policisë me Uniformë dhe propozimin për përjashtimin e tij nga Policia e Shtetit, bërë nga Shefi i Komisarariatit të Policisë nr. 3, rezultonte se motivacioni i lirimt të tij ishte vetëm për shkelje të Urdhërit të Kryeministrit nr. 226 datë 20.08.2002 “Për komunikimin me organet e medias së shkruar dhe elektronike” dhe Urdhërit të Ministrit të Rendit Publik nr. 1661, datë 08.04.2002 “Për komunikimin me median” dhe *jo për akte rebelimi publik*, siç ishte bërë motivacioni i përjashtimit të tij.

Nga studimi i bazës ligjore dhe i dokumentacionit për përjashtimin nga Policia e Shtetit të ankuesit rezultoi se:

a) Urdhëri i Drejtorit të Policisë së Qarkut Tiranë nr. 5053/1 prot., dt. 16.05.2003 dhe Vendimi i Këshillit Rajonal Emërues nr. 34, datë 15.05.2003, përsa i përket motivacionit të përjashtimit të tij nga Policia e Shtetit nuk përputheshin me atë që kishin kërkuar eprorët e drejtpërdrejtë të ankuesit me shkresat e cituara më sipër. Fakti i pezullimit nga shërbimi i punonjësit të policisë Q. H. vetëm me motivacionin “Për shkelje të Urdhërit të Kryeministrit nr. 226, datë 20.08.2002 “Për komunikimin me organet e medias së shkruar dhe elektronike” dhe Urdhërit të Ministrit të Rendit Publik nr. 1661, datë 08.04.2002 “Për komunikimin me median” ishte bërë publik dhe u njoftua edhe nga Ministria e Rendit Publik nëpërmjet TVSH në lajmet e mbrëmjes të dt. 08.05.2003. Sipas nenit 81, pika 2 e ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, *faktet të cilat janë njohur publikisht përbëjnë provë dhe nuk kanë nevojë për verifikim.*

b) Komunikimin e tij me mediat as ligji nr. 8553, dt. 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit” dhe as Rregullorja e Disiplinës së Policisë së Shtetit, *nuk e kanë parashikuar si shkelje në rastet e përjashtimit nga policia të punonjësit të policisë.*

Në rrethanat e përshkruara më sipër dhe për të bërë të mundur rivendosjen në vënd të së drejtës së shkelur ankuesit, i rekomanduar Drejtorit të Policisë së Qarkut Tiranë revokimin e urdhërit nr. 5053/1, dt. 16.05.2003 “Për përjashtimin nga Policia e Shtetit të punonjësit të policisë Q. H.” dhe të ripranonte atë në radhët e policisë.

Rekomandimi u zvarrit disa kohë, por pasi ky problem ju bë prezent nga ana jonë Kryeministrit Nano, me urdhër të tij, punonjësi i policisë u rikthye në detyrë.

2. Ankesa e shtetasit R. Sh., ish punonjës policie në Drejtorinë e Policisë së qarkut Durrës. Ai na shkruante se me urdhrin e Drejtorit të Policisë së Qarkut Durrës, nr. 291 prot., datë 12.06.2003, ishte përjashtuar nga Policia e Shtetit, me motivacionin “Nuk ka kryer arsimin e mesëm”. Ankuesi pretendonte se përjashtimi i tij nga policia me motivacionin e mësipërm ishte i padrejtë, sepse ai jo vetëm kishte mbaruar shkollën e mesme, por kishte mbaruar edhe Akademinë e Policisë. Gjithashtu ai na shkruante, se gjatë punës në polici kishte patur rezultate të larta në luftën kundër kriminalitetit, për të cilën ishte shpërblyer disa herë nga ana e komandës, si dhe nuk kishte marrë asnjë masë disiplinore.

Për të vërtetuar faktin që ka mbaruar shkollën e mesme, ankuesi i ishte drejtuar Gjykatës së rrethit Fier me kërkesë. Në përfundim të gjykimit të bërë edhe në prani të palës së tretë, Shkolla e Mesme e Naftës “Lefter Talo” Patos, me vendimin nr. 990, datë 16.06.2003, gjykata kishte vendosur: “Vërtetimin e faktit juridik të përfundimit të Shkollës së Mesme të Naftës “Lefter Talo” Patos, dega Mekanik i Përgjithshëm nga ana e kërkuarit R. Sh. në vitin shkollor 1987-1992. Gjithashtu ishte vendosur edhe korigjimi i aktit (rregjistër i veçantë) nga ajo e gabuara nr. 25, në atë të saktën nr. 704”. Kopjen e vendimit gjyqësor, i cili kishte marrë formë të prerë në datën 02.07.2003, ankuesi na e kishte dërguar së bashku me ankesën.

Fakti thelbësor në këtë çështje ishte se, me vendimin gjyqësor të përshkruar më sipër, ishte rrëzuar totalisht motivacioni i përjashtimit të ankuesit nga policia. Vendimet gjyqësore të formës së prerë sjellin pasoja ligjore të përcaktuara në ligj dhe sipas nenit 142/3 të Kushtetutës, ato përbëjnë detyrimin kushtetues për t’u njohur e zbatuar nga organet shtetërore.

Nga studimi i urdhërit të përjashtimit të ankuesit, si dhe nga verifikimi në vënd i bërë nga ana jonë, rezultoi se në rastin konkret ishte shkelur procedura e lirit të tij nga policia, e përcaktuar në Rregulloren e Personelit të Policisë së Shtetit dhe konkretisht në nenet 15, pika 2 dhe 22, gërma E/b, sepse drejtorit nuk i ishte bërë propozim nga këshilli rajonal

emërues për përjashtimin e tij nga policia. Sipas këtyre dispozitave, emërimi dhe lirimi nga detyra i punonjësve të policisë të rolit bazë bëhet nga drejtori i policisë së qarkut, pasi është bërë më parë propozimi i Këshillit Rajonal Emërues. Domosdoshmëria e propozimit të Këshillit Rajonal Emërues, është e përcaktuar edhe në nenin 25, pika 1 e 3 e Rregullores së Personelit, ku përcaktohen se, akti që përpilon Këshilli Emërues emërtohet “*propozim*” dhe se në aktin e emërimit apo lirimt përshkruan bazën ligjore, *propozimin e këshillit emërues,* Pra edhe forma e aktit, urdhërit të përjashtimit nga policia, nuk ishte në përputhje me kërkesat e dispozitës së mësipërme.

Nga verifikimet e bëra rezultoi gjithashtu, se ankuesi kishte patur rezultate të larta në detyrë, në luftën kundër kriminalitetit dhe për këtë ishte shpërblyer disa herë materialisht dhe moralisht nga komanda. Gjatë punës në polici, ai nuk kishte marrë asnjë masë disiplinore.

Për të rivendosur në vënd të drejtën ligjore të shkelur ankuesit, i rekomandua Drejtorit të Policisë së Qarkut Durrës revokimin e urdhërit nr. 291 prot., datë 12.06.2003, për përjashtimin e tij nga Policia e Shtetit, me motivacionin “Nuk ka kryer arsimin e mesëm” dhe rikthimin e tij menjëherë në detyrë.

Rekomandimi u mirëprit dhe ankuesi u rikthye në detyrë.

IV. Moszbatimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe mos pagesa e kuadrove kur ata lihen në dispozicion.

Ky problem tashmë është i njohur dhe i pranishëm pothuajse në të gjitha organet e administratës publike shqiptare. Prandaj ankesat në këtë fushë kanë qënë të shumta edhe për Ministrinë e Rendit Publik dhe institucionet apo organet e tjera në varësi të saj. Kështu për vitin 2003 janë bërë 18 ankesa për mosekzekutim të vendimeve gjyqësore për kthimin në punë dhe për mosdëmshpërblimin për kohën e qëndrimit pa punë, si dhe 5 ankesa për mos pagimin e kuadrove kur ata lihen në dispozicion. Si raste të zgjidhjes pozitive mund të përmëndim:

1. Ankesa e shtetasit I. M., ish punonjës policie në Komisaratin e Policisë Rrugore Tiranë. Ai na shkruante se ishte përjashtuar padrejtësisht nga policia me urdhërin nr. 2928/1, dt. 25.04.2002, të Drejtorit të Policisë së Qarkut Tiranë. Ankuesi këtë çështje e kishte bërë konflikt gjyqësor dhe Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin nr. 3506, dt. 17.09.2002 kishte vendosur çfuqizimin e urdhërit të Drejtorit të Policisë së Qarkut Tiranë dhe detyrimin e palës së paditur t’i paguajë paditësit pagën për kohën e qëndrimit pa punë. Vendimi kishte marrë formë të prerë dhe për të ishte

lëshuar edhe urdhëri i ekzekutimit të tij. Ankuesi pretendonte se kishte disa muaj që kishte bërë përpjekje për zbatimin e vendimit gjyqësor lidhur me rikthimin e tij në detyrë, por ai nuk ishte zbatuar nga Drejtoria e Policisë Tiranë.

I kërkuam shpjegime Drejtorisë së Policisë të Qarkut Tiranë për shkaqet ligjore të mos zbatimit të vendimit gjyqësor të cituar më sipër dhe u informuam se ky vendim gjyqësor nuk ishte zbatuar sepse në këtë vendim ishte vënë shënimi nga Drejtori i Policisë së Qarkut, ku cilësonte se: "Për njërëzit që marrin lekë në shërbim duke përdorur uniformën, nuk mund të firmos dot, pasi kodi etik nuk më lejon".

Mirëpo, urdhëri i përjashtimit të ankuesit nga detyra është akt administrativ. Në bazë të nenit 324 e vijues të K.Pr.Civile mosmarrveshjet administrative, në bazë të padive të ngritura nga palët e interesuara, gjykohen nga organet gjyqësore. Po kështu, e drejta e ankuesit për t'ju drejtuar gjykatës për të kërkuar shfuqizimin e urdhërit të përjashtimit të tij nga policia është parashikuar edhe në nenin 32, pika 5, e ligjit nr. 8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit".

Drejtori i Policisë së Qarkut, në bazë të ligjit "Për Policinë e Shtetit" ka të drejtë dhe kopetencë të bëjë lirim apo përjashtimin e punonjësve të policisë, kur janë kushtet ligjore, por ai nuk ka dhe nuk mund të ketë të drejtë të mos zbatojë vendimet gjyqësore, të cilat shfuqizojnë urdhërat e tij. Pretendimet për marje lekësh për shkak të detyrës nga ana e ankuesit, organi i policisë duhet t'i mbronte përpara gjykatës gjatë zhvillimit të gjykimit. Por megjithatë i ishte dhënë kjo mundësi nga ana e gjykatës, Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë nuk ishte paraqitur në asnjë nga pesë seancat gjyqësore të zhvilluara për këtë çështje.

Megjithatë, thelbësore në këtë ankesë që trajtuam ishte se ndodheshim përpara faktit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, i cili në bazë të nenit 142, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përbën një detyrim kushtetues për t'u zbatuar nga ana e çdo organi shtetëror.

Për të rivendosur në vënd të drejtën kushtetuese e ligjore që i ishte shkelur ankuesit, i rekomanduam Drejtorit të Policisë së Qarkut Tiranë zbatimin e vendimit nr. 3506, dt. 17.09.2002, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, duke e rikthyer në detyrë punonjësën e policisë I. M.. Rekomandimi u pranua dhe ankuesi u rikthye në detyrë.

2. Ankesa e shtetasit R. T., me profesion inxhinjer ndërtimi, ish oficer i M.R.Publik në Degën e Ndërtimit të Drejtorisë Llogjistike e Teknike, i cili me urdhërin e Ministrit të Rendit Publik nr. 2111, datë 16.09.1998, ishte pushuar nga puna. Meqënëse e ka konsideruar të padrejtë

këtë urdhër, ai kishte bërë padi në gjykatë dhe me vendimin nr. 258, datë 04.02.1999, të Gjykatës së rrethit Tiranë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, ishte vendosur anullimi i urdhërit të Ministrit të Rendit Publik. Ndërsa me vendimin nr. 3647, datë 25.09.2002, të Gjykatës së rrethit Tiranë, ishte vendosur detyrimi i M.R.Publik të paguajë në favor të tij pagën e ndenjes pa punë nga lirimi deri në ekzekutimin e vendimit. Vendimet kishin marrë formë të prerë dhe për ta ishin lëshuar edhe urdhërat e ekzekutimit të tyre. Ankuesi pretendonte se i kishte bërë kërkesë Zyrës së Përmbartimit Tiranë për ekzekutimin e tyre, por megjithë përpjekjet e bëra prej saj, nuk është bërë i mundur ekzekutimi i vendimeve gjyqësore, për shkak të pengesave të sjella nga M.R.Publik.

Për të bërë të mundur zgjidhjen e kësaj ankese, i kërkuam shpjegime Ministrit të Rendit Publik, për pretendimet e ankuesit. Drejtoria e Burimeve Njërëzore e M.R.Publik, më datë 22.09.2003, na ktheu përgjigje, duke na informuar se: *“Drejtoria e Burimeve Njërëzore mendon se, rikthimi i tij në punë është i vështirë për shkak të arsimit që ka. Në Policinë e Shtetit dhe Gardën e Republikës nuk ka vende të lira në përshtatje me arsimin e tij. Një mundësi për sistemimin e tij është konkurimi sipas ligjit “Për statusin e nëpunësit civil” në vendet e lira që janë shpalluar në Drejtorinë Ekonomike”.*

Përgjigjia e Drejtorisë së Burimeve Njërëzore, në pikpamje ligjore, ishte jo korrekte, mbasi vinte në kundërshtim me kërkesat ligjore. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore është një detyrim kushtetues për organet shtetërore. Shtojmë se në rastin konkret ai nuk mund t’i nështrohej konkurimit për rikthimin në punë, për faktin se nuk ndodhemi para faktit të fillimit të marrëdhënieve të reja të punës. Pavarësisht nga fakti që nuk ka vende ta lira, ankuesi duhet të rikthehet në vendin e mëparshëm të punës, ndonëse aktualisht mund të jetë i zënë.

Për të bërë të mundur rivendosjen në vënd të të drejtës kushtetuese dhe civile që i ishte shkelur ankuesit, i rekomanduam Ministrit të Rendit Publik ekzekutimin e plotë të vendimeve gjyqësore të cituara më sipër në favor të ankuesit R. T.

Pas rekomandimit tonë, Drejtoria Juridike dhe e Përfaqësimit Ligjor e M.R.Publik, më datë 17.11.2003 na ktheu përgjigje se: *“ Në lidhje me detyrimet financiare që rrjedhin nga këto vendime, ajo me shkresën nr. 65/2/R, datë 12.11.2003, i ka kaluar ato për kopetencë Drejtorisë së Buxhet dhe Financës në M.R.Publik”.* Ndërsa përsa i përket pjesës tjetër të vendimit, *anullimi i urdhërit të Ministrit të Rendit Publik, nr. 2111, datë 16.09.1998, që do të thotë rikthimi i ankuesit në vendin e punës, ka paraqitur disa kundërshtime. Sipas saj, “vendimi nr. 258, datë 05.02.1999, i*

Gjykatës së rrethit Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 829, datë 08.06.1999, të Gjykatës së Apelit Tiranë, në dispozitivin e tyre shprehen vetëm për detyrime financiare të M.R.Publik ndaj shtetasit R. T. Dy vendimet e mësipërme nuk shprehen për rikthimin në punë të paditësit R. T., si rrjedhojë kjo kërkesë nuk gjen mbështetje ligjore”.

Gjithashtu, ajo për të mbështetur pretendimet e saj, i referohej edhe dy vendimeve gjyqësore të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, nr. 156, datë 21.02.2002, si dhe vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të po kësaj gjykate, nr. 31, datë 14.04.2003, në të cilat shprehet se: *“rikthimi në punën e mëparshme është një kërkesë që nuk mund të gjejë më zgjidhje gjyqësore”.*

Në përgjigjen e saj kjo drejtori shprehej edhe për faktin se gjykimet janë bërë në mungesë të M.R.Publik dhe se ajo nuk ka patur dijeni për proceset gjyqësore.

Kundërshtimet e Drejtorisë Juridike dhe të Përfaqësimit Ligjor nuk ishin të bazura në ligj, në vendimet e cituara më sipër, si dhe nuk ishin të argumentuara drejt, sepse:

a) Me vendimin nr. 258, datë 05.02.1999, të Gjykatës së rrethit Tiranë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 829, datë 08.06.1999, ishte vendosur së pari, *“anullimi i urdhërit të Ministrit të Rendit Publik, nr. 2111, datë 16.09.1998”*, dhe pastaj detyrimet financiare. Vërtetë që gjykatat në vendimet e tyre nuk shprehen drejtpërdrejtë për rikthimin në punë të paditësit, por është shumë e vërtetë që ato kanë vendosur *anullimin e urdhërit të Ministrit të Rendit Publik*, me të cilin paditësi është liruar nga detyra. Përderisa është vendosur anullimi i urdhërit të lirimit të tij, i cili e largoi atë nga detyra, atëhere ky fakt do të thotë që të rivendosen marrëdhëniet e mëparshme të punës midis atij dhe M.R.Publik, d.m.th rikthimi i tij në punë. Në se do ishte ndryshe, siç shprehet Drejtoria Juridike dhe e Përfaqësimit Ligjor, atëhere gjykatat do të kishin *rrëzuar kërkesën e paditësit për rikthim në punën e mëparshme, e cila është bërë dhe fiksuar nga ai në objektin e kërkesës padisë.*

b) Vendimet e Gjykatës së Lartë, qofshin ato edhe unifikuese, shërbejnë vetëm si praktikë gjyqësore për organet gjyqësore, për çështjet me objekt të njëjtë që do të gjykohen në të ardhmen prej tyre. Ato nuk kanë dhe nuk mund të kenë fuqi prapavepruese. Po kështu duhet të theksojmë *se ato nuk kanë fuqi juridike për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të dhëna më parë dhe që kanë marë formë të prerë.*

c) Përsa i përket pretendimeve se M.R.Publik nuk ka patur dijeni për zhvillimin e proceseve gjyqësore, ato nuk kishin asnjë vlerë, sepse njoftimi i M.R.Publik për gjykimet ishte i provuar nga vetë vendimet gjyqësore dhe

se ato janë zhvilluar në mungesë të M.R.Publik konform dispozitave të K.Pr.Civile.

Detyrimi i M.R.Publik për të ekzekutuar vendimet gjyqësore është sanksionuar në nenin 142/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *”Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”*.

Për të bërë të mundur rivendosjen në vënd të të drejtës kushtetuese dhe civile që i ishte shkëlur ankuesit, ne i përsëritëm Ministrit të Rendit Publik rekomandimin tonë për të ekzekutuar plotësishtë vendimet gjyqësore të cituara më sipër në favor të ankuesit R. T.. Ky rekomandim është bërë kohët e fundit dhe jemi në pritje të shqyrtimit të tij.

3. Ankesat e disa punonjësve të policisë të rolit të mesëm dhe të lartë, të cilët ishin lënë në dispozicion të strukturave të M.R.Publik dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Në ankesat e tyre ata ngrinin shqetësimin se për periudhën e qëndrimit në dispozicion nuk paguheshin nga strukturat përkatëse. Megjithse ishin përpjekur që problemin ta zgjidhnin në rrugë administrative, duke u ankuar në organet përkatëse të M.R.Publik, përsëri nuk e kishin zgjidhur atë.

Nga verifikimet e bëra nga ana jonë pranë sektorëve përkatës në M.R.Publik rezultoi se deri në atë kohë ishin në dispozicion 42 punonjës policie të rolit të mesëm dhe të lartë, të cilët nuk paguheshin për periudhën e qëndrimit në dispozicion.

Si argument për mos pagimin e tyre, nga Drejtoria e Financës dhe Juridike në M.R.Publik përdorej neni 23 i ligjit nr. 8643, datë 20.07.2000 *“Për Gradat në Policinë e Shtetit”*, ku është parashikuar vënia në dispozicion në rolin madhor. Sipas tyre, meqënëse në ligj është parashikuar vënia në dispozicion vetën për rolin madhor, vetëm këta duhen paguar dhe jo ata të roleve të tjera.

Duke ju referuar kësaj dispozite, konstatojmë se ajo përcakton se:

“1. Pjestarët e rolit madhor të Policisë së Shtetit, kur e kërkojnë interesat e shërbimit, mund të vihen në dispozicion të M.R.Publik. Vënia dhe koha e qëndrimit në dispozicion përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Pjestarët e rolit madhor në dispozicion nuk mund të jenë më shumë se dy për çdo gradë dhe për një periudhë jo më shumë se 12 muaj”.

Nga studimi i kësaj dispozite rezultoi se:

Së pari, nga interpretimi i saj kuptohet qartë se kufizohet në numër dhe në kohë vënia në dispozicion për pjestarët e policisë të rolit madhor. Ajo nuk parashikon dhe në të njëjtën kohë nuk ndalon vënien në dispozicion

të pjestarëve të policisë të roleve të tjera. Sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës, *një gjë që nuk ndalohej lejohet.*

Së dyti, në se nuk do të ishte ligjore vënia në dispozicion e punonjësve të policisë të roleve të tjera, atëherë përse është bërë dhe ku është mbështetur ky veprim nga strukturat përkatëse të Policisë së Shtetit dhe M.R.Publik.

Së treti, nuk mund të lemë pa përmëndur edhe rregullin 12, pika 6 të Rregullores së Disiplinës së Policisë së Shtetit, ku është parashikuar “pezullimi nga detyra ose funksioni”. Sipas kësaj dispozite, punonjësi i policisë që pezullohet nga detyra ose funksioni, trajtohet me pagesë të barabartë sa paga bazë. Pra edhe nga kjo dispozitë kuptohet se përsa paguhen punonjësit e policisë të ndëshkuar me masë disiplinore, atëherë nuk mund të lihen pa paguar të tjerët që janë vënë në dispozicion për shkak të detyrës dhe jo për fajin e tyre.

Së katërti, në bazë të dispozitave të Kodit Civil punonjësit e policisë të vënë në dispozicion kanë të drejtën ligjore që të kërkojnë në rrugë gjyqësore dëmshpërblimin e shkaktuar nga ky veprim. Por kjo mënyrë zgjidhjeje e këtij problemi do të rëndonte detyrimet financiare të M.R.Publik edhe me shpenzimet gjyqësore dhe përmbarimore.

Për të bërë të mundur rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur ankuesve, i rekomanduam Ministrin të Rendit Publik që të merrte masat e nevojshme për pagimin e punonjësve të policisë të lënë në dispozicion. Rekomandi është bërë kohët e fundit dhe është në shqyrtim.

V. Ankesa për procedurat e marrjes dhe lënies së shtetësisë

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit janë depozituar 5 ankesa të cilat kanë të bëjnë me procedurat e shtetësisë. Në shumicën e rasteve ka rezultuar se zvarritjet më të mëdha burokratike vinin nga Policinë e Qarkut dhe nga punonjësit e këtyre Drejtorive, të cilët ishin ngarkuar të punonin, përveç procedurave të pajisjes me pasaporta edhe me procedurat që kanë të bëjnë me shtetësinë. Por nga hetimet pranë këtyre zyrave rezultoi se këta punonjës i jepnin më shumë “përparësi” procedurave të pasaportave se sa atyre që kishin të bënin me procedurat e shtetësisë. Ka mangësi në sportelet e informimit, oraret përkatëse dhe mënyra e komunikimit, shpjegimit dhe sqarimit lënë shumë për të dëshiruar, duke shkelur Udhëzimin e Ministrin të Punëve të Jashtme dhe Ministrin të Rendit Publik nr. 4252 dhe 3553, datë 27.11.2001.

Punonjësit e Policive të Qarkut që kryejnë këto detyra, rezultonte të ishin të patrajnuar për këtë detyrë.

Për këtë arsye në bashkëpunim me Presidencën e Republikës së Shqipërisë dhe Ministrinë e Rendit Publik u realizua një seminar trajnues ku mernin pjesë të gjithë përgjegjësit e Zyrave të Pasaportave dhe të shtetësisë në rang Republike. Në përfundim të këtij seminari institucioni i Avokatit të Popullit shpërndau dhe pajisi të gjithë pjesmarrësit me një përmbledhje aktesh ligjore për t'i ndihmuar më shumë në punën e tyre.

VI. Reagimi i Avokatit të Popullit ndaj rasteve të keqtrajtimit të shtetasve shqiptarë nga policitë e vëndeve fqinjë

Gjatë muajve shtator-tetor 2003 mediat shqiptare sensibilizuan opinionin publik shqiptar për rastet e torturimit dhe të keqtrajtimit fizik të shtetasve shqiptar nga policia greke. Në bazë të nenit 13 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.2003, "Për Avokatin e Popullit" institucioni ynë filloi procedurat e shqyrtimit të këtyre rasteve me nismën e vet. Nga ana jone u muar takim me të dëmtuarit, të cilët u pyetën dhe njëkohësisht u grumbulluan prova, të cilat vërtetonin dhunën barbare të ushtruar ndaj tyre nga Policia Greke.

Kështu mund të përmëndim:

1. Keqtrajtimin e shtetasve L. H., M. H. dhe Rr. P., banues në Elbasan, të cilët datën 15.09.2003, duke ardhur për në Shqipëri janë ndaluar nga disa punonjës të Policisë Greke, të veshur me uniforma ushtarake dhe me kapuçë në kokë. Policët i kanë bërë kontroll fizik në trup dhe në çanta. Gjatë kontrollit të ushtruar, policët i kanë marrë shtetasit Rr. P. 100 EURO dhe ndërkohë i kanë urdhëruar ata që të shtriheshin në tokë me fytyrë poshtë. Sapo janë shtrirë në tokë, njëri prej tyre i ka torturuar duke i goditur me shqelma dhe me dru në pjesë të ndryshme të trupit. Nga goditjet e shkaktuara, shtetasi L. H. ka patur dhimbje të mëdha në pjesën e brinjëve dhe nuk mund ngrihej në këmbë. Ndërsa shtetasit e tjerë kanë patur dhimbje të mëdha në brinjë e në pjesë të ndryshme të trupit. Pas keqtrajtimit policët grekë i kanë dërguar me makine policie deri në afërsi të pikës doganore të Kapshticës, në teritorin grek.

Meqënëse shtetasi L. H. nuk mund të ecte, ai është ndihmuar nga dy të tjerët, duke u mbajtur nga krahët dhe kështu kanë mundur të hyjnë në territorin shqiptar.

Të keqtrajtuarit menjëherë janë nisur me makinë për në vendbanimin e tyre në Elbasan. Gjate rrugës shtetasi L. H. ka patur dhimbje të forta dhe fryrje të barkut, ndërsa dy të tjerët dhimbje të forta në trup. Sapo kanë mbërritur në Elbasan, kanë shkuar në spitalin e qytetit për t'u vizituar e mjekuar. Nga ekzaminimet e bëra nga mjekët e urgjencës, është konstatuar

se shtetasi L. H. kishte dëmtim të rëndë të Heparit (shpretkës) dhe hemoragji të brëndëshme. Meqënëse gjëndja e tij shëndetësore po rëndohej dhe jeta po i rrezikohej, mjekët vendosën ta operonin atë, duke i hequr shpretkën dhe pastruar gjakun e mbeturinat e tij në hapsirën e kavitetit abdominal.

Disa raste të tjera të keqtrajtimit të shtetasve shqiptar nga policia greke, të cilat i kemi ndjekur me inisjativë mund të përmëndim:

2. Vrasjen me armë zjarri nga Policia e Greke e zonës së Kosturit të 18 vjeçarit V. B. nga rrethi i Hasit, në datën 23.09.2003.

3. Keqtrajtimin dhe grisjen e pasaportës me vizë të rregullt të shtetasit A.T. nga Gramshi, nga policët grekë në VKK Kapshticë, në datën 06.10.2003.

4. Keqtrajtimin nga Policia Greke në datën 24.09.2003 të tre shtetasve shqiptar L. Sh. nga Pogradeci, D. B. nga Devolli dhe S. H. nga Cërriku, etj.

Për të gjitha këto raste ne pasi kemi grumbulluar materialet e nevojshme ja kemi dërguar ato Ombudsmanit të Greqisë për të vazhduar hetimin dhe ndjekjen e tyre. Në të njëjtën kohë atij i kemi kërkuar që të ndërhyjë pranë autoriteteve shtetërore e policore greke për të frenuar ndjenjat ksenofobe dhe raciste ndaj shqiptarëve të ushqyera nga disa qarqe në Greqi.

Veprimet e mësipërme të Policisë Greke ndaj shtetasve shqiptarë bien ndesh me Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, Konventën Kundër Torturës dhe çdo trajtimi ose ndëshkimi mizor, jo njërëzor, ose degradues apo dokumentat e tjera ndërkombëtare, duke përfshirë këtu edhe legjislacionit grek. Për rrjedhojë, ne i kemi sugjeruar homologut grek që t'i drejtojë një rekomandim Policisë dhe Ushtrisë Greke, në mënyrë që ata të trajtohen në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Në të njëjtën kohë i kemi sugjeruar bërjen e një rekomandimi edhe autoriteteve greke të drejtësisë, në mënyrë që të jenë objektive në rastet e hetimit dhe proceseve gjyqësore ndaj policëve grekë që keqtrajtojnë dhe vrasin shqiptarët. Ne i kemi theksuar se e konsiderojmë jetën dhe dinjitetin e shqiptarëve të njëjtë me jetën dhe dinjitetin e çdo qytetari grek ose europian.

Për mbrojtjen e të drejtave të shtetasve shqiptarë nga veprimet e kundraligjshme të policive të vendeve fqinjë, ne në mënyrë të vazhdueshme i kemi dërguar informacione autoriteteve më të larta europiane e ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave të njeriut siç mund të përmëndim: Komisionerit të të Drejtave të Njeriut pranë Këshillit të Europës, zotit Alvaro Gil-Robles; Përfaqësuesit të Komitetit Kundër Torturës pranë Këshillit të Europës zotit Fabrice Kellens; Përfaqësueses së

Amnesty International, zonjës Melanie Anderson, etj. Për veç informimit të bërë, atyre i kemi kërkuar ndërkohë që të ushtrojnë autoritetin e tyre ndaj qeverive të vendeve që shkelin të drejtat e njeriut dhe konkretisht të shtetasve shqiptar, me qëllim që raste të tilla të mos përsëriten në të ardhmen.

VII. Rekomandime për parandalimin e torturës dhe formave të tjera të keqtrajtimit dhe shkeljeve të ligjit nga policia

Në raportin e vitit 2002 kemi bërë disa rekomandime, për të cilat gjykuan se respektimi i tyre do të sillte parandalimin e torturës dhe formave të tjera të keqtrajtimit dhe të shkeljeve të ligjit nga policia. Megjithëse ato ja dërguam Ministrisë së Rendit Publik, konstatojmë se edhe pas kësaj kohe relativisht të gjatë, pjesa më e madhe e tyre nuk janë zbatuar. Kështu p.sh. mund të përmëdim:

1. Nuk janë marrë masat e nevojshme që të sigurohet e drejta e vizitës nga një mjek për personat e privuar nga liria, qysh në fillim të privimit të tyre nga liria. Kjo e drejtë duhet gjithashtu të nënkuptojë të drejtën që këta persona kanë për t'u egzaminuar nëse ata dëshirojnë nga një mjek i zgjedhur prej tyre.

Për realizimin e kësaj gjithashtu duhet që:

- Të gjitha egzaminimet mjekësore të personave të privuar nga liria e tyre prej policisë duhet të jenë larg dëgjimit, dhe vetëm nëse kundërshton mjeku. Për ndonjë rast të veçantë, larg edhe shikimit të punonjësve të policisë kur ata vizitohen nga mjeku.

- Rezultatet e çdo egzaminimi, si dhe çdo deklaratë e bërë nga personi i vizituar, duhet të shënohen nga mjeku dhe të jenë në dispozicion të personit të privuar nga liria dhe të avokatit të tij.

2. Personave të privuar nga liria prej policisë, nuk u dorëzohen formulare ku të pasqyrohen e saktësohen të drejtat e tyre. Këta formulare duhet që të jenë të disponueshëm edhe në gjuhë të huaj. Për më tepër, të interesuarit duhet të ftohen që të firmosin një deklaratë që ata kanë qënë të informuar mbi të drejtat e tyre.

3. Nuk është nxjerë udhëzimi (kod i sjelljes) për marrjen në pyetje nga policia. Ky kod duhet ndër të tjera të trajtojë aspektet e mëposhtme; t'i tregohet sistematikisht të ndaluarit identiteti i personave të pranishëm gjatë marrjes në pyetje (emri dhe/ose matrikuli); kohëzgjatja e lejuar e një seance pyetjesh; periudhat e pushimit ndërmjet këtyre seancave dhe pauzat gjatë marrjes në pyetje; vendi apo vendet ku mund të mbahet një seancë e tillë; nëse do t'i kërkohët të ndaluarit të qëndrojnë në këmbë gjatë marrjes në

pyetje; dhe që ndalohet marrja në pyetje e personave nën ndikimin e drogës, alkoolit, ilaçeve ose nën një gjëndje tronditjeje. Ky kod duhet gjithashtu të parashikojë që të shënohet sistematikisht momenti i fillimit dhe i përfundimit të çdo marrje në pyetje, identitetin e çdo të pranishmi gjatë çdo seance pyetjeje, si dhe çdo kërkesë të formuluar nga i ndaluari gjatë kësaj seance. Situata e personave veçanërisht të pambrojtur (për shëmbull, minorenët, personat e prekur nga sëmundje ose mangësi mendore) duhet të bëhen objekt i garancive specifike.

4. Nuk zbatohen të drejtat e mësipërme edhe për personat e mbajtur nga policia për qëllime administrative. Në disa raste kemi konstatuar se “shoqërimi në polici” përdoret ndaj personave të dyshuar për një veprë penale. Pra shoqërimi përdoret për të sqaruar veprime administrative me qëllim hetimesh për vepra penale dhe mbas kohës së “shoqërimit” bëhen veprime proceduriale të ndalimit ose arrestimit. Po kështu kemi konstatuar disa raste të kryerjes së veprimeve që çojnë në kërkimin dhe mbledhjen e të dhënave në mënyrë të paligjshme, duke shkelur pikën 2 të nenit 32 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Të dhëna të tilla mund të përmëndim ato që janë marrë nën efektin e dhunës fizike.

5. Nuk është nxjerë nga autoritetet policore qarkorja që të sqarohet se koha e mbajtjes së personit, për arsye administrative ose gjyqësore duhet të llogaritet brënda afatit kohor të caktuar për paraqitjen e një personi para një gjyqtari, që, sipas nenit 28 të Kushtetutës, është jo më tepër se 48 orë. Nga verifikimi i disa ankesave ka rezultuar se koha e ndalimit ose arrestimit fillon pas asaj të shoqërimit, që në disa raste edhe ajo ka qënë tej afatit ligjor.

6. Titullarët dhe kuadrot drejtues të Policisë nuk ushtrojnë kontroll të vazhdueshëm në lidhje me librat e rregjistrimit dhe të mbajtjes së personave në ambjentet e policisë, me qëllim që ato të plotësohen saktë e të mos manipulohen për të mbuluar shkeljet e ligjit. Kemi konstatuar disa raste që shënimet në këto rregjistra nuk përputhen me kohën e saktë të qëndrimit të tyre në polici, ndërsa në raste të veçanta ata nuk rregjistrohen.

7. Nuk ka ndryshuar koncepti për personat e shoqëruar në polici, të cilët duhet të mbahen në dhoma shoqërimi dhe jo ndalimi, jo të prangosur ose në dhoma të mbyllura me dryn, siç veprohet në disa raste. Po kështu nuk ka ambjente për të shoqëruarit e mitur dhe femra. Dhomat duhet të jenë me kushte të përshtatshme higjienosantare dhe të pajisura me karrige e tavolina.

8. Nuk janë ndryshuar e përmirësuar kushtet e mbajtjes së të ndaluarëve e të arrestuarve në dhomat e paraburgimit në ambjentet e policisë, me qëllim që:

- të respektohen në mënyrë strikte kriteret e parashikuara lidhur me çështjen e hapësirës minimale për të ndaluarin, si dhe

- të ndahen të rriturit nga minorenët dhe t'i kushtohet këtyre të fundit një vëmëndje e veçantë në planin e shëndetit dhe të edukimit.

9. Nuk u mundësua akoma kalimi i dhomave të paraburgimit dhe i personelit të tyre nga vartësia e Ministrisë së Rendit Publik në atë të Ministrisë së Drejtësisë. Megjithëse këtë vit ky proces filloi me Drejtorinë e Policisë së Qarkut Vlorë, ai nuk mundi të realizohej sipas Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Rendit Publik dhe të Ministrit të Drejtësisë në disa Drejtori e Komisariate Policie. Kjo do të krijonte mundësinë për të vënë efektivisht në jetë të gjitha dispozitat e caktuara në “Rregulloren mbi sigurimin dhe trajtimin e të burgosurve”, të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.96 datë 09.03.2000.

Për veç zbatimit të rekomandimeve të mësipërme, nga organet e Policisë duhet të punohet më shumë për të zbatuar një nga detyrat kryesore institucionale të saj të përcaktuar në nenin 3 të ligjit nr. 8553, dt. 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, atë të mbrojtjes së ushtrimit të lirive dhe të drejtave të personit. Për realizimin e kësaj detyrë është e domosdoshme që:

1. T'i jepet një përparësi më e madhe edukimit dhe formimit profesional në vazhdimësi të punonjësve të policisë të të gjitha roleve dhe gradave. Në këto programe duhet të zërë një vënd të rëndësishem edukimi i tyre me ndjenjën e respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut. Niveli kulturor e profesional, njohja dhe respektimi i të drejtave të njeriut, si dhe aftësia komunikuese të jenë kriteret përcaktuese në rekrutimin, mbajtjen në punë dhe përzgjedhjen në emërimet e ngritje në detyrë të punonjësve të policisë të të gjitha roleve.

2. Duhet që autoritetet politike dhe teknike të niveleve më të larta të dalin herë pas here, më shpesh dhe më fort, me mesazhe të qarta që dënojnë rrepte keqtrajtimet nga policia. Kjo duhet të përsëritet me intervale të rregullta nga drejtuesit në të gjitha shkallët e policisë. Kjo në veçanti t'u theksohet punonjësve të policisë të ngarkuar me marrjen në pyetje të personave të privuar nga liria.

3. Në të gjitha ambientet e policisë të vendosen menjëherë posterat e përgatitura në bashkëpunim me institucionin tonë, të cilat bëjnë fjalë për respektimin e të drejtave të njeriut dhe parandalimin e dhunës nga punonjësit e policisë. Ato do të shërbejnë si një kujtesë e vazhdueshme për punonjësit e policisë dhe do t'i ndihmojë ata në zbatimin me rigorozitet të ligjit.

4. Bashkëpunimi i Ministrinë së Rendit Publik dhe i Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit me Institucionin e Avokatit të Popullit, në kuadër të punës për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, megjithëse ka qënë i mirë, fakt i cili u pasqyrua edhe në raportin e punës për vitin 2003, duhet të rritet e përsoset më tej në të ardhmen.

VIII. Rekomandime dhe propozime në fushën legjislative

Gjatë shqyrtimit të ankesave të ndryshme ne konstatuam se disa akte normative nënligjore ishin nxjerë në kundërshtim me dispozitat kushtetuese dhe shkelnin në mënyrë masive të drejtat e punonjësve të administratës publike dhe në veçanti të punonjësve të Policisë së Shtetit. Kështu p.sh. mund të përmëdim:

1. Rekomandimi drejtuar Ministrisë së Rendit Publik për të zgjatur afatin e pranimit të ankesave të punonjësve të policisë për gradat. Gjatë procesit të inkuadrimit të gradave ushtarake në gradat e Policisë së Shtetit, nga komisionet e gradimeve pati qëndrime dhe vlerësime subjektive. Këtë fakt e konfirmuan ankesat e shumta që u bënë nga punonjësit e policisë të roleve të ndryshme, shumica e të cilave u zgjidhën pozitivisht nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave me kryetar Zv/Ministrinë e Rendit Publik z. Thoma Jano.

Sipas informacionit të marrë nga ky komision me shkresën nr. 215/1 prot., datë 11.12.2003, rezultoi se nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave u morën në shqyrtim 1373 ankesa të punonjësve të policisë të rolit bazë, nga të cilat 1216 u zgjidhën pozitivisht. Ky Komision ka marrë në shqyrtim edhe 649 ankesa të punonjësve të policisë të rolit të mesëm e të lartë, nga të cilat 384 u zgjidhën pozitivisht.

Gjithashtu u informuam se pranë Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave vazhdojnë të vijnë ankesa edhe pse janë me shumë vonesë nga afati i caktuar. Deri ditët e fundit të vitit 2003 kishin ardhur 887 ankesa jashtë afatit, të cilat nuk janë shqyrtuar. Kjo ju heq mundësinë ankuesve që t'i drejtohen gjykatës apo edhe institucionit të Avokatit të Popullit, sepse ne kemi mbajtur qëndrimin se do t'i pranojmë ankesat vetëm pas shqyrtimit të ankimit nga komisioni përkatës.

Nga ndjekja e shqyrtimi i këtij problemi nga ana jonë, arritëm në konkluzionin se shumë punonjës policie nuk bënë ankesa për arsye mosbesimi e frike që u krijua në kohën që u dhanë gradat, si rezultat i qëndrimit të ashpër dhe të kundraligjshëm që u mbajt nga drejtuesit e M.R.Publik ndaj punonjësit të policisë Q. H., i cili guxoi të kritikonte publikisht padrejtësinë e bërë atij në lidhje me gradën.

Vonesa e bërjes së ankimeve ka ardhur gjithashtu edhe për shkak të mosnjohjes nga punonjësit e policisë të akteve normative për gradat dhe konkretisht të të drejtës së ankimit e afatit të tij. Kjo ndodhi për shkak të neglizhencës së treguar nga drejtuesit e policisë në qëndër e në bazë, të cilët nuk jua njohën këto akte normative efektive të tyre.

Duke mbajtur parasysh parregullsitë e konstatuara nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, faktorët e tjerë të përshkruar më sipër, si dhe faktin që e drejta e ankimit dhe afati i tij janë parashikuar në Urdhërin e Ministrit të Rendit Publik nr. 1484, datë 18.06.2001, pika 14 dhe në Urdhër – Shërbimin nr. 1172, datë 04.04.2003, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, pika 8, gjykuam se afati i pranimit të ankimeve mund të shtyhet nga autoritetet përkatëse.

Për të bërë të mundur rivendosjen në vënd të të drejtave së punonjësve të policisë që kanë bërë ankim për gradat jashte afatit, *kur grada konvertohet në para*, i rekomanduam Ministrit të Rendit Publik ndryshimin e Urdhërit të Ministrit të Rendit Publik nr. 1484, datë 18.06.2001, pika 14 dhe Urdhër – Shërbimin nr. 1172, datë 04.04.2003, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, pika 8, duke zgjatuar afatin e pranimit të ankesave të punonjësve të policisë për gradat, deri më 31.12.2004. Gjithashtu rekomanduam shqyrtimin e tyre me përparësi nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, si dhe kthimin e përgjigjeve të ankimit secilit ankues, me qëllim që atyre t’u krijohet mundësia e bërjes së ankimit tek institucioni i Avokatit të Popullit apo në gjykatë. Ministri i Rendit Publik më datë 16.01.2004 na ktheu përgjigje se: “Në lidhje me rekomandimin tuaj, për zgjatjen e afatit të ankimit për gradat dhe shqyrtimin e ankesave të ardhura jashtë afatit kohor, po shikohet mundësia e marrjes së masave për përgatitjen dhe hartimin e akteve normative, të cilat do të bëjnë të mundur zgjatjen e afatit të rishikimit dhe shqyrtimin e të gjitha ankesave të ardhura tej afatit kohor”.

2. Rekomandimi drejtuar Ministrit të Rendit Publik për përmirësimin e Urdhërit nr. 1661, dt. 08.04.2002 “Për komunikimin me mediat”. Gjatë shqyrtimit të ankesës së ish punonjësit të Policisë së Shtetit, Q. H., efektiv i Komisarariatit të Policisë Nr. 3 Tiranë, i cili i përjashtua nga policia për shkelje të Urdhërit të Ministrit të Rendit Publik “Për komunikimin me mediat”, konstatuam se:

Urdhëri i Ministrit të Rendit Publik nr. 1661, dt. 08.04.2002, ishte bërë shkak për shkeljen e të drejtave të punonjësve të policisë për arësye se:

a- Ai kufizonte një nga liritë themelore të njeriut të garantuar nga neni 22, pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se:

“Liria e shprehjes është e garantuar”. Çdo person ka të drejtë në çdo kohë të shfaqë e të shprehë mendimin e tij të lirë për çështje që çënojnë jo vetëm interesat e tij, por edhe ato publike. Në rastin konkret ankuesi kishte bërë publike një ankesë që nuk kishte lidhje me probleme të detyrës së tij si polic, por çështje që lidhen me statusin dhe pagën e tij.

b- Akti administrativ i mësipërm, i cili kufizon lirinë themelore të shprehjes, është nxjerrë në kapërcim të kompetencave ligjore të Ministrit, sepse në bazë të nenit 17 të Kushtetutës, *“Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj* për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjestim me gjëndjen që e ka diktuar atë. Këto kufizime nuk mund të çënojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut”.

c- Përmbajtja e urdhërit nr.1661, dt. 08.04.2002 nuk përputhet me bazën ligjore në të cilën ai është mbështetur si dhe në qëllimin për të cilin është nxjerrë *“në interes të rritjes së transparencës të M.R.Publik me median dhe me publikun”*, sepse: *Së pari*, në asnjë dispozitë të akteve normative në të cilat është mbështetur urdhëri, nuk kufizohet e drejta e punonjësve të policisë të komunikojnë me mediat dhe për problemet (ankesat) personale dhe *së dyti*, ky urdhër nuk i shërben rritjes së transparencës së M.R.Publik me median dhe me publikun, por të kundërtës.

Për të rivendosur në vend të drejtën kushtetuese të shprehjes, i propozuam Ministrit të Rendit Publik të përmirësonte (ndryshonte) Urdhërin nr. 1661, dt. 08.04.2002 “Për komunikimin me mediat”, me qëllim që dispozitat e tij të mos çënojnë liritë dhe të drejtat themelore të njeriut. Akoma nuk kemi përgjigje zyrtare, por pas revokimit të Urdhërit me të njëjtin objekt të Kryeministrit, pranimi i rekomandimit tonë është vetëm një akt formal, sepse Urdhëri i Ministrit tashmë është një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm.

3. Propozimi drejtuar Qeverisë dhe Ministrit të Rendit Publik, për të përmirësuar V.K.M. nr. 552, datë 27.11.1999, *“Për trajtimin ekonomik e financiar të familjarëve të punonjësve të policisë të vrarë e plagosur për shkak të detyrës”*. Qëllimi i këtij rekomandimi ishte që V.K.M të shtrinte fuqinë vepruese edhe para vitit 1999 dhe prej tij të përfitojnë edhe punonjësit e policisë të vrarë apo plagosur gjatë viteve 1991-1998. Për këtë problem para një viti ne kemi bërë rekomandimet përkatëse, të cilat i kemi pasqyruar edhe në raportin vjetor të vitit 2002. Fillimisht pati një reagim pozitiv nga Qeveria, e cila i kërkoi M.R.Publik që të studionte problemin dhe të bënte propozimin përkatës. Mbi këtë bazë M.R.Publik përgatiti

propozimin për përmirësimin e V.K.M dhe nga ish ministri Rama u premtua në Parlament se nga Qeveria do të përmirësohej së shpejti Vendimi. Por veç premtimit problemi nuk pati ndonjë avancim e konkretizim të tij, megjithëse ne kemi qënë në ndjekje të vazhdueshme të tij. Meqënëse Qeveria për vitin 2004 e ka shtuar buxhetin e M.R.Publik dhe të Policisë edhe 10 % më shumë se në vitin 2003, shpresojmë që ky problem të gjejë zgjidhje përfundimtare këtë vit.

6. Ministria e Mbrojtjes

Për vitin 2003 ndaj strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes janë bërë 106 kërkesa e ankesa dhe prej tyre janë përfunduar 93. Duke shtuar dhe 48 ankesa të mbartura nga viti 2002, për vitin 2003 janë përfunduar gjithsej 141 ankesa. Janë në shqyrtim për vitin 2004, 13 ankesa.

Nga ankesat e përfunduara gjatë vitit 2003, rezulton se 45 ankesa ose 32.4 përqind e tyre kanë gjetur zgjidhje pozitive. Ky është një tregues mjaft i kënaqëshëm që tregon efikasitetin e punës sonë si dhe bashkëpunimin e frytshëm me Ministrinë e Mbrojtjes. Ndërsa 53 ankesa ose 37.3 përqind kanë qënë jashtë kompetencës tonë dhe 43 ose 31.3 përqind kanë qënë ankesa të pabazuara.

Duke analizuar në tërësinë e tyre ankesat e ardhura në Institucionin tonë për periudhën e vitit 2003 konstatohet se ato janë bërë kryesisht nga oficerë, më pak nënoficerë, nga punonjës civilë dhe nuk ka asnjë kërkesë apo ankesë nga ushtarë të reparteve ose nënreparteve. Pavarësisht nga sa sipër nga ana e jonë u ndërmor një takim me ushtarë të distriktit detar të Vlorës. Në përfundim rezultoi se ushtarët nuk kishin ankesa të tilla që të përbëjnë dhe objektin e veprimtarisë së punës të Avokatit të Popullit.

Duke shqyrtuar shifrat e mësipërme mund të pohojmë se puna me ankesat që lidhen me Ministrinë e Mbrojtjes ka qënë e suksesshme. Por këtë konkluzion nuk e nxjerrim vetëm nga shifrat. Është kënaqësi të raportojmë se Ministria e Mbrojtjes është një nga dikasteret e Administratës sonë Publike ku ne gjithmonë, qysh në fillim të veprimtarisë sonë në vitin 2000 kemi gjetur partnerë të gatshëm për të bashkëpunuar në mënyrë institucionale, me qëllimin e mirë dhe të vetëm për zgjidhjen e drejtë të problemeve dhe shqetësimeve të ushtarakëve.

Bashkëpunimi i mirë me Ministrinë e Mbrojtjes është realizuar në kontaktet direkte me drejtues dhe specialistë të Drejtorive përkatëse, të ngarkuara për problemet dhe shqetësimet e ankesave të ushtarakëve si, me Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Departamentin e

Veteranëve, me Drejtorine Juridike etj, duke rritur në këtë mënyrë dhe përgjegjësinë e të gjitha strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes, për të trajtuar më me kujdes problemet dhe për të respektuar të drejtat e ligjshme të ushtarakëve.

Ky mirëkuptim dhe bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes shikohet nga ana e jonë si arritje e suksesshme në realizimin e objektivave tona në mbrojtje të të drejtave të ligjshme të njeriut, duke synuar që këtë eksperiencë të mirë ta shtrijmë edhe me dikastere të tjera. Ai ka konsistuar dhe në mirëpritjen, vlerësimin e pranimin e Rekomandimeve të bëra nga Avokati i Popullit

Pas shqyrtimit të problemeve kryesore të cilat na janë bërë prezent nëpërmjet ankesave të subjekteve ushtarake del përsëri në pah që, ankesat e ushtarakëve apo ish ushtarakëve që ndërpresin karrierën, apo e kanë ndërprerë atë kohë më parë në kuadrin e reformës në Forcat e Armatosura qysh nga viti 1992 e në vazhdim, zenë një vënd të konsiderueshëm.

Këta persona ankohen se, jo vetëm që masa e pensionit të tyre është më e ulët se pensioni i kolegevë të tyre që kanë dalë në pension pas vitit 1993, edhe pse kanë qënë të barazvlefshëm në detyrë, por dhe për mosnjohjen e pagës shtesë mbi pensionin e pleqërisë për vitet e shërbimit në ushtri në një kohë kur ushtarakët e dalë në pension pas vitit 1993 e përfitojnë këtë të drejtë ligjore.

Kërkesa apo ankesa të kësaj natyre kanë paraqitur jo vetëm individë të caktuar, por edhe Komiteti Kombëtar i Veteranëve të LANÇ-it, apo shoqata e grupime të tjera ish ushtarakësh.

Duke i konsideruar të drejta këto ankesa, Avokati i Popullit më datën 29.11.2003 i ka drejtuar Kryeministrin z. Fatos Nano, Rekomandimin në lidhje me shqyrtimin dhe kalimin në Kuvend të projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 8087, datë 13.03.1996”, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, Ministrisë së Rendit Publik dhe Shërbimit Informativ Kombëtar në Republikën e Shqipërisë”. Ky projekt ligj është ngrirë në Këshillin e Ministrave për mungesë fondesh.

Është për t’u përmëndur fakti se, pak nga këta subjekte kundërshtojnë daljen në rezervë pasi, për një gjë të tillë, në përkrahje të reformave në Forcat e Armatosura, ata janë ndërgjegjësuar. Por ankesat e tyre kanë të bëjnë me mospërfitimet e të drejtave që ju siguron atyre ligji nr. 8087 datë 13.03.1996 dhe ndryshimet përkatëse të mëvonshme të këtij ligji. Jo gjithmonë nga strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe disa komanda ushtarake është vepruar me korrektesë, drejt dhe në kohë, në

mënyrë që këta ushtarakë, pas ndërprerjes së karrierës, të përfitojnë atë ç'ka ju takon me ligj.

Nga përgjithësimi i këtyre rasteve, ne kemi arritur në konkluzionin se gjatë zbatimit të reformës, në mënyrën se si është vepruar ka patur shkelje të të drejtave të tyre. Ankesat e tyre janë bërë prezent tek ne gjatë vitit 2003 dhe kanë përbërë një pjesë të rëndësishme të punës sonë.

Konkretisht, pas hetimit tonë për këto ankesa doli se, Ministria e Mbrojtjes pas përcaktimit të kriterëve të reformës si mosha, profesionalizmi dhe përkushtimi në detyrë, ka filluar në vazhdimësi procedurat e ndërprerjes së marrëdhënieve të karrierës së oficerëve aktivë të planifikuar për t'u larguar.

Por këto procedura, nuk u kryen gjithmonë konform ligjit dhe akteve nënligjore, por u veprua në mënyrë të tillë, që solli hapur shkeljen e të drejtave e tyre, sepse ushtarakët e sipërpërmëndur u lanë "ushtarakë aktivë" por pagesë e në dispozicion për muaj të tërë.

Për ta rregulluar këtë situatë Këshilli i Ministrave nxorri vendimin nr.590 datë 28.08.2003 "Për rritjen e pagesës kalimtare të ushtarakëve", duke u zgjidhur kështu ankesat e z. Sh. B. nga Elbasani, F.L. nga Fieri, Th. T. nga Tirana, Z. K. nga Puka, P.Gj. nga Rrësheni etj.

Ndonëse për vitin 2003, në Institucionin tonë nuk ka patur ankesa nga ushtarakët në lidhje me mosprivatizimin e objekteve të dhëna nga Ministria e Mbrojtjes për strehimin e tyre, nga ana e jonë është ndjekur në vazhdimësi realizimi i projekt vendimit që do t'i paraqitet Këshillit të Ministrave, lidhur me ndryshimet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 379 datë 26.06.1995 që bën fjalë "Për kthimin në banesa të objekteve që mbeten të lira nga ristrukturimi i ushtrisë dhe Ministrisë së Rendit Publik". Ka qënë rekomandimi i ynë drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes për domosdoshmërinë e disa ndryshimeve të vendimit të mësipërm, me qëllim lehtësimin e procedurave të privatizimit të objekteve në fjalë, duke mos parashikuar nevojën e marrjes më parë të vendimit të bashkive për kthimin e tyre në fond banese, siç është vepruar në praktikë. Me kënaqësi mund të shprehemi se Ministria e Mbrojtjes jo vetëm që pranoi rekomandimin tonë, por përgatiti me kujdes projektvendimin përkatës me ndryshimet e nevojshme të cilin brënda muajit shkurt 2004 do ta dërgojë për miratim në Këshillin e Ministrave.

Veç problemeve të sipërpërmëndura, për vitin 2003 në Institucionin tonë oficerë të ndryshëm kanë paraqitur ankesa të tjera të cilat në mënyrë të grupuar paraqiten si më poshtë:

-Për nxjerrjen në lirim apo largime të padrejta nga puna.

Mund të përmendet ankesa e Y.D. nga Durrësi, ish gjeneral deri në vitin 1997. Ai është ankuar jo vetëm për lirimin e tij të padrejtë nga ushtria, por dhe degradim të pabazuar. Për këtë ankesë u zhvillua dhe një hetim, në përfundim të së cilit ka rezultuar se ankesa e tij është e drejtë jo vetëm për faktin se nuk ka prova që ai të kishte thyer ligjet apo rregulloret ushtarake, por edhe sepse ndonëse në korrik 1997 me kërkesë të tij ka dalë në lirim me dekret të Presidentit, duke ju lënë grada gjeneral, në shtator 1998 me një dekret të dytë presidencial i është hequr edhe grada e gjeneralit. Për rrjedhojë është negociuar dhe do t'i rekomandohet Ministrit të Mbrojtjes marrja e masave për të vënë në vënd të drejtën e shkelur, për të propozuar një projektligj (status) për përfitime të veçanta për ankuesin dhe disa ish Oficerë madhorë të tjerë të cilët kanë të njëjtat ankesa.

- Ankesa e P.Y. nga Tirana, me gradën major dhe detyrë ish pedagog në Akademinë Ushtarake “Skënderbej” për daljen në rezervë dhe largim nga puna në mënyrë të padrejtë. Është premtuar zgjidhja e drejtë e ankesës, me qëllim sistemimin e tij në punë në një funksion civil në Komandën e Doktrinave dhe Stërviçjes, me riorganizimin e strukturës administrative të asaj Akademie.

- Kërkesa për përfitim të pensionit suplementar për kategorinë e ish ushtarakëve të dalë në rezervë dhe të dënuar politikë, nga disa antarë të Shoqatës Kombëtare të Ushtarakëve të dalë në rezervë.

- Ushtarakë të cilët kanë kryer detyrën e inspektorëve pranë MCR, vend i cili u suprimua duke kaluar në varësi të Ministrisë të Decentralizimit dhe Pushtetit Lokal.

- Ushtarakë të cilët kanë nevoja urgjente për strehim, siç janë rastet e oficerëve z. R. Laska nga Berati, apo z. Fredi Shema nga Saranda.

- Ankesa të punonjësve civilë, të cilët janë larguar nga puna për arsye të reformës, ose kur objekti i punës ka kaluar në varësinë e një Ministrie tjetër, kryesisht në Ministrinë e Pushtetit Lokal; Ankesat e ish punonjësve të Tipografisë Ushtarake; ankesa e një grupi punonjës civilë të shtëpisë së ushtarakëve Korçë, apo të spitalit ushtarak në Tiranë.

Ministria e Mbrojtjes për të minimizuar pasojat sociale dhe ekonomike që vijnë nga dalja e papunë e këtyre punonjësve, ka paraqitur projektligjet apo projektvendimet përkatëse. Mbi këtë bazë Qeveria ka nxjerrë Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 678, datë 16.10.2003 “Për trajtimin e punonjësve që dalin të papunë nga reforma në Spitalin Ushtarak Qëndror Universitar”.

Gjithashtu Ministria e Mbrojtjes ka paraqitur në Komisionet Parlamentare dhe projektligjin “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarje të industrisë ushtarake”.

Nga ana tjetër vlen për t'u theksuar fakti se, nga numri i përgjithshëm i ankesave të ardhura për vitin 2003, rreth 42 përqind janë për statusin e veteranit të luftës.

Kështu për vitin 2003 veteranët kanë bërë 48 ankesa, nga të cilat 20 ankesa janë zgjidhur në favor, 16 ankesa jashte kompetence 8 ankesa të pabazuara dhe 4 ankesë në shqyrtim. Objekti i ankesave të paraqitura ka qënë për përfitimin e statusit të veteranit ose 2 ankesa për statusin e dëshmorit, apo dhe për përfitime shtesë që rrjedhin nga Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.190 datë 03.05.1995, për veteranë të cilët gjatë luftës kanë qënë në burgjet nazifashiste brënda apo jashtë vëndit.

Qysh në fillim konstatojmë se Ministria e Mbrojtjes ka bërë vlerësimin e veteranëve duke paraqitur projektligjet e nevojshme pranë Këshillit të Ministrave dhe Qeveria nga ana e saj ka nxjerrë Vendimet respektive si:

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 217 datë 10.04.2003 “Për rritjen e masës së shpërblimit të veteranëve të LANÇ-it të popullit shqiptar”.

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 393 datë 12.06.2003 “Për një shtesë në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 151 datë 25.04.2001 “Për Statusin e Dëshmorit të Atdheut”.

Nga shqyrtimi i disa ankesave për këtë kategori personash,(veteranët e luftës) doli se dokumentat e paraqitura prej tyre pranë Komisionit Qëndror të Statusit të Veteranit, janë paraqitur jashtë afatit ose paraqitja e dokumentave me vonesë është bërë mbi bazën e një vendimi të gjykatës për rivendosjen e afatit.

Në këto rrethana për ta zgjidhur këtë situatë u bashkëpunua dhe me Departamentin e Veteranëve në Ministrinë e Mbrojtjes ku gjetëm mirëkuptim dhe predispozicionin e duhur. Nga bashkëpunimi rezultoi se pranë atij Departamenti, numri i veteranëve që kishin paraqitur ankesa ishte dhe më i madh se sa i janë drejtuar Institucionit tonë. Konkretisht janë 208 persona në shkallë vendi; nga Tirana janë 67 persona, Kolonja 24, Shkodra 21, Vlora 14, Kavaja 6, Mati 11, Korça 6, Gjirokastra 10 persona dhe Durrësi 25 persona.

Personat e mësipërm i kishin paraqitur dokumentat e mësipërm jashte afatit të përcaktuar nga Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 29 datë 28.01.2002 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 190, datë 03.05.1995 të Këshillit të Ministrave “Për zbatimin e ligjit nr. 7874, datë 17.11 1994 “Për statusin e veteranit të luftës antifashiste nacionalçlirimtare të popullit shqiptar” pra, pas datës 30 Korrik 2002.

Me qëllimin e mirë për të vënë në vënd të drejtën e kësaj kategorie personash të cilët janë me moshë mbi 70 vjeç, me kushte jetese e mundësi të pakta financiare për të përballuar jetesën, dhe për t'ju dhënë një satisfaksion moral dhe material Avokati i Popullit i rekomandoi Ministrin të Mbrojtjes, ndërmarjen e inisiativës për hartimin e projektvendimit të Qeverisë, për caktimin e një afati të ri për paraqitjen e dokumentave pranë Komisionit Qëndror të Statusit të Veteranit të Luftës. Rekomandimi është në shqyrtim dhe ende nuk ka ardhur përgjigje zyrtare pranë Institucionit tonë.

Si konkluzion, e gjithë kjo pjesë e punës sonë me këto subjekte ka shërbyer mjaft pozitivisht për realizimin e objektivit kryesor të punës së Institucionit tonë, për të mbrojtur të drejtat e njeriut, duke ndikuar në këtë mënyrë në mirëadministrimin e pushtetit dhe mirëqeverisjen edhe në Forcat e Armatosura.

Në prioritetet e punës së Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2004, do të jenë organizimi i ditëve të hapura me grup ekspertësh në reparte të ndryshme që lidhen me Komandat e Forcave Tokësore, Ajrore dhe Detare, me qëllim tërheqjen e ankesave dhe nga nënoficerë dhe ushtarë të Forcave të Armatosura, bashkëpunimi më i ngushtë me drejtoritë e ndryshme në Ministrinë e Mbrojtjes dhe strukturat e tjera ushtarake për zbatimin korrekt të ligjit dhe zgjidhjen e drejtë të ankesave të ushtarakëve.

7. Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit

Për vitin 2003 Institucioni ynë ka ndjekur 36 ankesa me këtë Ministri, nga të cilat 14 prej tyre janë mbartur nga viti 2002. Nga ky numër ankesash, 25 prej tyre kanë përfunduar dhe 11 ankesa janë ende në shqyrtim e sipër. Nga 25 ankesat që kanë përfunduar, 7 prej tyre janë jashtë juridiksionit, 6 ankesa janë të pa bazuara, 9 janë zgjidhur në favor të ankuesve dhe 3 ankesa kanë përfunduar me orientime juridike, nepermjet të cilave ankuesit kanë gjetur rrugën e zgjidhjes së problemit. Gjithashtu gjatë këtij viti janë trajtuar dhe ankesa që cilat lidhen me shërbimin e Zyrave të Gjendjes Civile, shërbim i cili aktualisht është në varesi të këtij Dikasteri.

Problematika e ankesave ka qënë kryesisht mos përfitimi i ndihmës nga shteti në raste fatkeqësish që kanë ndodhur nga forcat madhore, si zjarre, shpërthime eksplozivi apo nga përmbytjet, shembje banesash nga rrëshqitjet e tokave, dëmet e shkaktuara nga tërmeti etj. Edhe për këtë vit problemet janë po ato që janë bërë prezent edhe në Raportet e mëparshme, sidomos për moszgjidhjen e ankesave për mungesën e fondeve buxhetore.

Në Drejtorinë e Emergjencave të kësaj Ministrie janë evidentuar edhe shumë ankesa të tjera, të bëra direkt nga shtetasit me të njëjtin objekt, por që nuk janë zgjidhur po për mungesë fondesh, të cilat duhet të jepen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

Pra ankuesit kërkojnë zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.206 date 26.03.1998 “Për kriteret e pjesëmarrjes se shtetit ne perballimin e demeve ne raste fatkeqesish” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.708 datë 21.12.2000 “Per disa ndryshime ne Vendimin Nr.206 date 26.03.1998 te Keshillit te Ministrave, “Per kriteret e pjesëmarrjes se shtetit ne perballimin e demeve, ne raste fatkeqesish””. Për këto ankesa përgjigjet janë standarte se me sigurimin e fondeve, do të zgjidhen edhe shqetësimet e qytetareve. Por kjo ka sjellë vetëm mbartjen e tyre nga viti ne vit. Nga shqyrtimi i ankesave ka rezultuar se kerkimet e shtetasve janë të drejta dhe burojnë nga vetë aktet ligjore dhe nënligjore, por zgjidhja e tyre në favor të ankuesve paraqitet e pamundur për pamundësi financiare të mbulimit nga buxheti i shtetit.

Për ankesat me objekt përfitimin e ndihmës nga shteti për dëmtime, jemi informuar nga Ministria e Pushtetit Vendor se që nga viti 1998 e më parë janë paraqitur shumë kërkesa, te cilat sipas dokumentacioneve te paraqitura duhet te perfitojne ndihme nga shteti. Këtij numri tashmë i janë shtuar dhe shumë raste të tjera, të cilat kanë ndodhur në vijimësi në vitin 2002-2003, sidomos nga përmbytjet e fundit që ndodhën në zonat veriore dhe jugore të vendit, dëmtimet e shtëpive muzeale të qytetit të Gjirokastrës, apo banesa tejet të amortizuara, por me vlera historike të cilat nga mungesa e trajtimit me fonde të veçanta rrezikojnë shembjen dhe humbjen e vlerave kulturore. Jemi informuar se per kete qytet muzeal Qeveria ka akorduar per vitin ne vijim me shume fonde, te cilat do te bejne te mundur restaurimin e vlerave kulturore te ketij qyteti.

Duke qënë se fondet për ndihmë jepen nga fondi rezerve i Këshillit të Ministrave, me vendime të veçanta të qeverisë dhe shteti mund të japë ndihmë financiare të pjesëshme apo të plotë, sipas pikës 1 të VKM-së Nr.206 datë 26.03.1998, është e nevojshme që duke njohur detyrimet e mbartura në vite për këto raste, të mund të parashikohen edhe mënyrat e zgjidhjeve hap pas hapi që në projekt buxhetin që miratohet çdo fillim viti. Edhe ndjekja jonë institucionale pranë këtij Dikasteri, ka synuar pikërisht në sensibilizimin dhe nxitjen e nismave për hartimin e planeve strategjike të sigurimit të fondeve.

Sidoqoftë ne mendojmë se strukturat përkatëse të kësaj Ministrie në bashkëpunim me organet e pushtetit vendor nuk duhet të qëndrojnë pasive vetëm duke grumbulluar ankesat. Ato për çdo rast të njoftojnë ankuesit, por

edhe të ndjekin se çfare mënyre tjetër mund të kete apo ka përdorur ankuesi për të zgjidhur problemin e tij, i cili natyrisht nuk mund të qëndrojë në pritje për disa vjet.

Është vërejtur gjatë shqyrtimit të ankesave se ka zvarritje procedurash administrative dhe ky fakt është evident në të gjitha strukturat. Këto zvarritje vijnë për shkaqe neglizhence, por edhe mos njohje të ligjit dhe të afateve që përcaktojnë procedurat administrative.

Me hyrjen ne fuqi te ligjit te ri qe rregullon veprimtarine e Sherbimit te Gjendjeve Civile u arrit qe shume problematika te grumbulluara ne vite te kishin nje rrugezgjidhje ligjore.

Nje nga problemet qe u ndoq me prioritet nga ana e Institucionit te Avokatit te Popullit ishte ai qe mori shkas nga nje ankese për Zyren e Gjëndjes Civile te rrethit Kavajë, ku rezultonte se në regjistrat e saj ekzistonin ende të gjallë persona të cilët dihej që kishin vdekur. Doli se te tilla kishte edhe ne rrethe te tjera si p.sh Elbasan, por ishte paradoksale qe ky fakt njihej dhe vërtetohej dhe nga vetë nëpunësit e Zyrave të Gjëndjes Civile.

Prandaj nga ana e Institucionit te Avokatit te Popullit u përpilua nje Rekomandim i dyte ne lidhje me zbatimin e nenit 51 te ligjit te ri, me ane te te cilit ngarkohen Zyrat e Gjendjes Civile te ndiqnin procedurat gjyqesore per te bere te mundur ç’regjistrimin e personave de fakto te vdekur, por de jure te gjalle. Them i rekomandim i dyte, pasi rekomandimi yne i pare i datës 11.09.2002, u pranua duke bere te mundur pikerisht futjen ne ligj te ketij neni. Por neni 51, i Ligjit nr 8950 datë 10.10.2002 "Për Gjëndjen Civile" njihej, por nuk po zbatohet nga nëpunësit e Zyrave të Gjëndjes Civile. Në këto kushte, duke e parë problemin për shkak se ishim edhe para zgjedhjeve vendore te Tetorit 2003, si mjaft të rëndësishëm dhe realitetin si gjëndje që duhej rregulluar sa më shpejt, ju sugjerua Ministrit te Pushtetit Vendor marja e masave për zbatimin e ligjit; së pari, njohjen e tij nga nëpunësit e Zyrave te Gjëndjes Civile dhe se dyti, hartimi i Udhëzimeve per te bere te mundur qe në rrugë administrative, keto Zyra të ngrejne padi në gjykatat përkatëse, për të bërë të mundur kështu, ç’regjistrimin nga regjistrat e gjëndjes civile në të gjithë vendin të të gjithë personave të vdekur, por të cilet figurojne ende te gjallë. Përveç faktoreve të tjerë, ne kete rekomandim u evidentua fakti i kontestimit të vazhdueshëm që ju ishte bërë listave të zgjedhësve gjatë gjithë zgjedhjeve të realizuara në 12 vitet e fundit, si dhe shmangte problematikën në fushën e përfitimit të sigurimeve shoqërore nga të tretë që mund të abuzojnë me këto raste. Ky rekomandim u pranua dhe nga ana e Ministrit Blushi i cili kerkoi bashkepunimin tone. Mendoj se sfida e vitit 2004 per Ministrine e Pushtetit

Vendor dhe Decentralizimit eshte kompjuterizimi i Zyrave te Gjendjes Civile dhe pajisja e te gjithë shtetasve shqiptare me kartat e identitetit.

Nje tjetër fenomen qe eshte pasqyruar ne ankesat e depozituara prane zyrave tona ka qene ajo e nderhyrjes te disa kryetareve te bashkive kundrejt Zyrave te Gjendjeve Civile qe jane te atashuara prane bashkive, por qe ligjerisht nuk kane varesi juridike nga kryetaret e bashkive. Shembull negativ eshte rasti i ish kryetarit te Bashkise Sukth i cili ne shkelje te nenit 38 te Kushtetutes si dhe paragrafit 1, te nenit 12 te ligjit Nr.8950 date 10.10.2002 "Per Gjendjen Civile" pa drejtesisht pengonte regjistrimin e shtetasit S. B. dhe te familjes se tij ne regjistrat e Zyres se Gjendjes Civile Sukth, nisur nga arsye politike, pasi shtetasi S.B ishte anetar i Partise Demokratike, dhe duke e moslejuar te regjistrohej e shmangte si kandidature te mundeshme per kreun e bashkise. Me nderhyrjen Institucionale te Avokatit te Popullit u arrit qe kjo çeshtje te zgjidhej pozitivisht.

Ankesat për organet e pushtetit vendor (Komunat, Bashkitë, dhe Prefekturat)

Gjatë vitit 2003 kemi patur 287 ankesa, problematika e të cilave lidhet me subjektet e mësipërme.

a. Ankesa për komunat

Nga 61 ankesa që kemi shqyrtuar me Komunat, 21 prej tyre janë të mbartuara nga viti 2002. Nga keto, 18 çeshtje jane ende ne shqyrtim dhe 43 jane perfunduar, nga te cilat 10 jane ne favor 20 jashte juridiksionit dhe 13 konsiderohen ankesa te pa bazuara. Kryesisht problematika është e njëjtë, sikurse për ankesat që janë ndjekur pranë Prefekturave. Duke qenë se qeverisja e tyre realizohet në komunitete, në të cilat infrastruktura ende nuk është në standartet e kërkuara, edhe ankesat që shfaqen janë nga më të ndryshmet, që nga konfliktet pronësore në ndarjen e tokës bujqësore dhe deri tek ankesat për mos përfitimin e ndihmave si familje me probleme, mos përfitimin e përkrahjes sociale, si dhe shume ankesa të cilat lidhen me ligjin për të drejtën e informimit. Nga mos njohja e ligjit komunat jo vetëm që nuk shqyrtojnë dhe zgjidhin probleme, por nuk kthejnë as përgjigje ankuesve për sa kërkojnë, duke i sorollatur nëpër dyer të administratës së tyre vendore për shumë kohë. Detyrimet që rrjedhin nga ky ligj ose nuk njihen ose nuk zbatohen e zvarriten për shkaqe të pajustificuara. Kodi i Procedurës Administrative është një ligj pak i njohur, kështu dhe detyrimet që burojnë nga ligji për këto organe nuk zbatohen gjatë procedimeve administrative. Është vënë re se aktet administrative apo shkallët e ankimit

administrativ, nuk njihen ose ndërmerren veprime nga kryetarët e komunave që kapërcejnë kompetencat e tyre. Gjithashtu është verejtur nga shqyrtimi i ankesave se të drejtat e të punësuarve pranë Komunave nuk njihen dhe niveli profesional i veprimtarisë administrative që ushtrojnë drejtuesit le për të dëshiruar. Kështu nga mosnjohja e akteve juridike që rregullojnë marrëdhëniet e punës, largimet nga puna bëhen në mënyre abuzive. Veç kesaj pas zgjedhjeve vendore të 12 Tetorit 2003, pritet të ketë edhe largime nga puna me motiv politik.

Gjatë shqyrtimit të ankesave me Komunat, shfaqen zvarritje dhe neglizhenca në trajtimin e problemeve, të cilat reflektohen në mos kthimin e përgjigjeve Institucionit tone, por edhe në mos informimin e ankuesve. Kryetarët e Komunave në veprimet dhe mosveprimet e tyre e konsiderojnë vehten të mbrojtur për faktin se janë të mandatuar politikisht me afat të përcaktuar nga ligji dhe shpesh bëhen burim konfliktesh, pikërisht nga moszbatimi i ligjit, nga mos njohja apo dhe shpërdorimi i postit për përfitime të ngushta personale. Kjo edhe për shkak se viti 2003 ka qenë viti i perfundimit të mandatit të tyre.

Nga gama e gjerë e ankesave me Komunat janë verejtur edhe probleme që lidhen me mosekzekutimin e vendimeve të Komisioneve të Kthimit të Pronave, duke shkelur kështu parimin kushtetues për mbrojtjen dhe garantimin e pronës private, si dhe mos ekzekutim vendimesh të Këshillave të Komunave për shume probleme që shqetesojnë Komunitetin, sidomos në zonat rurale. Në shume raste verëhen mosveprime nga ana e këtyre Këshillave, megjithatë brenda juridiksionit dhe kompetencave të tyre të përcaktuara në ligjin Nr.8652 datë 31.07.2000 "Për Organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore" ato mund të shprehën me vendimmarrje.

Rastin që kemi paraqitur në Raportin e vitit 2002 për mosekzekutimin e një vendimi gjyqësor, lidhur me 26 familjet e fshatit Libonik të Korçës, të cilët ankohen për moszbatim të një vendimi gjyqësor të vitit 1994, i cili i njeh të drejtën këtyre banorëve për likuidimin e një detyrimi monetar, detyrim i cili duhet të përmbushet nga Këshilli i Qarkut Korçë rezulton ende i pazgjidhur, duke injoruar kështu detyrimin kushtetues për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimeve gjyqësore nga të gjitha organet e shtetit shqiptar.

b. Ankesat për bashkitë

Gjatë vitit 2003 në Institucionin e Avokatit të Popullit kanë mbërritur edhe 143 ankesa kundrejt Bashkive. Gjithashtu kemi shqyrtuar edhe 59 ankesa të mbartura nga viti 2002. Nga këto janë perfunduar 126 dhe janë

ende ne shqyrtim 76 ankesa. Nga totali i ankesave te perfunduara kane rezultuar 25 ankesa ne favor te ankuesve, 70 prej tyre jashte juridiksionit dhe 31 ankesa te pa bazuara. Problematika e çështjeve është po ajo e prezantuar edhe në Raportin e vitit te meparshem, sepse shumica e këtyre ankesave kane ne objektin e tyre strehimin dhe lidhur me kete ende nuk ka asnjë strategji që të zgjidhë problemin. Kështu evidente janë ankesat e të pastreheve nga rënia e skemave piramidale, por edhe kategorite e tjera te te pastreheve të cilët për mungesë transparence asnjëherë nuk janë informuar se çfarë është arritur dhe praktikisht kur mund të zgjidhet problemi. Edhe për këtë vit nuk është zgjidhur ankesa e kontigjentit të të pastreheve ne Tirane, Durres etj. të cilët kanë akt marrëveshje të pazbatuara me pushtetin lokal dhe që sipas kriterëve ligjore përfshihen në kategorinë prioritare për t'u trajtuar. Kërkesa dhe sugjerimi jonë për zgjidhjen e problemit të strehimit ka qenë dhe është hartimi i një strategjie mbarë kombëtare me objektiva të qarta për mënyrën e zgjidhjes, kontigjenti që duhet të mbulohet, sigurimi i kushteve për arritjen e rezultateve të dukshme si dhe sigurimi i fondeve për këtë qëllim. Problemi i strehimit është një objektiv social, emergjent, i shtruar për zgjidhje. Por nga mos zgjidhja në kohë sjell shtimin e kontigjentit dhe pamundesitë e zgjidhjes shtohen nga viti në vit. Nga shumë ankesa të mbërritura gjatë këtij viti në Institucionin e Avokatit të Popullit, del se në të gjitha Bashkitë, edhe pse përfitohet statusi i të pastrehëve, mungon transparenca në vendimmarrje për radhën e trajtimit të qytetarëve, të cilët shpesh kanë rezerva për vonesat. Në këtë drejtim duhet të rritet transparenca nga organet e pushtetit vendor, për t'i bërë të njohur taksapaguesve dhe zgjedhësve të tyre punën e tyre për zgjidhjen e këtij problemi madhor, si dhe strategjitë përkatëse. Këto organe, duke qenë se ushtrojnë veprimtarine mbi bazen e parimit të autonomise dhe vetqeverisjes, duhet që të rritin bashkepunimin me komunitetin për tërheqjen e mendimit të tyre, për alternativat dhe kohën e zgjidhjes etj. Ligji Nr.8030, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha” dhe aktet e tjera nënligjore ngarkojnë për zbatimin e tij organet e pushtetit vendor dhe Entin Kombëtar të Banesave. Për gjithë këtë proces qytetarët janë krejtësisht të pa informuar, ka përshtjellim, i cili ka sjellë sorollatje pa fund. Pikërisht kjo mungesë informimi e qytetareve ka qenë nxitje për Bashkinë e Tiranës në projektin e kësaj të fundit, për ngritjen e zyrës së informacionit, nismë e cila është përshëndetur si një mjet efikas në mirëqeverisje. Në ankesat që kemi shqyrtuar lidhur me çështjen e strehimit duhet të bëjmë evident faktin se shpesh nga ana e Bashkive nuk shfrytëzohen mjetet ligjore për procedimin administrativ të ankesave. Ata hezitojnë në nxjerrjen e urdhërave administrative, duke i treguar qytetareve rrugën gjyqësore,

ndërkohë që sipas Kodit të Procedurave Administrative dhe ligjit Nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e organeve të qeverisjes vendore”, Bashkitë kanë të drejtë të ndermarrin procedime të tilla, duke marre në shqyrtim dhe vendosur edhe për ankimet administrative.

Nje impenjim i rëndesishem i Institucionit te Avokatit te Popullit ne fushen e respektimit e te drejtave te pakicave ishte dhe ai i ndermarre ne lidhje me ankesen e Unionit te Romeve te Shqiperise “Amaro Drom”, me ane te se ciles shprehej shqetesimi per disa probleme te renda sociale qe preokuponin rreth 120 familje te ketij komuniteti.

Konkretisht perfaqesuesit e ketij Unioni sqaronin se ne kuader te rehabilitimit te aneve te Lumit Lana, ju ishte kerkuar largimi nga terrenet me çadrat apo barakat e tyre. Kjo solli automatikisht krijimin e problemit te rende social, te mos strehimit te tyre. Nga ky Union kerkohej ndermjetesimi i Avokatit te Popullit per te bere te mundur impenjimin e te gjitha strukturave kompetente, per t’u marre realisht me problemet e tyre sociale, te akumuluarra nder vite, siç ishte strehimi, regjistrimi ne zyrat e gjendjes civile, arsimimi si per te gjithë shtetasit shqiptare etj.

Ne kushte te tilla, u kerkua impenjim nga Bashkia Tirane, Ministria e Punes dhe Çeshtjeve Sociale, Ministria e Rregullimit te Territorit dhe Turizmit si dhe nga Ministria e Pushtetit Lokal dhe Decentralizimit, per te bere te mundur qe problemet sociale te komunitetit Rom, te gjejne zgjidhje konforme normave ligjore nderkombetare dhe kombetare. Gjithashtu u orientuan keto Institucione qe te bashkepunonin dhe me Institucione te tjera, qe kane ne administrim te tyre objekte te tilla si reparte ushtarake (aktualisht te paperdorshem), fabrika ose ambjente te tjera qe jane jashte perdorimit funksional te tyre, me qellim qe ato te perdoreshin per nje sistemim te perkohshem te ketyre familjeve, duke ju dhene keshtu kohe dhe mundesi per nje zgjidhje perfundimtare te disa prej problemeve qe shqetesojne ato. Bashkepunimi i kerkuar nga ana e Avokatit te Popullit u ofrua nga te kater institucionet e sipercituara, por vlen te veçojme Bashkine e Tiranës dhe Ministrine e Pushtetit Lokal dhe Decentralizimit, qe moren realisht masa konkrete per kete çeshtje.

Nje nga parimet baze te funksionimit te organeve te njesive vendore eshte vazhdimesia e tyre, e percaktuar qarte ne piken 5 te nenit 4 te ligjit Nr.8652 date 31.07.2000 “Per Organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore”. Por ndryshimi i Kryetareve te Bashkive dhe i Keshillave Bashkiake, ne disa raste kane sjelle mos funksionim ne rregull dhe ne vazhdimesi te veprimtarive te ketyre njesive. Keshtu ne nje rast, Kryetari i Bashkise Gjrokaster, urdheronte Entin e Banesave qe te mos ekzekutonte

nje akt administrativ te nxjerre nga Keshilli Bashkiak i meparshem, duke shkelur jo vetem te drejtat e qytetarit R.B nga qyteti i Gjirokastrës, por edhe duke urdheruar nje Institucionin tjetër, si Degen Rajonale te Entit te Banesave te ketij qyteti, per mosveprim megjithese ky Institucion nuk ndodhet ne vartesine e tij.

Problematika te cilat jane hasur gjate trajtimit te ankesave me Bashkite, jane edhe ato qe lidhen me mos zbatimin e ligjit Nr.8549 date 11.11.1999 “Statusi i Nepunesit Civil”, i cili ne mjaft raste sidomos ne rrethe nuk njihet. Duke qene se nje pjese e punonjesve trajtohen me Kodin e Punes dhe nje pjese me “Statusin e Nepunesit Civil”, veprimet qe jane ndermarre ne largimet nga puna, kane qene te pa bazuara dhe shpesh abuzive. Veçojme ketu ankesen e shtetasit E.M, i cili ka qene punonjes ne Bashkine Tirane dhe megjithese ka fituar te drejtat e tij si nepunes civil ne Komisionin e Sherbimit Civil dhe ne Gjykate, perseri vendimet e mesiperme nuk zbatohen, duke arsyetuar mosveprimet me ndryshimet strukturore organizative te Bashkise.

c. Ankesat për prefekturat

Kanë qenë 16 ankesa për prefekturat per kete vit dhe 8 jane trajtuan te mbartuara nga viti 2002. Nga keto 13 jane perfunduar dhe 11 jane ende ne shqyrtim per kete vit. Nga ankesat te cilat kane perfunduar, 3 jane ne favor te ankuesve, 7 jane jashte juridiksionit dhe 3 ankesa jane te pa bazuara.

Nga shqyrtimi i tyre janë evidentuar probleme që kryesisht lidhen me largimet nga puna, mosekzekutim të vendimeve gjyqësore apo të vendimeve të Komisionit të Sherbimit Civil, me mos zbatimin e ligjit Nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit me dokumenta zyrtarë”, si dhe problemet që kanë dale nga veprimet apo mosveprimet e Komisioneve të Tokave. Vërehet se shumë shkelje të të drejtave kanë ardhur nga moszbatimi i procedurave administrative në procedimet e ndryshme që ndërmarin këto organe për zgjidhjen e problemeve me komunitetin, apo dhe në raport me nëpunësit e tyre.

Edhe gjatë ketij viti në Institucionin tonë janë adresuar shume ankesa nga punonjes të Prefekturave te ndryshme nga shqyrtimi i te cilave rezulton se ka paqartësi nga vetë Prefektët në trajtimin e punonjësve të tyre, të cilët në disa raste i rregullojne marrëdhëniet e punës me Kodin e Punës dhe në disa raste të tjera me ligjin “Për nëpunësin civil”. Në të gjitha rastet procedurat që duhen ndjekur dhe që garantojnë të drejtat e tyre anashkalohen.

Veçojmë rastin e shtetasit A.L nga qyteti i Korçes, për të cilin kemi paraqitur dhe rekomandim dhe jemi në shqyrtim e sipër, apo dhe rastin e N.A nga Gjirokastra, për të cilin perseri kemi paraqitur rekomandim për ekzekutim të vendimit të Komisionit të Sherbimit Civil dhe jemi duke e shqyrtuar rastin.

Nga shqyrtimi i ankesave, ka dalë se nga organet e qeverisjes vendore të të gjitha niveleve, ka raste që ka keqadministrim fondesh, kapërcim të radhës së shpërndarjes së tyre, mosakordim ndihmash apo fondesh për dëmshpërblime nga shteti, sidomos me Prefekturat që përfshijnë zonat veriore, mungesë transparence dhe mbi të gjitha mungojnë strategjitë apo alternativat e konkretizuara në plan afat gjatë dhe afat shkurtër për zgjidhjen e këtyre problemeve sociale të prekshme dhe të mprehta për qytetarët.

Veçojmë për organet e pushtetit vendor edhe problematikën e mos ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, problem i cili është evident në të gjitha organet qendrore dhe vendore, i pasqyruar edhe në Raportin e vitit 2002 të Institucionit tone. Ka qëndrime jo të drejta dhe jo ligjore për sa i përket vendimeve gjyqësore, për të cilat ka nepunes që marrin përsiper që të shprehin opinionin e tyre për ligjshmerinë ose jo të këtyre vendimeve. Shpesh mos ekzekutimi justifikohet me mungesë fondesh. Por ekzistenca e këtij shkak si pengesë për ekzekutim të vendimeve gjyqësore jo vetëm që nuk zgjidh problemin, por vetëm shton numrin e tyre duke i mbartur detyrimet për çdo vit.

Nga gjithë sa parashtruar më lart konkludojmë se duhet të rritet kontrolli mbi administrimin dhe veprimtarinë e organeve të pushtetit vendor në të gjitha hallkat e tij, si nga ana e të qeverisurës, ndaj të cilëve duhet të sigurohet besimi për votën e dhënë, ashtu dhe nga të gjitha hallkat kontrolluese të pushtetit qendror dhe drejtoritë përkatëse në Këshillin e Ministrave.

Rol më të madh duhet të luajnë edhe Prefekturat, të cilët duhet të kontrollojnë bazueshmerinë ligjore të akteve të organeve të pushtetit vendor. Rëndësi të dorës së parë ka dhe rritja e nivelit të nëpunësve për përvetësimin e akteve ligjore që kanë të bëjnë me mirëqeverisjen, sic janë Kodi i Procedurave Administrative dhe ligji “Për të drejtën e informimit me dokumenta zyrtarë”. Gjithashtu roli i juristëve në organet e Pushtetit Vendor duhet të rritet ndjeshëm.

8. Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale

Numri i ankesave të shqyrtuara nga Institucioni ynë lidhur me Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale, si dhe të institucioneve në varësi të saj, Institutin e Sigurimeve Shoqërore Shtetërore, Sherbimi Social Shtetëror dhe filialet e tyre në rrethe ka qenë 229. Nga keto 18 çështje kanë qenë për vetë Ministrinë. Problematika e ankesave të trajtuara ka qenë thuhet e njëjtë me ato të viteve të mëparshme.

Ajo që konstatohet dhe që vazhdimisht i vihet theksi nga zyra jone gjatë trajtimit të ankesave lidhur me shërbimin social, është se mundësitë e vendit për të siguruar shëndetin dhe mirëqenien e popullsisë janë kompromentuar nga infrastruktura e dobët, lëvizjet e mëdha demografike, mungesat e përkohshme të stabilitetit të brendshëm dhe kapacitetet e dobta teknike të strukturave përkatëse. Edhe një herë vëmë re dukje se ristrukturimi dhe reformimi i shërbimeve sociale bazë është një element prioritar në uljen e varfërisë.

Ne analizen vjetore të punës së Qeverisë për vitin 2003 është evidentuar se roli i Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale duhet të jetë më i madh se deri tani dhe pikerisht në aspektin që njerezit duhet të ndjejnë siguri dhe mbrojtje për të ardhmen. Kjo ministri nuk duhet ta shohe veten vetëm si një ministri që llogarit e shpërndan ndihme ekonomike. Strukturimi dhe zgjerimi i tregut të punës dhe vete punësimi janë detyrë themelore e saj. Kjo do të thotë se treguesi kryesor i rezultateve për këtë ministri nuk duhet të jetë numri i reformave të marra apo akteve ligjore të përgatitura, por numri i të punësuarve në secilin rreth.

Pikerisht ritmet e rritjes së punësimit dhe jo ritmet aktuale në të cilat ndodhemi, do të sillnin ndryshime dhe ulje të nivelit të varfërisë, duke patur parasysh që me punësimin janë të lidhura dhe përfitimet ose mospërfitimin e ndihmes ekonomike ose uljet apo rritjet në kontributet e sigurimeve shoqërore.

a) Instituti i Sigurimeve Shoqërore Shtetërore

Gjatë vitit 2003 ankesa të drejtuara ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore kanë qenë 183. Nga këto ankesa janë përfunduar 125 prej tyre dhe kemi akoma në proces shqyrtimi 58 prej tyre.

Konstatohet se problematika e tyre është thuhet e njëjtë me vitet paraardhëse 2000-2002. Kështu qytetarët ankohen për masën e përfitimit të pensionit të pleqërisë, për masën e përfitimit të pensionit të invaliditetit, të masës së pensionit familjar, mospërfitimin e statusit të invalidit,

mospërfitim të shtesave mbi pension, mospranim dokumentacioni, zvarritje te procedurave nga organet kompetente, etj.

Edhe pse gjate vitit 2002 pati ndryshime ne legjislacion, duke permiresuar disa te metat e meparshme, për ndryshimin e masës së pensioneve të një kategorie të caktuar përfituesish me tendencë rritjen e tyre, perseri vazhdojne ankesat prane Institucionit tonë.

Nisur nga ky fakt mendojme se ndjehet si e nevojshme qe gjithnje e me shume ky legjislacion te permiresohet dhe te perpunohet.

Nuk mund te leme pa vene ne dukje problematikat e ketij legjislacioni, ku midis shumë ankesave te llojeve te ndryshme së fundmi janë paraqitur ankesa, ku ngrihen nje sërë problemesh të cilat kanë të bëjnë me përmbajtjen e Ligjit Nr.7703 datë 11. 05. 1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, si dhe aktet nënligjore të cilat janë nxjerrë kohë pas kohe në zbatim të tij.

Në keto ankesa jane evidentuar çeshtje te cilat në thelb përfaqësojnë përmbajtjen e legjislacionit për Sigurimet Shoqërore, që shpesh shfaqet kontradiktor, si dhe jepen mendime për përmirësimin e këtij legjislacioni.

Kjo problematike eshte trajtuar ne vija te pergjithshme edhe ne vitet e meparshme por e veçanta e ketij viti qendron ne faktin se prekte edhe vete menyra e funksionimit te ISSH-se.

Ne shqyrtim te ketyre problemeve po paraqesim ne vijueshmeri çeshtjet e ngritura ne ankesa dhe gjykimin e zyres sone ne lidhje me to.

1. - Problemi i pare që ngrihet në këto ankesa, është përmbajtja e nenit 59, te Ligjit Nr.7703 date 11. 05. 1993 “Per Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” dhe parashikimit të bërë në Udhezimin nr.1 datë 24.12.2002 “Për llogaritjen dhe indeksimin e bazës së vlerësuar për efekt pensioni”.

Neni 59 i Ligjit per Sigurimet Shoqerore percakton se:”... *pas vitit 1996, baza e vleresueshme do te llogaritet mbi pagat per te cilat eshte derdhur kontributi qe nga viti 1994 e deri ne vitin e fundit te lenies se punes*”, ndërkohe që Udhezimi nr.1 date 24.12.2002, ne piken 1 te tij parashikon se:“ *Per personat qe e drejta per pension u ka lindur para dates 1.1.1997 e ne vazhdim, baza mesatare e vleresuar do te llogaritet mbi pagat per te cilat eshte derdhur kontribut qe nga janari 1994 e deri ne vitin e fundit te lenies se punes. Keto paga do te indeksohen me koeficientet e miratuar çdo vit me vendime te Keshillit te Ministrave*”

Ne lidhje me kete çeshtje nga ana jone eshte evidentuar fakti se Ligji “Per Sigurimet Shoqerore”, parashikon shprehimisht se “...pas vitit 1996, baza e vleresueshme do te llogaritet mbi pagat per te cilat eshte derdhur kontributi qe nga viti 1994 e deri ne vitin e fundit te lenies se punes”.

Se dyti, ne Udhezimin nr.1 date 24.12.2002 te Keshillit Administrativ, parashikohet e njejta gje si ne dispoziten e ligjit, duke shtuar ne termin baze e vleresueshme fjalen “mesatare” dhe konkretisht parashikohet menyra e llogaritjes se bazes mesatare te vleresueshme.

Termi “mesatare” me perdorimin e tij ne kete udhezim le te kuptosh se, ose kjo fjale eshte perdorur ne menyre te pakuptimte, ose eshte perdorur per te justifikuar ne nje fare menyre llogaritjen e bazes se vleresueshme, duke perfshire dhe vitet ose muajt per te cilet nuk eshte derdhur kontribut.

Ne vazhdim te analizes se problemit, ne nenin 58 te Ligjit “Per Sigurimet Shoqerore”, parashikohet shprehimisht se *“Maredhenia juridike ndermjet individit dhe I.S.Sh.-se vendoset gjate periudhave te Sigurimit. Me periudhe sigurimi jane parashikuar te gjitha periudhat :*

- *per te cilat jane paguar kontributet;*
- *gjate te cilave eshte bere pagesa nga Sigurimet Shoqerore perfshire dhe periudhen e perfitimit te pensionit te pjesshem te invaliditetit;*
- *periudha te tjera te cilat mund te deklarohen si te tilla nga Keshilli i Ministrave duke u derdhur kontributi ne fondin e Sigurimit Shoqeror nga buxheti i shtetit”.*

Pra pas gjithë kesaj analize arrijme ne konkluzionin se nuk mund te ekzistojë marrëdhënia juridike me Institutin e Sigurimeve Shoqerore, per periudhat qe nuk jane periudha sigurimi (koha gjate se ciles nuk derdhet kontribut) dhe per me teper, te prodhohen efekte per keto lloj periudhash, te cilat ndikojne direkt ne llogaritjen e mases se pensionit.

Ligji eshte shprehur ne menyre te qarte se “baza e vleresueshme” dhe jo “baza mesatare e vleresueshme”, do te llogaritet mbi pagat per te cilat eshte derdhur kontribut pra, duke perjashtuar periudhat e tjera te cilat nuk jane periudha sigurimi.

Si konkluzion mund te thuhet se permbajtja e ketij udhezimi sikurse dhe udhezime te tjera qe tashme jane shfuqizuar, vjen ne kundërshtim me vete permbajtjen e Ligjit Nr.7703 date 11. 05. 1993 “Per Sigurimet Shoqerore në Republikën e Shqipërisë”

2.-. Problemi tjetër qe ngrihet lidhet me faktin se ne udhezim nuk pasqyrohet kërkesa e nenit 59 te Ligjit Nr.7703 date 11.05.1993 “Per Sigurimet Shoqerore në Republikën e Shqipërisë”, ku thuhet shprehimisht se: *“Baza e vleresuar per te gjitha te ardhurat do te jene pagat sipas te cilave jane paguar kontributet per 3 vjet rresht ne 10 vjeteshin e fundit te punes”*

Nga kontakti i marre me specialiste te Sigurimeve Shoqerore ne lidhje me kete problem, eshte nxjerre perfundimi nga vete opinionin e dhene

prej tyre se meqenese vete ligji e parashikon kete gje, nuk eshte nevoja te parashikohet shprehimisht edhe ne udhezim.

Pra sipas kesaj llogjike, kemi nje llogaritje reale sipas parashikimit te bere ne nenin 59, te Ligjit “Per Sigurimet Shoqerore”.

Jemi te mendimit se ne llogjike te thjeshte juridike konstatimi i bere eshte i drejte, por kjo gje vetem ne kushtet kur udhezimi vete do te ishte rigorozisht i sakte ne terminologjine qe perdor ne reference te ligjit perkates.

Fakti qe vetem pak paragrafe me lart jane konstatuar perdorime termash jashte parashikimeve ligjore, ben te mendosh se ne keto raste do te ishte shume me korrekte qe udhezimi te parashikonte shprehimisht, per te mos krijuar keqkuptime apo keqinterpretime.

3.-Krahas ketyre problemeve, problemi me i madh qendron ne faktin se nese organi administrativ perkates (Keshilli Administrativ), i cili ka nxjerre keto udhezime, e ka kete kompetence ligjore apo jo?

Duke ju referuar neneve 72, 73 dhe 74, te Ligjit Nr.7703 date 11.05.1993 “Per Sigurimet Shoqerore në Republikën e Shqipërisë”, verejme se ky ligj nuk parashikon shprehimisht qe Keshilli Administrativ te kete kompetence per nxjerrjen e udhezimeve per zbatimin e ketij ligji.

Ne vijim konstatojme se, ne nenin 74, te Ligjit te sipercituar percaktohen shprehimisht te gjithe kompetencat qe ka Keshilli Administrativ dhe perveç pikes “e”, ku thuhet shprehimisht se :

- “.. miraton rregulloret te propozuara nga drejtori i pergjithshem qe kane te bejne me çeshtjet financiare” ,

nuk gjejme asnje kompetence tjeter, e cila t’a perafroje veprimin e ketij Keshilli deri ne nxjerrjen e udhezimeve.

Themi t’a perafroje sepse faktikisht edhe termi “rregullore”, eshte i ndryshem me termin “udhezim” dhe nuk mund te mendohet e jo me pastaj te pranohet ligjerisht, qe mbi kete baze Keshilli Administrativ te kete te drejten te nxjerre udhezime.

Pra si konkluzion, mund te thuhet se Keshilli Administrativ nuk ka kompetence ligjore nxjerrjen e akteve te tilla si udhezimet. Firmosja e ketij akti nga Ministri i Punes dhe Çeshtjeve Sociale, nuk justifikon ligjerisht nxjerrjen e tij, perkundrazi vazhdohet me shkeljen e kompetencave pasi ministri ne kete rast nuk eshte tjeter veçse Kryetar i Keshillit Administrativ ne fjale.

Meqenese ky organ rezulton jokompetent, atehere rrjedhimisht edhe akti qe ai ka nxjerre eshte absolutisht i pavlefshem, ne baze te nenit 116, pika b, te Kodit te Proçedurave Administrative ku percaktohet se:

“Aktet administrative do te quhen absolutisht te pavlefshme ne kuptimin e ketij Kodi ne rastet e meposhtme:

- kur akti eshte nxjerre nga nje organ administrativ ne kapercim te kompetencave te tij ligjore”.

Ndodh qe jo vetem qe ky fakt nuk merret parasysh, por nga keto akte prodhohen efekte financiare qe pasqyrohen ne masen e pensioneve dhe perfitimeve.

Kjo gje rezulton te jete nje nonsens juridik, pasi ne nenin 117, pika 1, te Kodit te Proçedurave Administrative percaktohet shprehimisht se:

“Aktet administrative absolutisht te pavlefshme nuk prodhojne pasoja ligjore pavaresisht nga fakti nese jane deklaruar ose jo si te tille”.

Ne lidhje me këtë çështje i kemi rekomanduar Ministrise se Punes dhe Çështjeve Sociale, marrjen e masave per rregullimin e duhur ligjor.

Nga kjo ministri rekomandimi yne eshte gjetur me vend dhe eshte pritur pozitivisht, duke na informuar se eshte ngritur nje grup pune nen drejtimin e Zv/ministrit, per shqyrtimin ne teresi te legjislacionit te sigurimeve shoqerore dhe pregatitjen e propozimeve perkatese per permiresimin e tij.

4.-Problemi tjetër qe mund te konstatohet si ne Udhezimin nr.1 date 24.12.2002, ashtu dhe ne vete Ligjin “Per Sigurimet Shoqerore”, eshte fakti se si element i mases se perfitimeve parashikohet dhe “indeksimi”.

Keshtu ne baze te nenit 61, pika 1, te Ligjit Nr.7703 date 11.05.1993 “Per Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, thuhet shprehimisht se:

“Pensionet baze te pleqerise dhe te invaliditetit do te indeksohen çdo vit si pasoje e ndryshimit te çmimeve te produkteve te konsideruara baze per nivelin minimal te jeteses”.

Ketu qendron dhe nje problem qe lidhet me masen e perfitimeve nga sistemi i Sigurimeve Shoqerore, sepse ne te gjitha vendimet e Keshillit te Ministrave te marra qe nga viti 1993 e deri tani dhe qe lidhen me ndryshimet e mases se pensioneve, perdoret termi “rritje”, term i cili nuk parashikohet ne Ligjin “Per Sigurimet Shoqerore”.

Ky problem eshte bere evident qe ne raportin e pare vjetor te Institucionit tone te vitit 2000, tashme i paraqitur ne Kuvendin e Republikes se Shqiperise.

5.-Nje nga problemet e tjera eshte edhe raporti ndermjet pensionit minimal dhe atij maksimal, i cili ne nenin 10 te Ligjit Nr.7703 date 11. 05. 1993 “Per Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” percaktohet ne masen 1:2, nderkohe qe kontributi i derdhur minimal me ate maksimal, ka arritur ne raportin 1:5.

Eshte mese e qarte se parimi baze i ligjit eshte ai i kontribucionit sipas te cilit, sa me shume te kontribosh per sistemin e sigurimeve shoqerore, aq me i madh do te jete dhe perfitimi qe do te marresh prej ketij te fundit.

Ky parim i pergjigjet edhe vete sistemit ekonomik mbi bazen e te cilit eshte orientuar pas viteve '90 vendi yne. Fakti eshte se megjithese ky eshte parimi baze i ligjit, efekti financiar i prodhuar duket se i nenshtrohet nje parimi tjetër, atij te barazise ne masen e pensioneve.

Mendojme qe kjo eshte nje kontradikte e cila per vete kohen kur eshte futur ne fuqi ky ligj, mund te kishte nje justifikim moral, por tashme duhet te behet nje kthese e forte ne kete drejtim, bazuar edhe ne percaktimin zyrtar te mases se minimumit jetik te jeteses.

Parimi tjetër i solidaritetit i aplikuar ne ligjin per sigurimet shoqerore, eshte nje parim i cili gjen zbatim ne kete ligj dhe nderthurje me parimin e kontribucionit.

Çfare nenkupton ne vetevete ky parim? Asgje tjetër veç nje ndarje te kontribucionit te nje individi ne favor te nje tjetri ne rast semundje, paaftesie te perkohshme, apo edhe ne marredhenie mase perfitimi te caktuar.

Lind pyetja: A duhet te ndikojë ky parim ne masen e perfitimit nga sistemi i sigurimeve shoqerore, duke ju referuar raporteve qe ne kemi cituar me lart persa i perket mases se kontribucionit dhe asaj te perfitimit ne raportin pension minimal me ate maksimal? Pergjigja eshte po. Por nga ana tjetër sa duhet te jete ky ndikim, aq sa te percaktoje taksativisht raportin e pensioneve?

Mendojme se pikerisht ky raport duhet ripare ne kuadrin e parimit te kontribucionit. Gjithkush e kupton se sistemi i sigurimeve shoqerore eshte nje sistem kompleks, por nga ana tjetër asnje nuk do te ishte dakort qe trajtimi i percaktuar ne termat e barazise dhe percaktimit taksativ te perfitimit, te shihej dhe te linte shijen e diskriminimit.

Ankesat e paraqitura lidhen edhe me rezerva te shprehura persa i perket nenit 88 te Ligjit "Per Sigurimet Shoqerore", per faktin se ky ligj i merr te mireqena pensionet e percaktuara para vitit 1993.

I vetmi element i cili parashihet per ndryshimin e mases se tyre, eshte indeksi. Duke patur parasysh elementet qe ne kemi dhene paraprakisht ne lidhje me indeksimin realisht, rezervat e shprehura qendrojne ne lidhje me kete nen.

Nuk duhet harruar se baza financiare e sistemit te sigurimeve shoqerore te ngritur sipas ligjit ne fuqi per sigurimet shoqerore, eshte

krijuar pikerisht mbi kontribucionin e mbledhur te kesaj kategorie individesh, te cilet ndjehen te diskriminuar me kete percaktim ligjor.

Sqarojme se evidentimet e bera jane ne sensin juridik te trajtimit te problemit, por keto evidentime patjeter qe kane sjelle dhe vazhdojne te sjellin pasoja financiare.

Strategjite e formulara nga ana e ISSH-se, mund te tentojne ne zbutjen e ketyre problemeve, por mendojme qe duhen zgjidhur ne menyre imediate dhe me konkrete per publikun çeshtjet e mprehta, te cilat lidhen me kuptimin dhe zbatimin e Ligjit “Per Sigurimet Shoqerore”.

Per sa me siper bazuar ne rolin dhe kompetencat qe Institucionit te Avokatit te Popullit i jepen prej Ligjit nr.8454 date 04.02.1999 “Per Avokatin e Popullit”, ne funksion te mirefunksionimit te administrates publike, si dhe te zbatimit rigoroz te ligjit apo dhe te mundesive te permiresimeve te tij, keto çeshtje i jane ngritur zyrtarisht Ministrise se Punes dhe Çeshtjeve Sociale, me rekomandimin per permiresimin e legjislacionit perkates, sikurse eshte vene gjithashtu ne dijeni edhe Keshilli i Ministrave.

Nga ministria e lartpermendur kemi patur mirekuptimin per problemet e evidentuara nga zyra jone, duke na sqaruar se pikerisht per problemet e ngritura, Ministria e Puneve dhe Çeshtjeve Sociale ne ate kohe, znj. Valentina Leskaj ka ngritur nje grup pune per shqyrtimin ne teresi te legjislacionit dhe pergatitjen e propozimeve perkatese. Po ne kete kuader eshte pergatitur nje projekt ligj i cili parashikon te zgjidhe kryesisht problemet qe lidhen me nenin 59 per llogaritjen e bazes se vleresueshme, nenin 61 me indeksimin e pensioneve, me nenin 88 per te drejtat e perfituara etj.

Ne vijim po paraqesim disa çeshtje të përfunduara gjatë vitit 2003, të cilat kanë rezultuar te zgjidhura pozitivisht.

1. Qytetari F.T. banor i qytetit të Peqinit, u ankua për zvarritje te procedurave per lidhjen e pensionit te pleqerise si nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqerore Elbasan dhe Instituti i Sigurimeve Shoqerore Tirane.

Lidhur me këtë çeshtje nga zyra jonë u hetua pranë organeve perkatese dhe rezultoi se pretendimi i qytetarit ishte plotësisht i drejtë. Në bazë të ndërmjetësimit dhe interesimit të vazhdueshëm nga ana jone prane DRSSH-se Elbasan ku qendronte dhe pengesa, u bë e mundur te realizohej lidhja e pensionit te ankuesit.

2. Qytetari DH.K. banor i qytetit te Tiranës, ankohej lidhur me mosperfitimin ende, te shperblimit ne baze te Statusit te veteranit te LANÇ. Nisur dhe nga fakti, qe ky ishte nje problem mjaft shqetesues per te gjithë

kategorine e nderuar te veteraneve te Luftes, Zyra jone i kerkoi shpjegime institucioneve pergjegjese.

Konkretisht, kemi marre pergjigjet shkresore nga ana e Institutit te Sigurimeve Shoqerore, Ministrise se Financave dhe nga Ministria e Mbrojtjes. Konfirmohet se kane qene 1700 veterane ne shkalle Republike qe nuk e kane marre shperblimin e Statusit, pasi ka pasur mungese fondi. Por nga konfirmimet e ardhura nga Instituti i Sigurimeve Shoqerore, nga muaji Dhjetor 2003 e ne vazhdim keto fonde jane dhene nga buxheti i shtetit, dhe si rrjedhim ne te gjitha Drejtorite Rajonale kane filluar pagesat dhe perkatesisht per 600 persona jane dhene, dhe per 1100 te tjere, po punohet per nje konkludim pozitiv.

3. Qytetari V.N. banor i qytetit të Korces, u ankua për mosdhënie të shteses mbi pensionin e pleqerise Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqerore Korçe.

Pas nderhyrjes se Avokatit te Popullit rezultoi se qytetari kishte dale ne pension pleqerie ne kushtet e kategorise se dyte me 1 Shtator 1998, dhe kategoria e I dhe II nuk e kane perfituar shtesen 4%. Me Ligjin e ri, nr.8776 date 26.04.2001, i jane bere ndryshime nenit 33 te Ligjit nr.7703 date 11.05.1993 "Per Sigurimet Shoqerore ne RSH", duke sjelle dhe perfitimin e shteses per ankuesin.

Pra si përfundim, ankuesit ju bë e mundur zgjidhja e ankesës si dhe mundësimi i procedurave të tjera ligjore, duke e orientuar te drejtohet tek DRSSH-ja per marrjen e shtesave, nga ana e Sigurimeve Shoqerore.

Si konkluzion, nga shqyrtimi i çështjeve dhe nga bashkëpunimi me strukturat e sigurimeve shoqërore, në një aspekt krahasues, numri i ankesave vjen gjithmonë e më shumë në rritje. Kemi parasysh që në raportin vjetor të vitit 2001 janë raportuar 118 ankesa për këtë organ, per vitin 2002 janë 174 ankesa dhe kërkesa dhe per vitin 2003 jane 183 ankesa e kerkesa.

b) Ndhma dhe Përkujdesi Shoqëror

Ankesa të lidhura me këtë fushë të paraqitura në Institucionin e Avokatit të Popullit, për vitin 2003 janë vetem 28. Nga këto janë përfunduar 16 prej tyre dhe janë akoma në proces shqyrtimi 12 të tjera.

Kryesisht këto ankesa kanë konsistuar në pretendime për masën e përfitimit të ndihmës ekonomike, ndërprerjen e ndihmës ekonomike, mospërfitim nga e drejta e kujdestarisë.

Në vijimësi, po ju prezantojmë disa nga ankesat tipike të trajtuara në këtë fushë:

1. Qytetari L.P. banor i qytetit të Tiranës, ka kërkuar të informohet pranë Zyres së Avokatit të Popullit, për kushtet që duhet të plotësojë në mënyrë që të strehohet në Shtëpinë e të Moshuarve të Tiranës.

Nisur nga kjo kërkesë, zyra jone, pasi mori informacionet përkatëse nga Sherbimi Social Shtetëror të Tiranës, sqaroi pretenduesin për dokumentet që duhet të paraqesë pranë kësaj institucioni.

Gjithashtu ai u sqarua se pas fazës së grumbullimit të kësaj dokumentacioni nga ana e Sherbimit Social Shtetëror, Komisioni Qendror e shqyrton dhe merr vendimin përkatës për pranimin e qytetarëve apo jo, komision ky që mbledhet një herë në muaj.

Pra në këtë rast detyra e Avokatit të Popullit konsistoi në orientimin dhe informimin e qytetarit për të drejtat e tij dhe rruget për t'i kërkuar këto të fundit.

2. Pranë zyrës së Avokatit të Popullit, Instituti Kombëtar i Jetimeve të Shqiperisë dergoi një ankësë lidhur me problemin në Shtëpinë e Femijes "Zyber Hallulli".

Ekspertet e Zyres së realizuan disa takime me punonjëset e kësaj Institucioni, e me pas i drejtuam kërkesat për shpjegime e dokumentacion Ministrisë së Punës dhe Çështjeve dhe Sherbimit Social Shtetëror. Dhe është konkluduar për secilin nga problemet e parashtruara, bazuar në përgjigjen e kthyer nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, në këtë mënyrë:

Lidhur me kuotën më të mirë 500 lekëshe, që femijet përfitojnë në bazë të VKM nr.402 datë 22.08.2002 "*Per percaktimin e kuotes financiare qe perfitojne nga shteti personat pa te ardhura, qe jetojne ne institucionet publike te perkujdesjes shoqerore, per shpenzime vetjake*", nga ana e drejtorit, na është bërë e ditur që ka pasur mungesë të fondesh, meqenëse tashmë ky problem është zgjidhur dhe femijet i kanë marrë shumat përkatëse për 10 muajt e kësaj viti së bashku, pra pavarësisht se ky lloj fondi u çel me vonë.

Lidhur me marrëdhëniet drejtor-staf-femije, Sherbimi Social Shtetëror pohoi se nuk mund të thuhet se çdo gjë ka shkuar mirë në këtë institucion, sepse mjaft gjëra varen nga mënyra e organizimit të brendshëm të institucionit, mënyra se si i ndërtojnë ata këto marrëdhënie. Po kështu pranë SHSSH nuk është paraqitur ndonjë ankësë gjatë këtyre 5 viteve nga punonjëset të kësaj Institucioni për drejtuesin e tyre".

Po kështu në analizat vjetore të institucionit, ku marrin pjesë dhe drejtuesit të SHSSH, asnjëherë nuk janë bërë prezent marrëdhëniet jo të mira të drejtuesit me stafin. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë në përgjigjen e tij pohon se: "Janë analizuar me kujdes vërejtjet e dy edukatorëve, dhe i është

lene drejtuesit te ri, qe t'i marrin ne konsiderate e te reflektojne situaten faktike te konstatuar. Ministria i ka analizuar keto verejtje dhe sugjerime dhe ka propozuar nje varg masash per permiresimin e gjendjes”.

Dhe se fundi, SHSSH konkludon se:

“Sherbimi Social Shteteror vleresoi problemet e ngritura ne kete institucion dhe duke gjykuar si te domosdoshme zbardhjen e verifikimin e tyre ne menyre publike realizoi nje kontroll kompleks ne bashkepunim me Drejtorine e Kontrollit ne MPÇS. U lane disa detyra per t'u realizuar nga kontrolli, po keshtu u moren nje sere masash administrative, ku nga me te rendesishmet ishte largimi i drejtorit te ketij Institucioni”.

Pra per sa konstatohet dhe me lart nga zyra jone u ndermoren hapa konkrete per hetimin dhe verifikimin ne menyren e administrimit te kesaj jetimoreje. Por megjithate vlen te theksohet se problemet e prezantuara jane zgjidhur dhe jane ne vazhdimesi te permiresimit te tyre nepermjet vete organit kompetent.

Gjate raportit te vitit te kaluar, duke ju referuar legjislacionit per ndihmen dhe perkujdesin shoqeror, nga ana jone është arritur në konkluzionin se përfitimi i kujdestarisë nuk duhej dhe s'kishte pse te lidhej me skemën e ndihmës ekonomike. Per kete qellim ne vitin 2002, i kemi rekomanduar Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme të Ndhimës dhe Shërbimeve Sociale, shfuqizimin e pikës 9-të, të Urdhërit Nr.2132, dt 23.09.1998, të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme të Ndhimës dhe Shërbimeve Sociale, sepse është në kundërshtim me ligjin në zbatim të të cilit ajo ka dalë.

Rekomandimi i bere nga ne eshte konsideruar i drejte dhe ligjor, nderkohe qe sipas konfirmimeve nga Ministria e Puneve dhe Ceshtjeve Sociale, nga kjo e fundit eshte pregatitur nje projekt ligj qe ne vitin 2002, i cili reflektonte ndryshimet e mesiperme.

Pas interesimit tone të vazhdueshëm, ky projekt ligj, nga procesi i shqyrtimit nga ana e Ministrisë përkatëse, është shqyrtuar dhe miratuar nga ana e Qeverise dhe tashme ndodhet pritje të miratimit të tij nga ana e Parlamentit.

Ashtu si dhe kemi evidentuar dhe ne raportin vjetor 2002, probleme kane sjelle ne praktike per qytetaret, kriteret e vendosura me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 113, datë 31.3.2002 “Për ndihmën ekonomike”, i cili ka sjellë si pasojë ndërprerjen e ndihmës ekonomike për persona që merrnin vite me rradhë.

Zyra jone, pavaresisht se kete vit nuk ka dale me rekomandime dhe propozime konkrete per ndryshimin apo permiresimin e legjislacionit per ndihmen ekonomike, edhe nje here ve ne dukje se ky legjislacion por dhe

saktesisht vendimi i siperpermendur kane nevojë për t'u ripare, në mënyrë që të shmangen vleresimet subjektive të organeve të ndihmes dhe perkrahjes ekonomike, dhe në të njëjtën kohë të caktohen dhe kriteret më të vërtetë objektive për përcaktimin e grupit të personave që duhet të përfitojnë nga skema e ndihmes ekonomike.

Perseri duke iu referuar analizës së punës së Qeverisë për vitin 2003, është theksuar fakti se politikat qeveritare për të ulur varferinë dhe për të mbrojtur të varferit vecanerisht në fshat nuk kanë dhënë rezultatet e pritshme, krahasuar me një realitet, ku një numër i konsiderueshëm familjesh që duket se është shumë më i madh se ai i deklaruar nga vleresimet e kursyera zyrtare, jeton me burime mjaft të pakta jetese ose në varferi të plote.

Nga kjo analizë ka dalë qartë se shumica e reformave të ndermarra kanë karakter legjislativ, nderkohe zbatimi me korrektesë dhe kompetencë të ligjeve progreson me ngadalë, përfshirë dhe legjislacionin e ndihmes dhe perkrahjes ekonomike.

9. Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit

a-Ankesa të ndryshme për Ministrinë

Për vetë Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vitit 2003 ka shqyrtuar 32 ankesa, nga të cilat 4 janë mbartuar nga viti 2002. Nga këto 5 janë zgjidhur në favor të ankuesve, 23 kanë qënë të pabazuara, kurse 4 janë në shqyrtim.

Problematika e ankesave ka qënë kryesisht për shpronësimet për interesa publike dhe problemet që kanë dalë gjatë këtij procesi, mos përfitimi i kompensimeve apo ankesa përkundrejt masës së kompensimeve, mos ekzekutim të vendimeve gjyqësore, etj. Kjo problematikë është e njëjtë me atë të prezantuar edhe në Raportin e vitit 2002.

Ka patur dhe ankesa të cilat lidhen me procedurat e privatizimit të banesave nga ana e Entit Kombëtar të Banesave dhe degëve në rrethe. Vecojmë ankesën e shtetasës H.G nga Tirana, e cila pas nderhyrjes tone institucionale zgjidhi ceshtjen e strehimit nepermjet ekzekutimit të vendimit të Keshillit Bashkiak nga ana e Entit të Banesave. Gjithashtu do të veçonim edhe ankesa që lidhen me mos zbatimin e ligjit Nr.8503, datë 30.06.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare", të cilat në

të gjitha rastet pas ndërhyrjes tonë institucionale janë zgjidhur në favor të ankuesve.

Ankesat e shtetasve që lidhen me moszbatimin e VKM-së Nr.85, datë 2.03.1994 “Për vënien në dispozicion të zonave të banimit për familjet që shpërngulen nga Ujëmbledhësi i Bovillës dhe ato që kanë ndërtuar pa leje, përreth qytetit të Tiranës”, si dhe të nenit 142/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, u paraqitën edhe vitin e kaluar.

Gjatë shqyrtimit në vijimësi të këtij problemi, pas rekomandimeve tona mendojmë se çështja është vënë drejt rrugës së zgjidhjes, pasi me Urdherin Nr.92 date 27.06.2003 të Kryeministrit u arrit ngritja e Komisionit të Posacem të Shpronësimeve, për ndjekjen e realizimit të procedurave të shpronësimeve të pasurive të paluajshme për ndërtimin e ujesjelles-kanalizimeve dhe problemeve të ujëmbledhësit të Bovillës. Duke besuar në këtë angazhim të dikasterit në fjalë, besojmë edhe në zgjidhjen e këtij problemi sa të drejtë, aq dhe të ligjshëm.

Gjatë shqyrtimit të ankesave me këtë Ministri gjatë vitit 2003 janë evidentuar dhe çështje të tjera të cilat lidhen kryesisht me marrëdhëniet e punës dhe gjithë problematikat që kanë lindur gjatë zbatimit apo mos zbatimit të dispozitave të Kodit të Punës.

Edhe këtë vit në këtë Ministri, janë konstatuar shkelje të nenit 142/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, për mos ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Si pengesë në çdo rast paraqitet mungesa e fondeve.

Nje rast tjetër që do të veçonim me këtë Ministri është ankesa e shoqërisë “Verria” SHPK me seli në Kavajë, lidhur me përcaktimin e koston mesatare të ndërtimit lek/m², për rrethin e Kavajës si me e larta në të gjithë Shqipërinë, në bazë të udhëzimit të Këshillit të Ministrave Nr.3 date 16.10.2002 “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banësive të vlerave në tregun e lirë të banësive dhe të koeficientit “k”...”. Pas ndërhyrjes tonë institucionale, u pranua se sa më sipër është një gabim dhe me pas doli Udhëzimi Nr.1 date 8.05.2003 i cili rregulloi përfundimisht problemin lidhur me vlerën e çmimit për njësi sipërfaqe ndërtimi për rrethin e Kavajës.

Lidhur me ankesat që kanë për objekt të tyre sigurimin e strehimit, zyra jonë ka ndjekur mjaft ankesa, sidomos ato që lidhen me të pastrehet e skemave piramidale. Për këtë kategori ndërhyrjet tona kanë qenë sistematike dhe dalja se fundi i Vendimit Nr.792 date 26.11.2003 “Për përdorimin e fondeve të ish fondacioneve për ndërtimin e apartamenteve për kreditorët që kanë humbur banesat nga renia e skemave piramidale”, e cila ve në dispozicion fondin prej 240 000 000 për ndërtim

apartamentesh per kete kategori, ka zgjidhur nje pjese te ketyre ankesave qe i jane drejtuar Avokatit te Popullit.

b. Ankesat për ndërtimet pa leje

Nisur nga një praktikë pune tashmë 4 vjeçare në këtë drejtim, vërejmë se numri i ankesave të paraqitura në zyrën tonë që kanë të bëjnë me këtë problematikë ngelet pothuajse i njëjtë, fakt që tregon se veprimtaria e këtij organi të administratës publike mbetet problematike në kuadër të respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të individit, në ushtrim të kompetencave që atij i jep ligji.

Faza e evidentimit të plotë dhe të ekzekutimit të ndertimeve të kundraligjshme (prishjes), nga ana e organit të Policisë të Ndërtimit, është në rend të ditës së punës të këtij organi. Kjo tregon angazhimin për zhvillimin e një urbanizimi të studjuar dhe jo më sporadik, sikurse ka ndodhur masivisht në këto vite dhe ka shenja të dobëta të vazhdimit të tij.

Kështu gjatë vitit 2003, për këtë problematikë, rezulton të jenë marrë në shqyrtim 117 ankesa, nga të cilat 106 lidhen me veprimtarinë direkte të Policisë të Ndërtimit. Ky numër tregon pothuajse të njëjtin nivel numerik ankesash sikurse edhe në vitin 2002, gjë që tregon se kjo veprimtari mbetet problematike.

Nga këto ankesa, deri në fund të vitit 2003, rezultojnë të përfunduara 64 ankesa dhe akoma në shqyrtim janë 53 ankesa.

Përsa i përket çështjeve të përfunduara ka rezultuar se janë zgjidhur në favor 7 çështje, të pabazuara 10 çështje, kurse jashtë juridiksionit dhe kompetencës 47 çështje.

Përsëri një moment i evidentuar në rastet e shqyrtuara në këtë vit ngelet ai që lidhet me mbartjen e problemeve që kanë të bëjnë me ndërtimet pa leje nga ana e organit të Policisë të Ndërtimit, vit pas viti, duke bërë që ngarkesa e punës të mos jetë më racionale, por të krijojë probleme të funksionimit të këtij organi që shpesh mund të vlerësohen si jo të mirëqena dhe fiktive.

Veprimi i pjesshëm në lidhje me ndërtimet e kundraligjshme është edhe një ndër shkaqet që megjithëse vërehet se ka nje rënie të dukshme të ngritjes të ndertimeve pa leje, sidomos nga individët, ndikon në anën psikologjike të kundravajtësve dhe në vetë imazhin dhe efijencën e këtij organi. Themi këtë pasi në të gjitha rastet e shqyrtuara ku ka rezultuar veprim i pjesshëm në ekzekutimin e vendimeve për prishje nga ana e degëve të Policisë të Ndërtimit, ankesat në drejtim të këtij organi janë përsëritur, duke evidentuar edhe faktin se kundravajtësit kanë vepruar duke

ringritur ndërtimet e tyre të kundraligjshme, madje edhe duke i zgjeruar më tej ato.

Një veçori e këtij viti është ajo e mosveprimit deri ne ekzekutim te plote te vendimeve përkatëse të marra për ndërtimet e paligjshme.

Kështu megjithëse ndërtimet e paligjshme evidentohen dhe ndaj tyre zhvillohet procedura përkatëse ligjore, deri ne marrjen e vendimit për prishjen e tyre, puna në shume raste ngec deri ketu, duke passjellë në radhë të parë pakënaqësinë e qytetarëve të cilët vuajnë pasojat e këtyre ndërtimeve dhe në radhë të dytë, veç problemeve të radhitura më sipër, edhe rënien e besueshmërisë në publik të punës së organit të Policisë të Ndërtimit.

Fenomeni më tipik i gjetur nga ana jonë këtë vit, ka të bëjë me përcaktimin e një afati vlefshmërie të përcaktuar zyrtarisht nga vetë Policia e Ndërtimit, në lidhje me vendimet që ajo merrte dhe ka marrë, me objekt prishje ndërtimesh të kundraligjshme.

Ky moment i është referuar nga ana jonë nëpërmjet një rekomandimi, të gjitha degëve të Policisë të Ndërtimit, si dhe vetë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë të Ndërtimit, ku kemi sqaruar kuptimin e ligjit (nenit 23 të Ligjit “Për kundërvajtjet administrative”), si dhe zbatimin e nenit 84 të Ligjit Nr.8405 datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën” në praktikën e përditshme të punës së këtij organi.

Në këtë rekomandim është evidentuar se gjatë shqyrtimit të një sërë ankesash nga ana e zyres tonë, rezulton se në përgjigjet e dhëna nga ana e degëve të organit të Policisë të Ndërtimit, i bëhet nje referim i gabuar përmbajtjes së nenit 23 të Ligjit “Për kundërvajtjet administrative”.

Sipas kësaj praktike, vendimet e percjella për ekzekutim (prishje ndërtimesh të kundraligjshme), për shkak të mungesës të mjeteve teknike nuk bëhen të mundura të ekzekutohen. Por sipas përgjigjeve të dhëna, ato do të ekzekutohen në mënyrë të padiskutueshme brenda afatit 1 vjeçar nga dita e marrjes së tyre, prej organit përkates kompetent.

Ky qëndrim është shfaqur edhe në takimet që zyra jonë ka zhvilluar me përfaqësues të këtij organi për çështje të veçanta, ku me sa rezulton vlefshmeria e aktit administrativ (vendim i KRRT-ve apo vetë organit të Policisë të Ndërtimit, për prishje ndërtimi të paligjshëm), lidhet me afatin 1 vjeçar të përcaktuar në nenin 23 të Ligjit “Për kundërvajtjet administrative”.

Nga ana tjetër një moment tjetër shumë i diskutueshëm sipas kësaj praktike, është ekzekutimi i një **dënimi administrativ**, brenda afatit 1 vjeçar nga data e nxjerrjes së vendimit për këtë qëllim, në bazë të nenit 23 të

Ligjit “Për kundërvajtjet administrative”, për nga menyra se si kuptohet dhe trajtohet ky nen nga ana e organit të Policisë të Ndërtimit.

Për sa është konstatuar në këtë praktikë është sqaruar se:

Në ligjin Nr.8405 date 17.09.1998 “Për urbanistikën”, përcaktohet se shkelja dhe kryerja e veprimeve në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji (sikurse ndërtimet e paligjshme), përbën kundërvajtje administrative në fushën e urbanistikës.

Përveç detyrimeve që përmbajnë këto dispozita si p.sh marrja e vendimeve nga KRRT-ja apo organi i Policisë të Ndërtimit, për pezullimin e punimeve apo prishjen e ndërtimit të kundraligjshëm, në nenin 81, parashikohet edhe dënimi me gjobë në masën e përcaktuar, sipas shkeljes së kryer.

Nga ana tjetër në nenin 23 të Ligjit Nr.7697 datë 7.04.1993 “Për kundërvajtjet administrative”, thuhet shprehimisht se:

“Dënimet për kundërvajtjet administrative nuk mund të ekzekutohen me kalimin e një viti nga data e dhënies së tyre”.

Duhet theksuar se në rastet e marrjes së vendimeve të KRRT-ve, apo dhe të vetë organit të Policisë të Ndërtimit, për prishjen e ndërtimeve të kundraligjshme, në reference edhe të teorise doktrinale për përcaktimin e llojeve të dënimeve administrative, nuk kemi të bëjmë me dënim administrativ, por me një masë administrative që merret ndaj kundravajtësit.

Në këtë konkluzion arrihet për faktin se, në bazë të Ligjit në fuqi Nr.6070 date 25.12.1979 ”Për kundravajtjet administrative”, jepen vetëm dy lloje dënimesh:

a- gjoba

b- heqje e lirisë deri në 30 ditë (kur ligji ngarkon gjykatën si organ për shqyrtimin e kundravajtjes).

Sipas nenit 4 të po këtij ligji, këto dy lloje dënimesh administrative që konsiderohen kryesore në varësi nga lloji i kundërvajtjes, shoqërohen edhe me masa administrative parandaluese të parashikuara në ligj.

Në këtë rast, vendimi i marrë nga KRRT-ja për prishjen e ndërtimit të paligjshëm nuk është më dënim administrativ, por një masë administrative parandaluese, pasi prishja e ndërtimit nënkupton ndalimin e vazhdimin të kësaj gjendje dhe mospërsëritjen e saj.

Edhe në Kodin e Proçedurave Administrative, në nenet 129-133, të cilat lidhen me ekzekutimin e akteve administrative, nuk parashikohet ndonjë afat në limite të përcaktuara, brenda të cilave duhet të bëhet ekzekutimi. Përkundrazi i vetmi term që përdoret është termi ”Ekzekutim i menjëhershëm”.

Në kuptim të dënimit administrativ, në këto raste mund të marrim përcaktimin e bërë në nenin 84 të Ligjit Nr.8405 datë 17.09.1998 "Për Urbanistikën", ku thuhet shprehimisht se:

"Gjobat, shpërblimet dhe shpenzimet e prishjes, të përcaktuara në këtë ligj, paguhen nga kundërvajtësit brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të organit të Policisë të Ndërtimit ose nga dita kur vendimi i gjykatës merr formë të prerë.....".

Si konkluzion, mund të thuhet se referenca që i bëhet nenit 23, të Ligjit Nr.7697 datë 7.04.1993 "Për kundërvajtjet administrative", në lidhje me afatin 1 vjeçar të ekzekutimit të mundshëm të vendimeve të KRRT-së, apo edhe të vetë organit të Policisë të Ndërtimit, ku vendoset prishja e një objekti të kundraligjshëm, është e gabuar dhe jo në përputhje me ligjin.

Problemi i vetëm në këtë rast i cili realisht nuk është trajtuar të paktën në praktikën që ne kemi zhvilluar deri tani, është përcaktimi i shpenzimeve të prishjes dhe ngarkimi i tyre në pagesë nga kundërvajtësi, dënim administrativ që nuk është aplikuar nga Policia e Ndërtimit dhe për të cilin mund të diskutoheshin afatet e parashikuara në nenin 23 të Ligjit "Për kundërvajtjet administrative".

Sa më sipër në funksion të mirëfunksionimit të organit të Policisë të Ndërtimit kemi sygjeruar, ndërprerjen e praktikës së referimit të gabuar për vlefshmërinë e ekzekutimit të vendimeve të KRRT-ve dhe të vetë organit të Policisë të Ndërtimit, sipas afatit 1 vjeçar të përcaktuar në nenin 23, të Ligjit "Për kundërvajtjet administrative", si dhe zbatimin e përcaktimit të shpenzimeve të prishjes që i ngarkohen kundërvajtësit, në bazë të nenit 84 të Ligjit Nr.8405 datë 17.09.1998 "Për Urbanistikën".

Referimi i saktë dhe zbatimi rigoroz i parashikimeve ligjore, sikurse edhe në këto raste, është vlerësuar nga ana jonë si rritës i efektivitetit në punë, shmangës i zvarritjeve, si dhe krijues i besueshmërinë të organeve të administratës publike, në sytë e njerëzve të thjeshtë që presin respektimin e lirive dhe të drejtave të tyre legjitime.

Problemi tjetër i rishfaqur këtë vit është ai i mosrespektimit i projekteve të miratuara në lejet e ndërtimit, nga ana e ndërtuesve. Edhe pse zyra jonë në këto raste është investuar në shqyrtimin sa më shpejtë të rasteve të paraqitura, shpeshherë vihemi para faktit të kryer, pasi në përgjigjet e dhëna si nga ana e degëve të Policisë të Ndërtimit, ashtu edhe nga ana e Zyrave të Urbanistikës në Bashkitë përkatesë, konfirmohet zyrtarisht se projektet përkatëse janë miratuar gjatë ndërtimit, fakt që kundërshtohet edhe më pas me forcë nga ankuesit. Në këto raste kemi vlerësuar si të domosdoshme ekspertizën e specialistëve të fushës, e cila lidhet me evidentimin në vend, problem i cili nuk mund të realizohet për

shkak të mungesës së këtij personeli apo edhe fondeve përkatëse për realizimin e një funksioni të tillë.

Numri i çështjeve të papërfunduara nga ana jonë për vitin 2003, është rreth 44 %, shifër e përafërt me një vit më parë. Arsyeja kryesore për këtë vazhdon të mbetet mungesa e gadishmërisë së organit të Policisë të Ndërtimit, por edhe e KRRT-ve, pranë Bashkive, për kthimin e përgjigjeve të kërkuara prej nesh, për sqarimin e çështjeve të paraqitura, ose sqarimi i pjesshëm, jo i qartë dhe i pamjaftueshëm, nganjëherë edhe i pakuptueshëm në këto çështje.

Rekomandimet e drejtuara nga ana jonë, vërejmë se në të shumtat e rasteve pranohen në heshtje, duke ndërmarrë veprime të ngadalta dhe jo konkludente dhe për më tepër duke mos përmbushur detyrimin ligjor të dhënies së prononcimit zyrtar, sikurse parashikohet në nenin 22, të Ligjit “Për Avokatin e Popullit”. Konkretisht nga 9 rekomandime të paraqitura për më shumë se gjysmën e tyre është konfirmuar ndërmarrja e veprimeve konkrete, që vënë në vend të drejtën e shkelur të individit ankues, ndërkohë që për pjesën tjetër ende nuk kemi përgjigje zyrtare.

Vazhdojnë të ngelen problematike në respektimin e këtij detyrimi ligjor Bashkia Tiranë, Bashkia Durrës, Bashkia Vlorë (KRRT-të) dhe përsa i përket organit të Policisë të Ndërtimit, problematike shfaqen Degët e Policisë të Ndërtimit, Tiranë, Durrës, Vlorë, por edhe vetë Drejtoria e Përgjithshme e Policisë të Ndërtimit.

Ndërturja e kompetencave në trajtimin e rasteve të ekzistencës së ndërtimeve të kundraligjshme, shfaq përsëri lojën e shkresave ndërmjet Policisë të Ndërtimit dhe KRRT-ve në Bashkitë përkatëse, lojë e cila nuk çon asnjëherë në vendim-marrje përfundimtare, por vetëm në zvarritje të problemeve. Kjo gjë ka bërë që të vazhdohet të ndërhyhet nga ana jonë me rekomandime për shpjegimin e përkatësisë të procesit të vendim-marrjes, rekomandime të cilat synojnë zgjidhjen përfundimtare të çështjeve dhe vënien në vend të së drejtës së shkelur të individit.

Mungesa e personelit, mungesa e mjeteve, ndërrimi i kohë pas kohshëm i personelit, si drejtues ashtu edhe ndihmës, mbetet problematik në kuadër të një veprimtarie normale të organit të Policisë të Ndërtimit, probleme që janë diskutuar si në takime për çështje të caktuara në rang ekspertësh dhe në takime ndërmjet titullarëve të organit të Policisë të Ndërtimit dhe Institucionit tonë.

Fakti është se ndaj kërkesave tona për marrje masash administrative ndaj punonjësve të cilët janë bërë shkak për zvarritje dhe moszgjidhje të çështjeve në kohë, organi i Policisë të Ndërtimit ka qenë më i ndjeshëm në

sensin pozitiv, duke marrë edhe masa konkrete, gjë që nuk ka ndodhur me Bashkitë (KRRT).

E drejta e individëve të cilët kanë qenë palë e proçedimeve administrative të zhvilluara nga Policia e Ndërtimit, apo organeve të tjera që lidhen me fushën e urbanistikës, si dhe e atyre që nuk e kanë gëzuar këtë cilësi, ka qenë një zhvillim tjetër i dukshëm këtë vit.

Nuk ka se si të shpjegohet mosdhënia e kopjeve të dokumentave zyrtare nga ana e organit të Policisë të Ndërtimit, sikurse edhe nga ana e sekretarive të KRRT-ve, në përputhje me parashikimet e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, përveçse me qëndrime përfitimi dhe abuzuese të punonjësve të këtyre organeve. Theksojmë se në një shumicë të konsiderueshme rastesh, thelbi i shkeljes së të drejtave të individit vjen nga mosinformimi, veprim i cili ndeshet shpesh edhe në këto ankesa.

Nuk kanë munguar edhe ankesat që kanë të bëjnë me veprimtarinë e Policisë të Ndërtimit në kundërshtim me ligjin, duke prishur objekte të ligjshme, raste të cilat janë ende në shqyrtim nga ana jone për shkak të mosdhënies në kohë të shpjegimeve të kërkuara nga ana jonë.

Ne vitin që sapo kemi lene pas ka pasur edhe nje sere zhvillimesh pozitive ne drejtim te urbanizimit ligjor te zonave te banuara tashme. Eshte i njohur vendimi perkates i KRRTRSH-se, i cili pezulloi dhenien e lejeve te ndertimit ne qendrat e qyteteve, derisa te perfundonin studimet pjesore per keto zona, zhvillim i cili ka dhene efektet e veta pozitive. Rasti me domethenes eshte konkursi nderkombetar i shpallur nga Bashkia Tirane, per studimin urbanistik te zhvillimit te qendres se Tiranës, i finalizuar edhe me shpalljen e projektit fitues.

Meqenese problematika ne kete drejtim vazhdon te mbetet e njejta, shpesh ankesat bëhen sepse studimet urbanistike pjesore apo tërësore në shumë prej Bashkive tona, mungojnë ose i përkasin periudhave të cilat nuk kanë parashikuar një zhvillim të tillë urban si ky që ne kemi aktualisht.

Veprimi i ndermarre se fundmi per qendrat e qyteteve, gjykojme se duhet te shoqerohet me nje parashikim dhe veprim paralel, per pergatitjen e studimeve urbanistike per zonat me te prekshme nga fenomeni i ndertimit te paligjshem, apo i fenomenit te shmangies nga projektet e miratuara ne perputhje edhe me studimet pjesore zonale.

Edhe vendimi me i fundit i KRRTRSH-se per prishjen e te gjitha ndertimeve te kundraligjshme te ngritura ne zonen bregdetare perben nje zhvillim te ri shume pozitiv ne kete drejtim. Por duhet te pohojme se ekzekutimi i tij dhe proçedurat pasuese nuk kane qene transparente dhe nuk kane konkluduar perfundimisht per problemin ne fjale. Edhe pse nje pjese e

mire ndertimesh te kundraligjshme jane prishur qe nga koha e daljes se ketij vendimi, shume te tjera vazhdojne te ekzistojne dhe nuk dihet nese ato do te prishen apo do t'i nenshtrohen nje proçesi legalizimi.

Kujtojme se njerës prej ankesave qe ka lidhje me kete problem sot e kesaj dite, megjithë interesimin tone te vazhdueshem nuk i është dhene pergjigje nga ana e Ministrise se Rregullimit te Territorit dhe Turizmit.

Proçesi i shumeperfolur i legalizimit te ndertimeve te kundraligjshme, ka ngelur si pjesa me e erret e gjithë kesaj problematike.

Pavaresisht nismave te ndermarra ne vazhdimesi, gjykojme se proçesi deri tani ka ngelur virtual pa dhene rezultate konkrete dhe ne nje fare menyre duke bllokuar edhe punen e organit te Policise te Ndertimit, per raste te caktuara kur ajo mund te vepronte ne lidhje me ndertime te caktuara. Gjithashtu gjykojme se proçedura ligjore e legalizimit te nje ndertimi, ne kushtet kur pretendohet se do te kete nje legalizim masiv te ndertimeve, ka nevojë per percaktime me te detajuara me akte ligjore dhe nenligjore te tjera, veç atyre ekzistuese, gje qe do ta lehtësonte edhe proçesin ne kuptimin e nje proçedimi administrativ, por edhe ne kuptimin masiv qe mendohet te perfaqesoje ai.

Shpeshhere, sidomos per ndertimet, te cilat gjate zbatimit te tyre shfaqen me shkelje ne zbatim te projektit te miratuar, nga ana e Bashkive apo Policise te Ndertimit dhenia e shpjegimeve jashte afateve te percaktuara ligjore, perkon edhe me hapjen e proçeseve gjyqesore ne lidhje me keto çeshtje, gje qe na detyron te nderpresim shqyrtimin e metejshem te rasteve. Duhet theksuar edhe fakti se nga shqyrtimi i shume çeshtjeve, jo vetem per vitin 2003 por edhe me pare, nuk është evidentuar ne asnje rast te mundshem ushtrimi i kompetences qe neni 6 i Ligjit “Per Policine e Ndertimit”, i jep organit te Policise te Ndertimit ne lidhje me pezullimin dhe njoftimin e KRRTRSH-se per vendimet e marra nga Keshilli i Rregullimit te Territorit, kur verën shkelje te ligjit ne vendimet e tyre.

Nje pjese e mire e kesaj problematike është evidentuar edhe ne analizen vjetore te punes se Qeverise per vitin 2003, ku është nenvizuar nevoja e reformimit te plote te sektorit te urbanistikes, nepermjet pergatitjes sa me pare te nje ligji te ri per urbanistiken.

Si prioritet ne kete analize shihet edhe reformimi i funksioneve te policise bashkiake, reformim i cili do te filloje me transferimin e funksioneve te policise ndertimore, duke e kthyer kete te fundit ne nje inspektoriat shteteror te urbanistikes. Ky zhvillim është cilesuar gjithashtu edhe si plotesues i boshllekut ekzistues te funksionit te kontrollit te cilesise se ndertimeve dhe te permbushjes prej tyre te disa parametrave thelbesore,

te percaktuara qarte ne legjislacionin ekzistues te ndertimit, por te pakontrolluara nga shteti.

Legalizimi si proces nga ana tjeter, eshte priorizuar ne kuadrin e perfundimit te nje ligji te posaçem, brenda muajit Mars 2004.

Gjate punes se zyres sone edhe ne kete vit nje rendesi e veçante i eshte kushtuar ndermjetesimit direkt per zgjidhjen e çeshtjeve qe i adresohen ketij grupimi, pa pasur nevoje per rekomandim apo propozim me shkrim nga ana jone.

Ne konkretizim te problematikave te mesiperme, po paraqesim disa nga rastet e shqyrtuara nga ana e zyrës sonë:

1. Ankesa e shtetases D.R nga qyteti i Durresit.

Ne letren qe kjo ankuese ka drejtuar ne zyren tone eshte shprehur shqetesimi ne lidhje me nje ndertim (shtese), me siperfaqe te madhe dhe pa leje ndertimi, te ngritur ngjitur me apartamentin ne pronesine e saj te ligjshme nga shtetasi A.Z.

Per kete problem ankuesja i eshte drejtuar nje sere organeve per zgjidhjen e tij, perfshire edhe Policine e Ndertimit, dega Durres, por gjithçka, sikurse edhe ajo eshte shprehur, ka ngelur ne kuadrin e letrave ankesa dhe asgje nuk eshte bere.

Sa me siper eshte kerkuar nderhyrja e Avokatit te Popullit prane organeve perkatese te administrates publike, per zgjidhjen e kesaj çeshtje.

Me pranimin e kesaj ankese per shqyrtim nga ana jone, jane kerkuar shpjegime te perseritura lidhur me trajtimin e kesaj çeshtje, nga ana e Policise te Ndertimit, dega Durres.

Veç shkresave te perseritura te derguara per kete problem, jane zhvilluar edhe nje sere takimesh prane zyres se Policise te Ndertimit, dega Durres.

Se fundmi, me ane te shkreses nr.501/1 date 23.05.2003 te kesaj dege te Policise te Ndertimit, jemi vene ne dijeni te faktit se me ane te urdher ekzekutimit nr.4 date 20.01.2003, kjo e fundit ka ekzekutuar vendimin e KRRT-se prane Bashkise Durres, per prishjen e objektit te kundraligjshem te shtetasit A.Z., duke vene ne vend keshtu te drejten e shkelur ndaj ankueses.

Ky rast perben nje prej atyre çeshtjeve kur nga ana jone eshte nderhyre nepermjet mediacionit direkt per zgjidhjen e tyre, prane organit te Policise te Ndertimit pa paraqitur rekomandime perkatese.

2. Ankesa e shtetasit I.K. nga qyteti i Tiranes

Ankesa e ketij shtetasi ka te beje me mosdhenien dhe mosinformimin e tij, nga ana e Policise te Ndertimit, dega Tirane dhe Prefektura e Qarkut Tirane, persa i perket nje dokumenti zyrtar.

Ankuesi ka konfirmuar faktin qe, edhe pse i eshte drejtuar organit dhe institucionit te sipercituar, brenda te gjitha rregullave ligjore per marrjen e nje kopje te kesaj shkrese, perseri ajo nuk i jepet dhe ceshtja zvarritet, duke mos respektuar asnje afat kohor.

Pergjigja e Prefektures se Qarkut Tirane, ka lene te hapur mundesine e kerkimit te kopjes se dokumentit perkates ne nje kohe te mevonshme, per shkak te riorganizimit te zyres se arkives ne kete institucion.

Nderkohe ne vazhdim te shqyrtimit te ketij rasti, eshte kontaktuar vazhdimisht me perfaqesues te organit te Policise te Ndertimit, si dhe jane perseritur shkresat per kerkimin e kopjes se dokumentit perkates, qe kerkohej nga ankuesi.

Edhe ne te gjitha kete praktike te ndjekur eshte evidentuar nje neglizhence e theksuar nga ana e organit te Policise te Ndertimit per permbushjen e detyrimit te tij ligjor per dhenien e kopjes se dokumentit zyrtar. Problemi eshte zgjidhur me nderhyrjen tone insistuese tek titullari i Policise te Ndertimit, dega Tirane.

Krahas mediacionit direkt nderhyres, ne kete rast eshte ushtruar edhe e drejta qe Avokatit te Popullit i jepet ne Ligjin "Per te drejten e informimit per dokumentet zyrtare", ku ky i fundit cilesohet si kujdestar per zbatimin e ketij ligji.

3. Ankesa e shtetases H.B nga qyteti i Tiranes

Ne ankesen e paraqitur nga kjo shtetase eshte paraqitur shqetesimi ne lidhje me nje ndertim te kryer nga shtetasi tjetere Y. B prane baneses se saj, ndertim ky i kryer sipas ankuseses, jashte kondicioneve urbanistike dhe qe i ka shkaktuar edhe demtim te baneses dhe mosveprimin e organeve perkatese ne kete rast.

Me marrjen ne shqyrtim te kesaj ceshtje, fillimisht jane kerkuar shpjegime nga Policia e Ndertimit, dega Tirane, ku sipas pergjigjeve te saj pohohet fakti se per ndertimin e sipercituar te Y.B, ishte vepruar duke pezulluar punimet e tij dhe duke i derguar materialin e nevojshem KRRT-se prane Bashkise Tirane, per t'u shprehur ne lidhje me kete objekt.

Ne pergjigje te kerkeses tone, Drejtoria e Urbanistikes Ligjore ne Bashkine Tirane, sqaronte se Y.B kishte paraqitur kerkese prane Drejtorise se Legalizim Shpronimeseve, per legalizimin e ndertimit ne fjale te kryer nga ana e tij.

Njekohesisht kjo drejtori sqaronte se kishte njoftuar edhe Policine e Ndertimit, dega Tirane, per te pezulluar ndertimin deri ne trajtimin dhe dhenien e vendimit nga KRRT-ja prane Bashkise Tirane.

Nga ana tjeter organi i Policise te Ndertimit, ka rikonfirmuar edhe nje here faktin se kishte kryer te gjitha proçedurat e nevojshme per kete rast.

Megjithate duke gene ne pritje te nje vendimi nga KRRT-ja prane Bashkise Tirane, per ndertimin e kryer nga Y.B, eshte vene re nje zvarritje e dukshme trajtimi nga ky organ, fakt ky i konstatuar edhe ne takime te vazhdueshme me perfaqesues te Policise te Ndertimit, dega Tirane.

Ne menyre te vazhdueshme nga ana e zyres sone, eshte kontaktuar me Drejtorine e Legalizimeve dhe Shpronesimeve ne Bashkine Tirane, per te marre sqarime per trajtimin perfundimtar te problemit.

Gjate ketyre takimeve dhe bisedave te zhvilluara me perfaqesuesit e kesaj drejtorie, eshte evidentuar zhvillimi i nje proçedimi administrativ te tejzgjatur dhe qe ka kaluar te gjitha afatet e percaktuara ligjore te zhvillimit te tij normal.

Keshtu qe nga koha kur Y.B kishte paraqitur kerkesen per legalizim e deri me sot, ka kaluar me shume se nje vit e gjysem, nderkohe qe te ben fakti se ne shkresat e Bashkise Tirane, ne asnje vend nuk permendet fillimi i proçedimit administrativ, i kerkuar me shkresen e Policise Ndertimore, dega Tirane, qe ligjerisht duhej te ishte iniciuesi i ketij rasti te shqyrtuar nga Bashkia.

Megjithate ne takimin tone me te fundit per kete problem, nga ana e Drejtorit te Drejtorise se Legalizimeve dhe Shpronesimeve, eshte konfirmuar fakti se dosja e trajtimit te rastit te kerkeses per legalizim te paraqitur nga Y.B, do t'i paraqitej Keshillit Teknik, i cili ja kalon me pas per trajtim KRRT-se prane Bashkise Tirane, ne mbledhjen e tij me te afert.

Po keshtu u konstatua se edhe pse vete personi i interesuar i cili ka kerkuar fillimin e proçedures te legalizimit, nuk ka shfaqur interes te metejshem per vazhdimin e ketij proçedimi administrativ, perseri prej Drejtorise se Legalizimeve e Shpronesimeve, atij i jane derguar nje sere njoftimesh, ndaj te cilave ai nuk ka reaguar, duke bere qe ky proçes te ngelet pezull dhe te zvarritet.

Perpjekja e Drejtorise se Legalizim Shpronesimeve per te njoftuar ne menyre te vazhdueshme palen e interesuar, ka ndikuar ne tejkalimin e afateve te percaktuara ne ligj per perfundimin e ketij proçedimi administrativ dhe eshte bere shkak per zvarritjen e marrjes se vendimit per kete rast.

Duke patur parasysh faktin se kemi te bejme me nje ceshtje te zvarritur, se procedurat perkatese nga ana e Bashkise Tirane jane zvarritur gjithashtu pa ndonje shkak te perligjur, trajtimi i ketij rasti te nxjerr ne perfundimin se kjo zvarritje eshte bere shkak per vazhdimin e gjendjes se shkeljes se te drejtave te ankueses, te drejta keto qe rrjedhin nga pronesia e saj e ligjshme.

Per sa me siper, kemi rekomanduar shqyrtimin sa me te shpejte te ketij rasti dhe marrjen e vendimit perkates lidhur me ndertimin e kundraligjshem te shtetasit Y.B, pas ezaurimit tashme te procedimit per kerkesen per legalizim, nga ana e strukturave perkatese prane Bashkise Tirane, per t'i hapur rruge me pas verpimit te mundshem te organit te Policise te Ndertimit.

Ceshtja eshte ne shqyrtim nga ana jone pasi ndaj ketij rekomandimi nuk kemi ende nje pronocim zyrtar nga ana e organeve perkates.

4. Ankesa e shtetasit I.R. nga qyteti i Vlores

Ne kete ankese eshte paraqitur shqetesimi lidhur me mosveprimin e Policise te Ndertimit, dega Vlore, persa i perket prishjes se nje ndertimi pa leje, te ngritur ne nje sipefaqe trualli, ish prone e shoqerise "Vefa", tashme e blere nga ankuesi.

Pavaresisht se prona ne fjale eshte blere ne menyre te rregullt nga ankuesi, ky i fundit ngre shqetesimin se ajo nuk po i dorezohet nga administratoret e shoqerise "Vefa" ne administrim, pasi ne nje pjese te saj eshte ngritur nje ndertim pa leje, i cili ka zene nje siperfaqe prej 162 m2.

Per kete problem, administratoret e Shoqerise "Vefa", ne administrim, i jane adresuar organit te Policise te Ndertimit, qe megjithese ka nxjerre nje vendim per prishjen e ketij ndertimi, perseri nuk ka vepruar, nderkohe qe kjo prone mbetej akoma e padorezuar.

Ne shpjegimet e dhena nga Grupi Mbikqyres, prane Keshillit te Ministrave, konfirmohet fakti se meqenese ne pronen e blere nga ankuesi me ankand, ndodhej nje ndertim i paligjshem, me ane te shkreses nr.467 date 5.09.2001, i eshte kerkuar Policise te Ndertimit, dega Vlore, prishja e ketij ndertimi.

Meqenese edhe pas disa takimeve me kryetarin e kesaj dege te Policise te Ndertimit, perseri nuk po veprohej, Grupi Mbikqyres, prane Keshillit te Ministrave, i eshte drejtuar perseri Policise te Ndertimit, dega Vlore, me nje shkrese te dyte, duke kerkuar perseri nderhyrje per prishjen e ndertimit te kundraligjshem.

Perseri nuk ka patur veprim nga organi i Policise te Ndertimit, ndaj administratori perkates i shoqerise "Vefa" ne administrim, eshte detyruar

qe per zgjidhjen e kesaj ceshtje, t'i drejtohet Drejtorise se Pergjithshme te Policise te Ndertimit, Tirane.

Ne shpjegimet e dhena nga Policia e Ndertimit, dega Vlore, konfirmohet fakti se me vendimin nr.245 date 9.04.2002, te ketij organi, eshte vendosur prishja e objektit te kundraligjshem, te ndertuar nga shtetasi Dh.K, ne siperfaqen e truallit te blere nga ankuesi.

Sipas kesaj pergjigje ekzekutimi i vendosur ne disa data qe na ishin konfirmuar me pare zyrtarisht per kete rast, nuk eshte bere i mundur per shkak te prishjes se mjetit fadrome.

Nderhyrja jone direkte dhe e vazhdueshme pas kesaj, eshte bere prane Drejtorise se Pergjithshme te Policise te Ndertimit, Tirane.

Per pasoje jemi vene ne dijeni se ne aksionin e Policise te Ndertimit, dega Vlore, ne daten 28.03.2003, eshte realizuar prishja e ndertimit te paligjshem te ngritur ne pronen e ankuesit. Duke ju dhene zgjidhje pozitive edhe kesaj ceshtje.

c. Ankesat per Ujesjelles Kanalizimet

Gjatë vitit 2003, janë shqyrtuar 4 ankesa, që kanë patur të bëjnë me ujësjellësin dhe kanalizimet. Duke e krahasuar me një vit më parë, rezulton se ato janë më të paktë.

Në të katër ankesat drejtuar Avokatit të Popullit disa konsumatore shprehin shqetesimin e tyre ne lidhje me procedurat qe ndiqnin Shoqerite Anonime te Ujesjellesit gjate instalimit te aparateve per matjen e konsumit te ujit. Ankuesit nuk nuk ishin dakort te bashkeinvestonin kundrejt nje shifre simbolike me pretendimin se eshte detyre e Ujesjelles sh.a te perballoje çdo shpenzim.

Institucioni i Avokatit te Popullit me objektivet dhe paanshmeri kontatoi me disa grupe konsumatoresh dhe u perpoq qe ti ndergjegjesonte ata ndër të tjera se vendosja e matesave te ujit si dhe masat per te perballuar pjeserisht nga ana financiare kete gjë, eshte bazuar ne akte ligjore dhe nenligjore qe mbulojne pikerisht kete fushe sherbimi publik. Edhe konsumatorët duhet te ndergjegjesohen per rolin e rendesishem qe kane vete ata per mbarevajtjen e sherbimeve publike. Respektimi i detyrimeve edhe nga ana e konsumatorit i hap rruge nje sherbimi bashkekohor ne ekonomine e tregut. Konsumatorët s'mund te pretendojne vetem te drejta, pa plotesuar detyrimet dhe pa ofruar bashkepunim.

Gjithashtu nga bashkepunimi me sherbimin e ujesjellesit ne rang Republike nisur dhe nga ankesat e disa grupe pensionistesh eshte arritur qe per konsumatorët pensioniste me te ardhura te reduktuara, te hartohen lista emerore ne menyre qe te kene lehtesira ne detyrimet e tyre.

Nga ana e Ministrise se Rregullimit te Teritorit dhe Turizmit u vume ne dijeni qe brenda muajit Korrik 2004, do te aprovohet nje Vendim i Qeverisë i cili do të bëjë të mundur përmirësimin e bazës ligjore që rregullon shërbimin e Ujësjetës.

10. Ministria e Ekonomisë

Per vitin 2003 ka patur vetëm 2 ankesa ndaj Ministrisë së Ekonomisë. Nga shqyrtimi i tyre ka rezultuar nevoja per t'u permiresuar legjislacioni perkates apo qe pjese te administrates tone shteterore duhet te permiresojne metoden e tyre te punes, per mbrojtjen e interesave te shtetasve shqiptare.

1-E para ka qene nje ankese e shoqerise "Infosoft systems", te cilen e kemi konsideruar te drejte dhe kemi dale me rekomandimin perkates.

Keshtu perfaqesuesi i shoqerise tregtare "Infosoft Systems" sh.a, ka paraqitur ankese, lidhur me ndryshimet me te fundit te bera ne Udhezimin e Keshillit te Ministrave nr.1 date 1.01.1996 "Per prokurimin publik", ku midis te tjerave ne pjesen e pergjithshme te dokumentave te tenderit, eshte shtuar edhe formulari "Autorizimi i Prodhuesit".

Sikunder shprehet ne ankese, ky formular nuk pasqyron formen aktuale te marredhenieve tregtare nderkombetare, pasi duke ju referuar permbajtjes se paragrafit te trete te ketij formulari, kerkohet qe firmat nderkombetare te autorizojne vetem nje kompani lokale per te ofruar dhe lidhur kontrate, per mallrat e prodhuara prej tyre.

Nje kerkese e tille, siç shprehet me tej ne ankese, vjen ne kundershtim me ligjin "Per konkurrencen", me parimet e tregtise se lire dhe praktiken nderkombetare te biznesit dhe si e tille, ajo nuk mund te pranohet nga firmat nderkombetare prodhuese, te cilat ne nje vend te caktuar kane te autorizuar disa kompani lokale dhe jo vetem nje.

Lidhur me sqarimin e trajtimit qe i eshte bere kesaj çështje, nga ana jone jane kerkuar paraprakisht sqarime prej Ministrise se Ekonomise dhe Agjencise se Prokurimit Publik.

Ne pergjigjen e dhene nga Agjencia e Prokurimit Publik ne baze te nje ankese te meparshme qe "Infosoft Systems" sh.a, ka paraqitur tek kjo e fundit ne lidhje me problemin e ndeshur me Formularin e Autorizimit te Prodhuesit, si pjese e dokumentave standarte te tenderit, sqaron se;

Modulet e dokumentave standarte te tenderit, te cilat do t'i vijne ne ndihme enteve prokurorese qe do te kryejne prokurimet publike ne perputhje me ligjin e prokurimit publik dhe aktet nenligjore te tij, jane

miratuar nga Keshilli i Ministrave, me Udhezimin e Keshillit te Ministrave nr.3, date 10.07.2003 “Per disa ndryshime ne UKM nr.1 date 1.01.1996 “Per prokurimin publik”.

Keto akte nenligjore, si edhe dokumentat standarte ne kete rast, jane fryt i bashkepunimit ne grupe pune nderdikasteriale, te cilat sipas pergjigjes, futen ne fuqi pas miratimit qe i behet nga Keshilli i Ministrave.

Keshtu ne kuader te projektit te Bankes Boterore “Per reformen ne Administraten Publike”, eshte firmosur kontrata me firmen konsulente ILI per hartimin e dokumentave standarte te tenderit, te cilat pasi jane rishikuar nga kjo firme, jane diskutuar gjeresisht ne grupin e punes te ngritur me perberjen e specialisteve te Agjencise se Prokurimit Publik dhe te enteve qendrore prokuruese.

Ne vazhdim ne pergjigjen e Ministrise se Ekonomise per kete problem, ne pak fjale thuhet se me kerkesen e autorizimit te prodhuesit si kerkese e dokumentave standarte te tenderit, kjo ministri ka zbatuar aktet ligjore dhe nenligjore ne fuqi, te cilat kane te bejne me proçedurat e prokurimit publik.

Veç argumentimit proçedural per nxjerrjen e Udhezimit te Keshillit te Ministrave perkates, konstatohet fakti se ne te dy pergjigjet e dhena per kete problem, nuk ka argumentim ligjor per bazueshmerine e Formularit te Autorizimit te Prodhuesit.

Ajo çfare te ben pershtypje nga ky formular, eshte pikerisht paragrafi i 5-te i tij, ne te cilin thuhet shprehimisht se: *“Asnje firme ose kompani tjeter perveç (emri dhe adresa e ofertuesit) nuk autorizohet te ofroje, negocioje dhe lidhe kontrate per mallrat tona”*.

Ky deklarim duhet te vije nga prodhuesi direkt i mallit, mall i cili kerkohet qe te ofertohej ne proçeduren perkatese te tenderimit.

Per nga menyra e formulimit te ketij paragrafi, te krijohet idea se ligjvenesit ka dashur te paraqese dhe afroje perfaqesuesin eskuziv te perfaqesimit te nje kompanie apo firme prodhuese, ne nje proçedure tenderimi.

Ne rastin konkret nepermjet formularit te autorizimit te prodhuesit, ndodhemi perpara faktit te nje kerkese apo propozimi per lidhjen e nje kontrate te mundshme te mevonshme, e cila i pergjigjet levrimit te nje malli qe ne kuptimin e gjetjes se tij ne treg, eshte i zevendesueshem per aq sa ai ofrohet nga disa subjekte ne treg dhe jo vetem nga nje.

Nga ana tjeter, kemi gjykuar se deklarimi i origjines se mallit nuk ka asgje te keqe ne nje proçedure tenderimi, perkundrazi krijon kushtet per prokurimin e nje malli me cilesor dhe me te kontrolluar, si dhe forcon kontrollueshmerine ne marredheniet e kontraktimit mes paleve. Sikurse eshte percaktuar ne nenin 7, te pjeses se Dokumentave Standarte te

Tenderit, (origjina e mallrave), nuk ka kufizime ne procedurat e tenderimeve ne kete aspekt veç atyre te percaktuara me ndonje Rezolute te Asamblese se Pergjithshme te Kombeve te Bashkuara.

Ne rastin konkret ka nje rezonance mes percaktimeve per deklarimin e origjines dhe faktit se kemi nje kerkese per autorizim te nenshkrimt te kontrates, per levrimin e nje malli qe do te prokurohet ne nje treg tjetër lokal, mes pjesmarresit ne tender dhe prodhuesit fillestar te mallit.

E kemi thene kete pasi jo vetem ne ligjin aktual ne fuqi "Per prokurimin publik", por edhe ne ligjin "Per konkurencen", nuk ka percaktime te cilat e ndalojne nje konkurence sa me te madhe ne treg dhe ne kushtet e respektimit te rregullave te konkurences.

Fakti qe ne autorizimin e prodhuesit jepet nje percaktim sikurse ne paragrafin e peste te tij, nuk do te thote gje tjetër veçse nje kufizim qe i behet pjesmarrjes sa me te gjere, nepermjet nje autorizimi nominal shume strikt, qe ne fund te fundit kushtezon edhe vete prodhuesin ne marredheniet e tij kontraktore me te tretet.

Zyra jone konkludoi se ankuesi me te drejte e sheh ekzistencen e ketij formulari ne rastin konkret per tregtine e mallrave kompjuterike, si kerkese qe vjen ne kundërshtim me parimet e ligjit per konkurencen dhe praktiken nderkombetare te biznesit, pasi autorizimi vetem ndaj nje firme qe operon ne tregun lokal nga ana e prodhuesit, jo vetem qe perben kufizim ndaj ketij te fundit, por edhe perben limitim dhe reduktim te konkurrences ne nje treg te caktuar, sikurse edhe tregu yne.

Pikerisht per kete arsye i kemi sugjeruar Keshillit te Ministrave revokimin e paragrafit qe parashikon formularin e "Autorizimit te Prodhuesit", ne kapitullin e trete te UKM nr.1 date 1.01.1996 "Per prokurimin publik", ndryshuar me UKM nr.3 date 10.07.2003 "Per disa ndryshime ne UKM nr.1 date 1.01.1996 "Per prokurimin publik".

Per kete rekomandim akoma nuk kemi marre asnje pergjigje.

Se dyti Sindikata e Pavarur e punonjesve te Transportit ka derguar nje ankese prane Institucionit te Avokatit te Popullit me ane te se ciles parashtronin se;

Kantjeri detar "Durrës-Gdansk" Sh.a. me shumice aksionesh rreth 56% kryesohej nga firma polake "Gdanska Stoczina Remontova Im.J. Pilsduskiego". Kjo firme beri shitjen e pjeses se kapitalit firmes turke "Kurrum Internacional". Lidhur me faktin e kalimit te shumices se kapitalit firmes turke "Kurrum Internacional", punetoret nuk ishin dakort per keto arsye;

-Firma polake "Gdansk" ishte debitore karshi Institutit te Sigurimeve Shoqerore sepse nuk kishte derdhur kontributet qe nga fillimi i aktivitetit te saj per punetoret.

-kjo firme ishte debitore karshi shtetit p.sh. ne rastin i mospagimit te energjise elektrike, tatim taksa etj.

Nga hetimet e ndermarra nga zyra jone ne Ministrine e Ekonomise, morem dokumentacionin perkates, dhe na sqaruan se eshte parashikuar ne kontraten per kalimin e aksioneve midis Gdansk dhe Kurum Internacional, kalimi i te gjitha te drejtave dhe detyrimeve kesaj te fundit, natyrisht duke u perfshire ketu dhe detyrimet e sigurimeve shoqerore te prapambetura.

Momenti qe zyres sone i intereson dhe ne te cilin bazohet thelbesisht pretendimi i punetoreve eshte shlyerja e detyrimeve te sigurimeve shoqerore, pavaresisht se ishte marre persiper shlyerja e tyre, nuk ishte bere pagesa edhe per detyrimin e 6 punetoreve qe kishin mbushur moshen per pension.

Nga hetimet tona doli se;

Per sa i perket kontributeve te sigurimeve shoqerore per punetoret e Shoqerise Gdansk dhe sot " Kurrum" Durres, rezultoi se qe nga viti 1996 prane ketij organi referuar legjislacionit si detyrime te sigurimeve shoqerore duhet te ishin derdhur;

Ne total

detyrimi-----99.292.778 leke

Kamate vonesat-276.734.744 leke

Sikunder eshte lehtesisht e konstatueshme kamatevonesat jane nje shume e kosiderueshme krahasuar me detyrimin.

Instituti i Sigurimeve Shoqerore duke patur parasysh borxhin e madh te kesaj shoqerie ku 44% i takon pales shtet ishte ne fazen e hartimit te nje projektligji, te paraqitur ne Keshillin e Ministrave dhe me pas per miratim nga Kuvendi, me objekt faljen e kamate vonesave Shoqerise Gdansk(Kurum) te Portit te Durresit.

Tashme ky ligj eshte miratuar dhe kane perfituar dhe subjekte te tjera qe kane patur probleme me mospagesen e kamate vonesave te sigurimeve shoqerore.

Ministria e Ekonomise dhe Ministria e Punes dhe Çeshtjeve Sociale ne rolin e ndermjetesit kolektiv pergatiten nje projekt marreveshje me ane te se ciles dy palet ISSH dhe Shoqeria "Kurum International" njohen dhe deklarojne detyrimin per strukturimin e detyrimeve ku eshte percaktuar shuma, kohet dhe afatet e shlyerjes. Nepermjet nje grafiku te noterizuar te ristrukturimit te detyrimeve nga ana e shoqerise "Kurrum" dhe ISSH, ju

dha zgjidhje çeshtjes per pagesat per ata punonjes qe kishin mbushur moshen per pension.

11. Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit

Gjatë vitit 2003 për Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit dhe për institucione ose organizma që kanë si objekt veprimtarinë dhe problemet e bujqësisë dhe të ushqimit janë gjithsej 58 ankesa, ndaj 79 që kanë qënë në vitin 2002. Në favor janë zgjidhur 4 ankesa apo kërkesa.

a) Ankesa për peshkimin dhe akuakulturën.

Kanë qënë tre ankesa me objekt mos-dhënien e licensave për aktivitete ekonomike që liçensohen nga kjo Ministri, dy prej të cilave në ushtrimin e veprimtarisë për peshkim profesional, si dhe për ruajtjen, zhvillimin dhe shfrytëzimin e eko-sistemit përkatës. Ankesa që i takonte shoqërisë “ Miqtë e Ramsarit”, me qëndër në Divjakë të Lushnjës, është zgjidhur pozitivisht me marrjen e liçensës përkatëse nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit. Ndërsa dy të tjerat janë ende në shqyrtim.

b) Ankesa për çështje të Ligjit “Për Tokën”

Ankesat që kanë të bëjnë me zbatimin e Ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 “Për Tokën” dhe kontestimet e ish pronarëve të tokave bujqësore lidhur me të, duket sikur janë ulur ndjeshëm në krahasim me dy vitet e fundit. Kështu nga 64 ankesa të tilla për vitin 2002, në vitin që lamë pas ishin 49. Por për një pjesë të konsiderueshme pas tyre, janë me dhjetra familje që ndajnë mes tyre të njëjtin shqetësim me një ankesë. Janë përfunduar 26 ankesa dhe 23 të tjera janë në shqyrtim.

Objekti i ankimit dhe problemet e ndarjes së tokës bujqësore në zbatim të Ligjit nr.7501, datë 19.7.1991, “Për Tokën”, vazhdojnë të mbeten të njëjta. Komisionet e Tokave në shumë fshatra nuk funksionojnë. Edhe atje ku janë formalisht, përfshi edhe ato të Komunave e në shumë raste edhe në Qarqe, nuk kanë vullnetin e duhur për zgjidhjen e ankesave të shtetasve. Nuk dërgojnë në kohë sqarimet përkatëse të kërkuara për çdo pretendim të familjeve bujqësore për mos dhënie të tokës në pronësi ose mos plotësim me të sipas normës së caktuar për çdo fshat, por edhe në rastet kur na i përcjellin, kanë vetëm justifikime të natyrës “që nuk ka më tokë për t’u ndarë”, “s’jemi në dijeni të një ankimi të tillë”, “ja kemi dërguar Komisionit të Tokës së Qarkut për ta zgjidhur”, etj.

Përmendim kështu vonesat dhe mos veprimet e pamotivuara për shumë kohë të Komisioneve të Tokave në Bashkitë e Laçit, të Mamurrasit dhe Komunës së Rrashbullit në rrethin e Durrësit për zgjidhjen e ankesave të shtetasve D.Gj, H.D, E.Sh, e të tjerë. Ka komisione të cilat herë premtojnë një trajtim të shpejtë të ankesave dhe herë heshtin për këto premtime.

Tepër problematike janë ankesat e grup-familjeve nga disa fshatra në rrethin e Shkodrës. Kështu në Boriç të Vogël ka probleme mjaft të mprehta me ndarjen e tokës bujqësore, të cilat janë bërë të ditura në të gjitha instancat shtetërore. Komisioni i Tokës i Qarkut Shkodër ka marrë vendim që problemi të trajtohej nga Komisioni i Tokës së Komunës brënda muajit Maj të vitit 2002. Deri tani nuk është bërë asnjë veprim konkret dhe për më tepër asnjë nuk të jep sqarime pse dhe ku ka ngecur kjo çështje. Në fshatin Rrenc të Komunës Guri i Zi ka një shqetësim të 16 familjeve që nuk janë plotësuar me tokë bujqësore në pronësi. Fillimisht ju është dhënë në përdorim një sipërfaqe prej 45.000m² tokë brënda territorit të Radio-Shkodrës. Por pas humbjes së gjyqit për konflikt pronësie me të, kanë mbetur pa tokë dhe nuk shohim asnjë impenjim për t'i dhënë rrugë zgjidhje. E njëjta situatë është edhe në fshatin Shkëzë, po në rrethin e Shkodrës, ku prej vitit 1993 ka një konflikt për kufinj të tokave bujqësore me ato të Bushatit. Komisioni i Tokës së Qarkut Shkodër edhe për këtë rast, si në dy të parat, nuk vepron, kur këto probleme, në bazë të VKM nr.230, datë 22.7.1991, "Për krijimin e Komisioneve të Tokave" janë në kompetencë të tij për t'ju dhënë zgjidhje.

Një grup i veçantë ankesash janë ato që kanë të bëjnë me tokat e ish Ndermarjeve Bujqësore. Në rrethet e Korçës, Vlorës dhe Elbasanit janë pezulluar prej më se një vit, pjesërisht ose tërësisht, aktet e Marrjes së Tokës në Pronësi në tokat e NB-ve dhe asnjë Komision, përfshi edhe atë të krijuar pranë Qeverisë, nuk po i jep zgjidhje problemit. Në rastin e ndarjes së tokave të ish-NB Korçë, ish Zv/Kryeministri, zoti Skënder Gjinushi me shkresën e tij nr.1765, datë 6.6.2002, i është drejtuar Prefektit të Qarkut Korçë për ngritjen e një grupi pune për rishikimin dhe evidentimin e praktikave të ndarjes së tokës që rezultojnë me probleme, duke veçuar ato që mund të zgjidhen në rrugë administrative dhe ato që do të zgjidhen gjyqësisht. Ndërsa në zbatim të Urdhërit nr.154, datë 23.10.2001 të Kryeministrit, u ngrit një grup kontrolli nën drejtimin e Departamentit të Kontrollit të Brëndshëm Administrativ për evidentimin e problemeve që kanë dalë në lidhje me veprimtarinë e Komisionit të Ndarjes së Tokave, ish-Komisionin e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve dhe Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Palujtëshme Korçë, përse i takon

ndarjes së sipërfaqes prej 209 ha tokë të ish NB Korçë. Ky Komision, pasi mori edhe mendimin e Grupit të ekspertëve të ngritur nga Prefektura e Korçës, verifikoi të gjitha Aktet e lëshuara nga Komisionet e mëparëshme të Tokave dhe veprimtarinë e Komisioneve të permendura më lart, propozoi pezullimin e aktivitetit të tyre lidhur me tokat e NB-së duke lënë edhe një afat prej 90 ditësh për plotësim dokumentacioni nga bashkëthemeluesit e të tjera veprime konform legjislacionit përkatës Ky afat ka kaluar disa herë dhe me keqardhje konstatohet se asnjë organ apo person nuk po merr përgjegjësitë e duhura për rifillimin e procesit. Institucioni jonë do të bëjë sugjerimet dhe rekomandimet përkatëse për të filluar sa më shpejt puna e Komisioneve të Tokave, e Komisionit të Kthimit dhe Kopsimit të Pronave dhe e ZRPP në rrethin dhe Prefekturën e Qarkut Korçë për të futur në rrugën e zgjidhjes trajtimin e tokave të NB Korçë.

Të njëjtën gjë mund të themi për ankesën e një grupi banorësh të fshatit Rrajcë të Librazhdit që kanë pretendime për ndarjen e tokës në zonën e Qafë Thanës, në kufirin midis rretheve të Elbsanit dhe Librazhdit. Me gjithë ndërhyrjet tona dhe korrespondencën e dëndur me Komisionet e tokave në Komunat përkatëse, në Komisionin e Tokës pranë Qarkut Elbasan, në Drejtorinë e Menaxhimit të Tokave në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit, problemi mbetet në të njëjtin nivel. Në njoftimin e fundit të drejtorisë së sipër-përmendur, se procedurat përkatëse janë pezulluar në bazë të Urdhërit të Kryeministrit nr.265, datë 1.10.2002, “Për evidentimin dhe ndërprerjen e procedurave të tjetërsimit ose dhënies me qira të pronës shtetërore, tokës bujqësore, pyjore, livadhe dhe kullota”

Për këtë tablo të gjëndjes faktike për ankesat e shtetasve që pretendojnë se ju janë shkelur të drejtat dhe interesat e tyre të ligjshme në fushën e zbatimit të Ligjit “Për tokën”, mendojmë se përpjekjet tona me ato mjete ligjore që na ka dhënë vetë ligji, nuk kanë dhënë rezultatet e pritura. Të shpresojmë se titullarët e organeve të pushtetit vendor të ri, të dala pas zgjedhjeve të tetorit 2003, që njëkohësisht janë edhe Kryetarë të këtyre Komisioneve, të kenë përkushtimin e zgjidhjes së shpejtë të tyre. Këtë e bazojmë në përgjigjet e ardhura kohët e fundit, si në rastet e Kryetarëve të Komunave Gjoricë të Bulqizës dhe Golem të Kavajës, që na kanë premtuar trajtim të shpejtë të këtyre rasteve.

c) Ankesa për pasurinë e ish kooperativave bujqësore

Ka vetëm një ankesë të tillë nga shtetësja K.N, banuese në Gjirokastrë, që kërkon kontributin e bashkëshortit të saj për punën e bërë si

veteriner, në kooperativën e Sofratikës deri në vitin 1987, kur ka dalë në pension.. Eshhtë në ndjekje.

ç) Probleme për pyjet

Për Drejtoritë e Shërbimit Pyjor kanë qënë vetëm 4 ankesa. Tre prej tyre janë zgjidhur në favor të ankuesve, ndërsa e katërta ka rezultuar e pabazuar.

Kështu pozitivisht janë zgjidhur ankesat e shtetasve M.B. dhe B.XH. për Drejtoritë e Shërbimit Pyjor të rretheve Devoll e Lushnjë, që nuk ju dorëzonin me proces-verbal, sipas akteve nënligjore, sipërfaqet pyjore të kthyer në natyrë me vendim të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Mbi bazën e rekomandimeve tona u bë e mundur dorëzimi fizik i pronave pronarëve legjitimë. Çështja tjetër e zgjidhur në favor të ankuesit F.B, kishte të bënte me dhënien e lejes profesionale nga Komisioni i Lejeve Profesionale në Drejtorinë e Përgjithëshme të Pyje-Kullotave për ushtrimin e aktivitetit për studim, projektim dhe shfrytëzimin e pyjeve.

Këto janë tregues të mjaftueshëm të mirëkuptimit dhe bashkëpunimit të frutshëm midis Institucionit të Avokatit të Popullit dhe Drejtorisë së Përgjithëshme të Pyje-Kullotave për vitin 2003.

d) Probleme për cilësinë e ushqimeve

Ka patur vetëm një ankesë, që ka të bëjë me forcimin e kontrollit veterinar për therjet ende të pakontrolluara të bagëtive në disa qytete. Problemi është i rëndësishëm, është vlerësuar nga ana jonë dhe çështja është në ndjekje.

e) Ankesa për Drejtoritë e Bujqësisë dhe Ushqimit në rrethe.

Nuk ka patur asnjë ankesë për vitin 2003.

12. Ministria e Financave

Numri i ankesave, kërkesave dhe njoftimeve drejtuar Avokatit të Popullit nga shtetas dhe subjekte tregtare për shkeljen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të tyre nga administrata financiare, ku përfshihen Ministria e Financave, organet doganore tatim-taksat dhe Agjensia Kombëtare e Privatizimit, për vitin 2003 është 48. Nga ky numër, duke

zbritur numrin e ankesave te AKP-së, 15 e cila do të trajtohet në temë të veçantë, rezulton se 16 ankesa janë ende në shqyrtim, 3 janë gjetur të pabazuara, 6 janë shpallur jashtë juridiksionit, 5 janë konsideruar me mungesë kompetence dhe 3 ankesa janë zgjidhur në favor që në fazën e parë të ndërhyrjes dhe verifikimit të tyre.

Në lidhje me ankesat në fushën financiare, do të trajtojmë disa prej tyre, të cilat janë zgjidhur në mënyre pozitive.

1. Shtetasja V.P me banim në Tiranë ka paraqitur një ankesë në të cilën pretendonte se Dega e Bankës së Kursimeve Nr.4 Tiranë pengonte veprimet bankare me prokurë që kryheshin nga ana e saj. Pasi u njoh me këtë ankesë dhe e vlerësoi të drejtë, Avokati i Popullit ndërhyri pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Bankës së Kursimeve. Drejtori konfirmoi më vonë se pengesat ishin krijuar nga keqinterpretimi i një udhëzimi të Bordit të Bankës së Kursimeve, ku jepej direktiva e kontrollit të prokurave të vjetra. Pas kësaj, shtetases në fjalë i është dhënë mundësia të kryjë me lehtësi procedurat bankare për të cilat u ankua.

2. Subjekti privat me qëndër në Durrës, përfaqësuar nga shtetasi F.L paraqiti ankesën pranë Avokatit të Popullit, sepse dy doganierë të Doganës, dega Shkozet Durrës, kishin bërë bllokimin e mallit të tij të importuar, duke mos dhënë shpjegime apo argumentime ligjore mbi këtë veprim. Shtetasi në fjalë pretendonte sipas tij, se ky problem kishte natyrë të dyshimtë, sepse mendonte se ishte nje sinjal kërkese për rushfet. Menjëherë u kërkuan shpjegime pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe u kontaktua me Drejtorinë e Doganës, dega Durrës. Në përfundim të këtyre veprimeve u arrit që me shpejtësi të zhblokohet malli, ndërkohë që për nëpunësit e doganës, Prokuroria e Durrësit ka filluar ndjekje penale në bazë të kallzimit të shtetasit F.L.

3. Nëpunësi U.S i Drejtorisë së Doganës, dega Durrës depozitoi një ankesë pranë Avokatit të Popullit, duke ngritur shqetësimin se dy inspektorë të Policisë Kriminale pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Durrës, në mungesë të veprimeve të rregullta dhe dyshimeve të arsyeshme, pasi kishin kryer një kontroll dokumentacioni për automjetin në pronësi të ankuesit, kanë bërë ndalimin e tij në Komisarjat, duke kaluar dokumentacionin në Prokurori. Për këtë çështje shtetasi ka dalë përpara Gjykatës, e cila në përfundim të shqyrtimit gjyqësor ka hedhur poshtë akuzën e ngritur, duke shpallur të pafajshëm shtetasin U.S. Në këto kushte pozita e ankuesit vazhdonte të ishte e rënduar, sepse mbi të rëndonte një akt pezullimi në detyrë. Avokati i Popullit, pasi u njoh me këtë ankesë, ka kryer menjëherë verifikimet dhe ndërhyrjet e tij dhe në përfundim të tyre, Drejtorja e Përgjithshme e Doganave ka bërë të mundur rikthimin në punë

të këtij shtetasi. Kurse për dy inspektorët e Policisë Kriminale Durrës, është konfirmuar se janë marrë masa disiplinore në lidhje me këtë ngjarje.

Në ankesat që kemi në shqyrtim, bëhet fjalë për mungesa të transparencës në veprimet administrative të organeve doganore e tatimore, trajtim të pa barabartë në dëm të disa subjekteve private; për abuzime dhe qëndrime korruptive e diskretituese të administratës financiare. Në këtë kuadër nuk mund të lëmë pa përmendur se shkakun që çështjet janë në shqyrtim është se administrata doganore ose tatimore, në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe në neglizhencë të plotë, nuk kthen përgjigje ndaj kërkesave për shpjegime të dërguara nga Avokati i Popullit, duke shkaktuar probleme serioze në hetimin dhe përfundimin e ankesave brenda një afati të arsyeshëm. Ndër shkaqet të tjera për këtë gjendje jo të mire në administratën publike të sektorit të Financës mendojmë se janë mosnjohja e Kushtetutës, Kodit të Procedurave Administrative, Kodit të Punës, Ligjit “Statusi i Nëpunësit Civil” ku vendosen rregulla për detyrimin e administratës në njohjen e mjaft të drejtave ndaj individëve

Avokati i Popullit ka vazhduar të kërkojë që të zbatohen vendimet gjyqësore për detyrimet që prekin buxhetin e shtetit. Ky problem madhor mori një përqëndrim të madh vëmendje në Konferencën Kombëtare të organizuar nga Avokati i Popullit në bashkëpunim me Komitetin Shqiptar të Helsinkit për vitin 2003, ku ekzekutimi i vendimeve gjyqësore si temë e këtij aktiviteti, u mundua të ngrihej në një çështje që i përket të gjithëve në procesin e ndërtimit të shtetit ligjor. Avokati i Popullit edhe në të ardhmen do të synojë të evidentojë dhe ndërhyjë për fenomene që vihen re në keqadministrimin e organeve të administratës publike financiare në raport me të drejtat dhe liritë themelore të individit.

a. Agjensia Kombëtare e Privatizimit

Në vitin 2003 kjo Agjensi ka kaluar nga vartësia e Qeverisë në vartësi të Ministrisë së Financave.

Për vitin 2002 ka patur 28 ankesa ndaj kësaj Agjensie, nga të cilat vetëm një është ende në procesin e shqyrtimit pranë Zyrës sonë. Në vitin 2003 ka patur 15 ankesa ndaj kësaj Agjensie. Nga këto 8 kanë qenë jashtë juridiksionit, 2 kanë rezultuar të pabazuara, dhe 5 ankesa janë ende në fazën e shqyrtimit. Për ankesat që kanë rezultuar të pabazuara ose jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit, ankuesve ju janë sqaruar dispozitat përkatëse ligjore, sidomos pretendimet nga ish-pronarët e trojeve lidhur me shkeljen e të drejtës së parablerjes së objekteve. Për të krijuar një ide për ankesat që kanë lidhje me AKP, po japim si shembull dy ankesa:

1. Shtetasi N.K. ka kërkuar nderhyrjen e Avokatit te Popullit për të privatizuar një objekt, në bazë të së drejtes së parablerjes si ish-pronar trualli, siç e përcakton neni 21 i Ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish pronarëve”. Kjo ankesë është cilësuar si e pabazuar, për arsye se nuk rezultoi që ankuesit t’i ishte shkelur ndonjë e drejtë nga veprimet e administratës vendore apo qendrore, sepse objekti nuk ishte privatizuar. Do të ndodheshim para shkeljes konkrete, nëse objekti do t’i ishte privatizuar nga ndonjë person tjetër. Pavarësisht kësaj, ankuesit i janë dhënë sqarimet e nevojshme lidhur me përcaktimet ligjore në mënyrë që ai të përfitojë nga cilësia e tij si ish-pronar trualli dhe si dhe cilave organe t’ia drejtojë kërkesën për parablerjen e objektit.

2. Shtetasi I.K. pretendonte mohimin që i ishte bërë, si ish pronar trualli, të të drejtës së parablerjes së disa zyrave të ish Minierës së Hekur-Nikelit në Prrenjas, të cilat kishin kaluar në fond banesash.

Nga shpjegimet perkatëse nga Bashkia e Prrenjasit, rezultoi se:

Ministri i Industrisë dhe Energjitikes, në bazë të pikës 2 të VKM nr.153, datë 3.4.1993 “Për kalimin e objekteve të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore” ka vendosur kalimin kapital të katit të dytë dhe të tretë te objektit “Zyrat e Ndërmarrjes” nga Miniera e Hekur-Nikelit Prrenjas, në Bashkinë e Prrenjasit. Me Vendim të Këshillit të Bashkisë Prrenjas ishte vendosur kalimi i këtyre zyrave nga pronë e bashkisë në fond banese, për 6 familje, të cilat që nga viti 1989 kishin banuar si qiramarrës. Më pas po me Vendim të Këshillit Bashkiak, këto zyra ju kaluan në pronësi 6 familjeve të sipërpërmendura kundrejt vlerës perkatëse.

Eshtë e vërtetë se në nenin 21 të Ligjit nr.7698, date 15.4.1993 “Për kthimin e kopmensemimin e pronave ish pronarëve” parashikohet se: “Në trojet, tokat bujqësore ose jobujqësore të zëna me ndërtime shtetërore, si dyqane, magazina, punishte etj, ish pronarët kanë të drejtën e parablerjes së këtyre objekteve kur privatizohen me çmimet e përcaktuara sipas dispozitave ne fuqi”. Por rasti konkret është i ndryshëm. Nuk është bërë privatizimi i objekteve nga organi kompetent i ngarkuar me kalimin e pronësisë së paluajtshme nga shtetërore në private, AKP-ja, sipas frymës së legjislacionit të privatizimit, por zyrat kanë kaluar në fond banese në bazë të të drejtave që kanë titullarët e institucioneve në vartësinë e të cilave ato janë, si dhe të organeve të pushtetit vendor.

Këtu mund të ketë edhe ndonjë boshllëk ligjor, por gjithsesi në kushtet e legjislacionit ekzistues, konkluduar se nuk kishte shkelje të të drejtës së ankuesit, si pronar trualli, apo të mohimit të të drejtës së parablerjes së objekteve të ndërtuara mbi të. Për këtë u sqarua ankuesi, por

nisur nga arsyetimi se çdo kontratë shitje e një pasurie të paluajtshme, sipas parimeve të mbrojtjes së pronës në të drejtën tonë civile, është e kontestueshme vetëm në rrugë gjyqësore dhe se në asnjë rast ato nuk mund të deklarohen si të pavlefshme pa një proces të rregullt gjyqësor, është orientuar ankuesi që nëse e konsideron të nevojshme t'i drejtohet Gjykatës së rrethit Librazhd, e cila me vendimin e saj përfundimtar dhe të formës së prerë do të vendosë për ligjshmërinë ose jo të tyre.

13. Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Gjatë vitit 2003 rezultojnë 42 ankesa apo kërkesa të ardhura ndaj Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe institucioneve në vartësi të saj. Janë në fazën e shqyrtimit pranë Zyrës sonë 16 ankesa. Në favor janë zgjidhur 6 ankesa apo kërkesa, kanë qenë jashtë juridiksionit 18 ankesa, kurse të pabazuara kanë qenë 2 ankesa. Ndërsa nga viti 2002 janë mbartur për shqyrtim 21 ankesa, nga të cilat 3 janë zgjidhur në favor, 11 jashtë juridiksionit dhe 3 të pabazuara.

Një numër i konsiderueshëm ankesash kanë patur si objekt problemet e largimeve nga puna të mësuesve apo transferimeve nga një vend pune në një tjetër nga ana e Drejtorive Arsimore në rrethe. Për këto ankesa janë orientuar ankuesit që të konsumojnë shkallët e ankimit administrativ, e më pas t'i drejtohen nëse është e nevojshme Zyrës së Avokatit të Popullit.

1-Një grup profesorësh të Fakultetit të Mjekësisë, janë ankuar për daljen në pension. Në aspektin ligjor rezultoi se ishin shkelur dispozitat e Kodit të Punës, që parashikojnë afate taksative për njoftimet, në varësi të zgjatjes së marrëdhënieve të punës. Gjithashtu disa të drejta që burojnë nga mbarimi i marrëdhënieve të punës nuk ishin ezauruar dhe nuk rezultojnë të ishin zbatuar.

Duke e gjykuar se përvoja e tyre e çmuar në fushën e mjekësisë, që duhet t'i transmetohet brezave të rinj dhe të ndërthuren harmonikisht me rritjen profesionale të më të rinjve, i kemi propozuar Ministrisë së Arsimit dhe Dekanit të Fakultetit të Mjekësisë, që me mirëkuptim dhe tolerancë të rikonsiderojnë vendimin administrativ Nr. 15 date 4.09.2003 për daljen e tyre në pension, pasi dhe vetë Udhëzimi i Rektoratit ka lënë hapësirë ligjore për veprim. Dekani nuk e mori parasysh rekomandimin tonë dhe ankuesit e kanë bërë çështjen objekt konflikti në Gjykatën e Tiranës.

2-Në raportin e vitit të kaluar kemi parashtruar ankesën e shtetas M.M., ish-asistent pedagogje në Departamentin e Filozofi-Sociologjisë pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, që kontestonte aktin administrativ

nr.6 datë 12.03.2001 të Dekanit të Fakultetit të Shkencave Sociale, që e kishte larguar nga puna. Pas shqyrtimit gjyqësor të problemit ishte vendosur përfundimisht pavlefshmëria e aktit administrativ të mësipërm dhe Fakultetit të Shkencave Sociale i lindi detyrimi për kthimin e ankueses si as/pedagoge. Zyra jonë i ka rekomanduar Rektorit të Universitetit të Tiranës ushtrimin e kompetencave ligjore për ekzekutimin e Vendimit Gjyqësor, që nuk ishte pranuar të zbatohet nga ana e Dekanit të Fakultetit të Shkencave Sociale.

Pas zgjedhjes së Rektorit të ri të Universitetit Z.Shezai Rrokaj, ky i fundit e ka pranuar rekomandimin e Zyrës sonë lidhur me këtë çështje, dhe ankuesja është kthyer në punë.

3-Shtetësja L.C. u ankua për faktin që nga ana e Dekanit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja nuk ju bë e mundur pajisja me diplomë.

Ky i fundit, në mënyrë verbale, i sqaronte ankueses se nuk pranonte të vendoste në diplomë fotografinë, ku ankuesja kishte dalë me shami si praktikante e fesë myslimane, duke përmendur si argument të vetëm faktin se shkolla është laike.

Për zgjidhjen e kësaj çështjeje i jemi drejtuar Dekanit të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, në veprimet e të cilit ishin konstatuar disa shkelje administrative.

Kështu, nisur nga fakti se një organ administrativ shprehet nëpërmjet akteve administrative, në rastin konkret vendimeve, Dekanit ju shpjegua se edhe kur ato janë verbale nevojiten të arsyetohen nga organi që i nxjerr ato. Pra, dhënia e arsyeve për nxjerrjen e një akti administrativ përbën një detyrim ligjor, bazuar në nenin 108/a të Kodit të Proçedurave Administrative.

Në të njëjtën kohë, nxjerrja e një vendimi të arsyetuar nga ana e organit administrativ, i jep mundësi ankueses, të parashtrojë më mirë ankimin e saj, në organin më të lartë në shkallë hirarkie, në Rektorat, e më pas në Ministrinë e Arsimit, dhe në përfundim i jepet mundësia e kontrollit gjyqësor të veprimtarisë administrative. Pra referuar nenin 18 të Kodit të Proçedurës Administrative, në mënyrë që të mbrohen të drejtat kushtetuese e ligjore të individit, ky i fundit duhet të pajiset me aktin konkret të nxjerrë nga vetë organi në lidhje me këtë çështje. Pra shprehja “Shkolla është laike” në rastin konkret nuk mund të konsiderohet si arsyesim i një akti administrativ.

Pas kërkesës për shpjegime, e cila ju dërgua në të njëjtën kohë dhe Rektorit të Universitetit të Tiranës, çështja mori zgjidhje pozitive dhe ankuesja u pajis me diplomë duke ju pranuar fotografia me shami.

14. Ministria e Shëndetësisë

Gjatë vitit 2003 për Ministrinë e Shëndetësisë dhe institucionet në vartësi të saj janë shqyrtuar gjithsej 24 ankesa. Nga këto 5 kanë qënë të mbartura nga viti 2002. Janë përfunduar 16 ankesa, 3 janë zgjidhur në favor, 3 kanë rezultuar të pabazuara dhe 10 kanë qënë jashtë juridiksionit dhe kompetencës sonë. Janë mbartur 8 ankesa për shqyrtim në vitin 2004.

Problematika e çështjeve që kanë të bëjnë me këtë ministri ka qënë kryesisht lidhur me vendimet e lëvizjes në detyrë, transferime, mospërfitim statusi si tetraplegjikë, ankesa lidhur me tregtimin e medikamenteve nga persona që nuk janë të pajisur me liçensë, mosrimbursim të ilaçeve, zvarritjen e procedurave dhe mos transparencën nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë në lidhje me pajisjen e lejes të transferimit të një farmacie, mosekzekutim vendimi gjyqësor etj.

Nga ankesat e përfunduara përmendim;

1. Shtetasi A.D me banim në Tiranë, është ankuar në lidhje me zvarritjen e procedurave dhe mos transparencën e Ministrisë së Shëndetësisë në lidhje me pajisjen e lejes të transferimit të farmacisë së tij që ishte licencuar po nga kjo Ministri.

Kështu, ai ka shpjeguar se prej kohësh nuk mund të pajisej me një kopje të lejes së transferimit të farmacisë së tij për shkak të zvarritjeve të pajustificuara të procedurave nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë.

Pas një korespondence të gjatë dhe kontaktimeve të vazhdueshme me Sekretaren e Përgjithshme të Ministrisë së Shëndetësisë u arrit që problemi i ankueses të zgjidhej pozitivisht.

2. Ankesa e M. K. Drejtoreshë e Kujdesit Shëndetësor Parësor, në Autoritetin Shëndetësor Rajonal Tiranë, për urdhrin e pezullimit të saj nga puna deri në mbledhjen e Bordit Drejtues. Ajo padrejtesisht akuzohej për thyerje të përsëritura të etikës në punë dhe paaftësi në drejtim. Ajo me tendencë ishte ndëshkuar edhe me masa të tjera administrative si “tërheqje vëmendje”, “paralajmërim për pushim nga puna” dhe “largim nga detyra si drejtoreshë”. Pas verifikimit në vend të ankesës nga ana jonë i është drejtuar një rekomandim Kryetarit të Bordit Drejtues të ARSH-së, ku bëheshin të njohura sa më sipër. Rekomandimi u vlerësua nga ana e Bordit dhe ankuesja u rikthye në vendin e saj të punës.

Nga ankesat të cilat janë ende në shqyrtim vlen të përmendim:

1. Ankesën e Shoqatës së Farmacistëve të Rrethit Dibër, e cila ka paraqitur shqetësimin se në qytetin e Peshkopisë janë hapur dhe funksionojnë farmaci pa drejtues teknik të diplomuar si farmacist. Në këtë rreth ka farmaci ku tregtojnë medikamente persona që nuk janë të pajisur me

liçensë. Ndërkohë që po në keto farmaci tregëtohen lëndë psikotrope-narkotike që janë kategorikisht të ndaluara të tregtohen nga subjekte të tilla pa liçensë dhe pa drejtues teknik.

Nga Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave është konfirmuar se shqetësimi është i drejtë. Si në qytetin e Peshkopisë, ashtu dhe në disa qytete të tjera është bërë një kontroll dhe është lënë akt mbyllja për keto farmaci. Por akoma deri tani nuk ka patur ndonjë hap konkret nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë për mbylljen e këtyre farmacive. Aq më tepër që ka të dhëna se farmacitë që nuk plotesojnë kriteret ligjore vazhdojnë të hapen.

2. Ankesën e kryetares së Shoqatës Kombëtare të Invalidëve Paraplegjike e Tetraplegjike “Shpresë dhe Dashuri”. Ajo parashtron një ankesë, që e kanë një kategori e tërë të sëmurësh tetraplegjike, të cilët nuk po arrijnë të përfitojnë “Statusin e invalidit paraplegjik e tetraplegjik”. Ajo sqaron se janë në tetraplegji totale, jo nga aksidenti, por nga një diagnozë tjetër “Miopati, distrofi muskulare”. Pavarësisht se kanë të njëjtin pozicion me disa të sëmurë të tjerë që janë aksidentuar në vitin 1997 dhe e kanë përfituar këtë lloj statusi, ajo vëren se të sëmurët me diagnozën “Miopati” nuk e kanë përfituar statusin. Ajo ka kërkuar ndërhyrjen e Institucionit tonë që të nxitet Ministria e Shëndetësisë për përcaktimin e definicioneve të reja mjekësore të të sëmurëve para e tetraplegjike, të cilat do të përmirësojnë Ligjin nr.8626 datë 22.06.2000 “Statusi i Invalidit Paraplegjik e Tetraplegjik”. Ministrisë së Shëndetësisë i janë kërkuar shpjegime, por nuk ka përgjigje nga ky institucion.

3. Ankesën e nje grupi farmacistësh të ish farmacive shtetërore, të cilët duke qënë se trualli ku janë ndërtuar farmacitë e mësipërme nuk ka pronar, kanë kërkuar fillimin e procedurave të privatizimit, por që ende ky proces nuk është realizuar.

Nga ana jonë është zhvilluar një korrespondencë e gjatë me Institucionet që janë kompetente për realizimin e këtij procesi. Por argumentat e dhëna prej tyre tregojnë një zgjatje pa fund të këtij procesi, zvarritje me karakter burokratik deri në atë moment që ky proces, u pezullua për shkak se do të miratohej paketa e re nënligjore lidhur me procesin e privatizimit. Edhe pas miratimit të V.K.M. Nr. 159 datë 13.03.2003 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet dhe procedurat e shitjes”, rezulton që ende procesi nuk ka përfunduar. Vërejmë se strukturat kompetente, Ministria e Shëndetësisë, Bashkia e Tiranës, Dega e Shoqërive Publike Tirane, nevojitet të përshpejtojnë realizimin e këtij procesi, konformë dispozitave ligjore.

4. Veçojmë gjithashtu rastin e shtetas V.D ankesa e të cilës është në ndjekje e sipër, pas rekomandimit që i kemi paraqitur Ministrisë së Shëndetësisë, që kjo e fundit të marrë masa në përmbushjen e detyrimit kushtetues e ligjor të ekzekutimit të një vendimi gjyqësor që i jep të drejtë ankueses të rivendosë të drejtat e saj, si Drejtoreshë e Autoritetit Rajonal Shëndetësor.

15. Ministria e Punëve të Jashtme

Gjatë vitit 2003 për Ministrinë e Punëve të Jashtme, ambasadat dhe konsullatat jashtë vendit janë shqyrtuar gjithsej 12 ankesa, nga të cilat 4 janë çështje të mbartuar nga viti 2002 dhe 8 janë ankesa të ardhura gjatë vitit 2003. Lidhur me objektin e këtyre ankesave duhet thënë që kryesisht ato kanë patur të bëjnë me veprime apo mosveprime të konsullatave apo sektorëve konsullorë në ambasadat tona në ato vende ku ka mjaft shtetas shqiptarë. Nga ankesat 10 rezultojnë të perfunduara dhe vetëm 2 çështje janë në shqyrtim. Nga ankesat e shqyrtuara 8 rezultojnë të kenë qenë jashtë juridiksionit dhe kompetencës së Avokatit të Popullit, një ankesë ka rezultuar e pabazuar dhe një ankesë është zgjidhur në favor. Pjesën më të madhe të ankesave që lidhen me këtë Ministri, e përbëjnë ankesat për përfaqësitë e huaja në Shqipëri. Kur kanë qenë jashtë juridiksionit, qytetarëve ju është treguar rruga që duhej të ndiqnin në secilin rast, dhe shpesh këto çështje i janë kaluar për kompetencë Drejtorisë Konsullore pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Edhe këtë vit ka patur ankesa nga qytetarët të cilët paraqesin shqetësimin lidhur me radhët e gjata dhe vonesat në realizimin e procesit të legalizimit të dokumentave nga ana e strukturës përkatëse të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Në kuadrin e rritjes së shërbimit ndaj qytetarëve, nga zyra jonë është ndërhyrë për hapësirat që ekzistojnë për një zgjidhje më të mirë dhe eficiente të problemit të legalizimit të dokumenteve,.

Në vijimësi të trajtimit të këtij problemi, vërejmë se në raportin tonë vjetor 2002 janë propozuar zgjidhje të tilla si aderimi në një Konventë për t'u njohur vula e noterit pa qënë nevoja e legalizimit të dytë nga Ministria e Punëve të Jashtme. Rezulton që me Ligjin nr.9060, datë 08.05 2003 "Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për heqjen e kërkesës për legalizim të dokumentave zyrtare të huaja", vendi ynë të ketë aderuar në Konventën për heqjen e kërkesës për legalizim të dokumentave zyrtare.

Zbatimi i kësaj Konvente do të unifikoj praktikat lidhur me procedurat për legalizimin e dokumentave zyrtare.

Gjatë vitit 2003, në bashkëpunim me Ministrinë e Jashtme dhe atë të Drejtësisë u realizua projekti i botimit në shqip të përmbledhjes së instrumentave kryesore juridikë ndërkombëtare, lidhur me të drejtat e njeriut dhe rrugët për mbrojtjen e rivendosjen e tyre në institucionet e sistemit penitenciar jashtë vendit, ku vuajnë dënimin rreth 5000 shtetas shqiptarë. Një botim i tillë u bë me qëllim që të ndihmojë të burgosurit shqiptarë jashtë vendit, të cilët janë një grup i veçantë i pambrojtur që nuk kanë mundësi për të patur një rrjet lidhjesh dhe mbështetje, sikundër të burgosurit e tjerë.

Tashme rezulton se ky libër është shpërndarë në disa shtete si: Greqi 1800 kopje, 25 kopje në Slloveni, 100 kopje në Angli dhe 20 kopje në Danimarkë. Po punohet për t'u pranuar sidomos në Itali dhe Maqedoni.

Në vitin 2002, Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Drejtësisë i jemi drejtuar dhe me një rekomandim tjetër, i cili është pranuar dhe që kishte të bënte me:

- Zbatimin e procedurës së përgatitjes dhe botimit të teksteve zyrtare në gjuhën shqipe të akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë, nga Ministria e Drejtësisë, e cila realizon përkthimin zyrtar të akteve ndërkombëtare të përgatitura për miratim, nga ana e organeve kompetente.
- Realizimin e botimit në gjuhën shqipe të teksteve të konventave dhe marrëveshjeve të ratifikuara nga vendi ynë, teksti i të cilave nuk është botuar në Fletoren Zyrtare, me qëllim që të kenë mundësi të gjithë organet që janë të detyruara t'i zbatojnë ato të njihen më parë me to.

Por rezulton se gjatë vitit 2003 nuk është ndërmarë asnjë hap konkret për të realizuar këtë proces kaq të rëndësishëm dhe që lidhet ngushtë me zbatimin e të drejtave të njeriut në vendin tonë. Megjithatë çështja është në ndjekje nga ana jonë.

Nga çështjet e shqyrtuara evidentojmë se çështja e mëposhtme tregon se angazhimi efektiv i strukturave përfaqësuese të shtetit shqiptar në mbrojtje të interesave të shtetasve shqiptarë që jetojnë e punojnë jashtë vendit përbën çelsin e zgjidhjes së problemeve të ndryshme që ndeshin këta te fundit në një shtet të huaj.

Nga ana e Komisionit Parlamentar të ligjeve pranë Kuvendit të Shqipërisë u njoftuam se shtetasit shqiptar I. E. dhe dy kolegë të tij, të punësuar në kompaninë e Sigurimeve SIGMA AD Shkup, pa ndonjë shkak ligjor, u

ishin marrë dhe mbajtur pashaportat e tyre nga ana e policisë maqedonase.

Menjëherë nga ana jone i janë kërkuar Ambasadorit tonë në Maqedoni, sqarime dhe zgjidhja e rastit, duke vënë në dijeni për këtë ngjarje dhe Drejtorine Konsullore në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Njëkohësisht, në kuadrin e Konventës Evropiane mbi të drejtat e liritë e njeriut, si dhe në frymën e bashkëpunimit e të mirëkuptimit, rastin ia bëmë prezent dhe homologut tonë në Maqedoni, Ombudsmanit z. Branko Naumovski, me qëllim zgjidhjen e ankesës.

Pas ndërhyrjes së tij, Ambasadori ynë në Maqedoni, na njoftoi se problemi i shtetasit shqiptar I.E. si dhe dy kolegëve të tij, u zgjidh. Policia maqedonase, ju ktheu pasaportat, dhe ju dha viza të interesuarve.

Zgjidhja e këtij problemi u arrit si rezultat i ndërhyrjes së Ambasadës tonë deri në instancat më të larta kompetente në Maqedoni.

Në tërësinë e problematikës së ankesave të ardhura rezulton që problematike për shtetasit shqiptarë janë refuzimet për pajisje me vizë nga përfaqësitë e huaja në vendin tonë. Çështje të tilla kërkojnë një angazhim më të madh të Drejtorisë Konsullore pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Në raportet tona, në vitet 2001 dhe 2002, kemi prezantuar ankesën e 5 ish-punonjësve të Ambasadës Shqiptare në Beograd, të cilët kërkuan dëmshpërblimin për sendet që ju dogjën e shkatërruan kur u larguan nga Beogradi më 5 Prill 1999. Megjithatë kjo kërkesë është pranuar si e drejtë, verbalisht dhe me shkrim nga ish-Ministrat e Jashtëm që kanë qënë në detyrë këto vite, nuk është zgjidhur akoma. Ky është një shembull tipik i zvarritjeve burokratike pa fund që ndeshin qytetarët shqiptarë përballë nënpunësve të aparateve, të cilët ankesat, zgjidhjet dhe përgjigjet i mbajnë nëpër dosjet në sirtaret e tyre dhe nuk ju japin rrugë atyre në përputhje me dispozitat ligjore.

16. Ministria e Transportit dhe Telekomunikacioneve

a. Ankesa për vetë Ministrinë

Gjatë vitit 2003 ka patur 6 ankesa për Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacioneve. Nga këto 2 ankesa kanë qënë të pabazuara, 3 ankesa kanë qënë jashtë kompetencës dhe juridiksionit dhe 1 ankesë është zgjidhur në favor të ankuesit.

Ankesa e zgjidhur pozitivisht është e shtetasit A.B me banim në Labinot, Elbasan, i cili pretendonte se Ministria e Transportit dhe

Telekomunikacioneve, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, gjatë fazës së hartimit të projektit për segmentin rrugor Elbasan-Librazhd, nuk kanë marrë parasysh kërkesën e tij për shmangien e rrugës, e cila në situatën faktike të pasqyruar në hartë, kërkonte shembjen e një pjese të konsiderueshme të objektit, ku ky shtetas zhvillon një aktivitet privat. Për këtë qëllim shtetasi A.B ishte paraqitur disa herë në këto organe, por nuk ka mundur të marrë sqarimet e nevojshme. Pas pranimit të kësaj ankese, Avokati i Popullit ka kryer kontakte të vazhdueshme me anë të ekspertëve të tij, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve. Si rezultat i ballafaqimit të dokumentave dhe analizës së fakteve të pasqyruara në hartën e Zyrës së Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Dega Elbasan, është bërë e mundur vënia në rrugën e zgjidhjes së këtij konflikti, duke dalë në konkluzionin e devijimit të segmentit rrugor. Shtetasit A.B pas këtij ballafaqimi i është krijuar mundësia të komunikojë me nëpunësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve për procedurat e mëtejshme të realizimit së kësaj të drejte.

Kjo ankesë për organet e Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacioneve, përbën një rast për të ilustruar në tërësi problemet që hasin qytetarët me titull pronësie gjatë momentit kur duhet të ndërtohet një vepër publike. Ashtu siç është përmendur edhe në Raportin tonë për vitin 2002, procedurat e tejzgjatura, konfliktet gjyqësore që lindin në kuadrin e këtij procesi, janë një fenomen që ndodh herë pas here dhe që tregon mangësitë që shfaq kuadri ligjor në fuqi për veprimtarinë me karakter evidentues dhe parandalues ndaj çënimeve të pronësisë. Kjo ndodh gjithashtu nga pasaktësitë në listat dhe të dhënat e tjera nga Zyrat e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe organizimi jo i mirë i punës nga organet e tjera kompetente të administratës. Garancitë e të drejtave mbi pronësinë që parashikon Protokolli I neni 1 i Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, si dhe nenet 41/42 të Kushtetutës së Shqipërisë, janë detyrime që duhet të respektohen nga organet e administratës publike. Në këtë kuadër, shprehim shqetësimin tonë se në realitet, nga ankesat që bëhen prezente pranë Avokatit të Popullit, këto detyrime kushtetuese shpesh herë janë anashkaluar nga organet shtetërore, duke i lënë rrugë të hapur konflikteve gjyqësore.

Për këtë qëllim Avokati i Popullit me synimin e rritjes së cilësisë së mirëqeverisjes në administratë, do të vazhdojë të ndërhyjë edhe në të ardhmen për një zgjidhje të konflikteve në rrugë administrative, pasi nga çështjet e shqyrtuara rezulton se ka shumë hapësira, nëpërmjet të cilave qytetarët mund të realizojnë interesat e tyre të ligjshme, pa qenë nevoja që të nisnin rrugën e gjatë gjyqësore.

a. Ankesa për Telekomin

Gjatë vitit 2003 pranë nesh janë shqyrtuar 56 ankesa dhe kërkesa për Drejtorinë e Përgjithshme të Telekom sh.a dhe filialet e tij nëpër rrethe. Per kete sektor jetik, për shërbimet publike mjaft ankesa behen, sidomos për të rritur standartet e shërbimeve në nivel bashkëkohor.

Pjesa më e madhe e tyre konsistojnë në mostransparencë në faturime, mosrespektim të afateve të ankimeve apo të vendosjes së shërbimit, riparimeve etj.

Është konstatuar që ky Ent publik, edhe pse ka rritur ndjeshëm tarifat e tij, shërbimi që ofron le shumë për të dëshiruar. Për shembull ende nga ana e Albtelekom sh.a nuk pajisen abonentët me faturat analitike për të patur kështu më shumë transparencë dhe për të plotësuar një nga të drejtat më elementare të konsumatorit atë të informacionit të detajuar për telefonatat e kryera, kohëzgjatjen e tyre si dhe vlerën përkatëse. Për më tepër kjo duhet bërë sepse Albtelekom, ndryshe nga KESH dhe Ujësjetllës aparaturat e matjes i ka në administrim pranë Entit të tij dhe jo pranë apo nën kontroll të abonentëve. Kjo bën të mundur edhe shmangjen e abuzime në dëm të konsumatorëve për të cilat ka mjaft ankesa.

Aktualisht Avokati i Popullit po heton në lidhje me çështjen e tarifave telefonike të operuara nga ana e Albtelekom sh.a që nga Dhjetori 2003. Avokati i Popullit ka bashkëpunuar dhe me ekspertë të kësaj fushe, duke synuar dashur që të ketë jo vetëm transparencë në procedurat juridike, por dhe një mendim të kualifikuar teknik për bazueshmërinë e këtyre ndryshimeve. Për të patur një kuadër sa më të gjerë dhe të qartë të të gjithë faktorëve, hetimi i Avokatit të Popullit ka përfshirë Albtelekom sh.a, Entin Rregullator të Telekomunikacionit, Ministrinë e Ekonomisë, Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit për çështjen në fjalë.

Arritje për bashkëpunimin e Institucionit tonë për vitin 2003 me Albtelekom sh.a ishte hartimi dhe futja në fuqi e kontratës së re që ju ofrua konsumatorit shqiptar të telefonisë fikse. Kjo kontratë mund të cilësohet një kontratë bashkëkohore ku sanksionohen qartë ne barazi të drejtat dhe detyrimet e te dy paleve.

Nga ana e Institucionit tonë po hetohet me iniciativë në lidhje me Kompanitë private të telefonisë celulare AMC dhe VODAFON për sa i takon faktit që këto kompani, dhe pse janë me fuqi të ndjeshme në tregun e telefonisë në Shqipëri, nuk janë shpallur si të tilla nga ana e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve duke mos respektuar kështu dispozitat e përcaktuara nga Ligji “Per Telekomunikacionet në R.SH”. Si rrjedhojë tarifat e tyre janë mjaft të larta, gjë që është bërë dhe vazhdon të jetë një

ankesë e njohur publike e konsumatorëve shqiptarë, por që është bërë edhe objekt interpelance në Kuvend nga deputeti Neritan Ceka në vitin 2003.

17. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

Për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për vitin 2003 kanë ardhur gjithsej 10 ankesa, kurse 7 ankesa i përkasin vitit 2002. Janë të përfunduara 11 ankesa, 3 janë zgjidhur në favor, 7 kanë qenë jashtë juridiksionit, 1 është rekomandim i refuzuar. Kanë mbetur në shqyrtim për vitin 2004 vetëm 6 ankesa.

Problematika e ankesave që kanë patur të bëjnë me këtë Ministri ka qenë në lidhje me mosekzekutimin e vendimeve të gjykatës, shkelje të së drejtës së informimit, apo për largime nga puna dhe masa disiplinore.

Përsa i përket çështjeve të trajtuara mund të permendim, 3 ankesa të cilat janë paraqitur në vitin 2002 por që janë zgjidhur pozitivisht gjatë vitit 2003. Një prej të cilave lidhej me ekzekutimin e një vendimi të Gjykatës Tirane, sipas të cilës Dega e Monumenteve të Kulturës Tiranë, detyrohej kundrejt shtetases G.L të shlyente një detyrim monetar. Pas ndërhyrjes tonë institucionale u arrit zgjidhja pozitive në favor të shtetases, me ekzekutimin që iu bë këtij vendimi. Ndërsa përsa i përket dy rasteve të tjera, të cilat pas ndërhyrjeve tona janë zgjidhur pozitivisht në favor të ankuesve, kanë të bëjnë me faktin se individët nuk informohen në lidhje me përmbajtjen e vendimit të largimit nga puna nga autoritetet përkatëse dhe nuk pajisen me kopje të këtyre vendimeve, duke shkelur dispozitat e Ligjit Nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejten e informimit për dokumentat zyrtare”.

1- Në vijim veçojmë ankesën e shtetasit M.F. i cili ankohet për disa shkelje ligjore të Federatës Shqiptare të Futbollit (FSHF) lidhur me sistemin e riliçensimit të klubeve të futbollit shqiptar.

Konkretisht ankuesi nuk ka pranuar të rikualifikohet për marrjen e liçencës së trenerit të futbollit, sepse me Vendim të Komisionit Shtetëror, dhe pas kryerjes së kursit pasuniversitar 1 vjeçar me shkelje nga puna, është titulluar trener. Ai ankohet për faktin që FSHF me anë të sektorit teknik të liçensimit të FSHF, nuk merr parasysh diplomën e tij të marrë në Institutin “Vojo Kushi” me specialitet trener futbollit, kurset pasuniversitare dhe të kualifikimit që ai ka bërë, në një kohë kur nuk ekziston ndonjë parashikim ligjor i cili t’i konsiderojë të pavlefshme këto diploma.

Ankesa është konsideruar e drejtë nga ana jonë, prandaj i është drejtuar një rekomandim Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve, për

anullimin e testimit dhe rilicënsimit të trainereve shqiptare të gjitha niveleve, si një procedurë e pa bazuar në ligjet dhe Vendimet e Këshillit të Ministrave. Ende nuk kemi përgjigje zyrtare.

2. Ankesën e 24 punonjësve të “Alba Film Studios” të cilëve u janë ndërprere pagat dhe ndërkohe nuk u paguhen sigurimet shoqërore. Sipas tyre ekziston një Vendim i Këshillit të Ministrave nr.49 datë 28.01.1999, që i shton një fond “Alba Film Studios” deri në transformimin e saj në shoqeri tregtare. Por Ministria e Kulturës u ka ndërprerë mbështetjen financiare me arsyetimin se nuk kane fondet e duhura për këtë qellim.

Nga shpjegimet zyrtare që ka dhënë Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve, rezulton që kjo ministri pranon që ankesa e punonjësve është e drejtë, por që nga Këshilli i Ministrave nuk janë miratuar asnjehere fondet që kjo ministri ka kërkuar për Alba Film Studio. Kjo nga që mendimi i Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë ka qënë negativ për akordimin e këtij fondi.

Nga shqyrtimi i kësaj çështje është konstatuar se Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.316 date 24.4.2003 “ Për një ndryshim në vendimin nr.78 datë 21.1.1999 të Këshillit të Ministrave “Për ruajtjen e pronësisë shtetërore në disa shoqëri tregtare dhe ndërmarrje”, përcakton se “Alba Film Studio” është shoqeri në transformim me kapital 100% shtetëror. Pra për sa kohë që kjo shoqeri “de jure” vazhdon të mos jetë shoqeri aksionere dhe sipas vendimit të mësipërm statusi i saj është shoqëri në transformim, mbetet i pazgjidhur problemi i pagesës së punonjësve dhe mosderdhjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore që nga Janari i vitit 2003.

Jemi në pritje të përgjigjes nga ana e Ministrisë së Financave lidhur me pengesat që ekzistojnë dhe argumentet për qëndrimin refuzues ndaj kërkesës së Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

18. Ministria e Mjedisit

Gjatë vitit 2003 kemi patur vetëm 2 ankesa me problematikën e ndotjes së mjedisit. Njëra ka rezultuar jashtë juridiksionit të Zyrës sonë, ndërsa ankesa tjetër është në fazën e shqyrtimit. Ndonëse numri nuk është i konsiderueshëm, objekti i ankesave tregon se publiku shqiptar po ndërgegjësohet për nevojën e një ambjenti të shëndetshëm dhe për menaxhimin më të mirë të tij.

1- Njëra nga ankesat ishte e përsëritur nga viti 2002 për “ndotjen e rrezikimit të ambjentit nga rrezatimet e antenave celulare” të ndodhura mbi godinat e banimit, të vendosura nga kompanitë e telefonisë celulare AMC dhe Vodafon.

Siç dhe e kemi raportuar vitin e kaluar, i rekomanduam Prokurorisë së Tiranës fillimin e hetimit për veprën penale të shpërdorimit të detyrës ndaj punonjësve dhe drejtuesve të ish Agjensisë Kombëtare për Mbrojtjen e Mjedisit, (sot Ministria e Mjedisit) dhe për veprën penale të “Ndotjes së ajrit”, ndaj drejtuesve të Kompanive “Vodafone Albania” sh.a, si dhe “AMC” sh.a. Prokuroria ka përfunduar hetimet, duke u shprehur se pas ekspertizave tekniko-shkencore të kryera nga ekspertët e caktuar prej saj, nuk ka rezultuar që të ketë rrezik real apo pasoja të rënda nga rrezatimi i këtyre antenave. Në këto kushte nuk ka patur shkaqe për të vënë para përgjegjesisë penale as zyrtarët e Agjensisë së Mbrojtjes së Mjedisit.

Përsa i përket rekomandimit për hartimin e një ligji të posaçëm për mbrojtjen e njerëzve dhe të ambientit nga këto lloj rrezatimesh, projektligji është hartuar, por nuk është dërguar për miratim në Qeveri nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë. Çështja është në ndjekje nga ana jonë, derisa projektligji t’i përcillet Parlamentit.

2-Në ankesën e qytetarit A.Ç. bëhet fjalë për mbetjet toksike të ish Uzinës së plastmasit në Lushnjë. Këto mbetje toksike rrezikojnë jetën e të gjithë komunitetit afër saj si dhe janë bërë një pengesë e madhe për të investuar. Ne i kemi rekomanduar Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Ekonomisë për të bashkërenduar punën, në mënyrë që të sigurohen fondet financiare për evadimin e këtyre mbetjeve toksike. Rezulton që Ministria e Mjedisit ka organizuar inspektime për verifikimin në vend të situatës si dhe ka hartuar një projektprogram pune që ja ka paraqitur Ministrisë së Ekonomisë dhe Ministrisë së Industrisë dhe Energjitikës, duke patur parasysh se ish Uzina e plastmasit ka qenë në varësi të Ministrisë së Industrisë dhe Energjitikës.

Por Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Industrisë dhe Energjitikës e konsiderojnë Uzinën e plastmasit si një subjekt tërësisht në pronësi private. Ndaj mbi këtë arsyezim Ministria e Mjedisit ka konkluduar se është kompetencë e aksionerëve privatë të sqarojnë fillimisht çështjen e pronësisë dhe të lëndës së parë dhe të përballojnë vetë riamballazhimin e mbetjeve që ndodhen në territor dhe më pas të bëjnë transportimin e tyre në destinacionin e caktuar për groposje. Siç shihet ka lënie të përgjegjësive nga një dikaster tek tjetri. Por Zyra e Avokatit të Popullit do ta ndjekë këtë problem të mprehtë për jetën e njerëzve deri në zgjidhjen përfundimtare.

19. Ministria e Industrisë dhe Energjitikës

Ankesa të vitit 2003 që kanë lidhje direkte me objektin e punës së kësaj Ministrie rezultojnë gjithsej 9. Janë edhe 12 ankesa të mbartura nga viti 2002. Kurse për vitin 2003 50 ankesa dhe kërkesa janë ndaj Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare.

a. Ankesa për vetë Ministrinë.

Nga 21 ankesat, 4 prej tyre kanë rezultuar jashtë juridiksionit, 8 të zgjidhura në favor, 1 ankesë e pabazuar, ndërsa 8 ankesa janë në proces shqyrtimi.

1-Në 8 prej këtyre ankesave objekt ka qenë mosplotësimi i detyrimeve të Këshillit të Ministrave të marra përsipër me hyrjen në fuqi të marrëveshjes së koncensionit nga Shoqëria italiane Darfo për objektet e Albkromit dhe Albbakër për pagesat e sigurimeve shoqërore të punonjësve që kanë punuar në këto miniera para dhënies me koncesion. Nga shqyrtimi i këtyre ankesave, ashtu siç kemi theksuar edhe në Raportin e vitit 2002, rezulton se detyrimi i Këshillit të Ministrave ndaj buxhetit të Sigurimeve Shoqërore dhe të tretëve është i madh.

Në bazë të Ligjit nr.8590 datë 23.02.2000 “Per miratimin e “Marreveshjes se koncensionit te formes BOT per uzinën e ferrokromit në Elbasan dhe për minierat e kromit Prrenjas e Pojske, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike e Privatizimit dhe Shoqërisë italiane Darfo SPA” dhe dhënien e disa stimuljeve dhe garancive për koncensionarin e kësaj marrëveshjeje”, në nenin 4 përcaktohet se: “*Me hyrjen në fuqi të marrëveshjes së koncensionit, Këshilli i Ministrave trajton detyrimet ndaj buxhetit të shtetit dhe të tretëve, që janë objekt koncensionit*”.

Institucioni i Avokatit të Popullit e çmoi të arsyeshme ndërhyrjen pranë Ministrisë së Industrisë dhe Energjitikës për ndërmarrjen e iniciativës për një projekt-vendim, ku të përcaktohen saktë mënyrat e shlyerjes së detyrimeve në afate dhe shumat përkatëse brenda mundësive të buxhetit të shtetit.

Nga kjo Ministri na është konfirmuar se ankesa e punëtorëve është e drejtë dhe se është vënë në rrugën e zgjidhjes. Kështu është paraqitur një projektvendim për Këshillin e Ministrave “Per regjistrimin, monitorimin dhe rregullimin e pagesave të detyrimeve të prapambetura ndërmjet ndërmarrjeve, shoqërive të sektorit publik”.

Siç shihet Zyra jonë ka ndikuar pozitivisht për vënien në lëvizje të Ministrisë kompetente, gjë që do të çojë në zgjidhjen e ankesës. Tashmë problemi i pagesave të sigurimeve shoqërore, nga bashkëpunimi i Ministrive të linjës dhe ISSH është zgjidhur, pra janë çelur fondet përkatëse

nga buxheti i shtetit. Ndërkohë që problemi i detyrimeve ndaj të tretëve, që përbën një faturë të lartë financiare ende po shqyrtohet, por nuk ka marrë zgjidhje përfundimtare.

2-Shtetasi P.H., likujdator i Uzines 12 dhe Nikel-Kobaltit Elbasan, u ankua pranë Zyrës sonë, për shkeljen e së drejtës së tij të informimit. Pas kërkesave që ai ka paraqitur pranë Drejtorisë së Kontrollit të Energjitikës dhe Drejtorisë së Industrisë së Energjitikës, të kësaj Ministrie, për informimin dhe vënien në dispozicionin e tij të disa dokumenteve zyrtare dhe refuzimit të ndeshur në këtë rast, ai ka kërkuar ndërhyrjen e Institucionit të Avokatit të Popullit.

Në kërkesën që i drejtuam këtyre dy Drejtorive, pranë Ministrisë së Industrisë dhe Energjitikës, argumentuam bazën ligjore të kërkesës për informim të shtetasit P.H. E konkretisht kjo e drejtë e tij bazohet në nenin 23/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe në mënyrë më specifike në dispozitat e Ligjit Nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

Çështja tashmë ka marrë zgjidhjen pozitive, dhe shtetasi ka arritur të realizojë të drejtën e tij të informimit me dokumentet zyrtare nga Ministria e Industrisë dhe Energjitikës.

3-Në ankesën e paraqitur nga shtetasi Y.A. (në emër të 13 punonjësve) të Policisë Elektrike Tiranë, shprehet shqetësimi për disa veprime antiligjore të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë Elektrike, që është në varësi të Ministrisë së Industrisë dhe Energjitikës. Këta ankues pretendojnë se janë larguar nga puna në mënyrë të paligjëshme, për arsye se kanë ngritur probleme të abuzimeve dhe korrupsionit.

Largimi i tyre i padrejtë nga puna është shqyrtuar dhe gjyqësisht. Në vendimet përkatëse gjyqësore theksohet se largimet e menjëhershme të këtyre punonjësve nga puna, janë bërë pa u marrë më përpara masa disiplinore dhe se nuk ka pasur vërejtje për punën e tyre. Por këto vendime Gjyqësore nuk janë zbatuar nga Drejtoria e Policisë Elektrike, Tiranë. Ndaj nisur nga fakti se lufta kundër korrupsionit është detyrë parësore për të gjitha organet dhe institucionet e administratës sonë publike, i kemi rekomanduar Ministrin të Industrisë dhe Energjitikës verifikimin e akuzave për korrupsion që ankuesit kanë paraqitur ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Elektrike. Por ende nuk kemi marrë asnjë përgjigje nga kjo Ministri lidhur me rekomandimin e paraqitur.

b. Ankesat për Korporatën Elektroenergjitike (KESH) Sh.A.

Gjatë vitit 2003 kemi patur 50 ankesa dhe kërkesa kundër KESH-it. Nga këto 6 janë zgjidhur pozitivisht, ndërsa 21 prej tyre mbas verifikimit kanë rezultuar të pabazuara, kurse 3 kanë qenë janë juridiksionit, 10 ankesa

vazhdojmë ti kemi në shqyrtim për vitin 2004. Faktikisht pas një ankese të regjistruar qëndrojnë me dhjetra apo qindra qytetarë. Numri me i madh i ankesave kanë ardhur nga Tirana. Problemet më kryesore të këtyre ankesave janë.

1. Mjaft shtetas ankohen se megjithëse kanë paguar rregullisht faturat e energjisë elektrike, ata nuk marrin energji elektrike për shkak se ndërpritet energjia që në kabinat apo fidrat përkatës të zonave apo lagjeve për shkak se disa nga fqinjët e tyre nuk paguajnë energjinë e konsumuar.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka vazhduar të kembengule pranë Kesh-it se askush nuk mund të ndëshkohet për shkak se fqinjët e tij nuk kanë zbatuar kontratën apo shkelin ligjet. Në çdo rast ky problem duhet të zgjidhet duke i shkëputur energjinë elektrike individit që nuk paguan dhe në asnjë rast klientit të rregullt. Zbatimi i ligjit nuk sigurohet me arbitraritete, por veçse me kërkesë për zbatim të ligjit nga çdo individ që shkel ligjet.

Në vitin 2002 me rekomandimin të Kesh-it ndryshoi pikat 1 dhe 6 të Urdhrit të tij nr.32, dt.2.02.2001 i cili legjitimonte denimet kolektive. Por faktikisht ky urdher vepron verbalisht përderisa vazhdojnë ankesat me këte objekt, sepse Kesh akoma nuk po arrin dot që t'ja prese energjinë vetëm atyre që nuk paguajnë.

2. Ka pasur mjaft ankesa në lidhje me faturat afrofe të zbatuara nga Kesh sh.a ndaj konsumatorëve të cilët nuk kanë aparate matës. Ka shumë familje të varfëra të cilat nuk kanë as mjettet më të domosdoshme dhe as aparatura shtëpiake që të harxhojnë shumë energji dhe, ndërkohë atyre ju dergohen fatura aforfe në një vlerë të lartë në krahasim me të ardhurat e tyre. Këto ankesa dhe fakte nuk merren parasysh nga Kesh, pavarësisht që është detyrë e këtij Enti vendosja e aparateve matës. Ky veprim është një shkelje e të drejtave të konsumatorit sepse zbatimi në këtë mënyrë i pagesës aforfe nuk është masë e përkohshme, por penalitet (dënim) financiar për ta.

Nga ana e KESH sh.a është marrë angazhim se brenda vitit 2004 me ndihmen edhe të një granti të akorduar nga Banka Botërore do të pajisen të gjithë konsumatorët shqiptarë me matës duke filluar kjo me përparësi në zonat si Shkodra, Vlora, Kukesi etj, ku niveli i arketimeve është shumë më i vogël, por edhe ku ankesat për energji elektrike janë të mëdha, njëjloj si të gjitha zonat e tjera.

3. Ankesa të shumta kanë ardhur edhe në drejtim të punonjësve të KESH-it, (faturuesve) të cilët për neglizhencë ose moskorrektësi në kryerjen e detyrës, megjithëse konsumatorët kanë matës të rregullt, ju shënojnë atyre sasi kilovat energji të ndryshme nga sa kanë harxhuar

konsumatorët realisht. Kjo ndikon në rritjen e vlerës së pagesës së konsumatorit, sepse dihet se çmimi është percaktuar edhe mbi disa limite 220-300 kilowat energji për çdo muaj.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka bërë një punë të madhe për sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e opinionit publik për çdo shkelje ligjore ose cenim të interesave të ligjshëm të shtetasve nga ana e KESH. Por edhe kemi kërkuar që qytetarët të plotësojnë detyrimet për pagesën e energjisë elektrike. Detyrë kryesore për vitin në vijim është zbatimi me korrektësi dhe paanshmeri i kontratës së re tip nga të dy palët, nga konsumatorët dhe nga Kesh sh.a.

4. Ashtu si dhe në rastin e Albtelekomit, edhe Kesh sh.a në fillim të vitit 2004 po punon me tarifa të reja për konsumatorin shqiptar. Për këtë arsye, Zyra për Mbrojtjen e Qytetarëve (organizate jo fitimprurëse) na ka përcjelle për shqyrtim ankesat e 6000 qytetarëve shqiptarë kundër rritjes së tarifave të pagesës së energjisë elektrike. Por ndryshe nga Albtelekomi, rezulton se procedurat e Kesh sh.a kanë qenë me transparente. Edhe për këtë rast nga ana e Institucionit tone është ngritur një grup ekspertësh për të bërë të mundur një opionencë sa më efektive për rritjen e këtyre tarifave. Nga ana jonë çështja është akoma në proces shqyrtimi.

20. Ankesa për shërbimet sekrete

Gjatë vitit 2003 kanë ardhur 2 ankesa nga punonjësit e Shërbimit Informativ Shtetëror kundër veprimeve të drejtuesve të këtij institucioni për marrëdhënie të punës.

Pas shqyrtimit të tyre ka dalë se një ankesë ka qenë e pabazuar, kurse ankesa tjetër është zgjidhur në favor të ankuesve.

Rasti i pabazuar qëndron si më poshtë:

1. Shtetasi P.M. ankohej se ishte larguar nga detyra padrejtësisht. Nga verifikimi doli se ankuesi ishte larguar nga detyra se nuk kishte përmbushur detyrat funksionale dhe se në mënyrë të vazhdueshme kishte abuzuar me financat e shtetit.

2. Shtetasi P.S. është ankuar tek Avokati i Popullit se në kuadër të ristrukturimit janë njoftuar disa persona se do të largohen nga puna në SHISH, vetëm për arsye se punojnë burrë e grua në të njëjtin institucion. Pas ndërhyrjes së zyrës tonë pranë Drejtorit të SHISH ky problem u zgjidh duke i sistemuar këta persona në detyra që të mos kenë asnjë lidhje me njëri-tjetrin.

Theksojmë se marrëdhëniet midis Avokatit të Popullit dhe Shërbimit Informativ Shtetëror kanë qenë ligjore. Nuk ka pasur pengesa, për çdo problem që kemi ngritur apo kërkuar. Zyrës tonë i janë vënë në dispozicion të gjitha dokumentet, edhe kur ato kanë qenë sekrete, duke zbatuar ligjin, kur ka patur çështje të tjera që lidheshin me këtë shërbim.

21. Pergjithësime në lidhje me ankesat që kanë të bëjnë me konsumatorin

Kur flitet për “konsumatorët”, instiktivisht të vjen në mendje një person duke blerë. Në fakt ky është një vizion jo i plotë. Të gjithë ne jemi konsumatorë dhe niveli ynë i jetesës është i kushtëzuar nga konsumi, që bën secili nga ne, në shumë momente të jetës sonë të përditshme. Pikërisht duke patur parasysh rolin shumë të rëndësishëm që ka konsumatori në këtë epokë globalizmi, si një subjekt që garanton mbarëvajtjen e çdo biznesi, institucioni ynë ka përdorur të gjitha mjetet ligjore që i ofron ligji për të ndërgjegjësuar në radhë të parë dhe vetë konsumatorin. Ky fakt është shprehur qartë në disa nga fushat e shërbimit publik me rëndësi jetike si KESH, Ujësjetllës, Albtelekom etj. Institucioni ynë ka qenë pjesë e çdo debati dhe tryeze ku në secilën nga këto shërbime, ne kemi qenë nismëtarë të rikonceptimit juridik të kontratave që ofrohen nga këto ente dhe të ndryshimit të mendësisë së tyre në përgjithësi. Këto iniciativa fillimisht janë ndërmarrë nga ana jonë thjesht si mbrojtës të të drejtave të njeriut. Por me hyrjen në fuqi të ligjit nr.9135 datë 11.09.2003 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, ku në nenin 55 të tij, shprehet qartë impenjimi dhe detyrimi ligjor që ka institucioni i Avokatit të Popullit për të mbrojtur konsumatorët dhe shoqatat e tyre nga të tretët, Institucioni ynë u motivua dhe më shumë në veprimtarinë që kish ndërmarrë shpesh me iniciativë në këtë fushë.

Do të donim të evidentonim faktin e pamohueshëm se roli i Institucionit të Avokatit të Popullit ka qenë i rëndësishëm në ndërgjegjësimin e mbarë opinionit për të drejtat e konsumatorëve si palë të barabarta në çdo shërbim që ju ofrohet, duke pranuar dhe faktin se ky ndërgjegjësim më parë ish i papërfillshëm.

Mendojmë se ligji “Për mbrojtjen e konsumatorëve” dhe pse ka rreth 6 muaj që ka hyrë në fuqi, ende nuk po gjen zbatim, sidomos nga strukturat kompetente të cilat në ligj titullohen struktura publike të kontrollit të tregut. Avokati i Popullit me qëllimin për të sensibilizuar opinionin publik mbi politikën që duhet të ndiqen në lidhje me konsumatorin në përgjithësi

ka këmbëngulur që të ndërjegjësohen strukturat e shtetit në radhë të parë, duke dashur që t'i shkëpusë ato nga mendësitë e centralizimit që i kanë karakterizuar deri së fundmi. Nisur dhe nga ankesat që janë depozituar pranë nesh, mendojmë se ndër fenomenet më të ndeshura në fushën e konsumizmit në Shqipëri janë ato që kanë të bëjnë me:

- mungesën e informimit real për cilësinë e mallit ose shërbimit.
- mospajisja e konsumatorëve me faturat fiskale duke sjellë evazion fiskal.
- mospërdorja e gjuhës shqipe në etiketimet e mallrave.
- përdorimi dhe abuzimi me reklamat e pandershme.
- mosçertifikimi i cilësisë dhe sanitar i mallit ose shërbimit.

Shërbimet publike si energjia elektrike, telefonia fikse dhe ajo mobile (celulare), ujësjellësi si dhe cilësia e ushqimeve dhe ndërtimeve janë fusha të rëndësishme ku qytetarin si konsumator duhet ta mbrojnë në radhë të parë entet publike të caktuara apo ngritura posaçërisht nga shteti për këtë detyrë. Të tilla janë Entet Rregullatore të Energjisë dhe të Telekomunikacioneve, inspektoriatet e kontrollit të ushqimeve apo ndërtimeve etj. Por për fat të keq veprimtaria e këtyre organizmave lë mjaft për të dëshëruar si për mungesë organizimi ashtu edhe të natyrës subjektive që lidhet me punonjësit e tyre. Kështu dy Entet e mëdha (ERT dhe ERE) komisionerët e të cilave zgjidhen nga Kuvendi, pikërisht për të garantuar pavarësinë e tyre nga Qeveria, rezultojnë me vonesa dhe mangësi në formimin e tyre, pa efektivitet dhe me neglizhenca për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve.

Pikërisht për këtë arsye dhe ne si Institucion i të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe të drejtave të konsumatorit në veçanti, nuk do të rreshtim së mbikqyruri zbatimin e ligjeve dhe plotësimin e të drejtave dhe detyrimeve ndaj konsumatorëve shqiptarë. Kam gjetur mirëkuptim dhe mbështetje edhe nga Akademia e Shkencave dhe Universitetet e Tiranës, për të bashkëpunuar me këto institucione shkencore kur nevojiten ekspertiza tekniko shkencore që lidhen me shërbimet jetësore për popullatën.

KREU I KATERT

1. Në ndjekje të rasteve të prezantuara në Raportet Vjetore 2000, 2001 dhe 2002.

Disa nga rastet (*ankesa, kërkesa apo rekomandime*) që janë prezantuar në Raportet e viteve 2000, 2001 dhe 2002 kanë përfunduar dhe gjatë këtij raporti janë pasqyruar në pjesët përkatëse ku trajtohet problematika e tyre. Prandaj në këtë Kre të këtij Raporti do të paraqesim shkurtimisht, rastet të cilat janë akoma në ndjekje edhe për vitin 2004.

1. Ndryshime në Kodin e Procedurës Penale që familjarët e viktimave të veprave penale të kenë të drejtë të marrin pjesë në gjykim për mbrojtjen e interesave të tyre. Ky rekomandim është përsëritur, duke propozuar edhe ndryshime të tjera që do të duhet t'i bëhen Kodit të Procedurës Penale, si për shkurtim të afateve të hetimeve paraprake etj. Në janar 2004, me rastin e projektit të sjellë nga Qeveria, ju sugjerua Komisionit të Ligjeve që të përfshihet dhe ky propozim duke patur si shkak ankesat e familjareve të tragjedisë së 9-janarit, ankesën e familjes së Gani Malushit etj.

2. Ndryshime në Kodin e Procedurës Civile, në lidhje me pjesëmarrjen e avokatëve të të dyja palëve ndërgjyqëse kur në Gjykatën e Lartë shqyrtohet kërkesa e ndonjërës nga palët për pezullim të ekzekutimit të vendimit. Gjithashtu edhe për gjykimin e të gjitha çështjeve me një gjyqtar të vetëm në shkallën e parë.

3. Plotësimi i ligjit “Për të Drejtat e të Dënuarve” me aktet nënligjore për shpërblimin e punës së të dënuarve dhe ndryshime të rregullores së policisë së burgjeve. Brenda vitit 2003 duhej të hartohej drafti nga Ministria e Drejtësisë. Nga verifikimet tona del se ky angazhim nuk është mbajtur, por është futur në programin e vitit 2004. Është kërkuar nga Ministria e Drejtësisë edhe asistenca e Avokatit të Popullit në hartimin e draftit të sipërcituar.

4. Ndryshime në ligjin “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, për përfitime të ushtarakëve të aksidentuar në krye të detyrës.

5. Ngritja e shërbimit të kontrollit mjekësor të të ndaluarve që mbahen në Rajonet e Policisë. Nuk janë marrë masat për zbatimin e këtij rekomandimi. Jemi në ndjekje të këtij problemi.

6. Rekomandim drejtuar Kuvendit të Shqipërisë “Për përmirësimin e nenit 4 të ligjit Nr. 8292 datë 25.02.1998 “Për Forcat Speciale dhe ato të Ndërhyrjes së Shpejtë”. Kemi dijeni se rekomandimi nuk është pranuar nga Kuvendi.

7. Rekomandim drejtuar Kuvendit të Shqipërisë “Për përgatitjen sa më shpejt të projekteve për plotësimin e legjislacionit për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe të ambientit nga rrezatimet jo jonizuese të telefonisë celulare”.

8. Rekomandim me të njëjtën përmbajtje, drejtuar Kryeministrit, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Mjedisit, dhe Ministrit të Transporteve. Ka kthyer përgjigje Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Drejtësisë se po përgatitet projektligji.

9. Ankesa e 17 familjarëve të viktimave nga Shkodra, të mbytur në kanalën e Otrantos në muajin maj të vitit 2000.

Familjarët kanë krijuar dhe shoqatën e tyre “Otranto 2000”, dhe në ankesën e paraqitur në Institucionin tonë qysh në vitin 2002. Ata ngrenë shqetësimin për heshtje të organeve të drejtësisë për mosvënien para përgjegjësisë ligjore të fajtorëve si në Shqipëri, ashtu dhe ndaj autoriteteve italiane për ngjarjen tragjike.

10.Rekomandim drejtuar Këshillit të Ministrave, që në mbrojtje të të drejtës kushtetuese të lirisë fetare të sanksionuar në nenin 24 të Kushtetutës, Këshilli i Ministrave duhet të respektojë detyrimin kushtetues të parashikuar në pikën 5 të nenit 19, në të cilin parashikohet se: “Marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe bashkësive fetare të rregullohen mbi bazën e marrëveshjeve të lidhura ndërmjet përfaqësuesve të tyre dhe Këshillit të Ministrave. Këto marrëveshje ratifikohen në Kuvend”. Ky rekomandim është përsëritur disa herë dhe ende ky detyrim kushtetues nuk është realizuar.

11.Rekomandim për ndryshim të legjislacionit në fushën e ndihmës dhe përkrahjes sociale, në lidhje me ndarjen e përfitimit të pagesës së kujdestarisë nga qenia në skemën e ndihmës ekonomike, si dhe plotësim të ligjit “Për ndihmën dhe përkrahjen sociale”, për sa i përket rrugës së ankimit administrativ ndaj vendimeve që merren shkallë pas shkalle.

12.Rekomandim drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes, për një plotësim në VKM nr.381 datë 20.05.1996, të nxjerrë në zbatim të ligjit nt.7889 datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”. Plotësimi i kërkuar do të mundësojë përfitimin e një shtese mujore mbi pensionin e invaliditetit për të gjithë të aksidentuarit gjatë kryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak, sipas kushteve të invaliditetit të përcaktuara në VKM nr.381 datë 20.05.1996.

13. Propozimi drejtuar Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë për ndryshimin dhe përmirësimin e Vendimit të K.M. nr.552 datë 27.11.1999 “Për trajtimin ekonomik e financiar të familjeve të punonjësve të policisë të vrarë apo plagosur për shkak të detyrës”, për t’i shtrirë efektet e zbatimit të tij nga 01 janari 1991. Megjithëse nga ish Ministri i Rendit Publik z. Luan Rama u premtua para parlamentit se vendimi do të ndryshohej, në fakt ai nuk u bë.

2. Çështje të filluara me iniciativën e Avokatit të Popullit

Sipas nenit 13 të Ligjit nr.8454, dt.4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, “Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur vëren ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar, si dhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike, por me pëlqimin e të interesuarit ose të dëmtuarit”.

Të 13 ankesat e ardhura nga Zyra e OSCE nuk janë konsideruar me iniciativë. Por në të gjitha rastet që ankesat na kanë ardhur nga Zyra e OSCE Tiranë, është filluar shqyrtimi dhe është shkuar në vend për të takuar ankuesit, apo atyre u është kërkuar të paraqiten tek ne, për të dhënë pëlqimin dhe shpjegimet përkatëse. Në përfundim të çdo rasti është njoftuar Zyra e OSCE me shkrim për mënyrën e përfundimit.

- Në total çështje të filluara me iniciativë gjatë vitit 2002 janë:	28
- Ankesa të drejta ose zgjidhur në favor	15
- Jashtë kompetence ose juriksionit	2
- Të refuzuara për shkak se nuk u bënë ankesa individuale sipas ligjit, ose gjatë shqyrtimit u tërhoqën, ose në përfundim doli se ankesa ishte e padrejtë apo e pavërtetë	2
- Në shqyrtim	9

Informacion më i hollësishëm është pasqyruar në tabelat përkatëse.

**ANKESA OSE PROBLEME TE TRAJTUARA ME INICIATIVE
TE INSTITUCIONIT GJATE VITIT 2003**

Nr	Media	Ankuesi	Përmbajtja e ankesës	Vendi Rrethi	Mënyra e zgjidhjes			
					Në favor	Moskompetencë	Refuzuar ose e padrejtë	Në shqyrtim
1	Gazeta Shqiptare Gazeta Albania Gazeta Koha Jonë Etj.	Hasan Tahirllari	Policia më ka vvarë djalim, Gazmendin dhe kërkon ta mbulojë së bashku me prokurorinë e Korçës, gjoja se vdiq nga pija alkolike e tepërt.	Korçë	+			
2.	Gazeta RD		Keqtrajtimit nga policia të operatorit të Top Chanel Ermir Begeja	Tiranë		Nuk dha pëlqimin		
3.	Gazeta Albania		Keqtrajtimit të homoseksualëve nga policia	Tiranë			E padrejtë	
4.	Tv. Top Chanel	(Fiks Fare)	Keqtrajtimit nga policia e Shkodrës të Përparim Babaj	Shkodër		Nuk dha pëlqimin		
5.	Gazeta Zëri i Popullit		Keqtrajtimit nga policia greke të Dashamir Braholli, L.Semilka dhe S.Hallka		+			
6.	Gazeta Korrieri		Vrasja nga policia greke e Vullnet Bytyçit		+			
7.	Gazeta Dita		Keqtrajtimit nga policia greke e Arjan Torka.		+			
8.	TV e Gazeta te ndryshme		Keqtrajtimit nga policia greke të Ligor Halili, Mili Halili e Rrahman Pashollari. Njërit i ishte çarë shpretka e cila ju hoq.		+			

Nr	Media	Ankuesi	Përmbajtja e ankesës	Vendi Rrethi	Mënyra e zgjidhjes			
					Në favor	Moskompe tëncë	Refuzuar ose e padrejtë	Në shqyrtim
9.	Gazeta Ballkan	Donato Di Tano (i dënuar) shtetas italian	Ka tentuar të vetëvritet duke prerë damarët e duarve, me pretendimin sipas gazetës se nuk lejohet nga policia për takim me familjarët	Durrës			E padrejtë	
10.	TV	Ilir Barçi	Njoftim nga gazeta, për t'u strehuar në shtëpinë e fëmijëve, "Zyber Hallulli"	Tiranë	+			
11.	TV	Dhimitër Kazanxhiu	Kërkon ndihmë për të mos u penguar për të mbrojtur pallatin për të cilin dhe ka paguar lekët. Pallatet "Hawai"	Tiranë	+			
12.	Në Media të ndryshme	Punëtorët e "Fabiona" shpk	Për mospagim page, sigurimesh për ISSH dhe kushtet e punës	Tiranë	+			
13.	Gazeta R.D.	Pronarët e Golemit	Për vendimin e KRRTRSH për prishjen e ndërtimeve të tyre	Kavajë				+
14.	Gazeta Ballkan	Vathi Kushta	Për mosdhënie pensioni pleqërie nga sigurimet shoqërore Vlorë	Vlorë	+			
15.	Gazeta Shqiptare, TV.Top Chanel	Kristo Pepa	Të burgosurit shqiptarë që janë gjykuar në Gjykatën e Selanikut në Greqi, janë mashtruar nga përkthyesja Niki Vavacula e cila nuk di gjuhën shqipe.	Greqi				+
16	Gazeta Dita	Tiranë	Në spitalin psikiatrik Tiranë nuk zbatohet ligji "Për shëndetin Mendor"					+

Nr	Media	Ankuesi	Përmbajtja e ankesës	Vendi Rrethi	Mënyra e zgjidhjes			
					Në favor	Moskompe tëncë	Refuzuar ose e padrejtë	Në shqyrtim
17.	Iniciuar nga Avokati i Popullit	Të burgosur	Kanë qëndruar në dhomat e izolimit pas vendimit të formës së prerë dhe kërkojnë t'u llogaritet 1 ditë e gjysëm burg. Për këtë është bërë Rekomandim për përmirësimin e ligjit nr.7941 dt.31.05.1995.		+			
18.	Iniciuar nga Avokati i Popullit	Të dënuar të burgut të Burrelit	Të dënuarit që vuanin dënimin me burgim në burgun e Burrelit, ankoheshin se nga administrata e këtij burgu nuk zbatohet ligji nr.8338, dt.16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, duke shkelur të drejtat e tyre. Me iniciativën e Avokatit të Popullit nga dt.22.10.2003 deri më dt. 24.10.2003 është bërë një inspektim nga ndihmësit e Avokatit të Popullit në burgun e Burrelit. Pas këtij inspektimi Avokati i Popullit ka bërë rekomandimin nr. doc.200301750/3 dt.03.11.2003	Mat				+
19.	Gazeta Koha Jonë	Elma Beluli	Kërkon të dijë nëse djali i saj është ose jo gjallë së bashku me shokun e tij. (Romeo Beluli dhe Martin Islamaj) dysohet se janë të arrestuar në Serbi.	Tiranë				+

Nr	Media	Ankuesi	Përmbajtja e ankesës	Vendi Rrethi	Mënyra e zgjidhjes			
					Në favor	Moskompe tëncë	Refuzuar ose e padrejtë	Në shqyrtim
20.	Gazeta Ballkan	Abonentët e Albtelekom sh.a.	Eshte bashkepunuar me ERT dhe Albtelekom, dhe është bërë i mundur aprovimi i Kontratës së re të Albtelekom sh.a.	Tiranë	+			
21.	Gazeta Shekulli Tv. Top Chanel	Mirela Sinani Mahmudije Matmuja Nereida Pepa	Shkelje e të drejtave prindërore në dëm të fëmijëve të mitur. Nisur nga ankesa e tre shtetaseve u arrit të dërgohen dy rekomandime, Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Rendit Publik në lidhje me të drejtat e fëmijëve të sanksionuara me ligj.	Tiranë Shkodër Kukës	+			
22.	Gazeta Shekulli	Hashim Domelezi, Nazmije Sinani	Ankoheshin për proceduat zvarritëse në sportelet që merren me procedurat e shtetësisë. U arrit të bashkëpunohej me Ministrinë e Rendit dhe Presidencën.	Shijak Durrës	+			
23.	Të gjitha mediat elektronike dhe e shkruar	BSSH	Problemi i ndryshimit të tarifave të shërbimit të telefonisë fikse.	Tiranë				+
24.	Të gjitha mediat elektronike dhe e shkruar. Inicuar nga Avokati i Popullit	Konsumatorët	Me inisiativë Institucionale është hetuar për ndryshimin e tarifave të ofruara nga KESH sh.a.	Tiranë				+

Nr	Media	Ankuesi	Përmbajtja e ankesës	Vendi Rrethi	Mënyra e zgjidhjes			
					Në favor	Moskompe tëncë	Refuzuar ose e padrejtë	Në shqyrtim
25.	Top Chanel Emisioni Fiks Fare	Vasil Dralo	Ankesa kishte të bënte me problemet e gjendjes civile. U mor inisiativa dhe u hartua rekomandimi përkatës, në lidhje me zbatimin e ligjit të ri “Për gjendjen civile” dhe procedimi gjyqësor për çregjistrimin e personave të vdekur.	Lezhë	+			
26.	Inicuar nga Avokati i Popullit	Alfred Kondi	Ankesa kishte të bënte me shërbimin publik të Ujësjetllësit. Nisur nga ankesa e shtetasit është hartuar një rekomandim për Kryeministrin Nano për përmirësimin e bazës ligjore që rregullon shërbimin publik të ujësjetllësit.	Tiranë				+
27.	Gazeta Korrieri	Jetimët e Shtëpisë së foshnjës “Zyber Hallulli”	Ankesa ka të bëjë me veprime të drejtorit të shtëpisë së foshnjës “Zyber Hallulli”. Fëmijët akuzojnë “Drejtori na mban lekët”.	Tiranë	+			
28	Gazeta Shekulli	Fëmijët e trafikuar	Nga raporti i Swiss Terre Des Hommes” në Agia Varvara, publikohet numri i fëmijëve të zhdukur pa adresë.	Tiranë				+

1. Vlerësime të Institucioneve dhe personaliteteve ndërkombëtare për punën e Avokatit të Popullit.

Veprimtaria e Institucionit të Avokatit të Popullit në Shqipëri është zhvilluar nën monitorimin e afërt të faktorit ndërkombëtar, ku përfshihen institucione të tilla prestigjioze si Këshilli i Europës dhe Komisioni Europian, OSBE dhe ODIHR, Departamenti i Shtetit të SHBA dhe organizata ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Gjithashtu edhe mjaft homologë të vendeve perëndimore ku ky institucion ka origjinën apo zhvillimin më të madh kanë vizituar zyrën tonë. Kështu që pas vëzhgimeve të situatës së të drejtave të njeriut në Shqipëri dhe veprimtarisë së zyrës tonë qysh nga fillimi i veprimtarisë së saj, përfaqësuesit e tyre në raportet, intervistat apo letrat kanë shprehur vlerësimet e tyre, të cilat në thelb nuk janë mesazhe kortezie, por shprehin situatën reale pozitive të institucionit tonë, në krahasim edhe me zyrat e tyre apo të tjera.

1. Ambasada e SHBA

I dashur Z. Dobjani,

Po ju shkruaj për të shprehur interesimin tim lidhur me vdekjen e Gazmend Tahirllarit menjëherë pasi doli nga arresti i policisë në Korçë, më 3 janar. Meqenëse ky rast përfaqëson potencialisht një dhunim të rëndë të të drejtave të njeriut, stafi im po i ndjek me vëmendje zhvillimet e mëtejshme.

Ju lavdëroj juve që përfaqësoni një nga institucionet e pavarura kyç të Qeverisë Shqiptare, për rolin tuaj aktiv në parandalimin e konfliktit midis familjes Tahirllari dhe policisë, për ndihmën në ndërtimin e besimit të publikut për sistemin juridik shqiptar. Unë u kënaqa që Ministri Rama bëri veprime të menjëhershme dhe publikisht dënoi dhunën e policisë. Unë gjithashtu u kënaqa kur pashë që investigimet e Prokurorit të Përgjithshëm proçeduan me efektivitet.

Unë kuptoj që faktet e këtij rasti janë duke dalë në shesh. Jam në pritje të përfundimit të një investigimi të plotë dhe të drejtë dhe, nëse faktet përlligjen, të një gjyqi në përputhje me ligjin shqiptar. Ju falenderoi juve për përkushtimin tuaj në zgjidhjen e kësaj çështje serioze.

Tiranë, më 23 janar 2003

Përzemërsisht,
James F. Jeffrey
Ambasador

2. Avokati i Popullit (Ombudsman) – një institucion që filloi të operonte në Korrik 2000 – hetoi veprime të papërshtatshme, joadekuate apo të jashtëligjshme nga ana e Qeverisë. Megjithëse i mungon pushteti për të vënë në zbatim vendime, Avokati i Popullit veproi si një roje ndaj shekljeve të të drejtave të njeriut... Ngarkesa e zyrës së Avokatit të Popullit vazhdoi të rritej ndërkohë që publiku u njoh më shumë me shërbimet e ofruara. Avokati i Popullit gëzoi mbështetjen politike të anëtarëve më të lartë të Qeverisë dhe është autorizuar të marrë informacion nga të gjitha agjencitë publike.

Washington 31 mars 2003

Nga Raporti i Departamentit të Shtetit të SHBA për të drejtat e njeriut në botë gjatë vitit 2002

3. Nga Raporti i 3-të vjetor i Zyrës së Komisionerit të Lartë për të drejtat e njeriut në Këshillin e Europës.

11. Zyra e Ombudsmanit Shqiptar ngjall shpresa të mëdha. Avokati i Popullit, i cili në kontekstin në fjalë, ka burime materiale dhe njerëzore impresionuese, është duke ndërmarrë të gjitha llojet e veprimeve duke përfshirë fushatën audiovizuale të fuqishme. Ne dëshirojmë ta falenderojmë atë për mënyrën e mrekullueshme që organizoi vizitën tonë dhe kemi besimin se zyra e tij do ti japë qytetarëve shqiptarë një ndihmë efikase në mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Strasburg, 19 qershor 2003

Alvaro Gil Robles

4. Në takimin e dytë më 29 tetor 2003, në Zyrën e Këshillit të Europës në Tiranë u bë prezantimi i draft raportit për vlerësimin e Programit të III-të të Bashkëpunimit midis Komisionit European dhe Këshillit të Europës për Shqipërinë.

Grupi i eksperimenteve të kompanise për konsultime PARTICIP, ngarkuar për të bërë vlerësimin e pavarur të Programit të III-të të Bashkëpunimit midis Komisionit Evropian dhe Këshillit të Evropës për Shqipërinë, bëri vlerësimin për efektshmërinë e ndihmës në fushën e drejtësisë. Pas intervistave të gjera me përfaqësues të institucioneve të tilla

si: Shkolla e Magjistratures, Agjenti Qeveritar, Qendra e Publikimeve Zyrtare, Gjykata e Larte, Avokati i Popullit, Ministria e Drejtesise, Qendra per Studime Europjane, ne perfundim te misionit te tij vleresues, Avokati i Popullit u vleresua ne masen e 9.4 pikeve, nga 10 te mundshme, duke u radhitur në vend të parë.

5. Raporti i Byrosë së Demokracisë të të Drejtave të Njeriut dhe Punës të SHBA mbi lirinë ndërkombëtare të fesë, publikuar në dhjetor 2003.

Kufizimet mbi lirinë fetare.

Qeveria është laike dhe besimi fetar përfshihet në programin e shkollave publike. Megjithëse nuk ka ligj që kufizon demonstrimin e kahjeve fetare në shkollat publike, nxënësit nuk janë lejuar ta demonstrojnë këtë në praktikë. Në korrik 2003, një studente myslimane që po diplomohej në universitet u ndalua të vishte shaminë e kokës për foton e diplomës. Pas ndërhyrjes së zyrës së Avokatit të Popullit (një institucion qeveritar me detyrën për të hetuar akuzat e qytetarëve për shkelje të të drejtave të njeriut dhe për të mbrojtur liritë e tyre themelore), studentja u lejua të dilte në fotografi me shaminë e kokës dhe çështja u zgjidh.

6. Nga Analiza e parë e plotë e Sistemit Ligjor në Shqipëri, përgatitur nga Prezenca e OSBE-së në Tiranë (fq.244) “Arritjet e zyrës së Avokatit të Popullit mbështeten kryesisht në pavarësinë e këtij institucioni, e cila është e garantuar nga Kushtetuta. Rritja e besimit të publikut mund të vihet re në rritjen e numrit të njerëzve, të cilët i drejtojnë ankesat apo kërkesat e tyre pranë këtij institucioni. Anëtarët e personelit të Avokatit të Popullit kanë fituar reputacionin e të qënurit komunikues dhe profesionistë në marrëdhënie me shtetasit”.

Publikuar në Tiranë më 19 shkurt 2004.

2. Letra falenderimi nga qytetarët

* * *

1. Komisionerit të Avokatit të Popullit

Z. Jorgo Dhrami

Tiranë

Mora mesazhin tuaj që më dërguat, në lidhje me problemin e vëllait. Edhe një herë ju falenderoj për zemërsisht ju dhe stafin tuaj të Avokatit të Popullit.

Jam i bindur plotësisht dhe njëkohësisht i gëzuar që së fundi populli ynë arriti të ketë një institucion kaq humanitar, të vetëm e të pa influencuar, ku çdo qytetar do të qajë hallet, duke qenë i sigurtë në drejtësinë e vendimit tuaj.

Edhe një herë uroj stafin e Avokatit të Popullit si njerëzit e zgjedhur të Zotit që dinjiteti i tyre të jetë i palëkundur në atë tempull të drejtësisë shqiptare.

Si qytetar shqiptar (që e kam për nder të jem i tillë) rezervoj pa kufi ndihmën time modeste në se do të jetë e nevojshme për institucionin tuaj.

Virginia USA 19 mars 2003

**Përshëndetjet e mia
Edmond Aliaj**

* * *

2. Zotit Ermir Dobjani

Avokat i Popullit

Tiranë

Unë e nënshkuara Durije Misja (Muzhaku) ju falenderoj nga zemra dhe me gjithë shpirt, juve në radhë të parë zoti kryetar dhe gjithë personelin tuaj për drejtësinë e vërtetë, mbi të drejtat e njeriut, duke zbatuar pikë për pikë zbatimin e ligjeve që janë në fuqi.

Kam patur një shtëpi si trashëgimi nga motra ime Rukije Muzhaku bashkë me 7 pjestarë nipër dhe mbesa.

Pas 3 vjet gjyqesh në tre shkallët si në Gjykatën e Rrethit Tiranë, Apelit dhe të Gjykatës së Lartë, e cila mori formë të prerë, ku na u dha e drejta e pronësisë neve trashëgimtarëve ligjorë të lartpërmendur (të cilën na

e kishin uzurpuar të tjerët me dokumenta falso, ku edhe e kishin shitur). Ky fakt u vërtetua plotësisht në të tre instancat e gjykatave.

Në vitin 2003, përmbaruesi e zvarriti shumë lirim të shtëpisë nga muaji janar, deri në muajin gusht të vitit 2001, dhe kur neve u ankuam pranë zyrave tuaja, me ndërhyrjen tuaj, ne e liruam dhe na e dorëzuan shtëpinë, më 15 tetor të vitit 2001. Për këtë detyrë ju kishit ngarkuar zotin Hajredin Hysa, të cilin ne e falenderojmë nga zemra.

Në muajin tetor të vitit 2002 vendosëm që t'a shesim shtëpinë, objekt trashëgimi, por për çudinë e të gjithëve, na vjen një shkresë nga pasuria e paluajtshme Tiranë e firmosur nga Vladimir Pëllumbi, që shtëpia jonë është e bllokuar dhe nuk mund të shitet, megjithëse po kjo Hipotekë, një vit më parë, na kishin dhënë çertifikatën e pronësisë së trashëgimtarëve, dhe nuk pranonte as një lloj bisede për t'a çbllokuar, megjithëse vendimi i Gjykatës së Lartë, ishte i formës së prerë, në favorin tonë.

Ne, menjëherë u drejtuam përsëri në zyrat tuaja zoti kryetar, në të cilën për zbatimin e kësaj detyre, u ngarkua zoti Fredi Paskali, i cili e çbllokoi menjëherë. I jam mirënjohës dhe e falenderoj nga zemra.

Megjithë njerëzit që takoj u flas të vërtetën si për ju dhe për Institucionin që ju drejtoni dhe është krijuar një bindje që Avokati i Popullit mbron në mënyrë të përpiktë të drejtat e njeriut.

E shkruaj këtë letër falenderimi zoti kryetar jo për servilizëm, por për respektin e madh që kam karshi jush dhe për gjithë personelin që ju drejtoni.

Tiranë, më 15.04.2003

Me respekt
Durije Miska

* * *

3. Zotit Ermir Dobjani
Avokat i Popullit
Tiranë

Siç jeni në dijeni, unë Siri Hanaj, me Zyrën Tuaj kam patur prej vitesh një bashkëpunim e mirëkuptim shumë të mirë. Nuk është e thënë që unë doemos të kisha gjithnjë të drejtë. Por në fakt rezultoi se në Zyrën Tuaj i nderuar Avokat, pothuaj çdo problem që u kam ngritur ka gjetur mirëkuptim të plotë ligjor dhe zgjidhje ligjore. Po e filloj së pari me

konceptimet e mia lidhur me zbatimin e ligjit të Sigurimeve Shoqërore nr.7703 dt.11.05.1993, pra shkeljet e rënda me aktet nënligjore, antiligjore e antikushtetuese, si edhe me vetë të metat e ligjit. Të gjitha këto më janë konfirmuar nga ajo zyrë se janë të drejta dhe se keni bërë rekomandimet përkatëse që u njuh ligji drejtuar Ligjvënësist dhe Ekzekutivist. Si intelektual e qytetar ndihem i kënaqur që njerëzve të thjeshtë u dëgjohef fjala. Por, nuk do të lë pa përmendur dhe zgjidhjen e një problemi personal të një personi, ku qëllimisht e pa asnjë bazë ligjore iu ndaluan pagat e 4 (katër) muajve, por që falë ndërhyrjes nga Zyra Juaj ato u përfituan.

I nderuar Avokat, nëse do të më lejoni do të bëja edhe një sugjerim: Ndoshta për kushtet e Shqipërisë – ku zyrtarët (jo të gjithë) sillen si padron e nuk e përfillin ligjin, duke shkelur brutalisht të drejtat e njeriut, ligji i Avokatit të Popullit, ndoshta për një periudhë 40-50 vjeçare të përforcohej me sanksione të forta (të themi gjoba, shkarkime e pse jo edhe kallzime penale) për mos zbatim e rekomandimeve që jep Zyra e Avokatit të Popullit.

Sipas mendimit tim, ky amendament i ligjit do të bënte që “Maliqët” të mos gjenin vend në se do shkelnin ligjin e të mos përfillnin Zyrën e Avokatit të Popullit dhe në shoqëri të sundojë ligji e vetëm ligji, ashtu si atje në atë vend ku ka lindur ky ligj.

Duke iu përsëritur falenderimet dhe mirënjohjen për respektin dhe mirëkuptimin me mua për çdo problem që u kam ngritur – do të dëshiroja edhe një takim me Ju.

Tiranë, 28.05.2003

Me respekt
Prof.As.Dr.Siri Hanaj

* * *

4. Lënda: *Falenderim për mirëkuptim dhe angazhim konkret lidhur me vënien në lëvizje të hetimit të çështjes së marrjes dhe zhdukjes pa lënë gjurmë të shtetasit*
Remzi Hoxha

Drejtuar: Institucionit të Avokatit të Popullit
të Republikës së Shqipërisë

Mirëkuptimi dhe gatishmëria e Institucionit tuaj, për bashkëpunim, si dhe angazhimi Juaj konkret në drejtim të vënies në lëvizje të mekanizmave institucionale për hetimin e rastit të veçantë të marrjes dhe zhdukjes “pa

lënë gjurmë” të bashkëkombasit dhe bashkëpunëtorit tonë Remzi Hoxha, për ne, paraqet lajm shumë kohë të pritur nga Institucionet kompetente të Republikës së Shqipërisë.

Sindikata e Pavarur e Ekonomisë së Vogël dhe Zejtarisë së Kosovës i është tepër mirënjohëse Institucionit të Avokatit të Popullit të Republikës së Shqipërisë, lidhur me angazhimin dhe përpjekjet që bën për ndriçimin e këtij rasti, vërtetë fatkeq dhe tepër të veçantë, prandaj ju falenderon për faktin se në kreun e këtij Institucioni keni të angazhuar zotin Ermir Dobjani dhe bashkëpunëtorët e tij, të cilët, në këtë rast human, duke e kryer punën e Avokatit (vërtetë) të Popullit, në mënyrë të tërthortë po dëshmojnë se:

- po e ngrisin moralin për punë të sinqertë të punëtorët e Institucioneve shtetërore kudo në hapësirën e trojeve etnike,
- ndër bashkëkombasit tanë po e ngrisin krenarinë për institucionet që i kanë duke jua rikthyer besimin të të njëjtat dhe duke i vetëdijësuar e bindur se krimi nuk ka vend në trojet tona.
- faktori ndërkombëtar përditë e më shumë po e rrit besimin se shqiptarët janë popull i civilizuar që kanë aftësi dhe dije për t’u vetëorganizuar institucionalisht në zbulimin, pengimin dhe luftimin e krimit, gjithnjë duke respektuar normat e së drejtës ndërkombëtare.

Së fundi, të shpresojmë se angazhimi juaj në këtë rast, kaq fatkeq dhe të prekshëm për familjen Hoxha dhe për subjektet që ne i përfaqësojmë, do të rezultojë me gjetjen e bashkëkombasit dhe bashkëpunëtorit tonë Remzi Hoxha.

Prishtinë, 02.06.2003

Nga: Sindikata e Pavarur e Ekonomisë së

Vogël

dhe Zejtarisë së Kosovës

Prishtinë

K r y e s i a

* * *

5. Zotit Ermir Dobjani
Avokat i Popullit
Tiranë

Në radhë të parë ju kërkujmë ndjesë që nuk ju kemi falenderuar më parë me zgjidhjen e problemit tonë.

Jemi 7 familje nga fshati Zhym i Rrethit të Lushnjës. Ju falenderojmë stafin tuaj të Avokatit të Popullit dhe veçanërisht ju si drejtues i këtij institucioni, si dhe zotin Fredi Paskali, i cili brenda afatit 13

ditor zgjidhi problemin e rregjistrimit të pronësisë që kishte një vit e aplikuar me dt. 24.06.2002 dhe nuk merrnim dot aktin e pronësisë.

Kjo gjë u realizua në sajë të punës tuaj.

Kjo pronë është marrë me formën e prerë nga Gjykata e Apelit Vlorë me Nr.89 dt.29.02.2002 si dhe nga Gjykata e Lartë Tiranë me Nr.19 dt.25.07.2001. Por për çudi në Gjykatën e Shkallës së I të rrethit Lushnje janë zhvilluar 3 gjyqe për këtë objekt që me vendimet e mësipërme kanë marrë formë të prerë dhe në Gjykatën e Rrethit Lushnje vazhdon kalvari i gjyqeve dhe nuk e dimë se kur do të merrej ky gjykim.

3 gjykimet në Gjykatën e Rrethit Lushnje janë marrë me vendim pushim gjykimi të cilët janë:

- Vendimi Nr.203 dt. 13.03.2001
- Vendimi Nr. 19 dt. 06.02.2002
- Vendimi Nr.597 dt. 06.09.2002

Një gjykim që ka marrë formën e prerë si ka mundësi që të rigjykohet në Gjykatën e Shkallës së I dhe meqenëse ka sa herë është e drejtë që të gjykohet në Gjykatën e Shkallës së I.

Mbetemi me shpresën se problemi ynë do të rishikohet dhe do të zgjidhet sa më shpejt.

Lushnje

Zhym 24.07.2003

Me nderim dhe respekt

1.Kostandina Allkonja, 2.Lili Allkonja,
3.Kristaq Allkonja etj.

Media e shkruar per vitin 2003

NR	DATA	GAZETA	TITULLI	RUBRIKA
1	07.01.2003	BALLKAN	Specialistet e Avokatit te Popullit hartojne raportin per gjendjen ne dhomat e paraburgimit.	Njoftim
2	07.01.2003	SOT	Korçë, Dobjani heton policet.	Njoftim
3	08.01.2003	DITA	AP: dhe roli i tij ne mbrojtjen e te drejtave te njeriut ne Shqiperi.	Njoftim
4	08.01.2003	TEMA	AP dhe te drejtat e njeriut.	Njoftim
5	09.01.2003	SOT	Dobjani : Polici e dhunshme.	Njoftim
6	10.01.2003	Gazeta SHQIPTARE	Komiteti Shqiptar i Helsinkit pershendet qendrimin e AP-se.	Njoftim
7	11.01.2003	SHEKULLI	AP kerkon zhvarrimin e Tahirlarit.	Njoftim
8	11.01.2003	ALBANIA	AP kerkon zhvarrimin e kufomes se Tahirlarit per ekspertize te dyte mjeksore.	Njoftim
9	11.01.2003	BALLKAN	AP: Ekspertiza mjeko-ligjore do te jape nje pergjigje shume te vertete.Zhvarroset Tahirlari, ekzaminohet trupi.	Njoftim
10	11.01.2003	DITA	AP premtion version objektiv per vdekjen e Tahirlarit.	Njoftim
11	11.01.2003	Gazeta SHQIPTARE	Avokati i Popullit: Tani e verteta.	Njoftim
12	12.01.2003	REPUBLIKA	Tre zyrtare firmosin per Tahirlarin. Zbardhet e verteta.Ne gjak kishte perqindje alkoli, por vdekja erdhi nga goditja me shkelm ne koke, ku i eshte prekur dhe truri.	Njoftim
13	17.01.2003	KOHA JONE	AP dhe Prokurori i Pergjithshem te rakordojne veprimet.	Artikull
14	17.01.2003	Gazeta SHQIPTARE	AP i kenaqur nga mbeshtetja e Prokurorise	Artikull
15	17.01.2003	REPUBLIKA	Dobjani dhe Sollaku leshojne alarmin! Akuzohet Policia.	Artikull
16	17.01.2003	SHEKULLI	Prokuroria, bashkepunim i frytshem me Dobjanin.	Artikull
17	17.01.2003	ZERI POPULLIT	Sollaku konfirmon dyshimet se Tahirlari vdiq nga dhuna e policise.	Artikull
18	17.01.2003	BALLKAN	Banoret e Koder-Kamzes ankohen te Avokati i Popullit.	Njoftim
19	17.01.2003	BALLKAN	Prokurori i Pergjithshem dhe Avokati i Popullit ne nje Konference te perbashket shtypi.	Konferencë shtypi
20	26.01.2003	Gazeta Dnevni Avaz-Bosnje Herzegovina	AP ne takimin e Ombudsmaneve te Ballkanit.	Artikull

21	28.01.2003	TEMA	Sollaku-Dobjani konfirmojne bashkepunimin.	Artikull
22	28.01.2003	ATSH	Dobjani merr pjese ne takimin e Ombudsmaneve te Ballkanit	Njoftim
23	29.01.2003	DITA	AP merr pjese ne takimin e Ombudsmaneve te Ballkanit.	Artikull
24	31.01.2003	BALLKAN	Dobjani : Masa per prokuroret e Fierit	Artikull
25	31.01.2003	ATSH	Ambasadori amerikan Xheffri pershendet Avokatin e Popullit, Dobjani.	Njoftim
26	01.02.2003	KOHA JONË	Jeffrey interesohet per Tahirllarin.	Njoftim
27	01.02.2003	BALLKAN	AP: "Mjeke ligjore ne çdo akt-ekspertimi".	Njoftim
28	01.02.2003	Gazeta SHQIPTARE	Ambasadori amerikan Xhefri falenderon Avokatin e Popullit : Po ndaloni konfliktin.	Njoftim
29	01.02.2003	ALBANIA	Deputetet ne Korçe per dosjen "Tahirllari".	Njoftim
30	01.02.2003	KORRIERI	Ambasadori USA : Avokati i Popullit eshte nje nga institucionet me te pavarura shqiptare.	Njoftim
31	01.02.2003	ZERI POPULLIT	Xhefri, pershendet Avokatin Dobjani per ndihmen ne ndertimin e besimit te publikut ne sistemin juridik shqiptar.	Njoftim
32	05.02.2003	Gazeta SOT	Dobjani nxjerr nga burgu Ligor Papen.	Artikull
33	05.02.2003	KOHA JONE	AP kerkon hetim ndaj Prokurorit.	Artikull
34	07.02.2003	KOHA JONE	AP lideri socialist ne rolin e Avokatit te Popullit.	Artikull
35	11.02.2003	ZERI I POPULLIT	Dobjani, padi penale ne Prokurorine e Pergjithshme per antenat celulare.	Njoftim
36	12.02.2003	Gazeta SHQIPTARE	AP ne Konferencen per Reformat ne drejtësi : Aktet nenligjore pa nivel.	Artikull
37	12.02.2003	ATSH	AP takim me nje perfaqesi te shoqates "Besa".	Njoftim
38	13.02.2003	ZERI POPULLIT	Avokati i Popullit, ndihme per te bashkepunuar.	Njoftim
39	13.02.2003	KOHA JONË	AP i jep besën "Besës".	Artikull
40	13.02.2003	Gazeta SOT	Dobjani : Jam Avokat i Popullit.	Njoftim
41	18.02.2003	ATSH	AP se shpejti nje liber per te burgosurit shqiptare jashte shtetit.	Njoftim
42	19.02.2003	Gazeta SHQIPTARE	Dobjani te "Shtepia e Femijes" per Ilir Barçin.	Artikull
43	19.02.2003	Gazeta SHQIPTARE	Te drejtat e te burgosurve	Prononcim
44	19.02.2003	KORRIERI	AP : Botohet manuali juridik per te burgosurit jashte vendit.	Artikull
45	19.02.2003	Gazeta SHQIPTARE	Te drejtat e te burgosurve - botim i AP-se.	Artikull
46	19.02.2003	ATSH	AP dhe Ministria e Jashtme promovojne nje liber ne ndihme te te burgosurve shqiptarë jashte shtetit.	Njoftim

47	19.02.2003	ATSH	Avokati i Popullit ne mbrojtje te interesave te te burgosurve shqiptare jashte shtetit.	Njoftim
48	20.02.2003	Gazeta SHQIPTARE	AP sistemon 13-vjeçarin tek "Zyber Hallulli".	Njoftim
49	20.02.2003	ATSH	Avokati i Popullit pret Perfaqesuesin Politik te NATO-s.	Njoftim
50	20.02.2003	ALBANIA	Dobjani : "Te mbrojme 5 mijë të burgosurit nëpër botë".	Artikull
51	20.02.2003	ALBANIA	Nje liber per te burgosurit jashte Shqiperise.	Artikull
52	20.02.2003	KORRIERI	Promovohet libri per te drejtat e emigranteve, qe vuajne burgimin jashte shtetit.	Artikull
53	21.02.2003	Gazeta SHQIPTARE	Dobjani takon Elgersmanin e NATO-s.	Artikull
54	21.02.2003	ATSH	Avokati i Popullit ben thirrje "Kujdes nga avokatet e rremë".	Njoftim
55	21.02.2003	Gazeta "55"	Avokati i Popullit pret Perfaqesuesin Politik te NATO-s, Stefan Elgersma.	Njoftim
56	21.02.2003	ZERI I POPULLIT	Avokati i Popullit takohet me perfaqesuesin e NATO-s.	Artikull
57	22.02.2003	ZERI I POPULLIT	Avokati i Popullit ben thirrje "Kujdes nga avokatet e rremë".	Artikull
58	22.02.2003	Gazeta "SOT"	Avokati i Popullit : Kujdes nga avokatet e rremë".	Artikull
59	22.02.2003	Gazeta SHQIPTARE	Avokati i Popullit : Punojmë gratis.	Artikull
60	22.03.2003	ALBANIA	Në Has, mashtrues ne emer te Avokatit te Popullit.	Prononcim
61	22.02.2003	BALLKAN	Avokati i Popullit : "Kujdes nga avokatet e rremë".	Njoftim
62	22.02.2003	SHEKULLI	Avokati i Popullit"Kujdes nga avokatet e rreme".	Njoftim
63	26.02.2003	BALLKAN	AP ne seminarin "Mbi shtetesine shqiptare"	Artikull
64	26.02.2003	ATSH	AP ne seminarin "Mbi shtetesine shqiptare"	Njoftim
65	27.02.2003	ATSH	Avokati i Popullit, Dobjani, takohet me Ombudsmanin kroat, Klariç.	Njoftim
66	27.02.2003	ATSH	Ombudsmani i Kroacise vizite dy ditore ne vendin tone.	Njoftim
67	27.02.2003	ATSH	Presidenti Moisiu ne takim me Avokatin e Popullit te Kroacise Klariç.	Njoftim
68	28.02.2003	ATSH	Institucioni i Avokatit te Popullit, i rendesi-shem ne sistemin e vlerave te demokracise, shprehet kryetari i Kuvendit Pellumbi.	Njoftim
69	28.02.2003	ATSH	Ombudsmani Kroat pritet nga autoritetet e Drejtesise shqiptare.	Njoftim
70	28.02.2003	Gazeta SHQIPTARE	Ante Klariç vjen ne Tirane.	Artikull
71	28.02.2003	Gazeta ALBANIA	Ombudsmani i Kroacise vizite ne Tirane.	Artikull

72	01.03.2003	Gazeta SOT	Moisiu-Ombudsmani Kroat. Ballkani duhet të bashkëpunojë.	Artikull
73	01.03.2003	Gazeta RD	AP: Moisiu takon Avokatin e Popullit te Kroacise.	Artikull
74	04.03.2003	Gazeta TEMA	Shtohen ankesat te "Avokati i Popullit".	Artikull
75	04.03.2003	REPUBLIKA	Policia ne gjyq.Dobjani akuzon kreret e zyrave te legalizimit te te huajve.	Artikull
76	04.03.2003	Gazeta SOT	AP : Telefon per ankesat.	Artikull
77	09.03.2003	Gazeta DITA	Boton librin per te drejtat e te denuareve.	Artikull
78	09.03.2003	SHQIPTARE	AP e ndihmoi te rikthehej ne Akademi.	Artikull
79	09.03.2003	Gazeta DITA	Dobjani shenon ankesen nr.4000.	Artikull
80	12.03.2003	Gazeta SHQIPTARE	Aventura e babait dhe "fitorja"me Avokatin e Popullit.	Artikull
81	12.03.2003	Republika	Dobjani: Provat per zyrtaret e korruptuar i kemi çuar ne Prokurorine e Pergjithshme.	Artikull
82	13.03.2003	SHEKULLI	Nëna në Shtiqën: Se mos ma keni humbur djalin se do t'ju padis te Avokati i Popullit.	Artikull
83	16.03.2003	BALLKAN	AP me nje qytetar nga Dropulli.	Artikull
84	16.03.2003	ZERI I POPULLIT	Dobjani: Akti 1993 cenon parimin kushtetues te barazise para ligjit.	Artikull
85	18.03.2003	BALLKAN	AP: KE ne nje seminar per mbrojtjen e te drejtave te njeriut.	Artikull
86	19.03.2003	ATSH	Ambasadori i SHBA James Jeffrey takon Avokatin e Popullit, Ermir Dobjani.	Njoftim
87	20.03.2003	DITA	AP - Xhefri: Jeni institucion i rendesishem.	Artikull
88	20.03.2003	DITA	Pas ankesave te konsumatoreve tek Avokati i Popullit, Harasani premtion bashkepunim.	Artikull
89	20.03.2003	ALBANIA	Xhefri-Dobjani : Ambasada e SHBA-se kerkon vazhdim te bashkepunimit.	Artikull
90	20.03.2003	REPUBLIKA	Xhefri takon Dobjanin per te Drejtat e Njeriut.	Artikull
91	20.03.2003	BALLKAN	Xhefri tek Avokati Dobjani: Erdha t'ju inkurajoj.	Artikull
92	20.03.2003	Gazeta SHQIPTARE	Nderhyn Avokati i Popullit.Protesta, rikthehet energjia ne Kamez.	Artikull
93	21.03.2003	BALLKAN	Njerezit e Tahirllarit tek Avokati i Popullit. "Prokuroria fshehu provat".	Artikull
94	21.03.2003	ALBANIA	Te afermit e Tahirllarit, ankese tek Dobjani.	Artikull
95	21.03.2003	BALLKAN	Familjaret : Prokuroria fsheh provat.	Artikull
96	21.03.2003	RD	Familjaret e Tahirllarit tek AP : "Provat jane fshehur qellimisht dhe si rrjedhim vendimi i dhene eshte shume i ulet".	Artikull
97	22.03.2003	KOHA JONE	AP zbulon ne arkivat e Ministrise se Rendit dokumentin e rralle.Ne kerkim te viteve te burgut.	Artikull
98	22.03.2003	REPUBLIKA	Kreu i Mbrojtjes se Popullit nis denoncimin per tek Ministri i Energjetikes.	Artikull
99	26.03.2003	REPUBLIKA	Avokati i Popullit : Nuk kemi bere asnje padi!	Njoftim

100	26.03.2003	Gazeta SHQIPTARE	Policet tremben per te kerkuar oret shtese te papaguara.	Prononcim Sotirag Nushi
101	27.03.2003	REPUBLIKA	AP denoncon dhunen dhe trajtimin mizor nga Rendi në Kuvend.	Artikull
102	28.03.2003	RD	Nano i premtion Abdiut vendin e Dobjanit.	Artikull
103	28.03.2003	TEMA	AP: 144 policeve u jane mbajtur oret suplementare.	Artikull
104	29.03.2003	BALLKAN	Ceshtja Tahirllari risjell ne Korçe Avokatin e Popullit.	Artikull
105	29.03.2003	Gazeta SHQIPTARE	"KESH po me ha pensionin". Dergon ankesen dhe tek Avokati i Popullit.	Artikull
106	30.03.2003	BALLKAN	AP pension, policet e vrare para ' 99.	Artikull
107	01.04.2003	REPUBLIKA	AP denoncon manipulimet.	Artikull
108	03.04.2003	BALLKAN	Pensionet shkojne tek Avokati i Popullit.	Artikull
109	04.04.2003	BALLKAN	AP: Raporti i SHBA-se, i vertete.	Intervistë Artur Lazebeu
110	06.04.2003	TEMA	AP mbulon shkeljet e medha te te drejtave te njeriut.	Artikull
111	07.04.2003	ATSH	Avokati i Popullit synon te ruaje paanesine politike ne veprimtarine e tij.	Njoftim
112	07.04.2003	ATSH	Avokati i Popullit gjate vitit 2002 nje rritje te numrit te ankesave.	Njoftim
113	07.04.2003	ATSH	Forcimi i institucionit te Avokatit te Popullit eshte kusht per integrimin e vendit.	Njoftim
114	08.04.2003	ATSH	Ligji per Avokatin e Popullit, nevoja per permiresime.	Njoftim
115	08.04.2003	KOHA JONE	Avokati i Popullit, shuplake per Qeverine.	Njoftim
116	08.04.2003	RD	Dobjani apo Departamenti i Shtetit eshte Avokati i Popullit.	Prononcim
117	08.04.2003	BALLKAN	Dobjani denoncon policine ne Kuvend.	Njoftim
118	08.04.2003	ALBANIA	Rriten ankesat tek Avokati i Popullit.	Njoftim
119	10.04.2003	BALLKAN	Prokuroret harrojne ne burg te riun.	Artikull
120	13.04.2003	DITA	Avokati i Popullit: Vogelushi 11-vjeçar u shtyp nga ushtari belg.	Artikull
121	13.04.2003	Agjensia PRIMA	Ombudsmani Shqiptar takime zyrtare ne Moske	Njoftim
122	19.04.2003	REPUBLIKA	Avokati i Popullit: Kaos ne gjendjet civile. Ne dosjet me emra, "jetojne" me te gjallet edhe te tjeret	Prononcim
123	19.04.2003	SHEKULLI	Kukes, Avokati i Popullit, per dhunen ndaj 5 te burgosurve	Njoftim
124	23.04.2003	ATSH, "55", Albania, Sot, Korrieri, G.Sh., Z.P. Republika	Avokati i Popullit, Ermir Dobjani, dekorohet me Medaljen e Arte "Naim Frasheri"	Njoftim
125	24.04.2003	Gazeta SHQIPTARE	Diskutohen komisioneret e Avokatit te Popullit	Njoftim
126	24.04.2003	ATSH	Avokati i Popullit pret Ombudsmanin e Maqedonise	Njoftim

127	26.04.2003	SOT	Naumovski, takim me krere te larte te qeverise	Njoftim
128	26.04.2003	Gazeta SHQIPTARE	Naumovski, takon drejtuesit e qeverise	Njoftim
129	26.04.2003	ZERI I POPULLIT	Avokati i Popullit Maqedonas, takime me personalitete te vendit	Njoftim
130	06.05.2003	DITA	Dobjani: Ja ku e shkel ligjin policia	Prononcim
131	13.05.2003	Gazeta SHQIPTARE	Dobjani i shkruan Athines per Kapllanin	Njoftim
132	13.05.2003	ALBANIA	Rama: "Nuk u dhame grada ish te perndjekurve". Mbledhje e zhvilluar nga Ministri i Rendit, i ftuar Avokati i Popullit etj.	Prononcim
133	13.05.2003	KORRIERI	Avokati i Popullit: Do te shqyrtojme rastin e Policite te larguar nga puna per Graden.	Njoftim
134	13.05.2003	E perjavshme e Gazetes SHQIPTARE	Avokati i Popullit, Ermir Dobjani, emerimi dhe lirimi nga detyra i policeve te rolit baze duhet te behet nga drejtori i Qarkut dhe jo i Pergjithshem etj...etj...	Prononcim
135	14.05.2003	DITA	Dobjani: Ankohuni tek Rama	Prononcim
136	14.05.2003	KOHA JONE	Avokati i Popullit mbron policin Hajdari	Njoftim
137	16.05.2003	ZERI I POPULLIT	Avokati i Popullit "Gju me gju" me qytetaret	Njoftim
138	23.05.2003	GAZETA "55"	Institucioni i Avokatit te Popullit "ka zbritur" ne baze.	Njoftim
139	23.05.2003	ALBANIA	Familjaret e viktimave denoncuan tek Avokati i Popullit disa muaj me pare	Njoftim
140	23.05.2003	SHEKULLI	Dobjani: Materialet ia kam derguar prokurorise	Prononcim
141	27.05.2003	ALBANIA	"Te nderpritet dhuna ne qelite e paraburgimit"	Prononcim
142	27.05.2003	KORRIERI	Avokati i Popullit: Me shume te drejta per te paraburgosurit	Prononcim
143	28.05.2003	GAZETA "55"	Avokati i Popullit takohet me perfaqesi te shoqatave te ish te perndjekurve politike	Njoftim
144	28.05.2003	SOT	Dobjani, ndihme te perndjekurve	Njoftim
145	28.05.2003	Gazeta RD	700 ankesa tek Avokati i Popullit kunder Ministrit te Rendit per ndarjen e padrejte te gradave	Njoftim
146	28.05.2003	Gazeta RD	Nje perfaqesi e shoqatave te ish te perndjekurve politike takon Avokatin e Popullit	Njoftim
147	28.05.2003	ZERI I POPULLIT	Avokati i Popullit takohet me nje perfaqesi te ish te perndjekurve politike.	Njoftim
148	28.05.2003	ALBANIA	Ish-te perndjekurit ankohen per dhunen tek Avokati i Popullit	Njoftim
149	28.05.2003	BALLKAN	Alket Jaupi i plotesonte kriteret per komisioner te Avokatit te Popullit	Njoftim
150	28.05.2003	ATSH	Kryeministri Nano bisedon me Avokatin e Popullit per te perndjekurit politike	Njoftim

151	29.05.2003	ZERI I POPULLIT	Nano: Marreveshje Qeveri - Te Perndjekur me ndermjetes Avokatin e Popullit	Njoftim
152	29.05.2003	BALLKAN	Te persekutuarit, Nano te Dobjani	Njoftim
153	29.05.2003	DITA	Kryeministri takon Avokatin e Popullit per te zgjidhur konfliktin me protestuesit	Njoftim
154	29.05.2003	ALBANIA	Dobjani, garant mes qeverise dhe ish - te perndjekurve	Njoftim
155	29.05.2003	SOT	Nano: Te nisin hetimet per dosjet e te perndjekurve	Njoftim
156	29.05.2003	Gazeta SHQIPTARE	Dobjani garant per shperblimet	Njoftim
157	29.05.2003	TEMA	Nano, nga pergjakja te hetimet per te perndjekurit	Njoftim
158	29.05.2003	ATSH	Te perndjekurit - Qeveria Pranohet roli ndermjetes i Avokatit te Popullit	Njoftim
159	30.05.2003	Gazeta SHQIPTARE	Avokati i Popullit: Ligj per shperblimin e ish-te perndjekurve.	Njoftim
160	30.05.2003	ZERI I POPULLIT	Avokati i Popullit, negociata me ish te perndjekurit polike.	Njoftim
161	30.05.2003	TEMA	Te perndjekurit tek Avokati i Popullit: Duam 3400 leke per çdo dite burgu	Njoftim
162	30.05.2003	BALLKAN	Avokati i Popullit: Qeveria ne bisedime me te perndjekurit	Njoftim
163	30.05.2003	ATSH	Avokati i Popullit: Fillojne bisedimet per per-shkrimin e projekt-marreveshjes angazhuese per ish te perndjekurit politike	Njoftim
164	02.06.2003	SHEKULLI	Takimi i radhes mer paleve ne zyren e Avokatit te Popullit	Njoftim
165	03.06.2003	"55"	Shoqatat e te perndjekurve, negociata tek Avokati i Popullit	Njoftim
166	03.06.2003	DITA	Avokati i Popullit takon Sekretarin e Pergjithshem te Keshillit te Ministrave	Njoftim
167	03.06.200.	ATSH	Avokati i Popullit: Nuk ka pakt me qeverine per demshperblimin e ish te perndjekurve politike	Njoftim
168	03.06.2003	ATSH	Avokati i Popullit: Unifikohen pikat baze per nenshkrimin e marreveshjes per demshperblimin e ish te perndjekurve politike	Njoftim
169	04.06.2003	DITA	Te perndjekurit, "OK" propozimeve te Qeverise	Njoftim
170	04.06.2003	TEMA	Avokati i Popullit merr ne mbrojtje deputetin Metko	Njoftim
171	04.06.2003	SHEKULLI	Projektohet pakti mes Qeverise dhe ish-te perndjekurve	Njoftim
172	04.06.2003	ZERI I POPULLIT	Avokati i Popullit: Unifiohen pikat baze per marreveshjen e demshperblimit te ish te perndjekurve politike	Njoftim
173	04.06.2003	PANORAMA	Avokati i Popullit ka ndihmuar unifikimin e kerkesave te ish te perndjekurve.	Njoftim

174	05.06.2003	ATSH	Avokati i Popullit Dobjani takon perfaqesues te opozites ne kuadrin e negociatave per ish te perndjekurit	Njoftim
175	06.06.2003	"55"	Opozita i kerkon "Avokatit te Popullit" Dobjani llogari per negociatat me ish te perndjekurit	Njoftim
176	11.06.2003	BALLKAN	Avokati i Popullit dhe Kontrolli i Larte i Shtetit bashkepunojne per pensionet	Njoftim
177	12.06.2003	ATSH	Avokati i Popullit: Ministri i Shtetit, diskuton me perfaqesues te shoqatave te ish te perndjekurve politike	Njoftim
178	13.06.2003	ZERI I POPULLIT	Avokati i Popullit vazhdon ndermjetesimin midis Qeverise dhe te perndjekurve"	Njoftim
179	13.06.2003	KOHA JONE	Klosi dhe Dobjani takojne te perndjekurit	Njoftim
180	13.06.2003	SOT	Te perndjekurit, ndihme Avokatit te Popullit	Njoftim
181	17.06.2003	ATSH	Avokati i Popullit rekomandon zbatimin e ligjit "Per shendetin Mendor" ne Spitalin Psikiatrik ne Tirane	Njoftim
182	20.06.2003	TEMA	Si hapen letrat e "Avokatit te Popullit"	Njoftim
183	21.06.2003	SOT	Vidhen letrat e Avokatit te Popullit	Njoftim
184	24.06.2003	Gazeta SHQIPTARE	Avokati i Popullit per Gjendjet Civile	Prononcim
185	Qershor 2003	Reviste SHPRESE Nr.5	Avokati i Popullit: Ligji eshte ligj	Interviste Harallamb Bano
186	01.07.2003	Gazeta SHQIPTARE	Familja e Petrit Lleshit te "Avokati i Popullit", "Policia dhune ndaj djemve"	Njoftim
187	04.07.2003	Panorama	Deklarata e Avokatit te Popullit: Dobjani, Kontrolli u be pa pranine e delegacionit	Prononcim
188	04.07.2003	ZERI I POPULLIT	Avokati i Popullit hetim per policine e Rinasit	Prononcim
189	08.07.2003	ATSH	Ligji "Per te drejtat dhe trajtimin e te denuarve", nje mundesi me shume per mbrojtjen e te drejtave te njeriut	Njoftim
190	15.07.2003	Gazeta SHQIPTARE	Te semuret ne burg, "peng" sistemimi	Artikull
191	16.07.2003	Koha Jone	Avokati i Popullit per ligj te qarte te shtypit	Prononcim
192	19.07.2003	SHEKULLI	Avokati i Popullit: Ky ligj qe s'zbatohet kurre	Intervistë Brizida Gjikondi
193	19.07.2003	ZERI I POPULLIT	Avokati i Popullit: Si shkelen urdherat e gjykates dhe sa pune mbarojne zyrat e permbarimit	Prononcim
194	22.07.2003	SHEKULLI	Histori e dhimbshme divorci. Qe paguhet nga femijet. Njeri nga rastet me te fundit qe ka perfunduar tek Avokati i Popullit	Prononcim
195	22.07.2003	ZERI I POPULLIT	Avokati i Popullit: "Te shikohet interesi i femijeve"	Prononcim

196	23.07.2003	ALBANIA	Avokati i Popullit: Ne ju mbrojme nga shteti	Intervistë A.Lazebeu
197	23.07.2003	KORRIERI	600 ankesa per gradat te Avokati i Popullit	Prononcim S.Nushi
198	23.07.2003	KORRIERI	Avokati i Popullit nxit administraten te jete e hapur me median	Prononcim S. Nushi
199	24.07.2003	ALBANIA	Avokati i Popullit ndihmon qytetaret per sherbimet e KESH-it dhe Albtelekomit	Prononcim
200	25.07.2003	ATSH	Avokati i Popullit inicon kontraten e re te KESH me konsumatoret	Prononcim
201	26.07.2003	TEMA	Avokati i Popullit propozon nje kontrate te re me KESH qe mbron me shume te drejtat e qytetareve dhe ben perpjekje per te frenuar abuzimin e shtetit ne kontratat e tij te njeanshme me konsumatoret	Prononcim
202	26.07.02003	BALLKAN	Avokati i Popullit: Kontrate e re me KESH	Prononcim
203	26.07.2003	DITA	Avokati i popullit dhe KESH kontrate ne ndihme te qytetareve	Prononcim
204	26.07.2003	ATSH	Institucioni i Avokatit te Popullit i jep fund ankthit te nje nene nga Elbasani	Prononcim Y.Hasani
205	26.07.2003	KOHA JONE	Fale Avokatit te Popullit, tani jam e bindur per vdekjen e vajzes sime pas 11 vjetesh	Prononcim Ymer Hasani
206	27.07.2003	SOT	Avokati i Popullit zbardh çeshtjen e harruar	Prononcim Ymer Hasani
207	27.07.2003	KORRIERI	Hetimi i Dobjanit bind nenen per vdekjen e femijes	Prononcim Ymer Hasani
208	27.07.2003	REPUBLIKA	Avokati i Popullit: 11 vjet hetime per te zbardhur vdekjen e vajzes 3-vjeçare	Prononcim Ymer Hasani
209	27.07.2003	DITA	Dobjani: Vajza juaj ka vdekur	Prononcim Ymer hasani
210	27.07.2003	KOHA JONE	Pas kontaktit ne burg vellezerit Lleshi refuzojne takimin me komisioneret e Avokatit te Popullit	Prononcim Sotiraq Nushi
211	30.07.2003	SHEKULLI	Me ne fund u gjet gjuha e perbashket	Prononcim
212	31.07.2003	BALLKAN	Avokati i Popullit: Kontrate e re me Albtelecomin	Prononcim
213	31.07.2003	PANORAMA	Studentja e Gjuheve te Huaja ankohet tek Avokati i Popullit	Artikull
214	10.08.2003	Gazeta SHQIPTARE	Vdekja e shoferit, nesor dosja tek Avokati i Popullit	Artikull
215	12.08.2003	Gazeta SHQIPTARE	Shoferi i vrare, Avokati i Popullit sot te familja	Artikull
216	13.08.2003	Gazeta SHQIPTARE	Vdekja e shoferit, familja rrefen te Avokati i popullit	Artikull
217	14.08.2003	ZERI I POPULLIT	Avokati i Popullit vlereson marredheniet e tij me prokurorine	Prononcim
218	16.08.2003	ALBANIA	Avokati i Popullit, ligj te ri per te denuarit	Artikull
219	18.08.2003	KOHA JONE	Hallexhinjte nuk njohin pushime	Artikull
220	19.08.2003	KORRIERI	Dobjani: Ndeshkime per shkelesit	Njoftim

221	19.08.2003	Gazeta SHQIPTARE	Dobjani: Shkelesit e ligjit jashte komisioneve zgjedhore	Njoftim
222	19.08.2003	REPUBLIKA	Dobjani, tani zgjidhje "ALSAT"	Prononcim
223	19.08.2003	REPUBLIKA	Celibashi dhe Dobjani arrijne marreveshjen per komisioneret	Njoftim
224	19.08.2003	KOHA JONE	Avokati i Popullit i sugjeron Celibashit propozimin parazgjedhor	Njoftim
225	19.08.2003	ALBANIA	Avokati i Popullit i rekomandon KQZ-se: Perjashtoni shkelesit e ligjit!	Njoftim
226	19.08.2003	Gazeta RD	Dobjani i kerkon Celibashit te lere jashte liste komisioneret e dyshuar per manipulime	Njoftim
227	19.08.2003	SOT	Avokati i Popullit i kerkon KQZ-se te verifikoje komisioneret	Njoftim
228	19.08.2003	TEMA	Dobjani: Shkelesit e ligjit, te mos numerojne vota	Prononcim
229	19.08.2003	ZERI I POPULLIT	Avokati i Popullit i rekomandon KQZ-se, hartimin e nje udhezimi te ri per zgjedhjet	Njoftim
230	20.08.2003	BALLKAN	Avokati i Popullit pret ankesat e njerezve	Njoftim
231	22.08.2003	BALLKAN	Motrat e "Nene Terezes" çlirohen njehere e pergjithmone nga akuza per humbjen e foshnjes (Investigimi i Avokatit te Popullit)	Prononcim
232	27.08.2003	REPUBLIKA	Avokati i Popullit: Listat e votimit, rikthehen te vdekurit!	Artikull
233	27.08.2003	KORRIERI	7000 te vdekur ne lista	Prononcim
234	27.08.2003	TEMA	Avokati i Popullit ka kerkuar qe zyrat e gjendes civile te çregjistrojne emrat e personave te vdekur	Prononcim
235	27.08.2003	BALLKAN	Avokati i Popullit: Gjendjet civile te nderhyjne ne listat e zgjedhesve	Intervistë
236	27.08.2003	SOT	Dobjani: Te çregjistrohen urgjentisht te vdekurit	Prononcim
237	27.08.2003	Gazeta SHQIPTARE	Avokati i Popullit: Vota e te vdekurve	Prononcim
238	27.08.2003	Gazeta SHQIPTARE	Dobjani: 4 mije te vdekur ne listat e zgjedhesve	Konferencë Shtypi
239	27.08.2003	ZERI I POPULLIT	E panevojshme dhe panikndjellese nje deklarate publike e Avokatit te Popullit, sipas te cilit, listat zgjedhore jane te mbushura me emra te vdekurish	Prononcim
240	27.08.2003	ZERI I POPULLIT	Ferdinand Pone: "Avokati i Popullit meqe ka marre persiper qe keto zgjedhje te mos administrohen nga hajdutet e votave duhet qe te hetoje per keto zyrtare"	Prononcim
241	27.08.2003	SHEKULLI	Avokati i Popullit denoncon parregullsine ne listat e zgjedhesve	Prononcim
242	27.08.2003	KOHA JONE	Avokati i Popullit pohon shkeljen e bere ne listat paraprake te votimit	Artikull
243	27.08.2003	Gazeta RD	Avokati i Popullit kerkon masa urgjente per permiresimin e regjistrimit elektoral	Njoftim

244	27.08.2003	GAZETA "55"	Mbi 8 mije shqiptare te vdekur figurojne ende ne listat e votimit, nderkohe qe ministri i pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Ben Blushi, perpiqet te fshehe nje skandal te tille	Artikull
245	03.09.2003	Gazeta ShQIPTARE	Avokati i Popullit: Bashkia me pak e denoncuar tek ne.	Artikull
246	07.09.2003	KOHA JONE	Nena e skafistit i drejtohet Avokatit te Popullit, Ermir Dobjani, "Me ndihmo te gjej djalin ne burgjet malazeze'	Artikull
247	gusht 2003	Tribuna Juridike (Nr.43)	Pergjegjshmeria e hetimit ne gjendje arresti te te pandehurit	Artikull Ymer Hasani
248	15.09.2003	ATSH	Avokati i Popullit pret ne zyren e tij Ambasadorin Robert Barry, Kryetar i Misionit te OSBE/ODIHR per vezhgimin e zgjedhjeve per organet e pushtetit lokal 2003	Njoftim
249	18.09.2003	ATSH	Institucioni i Avokatit te Popullit nis hetimin e ceshtjes se keqtrajtimet te tre emigranteve shqiptare ne Greqi	Prononcim Artur Lazebeu
250	18.09.2003	PANORAMA	Avokati i Popullit nis hetimet per emigrantet	Prononcim Artur Lazebeu
251	19.09.2003	SHEKULLI	Emigrantet, ceshtja gjykohet ne Greqi	Prononcim Artur Lazebeu
252	19.09.2003	KOHA JONE	"Vjeshtuket" ankohen tek Avokati i Popullit	Njoftim
253	19.09.2003	Gazeta "55"	Keqtrajtimi i tre emigranteve shqiptare ne Greqi, ka nxitur hetimin nga Avokati i Popullit.	Prononcim
254	19.09.2003	Gazeta "RD"	Avokati i Popullit, hetime per keqtrajtimin e emigranteve	Prononcim
255	19.09.2003	ZERI I POPULLIT	Avokati i Popullit nis hetimin e ceshtjes se keqtrajtimet te 3 emigranteve shqiptare ne Greqi	Artikull
256	19.09.2003	KORRIERI	Avokati i Popullit heton keqtrajtimin e tre emigranteve, proteston Ministria e Jashtme	Njoftim
257	19.09.2003	DITA	Dobjani heton dhunen ndaj emigranteve	Njoftim
258	19.09.2003	SOT	Hetim per rrahjen e emigranteve	Prononcim Artur Lazebeu
259	19.09.2003	ATSH	Avokati i Popullit konfirmon mosveprimin e policise shqiptare	Prononcim Artur Lazebeu
260	20.09.2003	ALBANIA	Hetimet e Avokatit te Popullit konfirmojne mosveprimin e policise shqiptare	Prononcim
261	21.09.2003	KORRIERI	Policia nuk zbaton udhezimet per emigrantet	Artikull
262	26.09.2003	ALBANIA	Avokati i Popullit, hetim tjetër per viktimat greke	Artikull
263	26.09.2003	ZERI I POPULLIT	Avokati i Popullit per te keqtrajtuarit nga policia greke	Artikull
264	26.09.2003	DITA	Dobjani fillon hetimin ne Devoll	Artikull

265	27.09.2003	Gazeta SHQIPTARE	Vrasja e e Bytyçit, Avokati i Popullit po ploteson dosjen per prokurorine greke	Prononcim Artur Lazebeu
266	27.09.2003	Gazeta RD	Avokati i Popullit njihet me ngjarjen dhe variantin grek te vrasjes se 18-vjeçarit	Artikull
267	27.09.2003	ALBANIA	Dobjani ne Kapshtice per vrasjen e shqiptarit	Prononcim
268	29.09.2003	ATSH	Presidenti Kroat Mesiç pret Dobjanin	Njoftim
269	30.09.2003	ZERI I POPULLIT	Avokati i Popullit takohet me homologun e tij kroat, Ante Klariç	Njoftim
270	Shtator 2003	Revista te drejtat e njeriut	Te drejtat e njeriut - gur themeli i demokracise	Interviste Ermir Dobjani
271	30.09.2003	Gazeta "55"	Dobjani, takim me Klariç	Njoftim
272	01.10.2003	ATSH	Libri per te burgosurit shqiptare jashte shtetit.	Njoftim
273	03.10.2003	ATSH	Konsumatori shqiptar i pambrojtur nga administrata shqiptare	Prononcim
274	07.10.2003	KOHA JONE	Avokati i Popullit kerkon ndihmen e Luan Rames dhe Spiro Peçit per te mbrojtur te vegjelit	Prononcim
275	07.10.2003	KORRIERI	Avokati i Popullit: Ministra, respektoni femijet	Prononcim
276	07.10.2003	DITA	Avokati i Popullit u kerkon dy ministrave respektimin e femijeve me prinder te divorcuar	Prononcim
277	07.10.2003	ATSH	Avokati i Popullit takohet me familjaret e viktimes se polivise greke.	Prononcim Ermir Dobjani
278	08.10.2003	BALLKAN	Dobjani pret familjaret e Vullnet Bytyçit	Prononcim Ermir Dobjani
279	08.10.2003	SOT	Avokati i Popullit takon te afermit e emigrantit te vrare	Njoftim
280	08.10.2003	KOHA JONE	Dobjani takon familjen Bytyçi	Njoftim
281	08.10.2003	Gazeta SHQIPTARE	Emigranti i vrare, Dobjani: Demshperblimi per familjaret	Prononcim Ermir Dobjani
282	08.10.2003	ALBANIA	Dobjani: "Ndeshkim per vrasesin e Bytyçit"	Prononcim Ermir Dobjani
283	08.10.2003	ZERI I POPULLIT	Avokati i Popullit takohet me familjaret e viktimes greke, Vullnet Bytyçi	Njoftim
284	08.10.2003	Gazeta "RD"	Avokati i Popullit kerkon pergjegjesine e autoriteteve greke	Prononcim Ermir Dobjani
285	08.10.2003	GAZETA "55"	Avokati i Popullit takon familjaret e Vullnet Bytyçit	Njoftim
286	08.10.2003	SHEKULLI	Avokati i Popullit: Çeshtja te ndiqet nga ambasadori shqiptar ne Greçi	Njoftim
287	15.10.2003	BALLKAN	Pas 8 vitesh burg, Shkelzen Kodra i kerkon Avokatit te Popullit gjetjen e vajzes qe e la 1 vjeç e gjysem	Prononcim Iljaz Çeço

288	21.10.2003	ATSH	Avokati i Popullit anetar i Keshillit Administrativ te Shoqates se Ombudsmaneve Frankofon	Njoftim
289	05.11.2003	Gazeta SHQIPTARE	Avokati i Popullit hetim trajtimit te Imeldes ne qeli	Njoftim
290	05.11.2003	ATSH	Avokati i Popullit per inspektim ne burgun e Burrelit - Pas ankesave te ndryshme te te burgosurve	Njoftim
291	05.11.2003	ATSH	Avokati i Popullit takim me te pandehuren Tasho - Nuk i eshte mohuar e drejta e mbrojtjes me avokat	Njoftim
292	05.11.2003	ALBANIA	Avokati i Popullit, asnje zgjidhje per jetimet	Njoftim
293	06.11.2003	ZERI I POPULLIT	Avokati i Popullit takim me te pandehuren Tasho	Njoftim
294	06.11.2003	ALBANIA	Avokati i Popullit rrefen takimin me te dashuren e Altin Arapit	Njoftim
295	06.11.2003	KOHA JONE	Avokati i Popullit, takim me te fejuaren e Arapit	Njoftim
296	06.11.2003	SOT	"Avokati i Popullit" takon Imelda Tashon	Njoftim
297	06.11.2003	SHEKULLI	Avokati i Popullit: Imelda Tasho trajtohet mire	Njoftim
298	06.11.2003	BALLKAN	"Avokati i Popullit, vizite ne qeli, Imeldes	Njoftim
299	07.11.2003	Gazeta SHQIPTARE	Avokati i Popullit: Dhune ne Burrel	Njoftim
300	07.11.2003	Gazeta SHQIPTARE	Avokati i Popullit merr ne dore ceshtjen e studenteve te perjashtuar	Njoftim
301	08.11.2003	REPUBLIKA	Skandal ne Burgun e Burrelit. Dobjani dorezon raportin	Njoftim
302	08.11.2003	SHEKULLI	Avokati i Popullit denoncon shefin e regjimit te burgut: Dhune dhe diskriminim krahinor	Njoftim
303	08.11.2003	KORRIERI	Avokati i Popullit "dyshon" per Imelden	Njoftim
304	04.12.2003	ATSH	Zyra per Mbrojtjen e Qytetareve, peticion Avokatit te Popullit kunder rritjes se tarifave te telefonise fikse	Njoftim
305	05.12.2003	ATSH	Avokati i Popullit nis hetimin ndaj Albtelekomit per tarifat e reja te telefonise fikse	Konferencë Shtypi
306	06.12.2003	ZERI I POPULLIT	Avokati i Popullit nis hetimin ndaj Albtelekomit per tarifat e reja te telefonise fikse	Njoftim
307	06.12.2003	ALBANIA	Me kerkesen e Zyres per Mbrojtjen e Qytetareve Avokati i Popullit nis hetimin ndaj Albtelekomit	Njoftim
308	06.12.2003	KOHA JONE	Dobjani: "Hetime Albtelekomit"	Artikull
309	06.12.2003	SHEKULLI	Avokati i Popullit: Albtelekom, nis hetimi per rritjen e tarifave telefonike	Artikull
310	08.12.2003	BALLKAN	Avokati i Popullit: Projekt-kontrata e Albtelekom ka mangesi thelbesore	Artikull
311	10.12.2003	SHEKULLI	Avokati i Popullit propozon: Grup akademik per oponente ndaj KESH	Artikull

312	10.12.2003	ATSH	Avokati i Popullit, Dobjani, takon akademikun Popa, për përmirësimin e shërbimeve publike	Njoftim
313	10.12.2003	DITA	Drejtori i KESH-it Harasani, konsultohet me Avokatin e Popullit	Artikull
314	10.12.2003	ALBANIA	Avokati i popullit: Rritet çmimi i energjise, por me transparencë	Artikull
315	10.12.2003	BALLKAN	Harasani, Dobjani dhe Spahiu diskutojnë për procedurat e ndjekura në rritjen e çmimit të energjisë elektrike	Artikull
316	10.12.2003	SHEKULLI	Avokati i Popullit: Respektim ligji dhe transparence	Njoftim
317	10.12.2003	KOHA JONE	Avokati i Popullit Dobjani kërkoi dje të merren masa për disa kategori që duhet të përjashtohen nga ky vendim	Artikull
318	10.12.2003	TEMA	Andis Harasani dhe Ermir Dobjani diskutojnë mbi rritjen e çmimit të energjisë	Artikull
319	10.12.2003	EKONOMIA	Rritja e çmimit të energjisë elektrike kërkon transparencë	Artikull
320	10.12.2003	SOT	Harasani, Dobjani dhe Spahiu për rritjen e çmimit të energjisë	Njoftim
321	11.12.2003	SHEKULLI	Avokati i Popullit - Akademia e Shkencave: Gati për oponencën ndaj KESH-it	Artikull
322	16.12.2003	REPUBLIKA	Avokati i Popullit, hetime urgjente	Njoftim
323	18.12.2003	ATSH	Konferencë kombetare e organizuar nga Avokati i Popullit dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit mbi "Ekzekutimin e vendimeve gjyqësore	Njoftim
324	18.12.2003	REPUBLIKA	Çmimet e larta te energjise tek Avokati i Popullit	Artikull
325	18.12.2003	KOHA JONE	Avokati i Popullit, proces hetimi per çmimet e reja te Telekomit dhe KESH-it, Ekspertët hetim tarifave	Njoftim
326	18.12.2003	ALBANIA	Ekspertë për rritjen e tarifave të KESH-it dhe Albtelekom-it	Njoftim
327	18.12.2003	KORRIERI	Ekspertë për hetimin e çmimeve në KESH e Albtelekom	Njoftim
328	18.12.2003	"55"	Dobjani: Ekspertë për rritjen e tarifave të KESH dhe Albtelekom	Njoftim
329	18.12.2003	DITA	Avokati/Dobjani takon Harasanin dhe Notin: "Do të ketë një proces të ekspertimit në institucionet tuaja	Njoftim
330	18.12.2003	Gazeta SHQIPTARE	Avokati i Popullit: Ekspertët hetojnë Albtelekom e KESH	Njoftim
331	18.12.2003	ZERI I POPULLIT	Avokati i Popullit ngre Grupet e ekspertëve për tarifatat e telekomit dhe të KESH-it	Njoftim
332	18.12.2003	R.D.	Avokati i Popullit: Ekspertët do të studiojnë tarifatat	Njoftim
333	18.12.2003	SHEKULLI	Avokati i Popullit: Hoda - Si do të monitorojmë KESH-in.	Artikull

334	19.12.2003	ATSH	Avokati i Popullit, vëren se individi është i zhgënjyer nga zyrat e Përmbartimit.	Njoftim
335	24.12.2003	ZERI I POPULLIT	Grupi oponent, jo çmimeve të reja të energjisë elektrike	Prononcim
336	24.12.2003	BALLKAN	Avokati i Popullit: Të llogaritet kosto e shërbimit nga KESH-i	Njoftim
337	24.12.2003	REPUBLIKA	Ermir Dobjani: "Duhet të mbrojt qytetarët"	Prononcim
338	24.12.2003	Gazeta SHQIPTARE	Grupi i ekspertëve të Avokatit të Popullit: Dakort, por të ulët çmimi tavan	Artikull
339	24.12.2003	SHEKULLI	Akademikët: 12 pikat e projektit që grupi i oponentëve i prezantoi Avokatit të Popullit	Artikull
340	24.12.2003	KOHA JONE	Avokati i Popullit, përballë drejtësisë me ankesën për padrejtësi	Artikull

Media Elektronike për vitin 2003

	ORGANI	DATA	RUBRIKA	PASQYRIMI
1	NEWS 24	01.01.2003	AP: Përfaqësoj interesat e banoreve	Interviste Ermir Dobjani
2	TVSH; TVA; Shijak TV; TNSH.	09.01.2003	AP: Ndalo dhunës nga policia	Prononcim
3	TV Gjeli	14.01.2003	AP në Ajsberg	Emision Jorgo Dhrami
4	Vizion +	15.01.2003	AP dhe kontratat me KESH dhe Ujesjellesin.	Emision Brizida Gjokondi
5	KTV	15.01.2003	AP, Prokuroria dhe Policia	Emision Sotiraq Nushi
6	Zeri i Amerikës	15.01.2003	AP në raportin e HR Watch	Njoftim
7	TVSH; Top Channel TNSH; Vizion+ TVA; KLAN ;	16.01.2003	AP dhe Prokuroria e Përgjithshme të rakordojnë veprimet.	Konferencë shtypi
8	Radio "Europa e Lire".	16.01.2003	AP mbi situatën e të drejtave të njeriut.	Interviste Ermir Dobjani
9	Zeri i Amerikës	16.01.2003	AP mbi Raportin e Human Rights Watch.	Interviste Ermir Dobjani

10	TVSH; TNSH; Top Channel; TVA; Vizion+; TV Klan	17.01.2003	AP takon Drejtorin e KESH-it. Qytetaret dhe KESH-Detyrime te ndersjellta.	Interviste Ermir Dobjani
11	TV KLAN	20.01.2003	AP dhe Prokuroria zbardhin dhunen mbi Tahirllarin.	Interviste Jorgo Dhrami
12	TV Alsat	23.01.2003	AP dhe Problemet me Policine.	Interviste Jorgo Dhrami
13	TVSH, TVA, TNSH	28.01.2003	AP takohet me Ombudsmanët e Ballkanit.	Njoftim
14	TV Alsat	30.01.2003	AP per respektimin e te drejtave te te miturve.	Interviste Jorgo Dhrami
15	TNSH	30.01.2003	AP ne forumin qytetar te Kavajes.	Njoftim
16	TVSH, TVA, News24, TNSH	31.01.2003	Ambasadori Amerikan mesazh falenderimi AP-se.	Njoftim
17	Radio Tirana	15.02.2003	Prezantimi i librit "Akte ligjore ne ndihme te burgosurve jashte Shqiperise".	Emission Ervin Karamuço
18	TVSH, TNSH, Real TV, TVA TV Koha, .	19.02.2003	Ambasadori Amerikan falenderon Avokatin e Popullit	Prononcim
19	TVSH, TNSH, TVA, Real TV	20.02.2003	Ambasadori Amerikan: Parandalohet konflikti popull-polici	Njoftim
20	TVSH, TV Koha, Radio Tirana	27.02.2003	Ambasadori Amerikan çmon kontributin e A.P.-së	Njoftim
21	TV Teuta	05.03.2003	Ambasadori Amerikan vlerëson bashkëpunimin me A.P-n.	Prononcim
22	NEWS 24	09.03.2003	Ambasadori Amerikan mesazh falenderimi AP-se.	Njoftim
23	Vizion +	11.03.2003	AP ndeshkon korrupsionin ne Polici	Prononcim
24	News 24	11.03.2003	AP denoncon dy police per korrupsion	Njoftim
25	Top Channel	14.03.2003	AP në "SHQIP"	Emission Ermir Dobjani
26	TV Shijak	17.03.2003	AP dhe Konventa Europiane e te Drejtave te Njeriut.	Njoftim
27	Vizion+Alsat	18.03.2003	Seminar i AP me KE per Konventën.	Njoftim
28	Top Channel, TNSH, TV Shijak, Vizion+	19.03.2003	AP pret Ambasadorin Amerikan.	Njoftim
29	TNSH	19.03.2003	AP permireson kontratat me KESH.	Prononcim Brizida Gjickondi
30	TV Klan, News 24, TNSH	20.03.2003	Familjaret e Tahirllarit shprehin besimin tek AP.	Prononcim
31	TV KOHA	21.03.2003	Perse rierdhen Tahirllaret tek AP ?	Interviste Jorgo Dhrami

32	Vizion+	21.03.2003	Policeve t'u jepen oret shtese.	Prononcim Sotiraq Nushi
33	TV KLAN	21.03.2003	Do te ndihmojme familjaret e Tahirllarit.	Prononcim Jorgo Dhrami
34	TV Publik Gjerman ARD	31.03.2003	Ombudsmani shqiptar ben rekomandim per Gjakmarrjen.	Emision Ermir Dobjani
35	TV Shijak	01.04.2003	AP eshte i gatshem te prese ankesa nga policet.	Prononcim Sotiraq Nushi
36	Radio ALSAT	02.04.2003	Avokati i Popullit komenton Raportin e Departamentit te Shtetit.	Interviste Ermir Dobjani
37	BBC	13.04.2003	Ombudsmani shqiptar takime zyrtare ne Moske.	Njoftim
38	Radio Gollos Rosii	13.04.2003	Ombudsmani shqiptar takime zyrtare ne Moske.	Njoftim
39	TV Mir	13.04.2003	Ombudsmani shqiptar takime zyrtare ne Moske.	Prononcim
40	Eho TV	13.04.2003	Ombudsmani shqiptar takime zyrtare ne Moske.	Konference shtypi
41	Top Channel	17.04.2003	Avokati i Popullit Te rregullohen regjistrat e Gjendjes Civile.	Prononcim Brizida Gjickondi
42	Gjeli Vizion	19.04.2003	Avokati i Popullit dhe Ligji per te Drejten e Informimit per Dokumentat Zyrtare	Emision. Artur Lazebeu
43	TVSH; TNSH; Real TV; Alba TV	23.04.2003	Presidenti Moisiu Dekoron Avokatin e Popullit me medaljen e artë "Naim Frashëri".	Njoftim
44	TVSH; TNSH	24.04.2003	Avokati i Popullit pret Ombudsmanin e Maqedonise	Njoftim
45	ALSAT	27.04.2003	Te ndihmojme njeri-tjetrin institucionalisht si Ombudsmene	Interviste E.Dobjani, B.Naumovski
46	Radio Europa e Lire	27.04.2003	Pengesa me e madhe ka qene nga prokuroria shqiptare	Interviste Ermir Dobjani
47	TNSH; TV-Teuta	29.04.2003	Presidenti Moisiu dekoron perfaqesuesin e DANIDA me propozim te Avokatit te Popullit	Njoftim
48	ALSAT	10.05.2003	Vleresimi i Avokatit te Popullit per te Drejtat e Njeriut ne vend.	Njoftim
49	ALSAT	12.05.2003	Avokati i Popullit per Emigrantet	Njoftim
50	TVSH; TVA; Real TV; TNSH	27.05.2003	Avokati i Popullit takohet me nje perfaqesi te shoqatave te ish te perndjekurve politike	Njoftim
51	Top Channel; TNSH; TVSH; News 24	28.05.2003	Kryeministri kerkon ndermjetesimin e Avokatit te Popullit per te perndjekurit politike	Prononcim
52	Top Channel; TVA; TNSH; TVSH	29.05.2003	Avokati i Popullit - Perfaqesuesi i Qeverise dhe te Perndjekurit Politik fillojne bisedimet	Njoftim
53	Vizion +	01.06.2003	Problematika e Avokatit te Popullit ne muajt e pare te vitit 2003	Interviste

54	TVSH, Vizion +	02.06.2003	Avokati Popullit vazhdon negociatat me ish te perndjekurit politike	Njoftim
55	TVSH, TNSH, Vizion +	03.06.2003	Avokati i Popullit i percjell Kryeministrit kerkesat e ish te perndjekurve politike	Njoftim
56	NEWS 24	03.06.2003	Avokati i Popullit: Unifikohen kerkesat e te perndjekurve	Interviste Artur Lazebeu
57	NEWS 24, TVSH	03.06.2003	Avokati i Popullit: Jo pakt, por kerkesa te unifikuara Qeverise	Interviste Ermir Dobjani
58	TVSH	12.06.2003	Avokati i Popullit: Ministri i Shetit, diskuton me perfaqesues te shoqatave te ish te perndjekurve politike	Njoftim
59	TVA	12.06.2003	Avokati i Popullit: Ministri i Shetit, diskuton me perfaqesues te shoqatave te ish te perndjekurve politike	Njoftim
60	TV.KLAN	12.06.2003	Avokati i Popullit: Ministri i Shetit, diskuton me perfaqesues te shoqatave te ish te perndjekurve politike	Njoftim
61	TV.KOHA	24.06.2003	Avokati i Popullit per regjistrat e Gjendjes Civile	Prononcim Brizida Gjickondi
62	Top Chanel	24.06.2003	Avokati i Popullit: Te ndaluarve te mos u ekspozohet fytyra	Prononcim Alket Jaupi
63	TV Shijak	25.06.2003	Avokati i Popullit per mbajtjen e te semureve mendore ne vendet e duhura	Prononcim Harallmb Bano
64	TVA	10.07.2003	Ndryshimet e ligjit per te burgosurit akses me shume per Avokatin e Popullit	Interviste Harallamb Bano
65	Top Chanel	17.07.2003	Avokati i Popullit ne mbrojtje te te drejtave te femijeve	Interviste Brizida Gjickondi
66	Zeri i Amerikes	18.07.2003	Avokati i Popullit mbi luften kunder korrupsionit	Interviste Ermir Dobjani
67	TV Klan	28.07.2003	Avokati i Popullit: Per keqtrajtimet nga policia	Interviste Jorgo Dhrami
68	ALSAT	18.08.2003	Askush mbi vendimin e Gjykates	Prononcim Ermir Dobjani
69	ALSAT	18.08.2003	KESH - Kontrata te reja me qytetaret	Prononcim Ermir Dobjani
70	TNSH, TVA, ALSAT, TV.Shijak	18.08.2003	Shkelesit e ligjit jashte komisioneve zgjedhore	Njoftim
71	TVSH	18.08.2003	Avokati i Popullit i gatshem per mirefunksionimin e procesit zgjedhor	Interviste Ermir Dobjani
72	Radio Tirana	19.08.2003	Avokati i Popullit per komisionet zgjedhore	Interviste Ermir Dobjani
73	BBC	19.08.2003	Avokati i Popullit: Shkelesit e ligjit, jashte komisioneve zgjedhore	Interviste Ermir Dobjani

74	TVSH, KLAN, Top Chanel, News 24, TV. Koha, TV. Teuta etj.	26.08.2003	Avokati i Popullit kerkon çregjistrimin e te vdekurve nga listat zgjedhore.	Prononcim Ermir Dobjani
75	TVSH, Top Chanel, News 24,	15.09.2003	Avokati i Popullit me Ambasadorin Robert Barry, Kryetar i Misionit të OSBE/ODIHR për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e pushtetit lokal 2003 në vendin tonë	Njoftim
76	Top Chanel, News 24	17.09.2003	Avokati i Popullit hetime per keqtrajtimin nga policia greke te emigranteve	Prononcim Ermir Dobjani
77	TV.Koha	18.09.2003	Dosjet do ti percillen homologut Grek	Prononcim Artur Lazebeu
78	Real TV, Top Chanel	19.09.2003	Avokati i Popullit konfirmon mosveprimin e policise shqiptare	Prononcim Artur Lazebeu
79	Vizion +	24.09.2003	Avokati i Popullit: Si te ankohen emigrantet e keqtrajtuar	Interviste Artur Lazebeu
80	TV.KLAN	29.09.2003	Avokati i Popullit takohet me homologun e tij Kroat.	Njoftim
81	TVSH, TNSH, TV.Klan, Top Chanel	01.10.2003	Libri per te burgosurit shqiptare jashte shtetit	Njoftim
82	TVSH, TNSH, Tv.Klan, TVA, Top Chanel, News 24	07.10.2003	Avokati i Popullit pret familjaret e Bytyçit, vrarë nga policia greke	Prononcim Ermir Dobjani
83	Tv. Alsat	21.10.2003	Shteti, Avokati i Popullit, Shoqeria civile komplementare ne mbrojtjen e te drejtave te emigranteve	Interviste Artur Lazebeu
84	Tv.Klan	31.10.2003	Çeshtja per shtepine e Femijes "Zyber Hallulli"	Prononcim Anila Nepravishta
85	Radio +2	19.11.2003	Avokati i Popullit ballafaqim me instancat nderkombetare kunder keqtrajtimin te shqiptareve	Interviste Artur Lazebeu
86	Top Chanel	21.11.2003	Avokati i Popullit per te denuarit pa perkthyes nga gjykata greke	Emisioni SHQIP
87	Top Chanel	26.11.2003	Avokati i Popullit i drejtohet nderkombetareve per çeshtjen e te denuarve shqiptare ne Greqi	Interviste Ermir Dobjani
88	TVSH, TVA, Top Chanel, Tv.Klan, TNSH, Radio Zeri Amerikes	05.12.2003	Avokati i Popullit nis hetimin per tarifat e Albtelekomit	Konferencë shtypi Ermir Dobjani
89	TV 1	08.12.2003	Avokati i Popullit kerkon shpjegime per tarifat e Albtelekomit	Prononcim Artur Lazebeu
90	TVSH, TVA, Top Chanel, Tv.Klan, TNSH, Vizion +, News 24	09.12.2003	Avokati i Popullit dhe CAO per tarifat me KESH-in	Konferencë Shtypi

91	TV. Koha	09.12.2003	Avokati i Popullit per KESH, Albtelekom dhe pensionet	Interviste Ermir Dobjani
92	TVA	10.12.2003	Mesazh i Avokatit te Popullit per Diten Nderkombetare te te Drejtave te Njeriut	Prononcim Ermir Dobjani
93	TVA, Alsat, Top Chanel, TNSH, News 24 etj	10.12.2003	Avokati i Popullit kërkon oponencën e Akademisë së Shkencave për shërbimet publike	Njoftim
94	TVSH, TVA, Top Chanel, Tv.Klan, TNSH, Vizion +,	17.12.2003	Dobjani, Harasani dhe Noti takohen me ekspertë për rritjen e tarifave të KESH dhe Albtelekom.	Njoftim
95	TVA, Alsat, Vizion +, TNSH, Real Tv, Tv.Teuta	19.12.2003	Avokati i Popullit - Shërbimi Përmbartimor. Konferencë Kombëtare	Njoftim
96	Vizion +	24.12.2003	Avokati i Popullit gjatë vitit 2003	Emision Artur Lazebeu
97	TVSH, Klan, Top Chanel, Vizion +, Alsat etj	24.12.2003	Avokati i Popullit i paraqet ERE-s rekomandimet e ekspertëve për KESH-in.	Njoftim

STATISTIKE PERMBLEDHESE E MBULIMIT MEDIATIK 2003

MEDIA E SHKRUAR

Njoftime	Prononcime	Intervista	Artikuj	Konferencë shtypi	Gjithsej
162	68	6	101	3	340


MEDIA ELEKTRONIKE

Njoftime	Prononcime	Intervista	Emisione	Konferenca shtypi	Gjithsej
33	25	26	9	4	97


Shënim

Problematika e ndërhyrjeve të Avokatit të Popullit duket edhe nga titujt që është gjykuar të paraqiten në Statistikë. Sidoqoftë veprimtaria e Avokatit të Popullit është edhe me shumëpërfshirëse, pasi ka mjaft çështje të zgjidhura që Avokati i Popullit e ka gjykuar të mos u japë publicitet. Për këtë shihni statistikat sipas seksioneve.


Ankesat e trajtuara gjate vitit 2003
Totali 2767




**Mënyra e zgjidhjes së ankesave dhe kërkesave të përfunduara gjatë vitit 2003,
pavarësisht nëse kanë qenë brenda ose jashtë juridiksionit
Totali 2254**




**Mënyra e zgjidhjes së ankesave dhe kërkesave që kanë qenë brenda
juridiksionit gjatë vitit 2003
Totali 1410**




Gjendja e ankesave në fund të vitit 2003
Totali 2767



**Ankesa dhe kërkesa të paraqitura verbalisht pranë
Zyrës së Pritjes së Popullit gjate vitit 2003
Totali 2160**




Ankesa, kërkesa dhe njoftime të trajtuara nga zyra e AP gjatë vitit 2003
Totali 4400



Ankesa të trajtuara gjatë vitit 2003 (2000 të vitit 2003 dhe 767 të mbartura nga viti 2002)


Ankesa të paraqitura në zyrën e pritjes së popullit, gjatë vitit 2003, të cilave ju është dhënë përgjigje menjëherë

**Krahasimi i ankesave të ardhura për vitet 2000, 2001, 2002 dhe 2003,
(përfshirë edhe ato që ju është dhënë përgjigje menjëherë)
Totali 11509**




Shpërndarja e ankesave sipas degëve të qeverisjes per vitin 2003


Gjithsej 2767 ankesa



Shperndarja e ankesave te vitit 2003 sipas rretheve
Totali 3633



MEDIA E SHKRUAR PER VITIN 2003



MEDIA ELEKTRONIKE PER VITIN 2003

